

+

LIDERSHIPI SHQIPTAR – SHQIPËRIA POLITIKE: 1912 – 1989

Emri Mbiemri i doktorantit:

Fejzi LILA

Dorëzuar

Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca Sociale, me profil Shkenca Politike, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Lisen BASHKURTI

Vendi, muaji viti i dorëzimit

Universiteti European i Tiranës

Tiranë: Shtator 2017

Tema: nr. fjalëve 66.000

DEKLARATA E AUTORËSISË

Unë i quajhuri Fejzi Hamit LILA rregjistruar në fakultetin Shkenca Sociale, profili Shkenca Politike, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”, në Universitetin Europian të Tiranës (UET) deklaroj se; punimi me titull: **Lidershipi shqiptar – SHQIPËRIA POLITIKE: 1912 – 1989**, është punë origjinale e imja.

Në material nuk përfshihen përdorimi i ideve, i të dhënave ose i gjuhës së një subjekti tjetër pa njohjen dhe referencën specifike. Shembull: kopjimi i punimit të dikujt, i artikujve dhe i prezantimeve në formë elektronike si dhe paraqitja e tyre si punë origjinale për t’u vlerësuar ose për t’iu prezantuar një audience, klonimi i idesë së dikujt tjetër pa ia atribuar autorësinë, mosvënia e referencave/citimeve të qarta në çfarëdo lloj publikimi të shtypur/printuar.

Kjo deklaratë vërteton origjinalitetin e punimit dhe vendoset në dispozicion të shkollës doktorale për procedura të mëtejshme.

ABSTRAKTI

Tema e Projektit Doktorat: Lidershipi shqiptar – SHQIPËRIA POLITIKE: 1912 – 1989, është tezë që hulumton mbi lidershipin politik. Është një studim historik, teorik dhe praktik i lidershipit, mbi politikën ndikuese të individit, komunitetit, kombit dhe politikës ndërkombëtare.

Historia e shqipëtarëve ka formuar një traditë të lidershipit të vet. Kjo traditë në periudha të caktuara ka pasur më shumë ndikim nga jashtë – brenda, sikundër në periudha të tjera nga brenda – jashtë. Teza themelore synon të paraqesë variablat, ndërthurjen dhe ndikimin e faktorëve të jashtëm e të brendshëm në profilet e lidershipit shqiptar.

Studimi bazohet në analizën historike, bazën teorike, format dhe stilet si dhe në praktikën e lidershipit. Studimi shtrihet nga Epoka e Rilindjes, të shek. XIX-të deri me shembjen e komunizmit në Shqipëri. Studimi analizon profilet kryesore të liderëve shqiptar që dominuan Shqipërinë politike 1912 – 1989. Studimi bazohet në historiografi dhe faktologji shqiptare, rajonale e ndërkombëtare, në teoritë e modelet lidershipit të kohës duke profilizuar liderët shqiptarë të kësaj periudhe.

Studimi synon arritjen e ndriçimit të vlerave të lidershipit shqiptar; të analizojë problematikat që i kanë shoqëruar këto profile dhe të bëjë analizë krahasuese me liderat rajonalë.

Punimi bazohet në analizë arkivore të periudhës 1912-2014, analizës krahasuese me liderët rajonalë dhe bazën teorike mbi lidershipin e kohës.

Tema ka një karakter të theksuar historik, por duke u bazuar në arkivat nacionale, rajonale, europiane, ruse, amerikane, doktrinën dhe botime të autorëve e aktorëve të kohës.

Tema bazohet dhe mbi historinë në Marrëdhëniet Ndërkombëtare, ndikimin e kulturës politike, medias, vlerat e demokracive perëndimore dhe fenomenet simetrike e asimetrike të vendeve në proces integrimi. Studimi merr në konsideratë edhe literaturë teorike e autorë të ndryshëm bashkohorë, studime mbi rajonin e Ballkanit, burime sekondare e linke (websites).

Punimi synon të hedhë dritë mbi traditat e lidershipit shqiptar. Punimi konkludon se profilet e lidershipit politik shqiptar janë produkt i ndikimeve dhe evoluimi i identitetit shqiptar, i kulturës e mentalitetit dhe rrethanave gjeopolitike. Këto profile me avantazhet dhe disavantazhet e veta kanë mundur ekzistencën, mbijetesën, zhvillimin deri në konsolidim në kohën moderne.

Profilet e lidershipit shqiptar – SHQIPËRIA POLITIKE: 1912 – 1989, analizohen në kontekst historiko-teorik si lidership për pavarësi, lidership përballë nacionalizmit dhe doktrinave, lidership në përpjekje në luftat e proceset asimetrike, në nismat individuale e rajonale, në fqinjësi e aleancë strategjike.

ABSTRACT

Doctoral Project topics: Leadership - Albania POLITICS: 1912 - 1989, it is the thesis that explores the political leadership. It is a landmark study, theoretical and practical leadership, policy influencing the individual, community, national and international policy. Albanians history has formed a tradition of its own leadership. This tradition in certain periods there was more influenced from outside - inside, as in other periods from the inside - out. The basic thesis aims to present the variables of external internal and external factors trying to identifying profiles the Albanian leadership.

The study is based on historical analysis, theoretical basis, forms and styles as well as in the practice of leadership. The study extends from the Renaissance era, century. XIX-up with the collapse of communism in Albania. The study analyzes the main profiles of Albanian leaders who dominated political Albania 1912 – 1989.

The study is based on the Albanian history, facts and reaches to the individual features of each Albanian Leaders during that period of the time.

The study aims to achieve the lighting values of Albanian leadership; analyze problems that have accompanied these profiles and make a comparative analysis with regional leaders. The paper is based on the period 1912-2014 archival analysis, comparative analysis with regional leaders on leadership and theoretical basis of time.






The theme has a pronounced historical character, but based on national archives, regional, European, Russian, American, doctrines and publications authors of actors of the time.






The theme is based in context of International Relations, the impact of political culture, the media, the values of Western democracies and symmetric and asymmetric phenomena of countries in the integration process. The study takes into account the theoretical literature of various contemporary authors, studies on the Balkans, the links to secondary sources (websites).

The paper aims to through light on the traditions of the Albanian leadership. The paper concludes that the Albanian political leadership profiles are the product of influences and the evolution of Albanian identity, culture and mentality and geopolitical circumstances. These profiles with the advantages and disadvantages have enabled the existence, survival, development by the consolidation in the modern era.

Profiles of leadership - Albania POLITICS: 1912 - 1989 are analyzed in the context of historical and theoretical as leadership, independence, leadership to nationalism and doctrines, leadership efforts in the wars of processes asymmetric initiatives lying on individual regional, neighborhood and strategic alliance.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

| | |
|---|----|
| Hyrje: | 7 |
|  Kap I-rë. Metodologjia e punimit dhe bazat teorike të lidërshiptit. | 8 |
| 1.1. Metodologjia e punimit, pyetja kërkimore, objektivat, modeli teorik dhe literatura, hipotezat kërkimore dhe kufizimet metodologjike të temës. | 8 |
| 1.2. Bazat teorike të lidërshiptit. | 9 |
| 1.2.1. Përkufizimi i lidërshiptit. | 10 |
| 1.2.2. Teoritë e lidërshiptit. | 11 |
|  Kap. II. Rilindja Kombëtare Shqiptare. | 15 |
| 2.1. Ngritja e nacionalizmave në Ballkan. Megali-Idea. Naçetania. | 15 |
| 2.2. Rilindja Kombëtare Shqiptare dhe Lidhja shqiptare e Prizrenit. | 17 |
|  Kap. III. Profili i Ismail Qemalit dhe kontributi i tij në shtetin e parë modern shqiptar. | 19 |
| 3.1. Ismail Qemali dhe fqinjët rreth shqiptarëve. | 20 |
| 3.2. Sfidat diplomatike të shqiptarëve në fund të shek. XIX-të dhe fillim të shek.XX-të. | 21 |
| 3.3. Ismail Qemali – lider drejt të ardhmes së Shqipërisë së pavarur. | 22 |
| 3.4. Ndikimi i Monarkisë Austro–Hungareze mbi evoluimin e Ismail Qemalit nga autonomia drejt pavarësisë. Dilemat e tij nga autonomia drejt pavarësisë. | 25 |
| 3.5. Konkluzione. | 36 |
|  Kap. IV. Fan Noli misionari shqiptar në SHBA dhe në Lidhjen e Kombeve. Fan Noli klerik, alternativë, opozitë, qeveri dhe dështim. | 36 |
| 4.1. Ngritja e shtetit shqiptar, 1919-1923. Dalja e figurave si Noli dhe Zogu. Noli misionari shqiptar në SHBA dhe në Lidhjen e Kombeve. | 36 |
| 4.2. Alternativat politike shqiptare. Fan Noli – themelues i Kishës Ortodokse Shqiptare dhe i alternativës së parë liberale e demokratike shqiptare. | 39 |
| 4.3. Shqipëria dhe shqiptarët (1923-1925). Noli si opozitë. | 42 |
| 4.4. Noli si qeverisje. | 44 |
| 4.5. Dështimi i Nolit. | 52 |
| 4.6. Konkluzione. | 54 |
|  Kap V-të. Alternativa e A Zogut – rruga drejt suksesit. | 55 |
| 5.1. Rrymat e kohës dhe ndikimi i tyre! Legaliteti – alternative politike dhe konstituive. | 55 |
| 5.2. Ardhja e Zogut nga Jugosllavia. Rruga drejt pushtetit. | 62 |
| 5.3. Kryeministri, Presidenti – tranzicioni drejt Monarkisë. | 65 |

| | |
|---|-----|
| 5.4. Zogu I-rë – Mbreti i shqiptarëve. Dritëhijet e tij, 1929-1939. | 80 |
| 5.5. Konkluzione. | 90 |
|  KapVI. Shqipëria në Luftën e II-të Botërore. PKSHE dhe Enver Hoxha. | 93 |
| 6.1. PKSHE – Ndikimi jugosllav dhe i Komiternit. Fronti antifashist dhe ushtria NÇL Shqiptare. | 93 |
| 6.2. PKSHE – rruga drejt pushtetit. Konferenca e Pezës, Mukja, Konferenca e Labinotit dhe Kongresi i Përmetit. | 94 |
| 6.3. Zgjedhjet e para të vitit 1945. Shpallja e Republikës 1946. Komunistët në pushtet. Problemet me SHBA dhe Britaninë e Madhe. | 97 |
| 6.4. Shqipëria në Kampin Lindor – vasale e Jugosllavisë Komuniste. | 99 |
|  Kap.VII-të. Enver Hoxha nga vasal i Jugosllavisë në satelit të BRSS (1948-1961). | 102 |
| 7.1. Plani Marshall dhe Traktati i Varshavës.Sovjetizimi i Shqipërisë. Nga Stalini tek Hrushovi. | 102 |
| 7.2. Kongresi i 20-të i PK të BRSS – ndarja nga nga Hrushovi. | 105 |
| 7.3. Konflikti shqiptaro – sovjetik. Lufta për pushtet. | 108 |
| 7.4. Konflikti ideologjik, politik dhe ushtarak. Dalja nga traktati i Varshavës, 1968. | 111 |
|  Kap. VIII-të. Aleancat fluide shqiptaro-kineze, 1968-1978. Konteksti i zhvillimeve globale në periudhën e detantes. | 118 |
| 8.1. Shqipëria sponsorizuese e Kinës komuniste. Pragmatizmi dhe subjektivizmi ndërkombëtar i Kinës. | 122 |
| 8.2. Lëvizjet e Kinës drejt Jugosllavisë dhe Rumanisë. Rënia e interesit për Shqipërinë. | 123 |
| 8.3. Konfliktet shqiptaro – kineze, shkaqet dhe pasojat. | 124 |
| 8.3.1. Rënia ekonomike e Shqipërisë dhe ashpërsimi i luftës së klasave. | 127 |
| 8.3.2. Vetëizolimi i plotë i vendit. | 129 |
| 8.4.Konkluzione. | 130 |
|  Konkluzione të përgjithshme. | 133 |
|  Bibliografia. | 144 |
| Literatura. | 144 |
| Leksione & Studime. | 150 |
| Gazeta & Raporte & Dokument. | 151 |
| Linke (websites). | 153 |

Tema: Lidershipi Shqiptar – Shqipëria Politike: 1912 – 1989

Hyrje: Studimet mbi lidershipin politik shqiptar përmbajnë dilema të ndryshme. Këto dilema burojnë nga vështirësitë, momente e mjaft procese që e shoqërojnë këtë subjekt. Vështirësia ka rrënjë historike, ndërsa proceset shoqëruese kanë rritur e provuar liderët. Literatura e shkruar botërore mbi “Lidershipin” ka tërhequr vëmendjen e shkrimtarëve, shkencëtarëve, studiuesve, gazetarëve, njerëzve të thjeshtë ndofta më shumë se çdo subjekt tjetër në historinë e njerëzimit. Janë shumë të rrallë ato shkrimtarë, shkencëtarë, studiues, gazetarë e njerëz të thjeshtë që nuk janë marrë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi me lidershipin e pushtetin.

Studimet mbi lidershipet kanë shpalosur formate të ndryshme liderash. Shoqëria në përgjithësi evidenton lidera në fusha të ndryshme si lidera fetarë, ushtarakë, ekzekutiv, ekonomistë, diplomat, akademik. Qëllimi i këtij studimi është të tregoj si ndikon roli i liderit dhe lidershipit në zhvillimin e vendit. Ndikimi në lidership i fenomeneve, proceseve të ndryshme, nga faktorë objektiv e subjektiv, të brendshëm e të jashtëm, nga ambicjet e një kombi për bashkjetesë apo vasalitet deri në asimilim. Kapërcimi në lidership cilësor parakupton një transformim shumë të thellë dhe kompleks në botëkuptim, metodologji e ndjekur dhe etikë të demonstruar.

Transformimi kualitativ në lidership kërkon sigurim idesh të reja, metoda të reja dhe një etikë krejtësisht të re politike. Lidershipi shqiptar ndodhet midis sfidave të së shkuarës dhe të së ardhmes, midis mbylljes dhe hapjes, midis mentalitetit autokrat, oriental, lindor dhe modelit transparent, bashkëpunues, gjithëpërfshirës të demonstruar përgjithësisht nga lidershipi perëndimor. Diakronia që shoqëron kombin shqiptar në krahasim me kombet e tjerë të rajonit të Ballkanit dhe Europës vendos sfidë serioze përpara këtij lidershipi. Kjo sfidë kërkon lidership me memorje, kualitet sasiorë e cilësorë, me kointunitet permanent, me demonstrim vlerash dhe prioritet interesash, me objektiva afatmesme dhe afatgjatë në një trajektore të mirëpërcaktuar.

Kjo eksperiencë e aplikuar nga lider e lidership në etapa të ndryshme e alternuar edhe me gjithë eksperiencat, sistemet, teoritë e shkollave të ndryshme politike në mbarë globin do të shërbejë si bazë për krijimin e gjeneratave të dala nga shkolla politike shqiptare. Kjo është sfida më e madhe e cila kërkon kapërcim dhe ballafaqim serioz me partner e kundërshtar të interesave të kombit shqiptar në këtë trend të ri të epokës së globalizmit. *“Populli dhe kombi shqiptar kur nuk kanë pasur politikanë të mëdhenj kanë nxjerrë heronj popullor të përbotshëm, kur nuk kanë pasur ushtarakë të mëdhenj kanë nxjerrë shkrimtarë të shquar, kur nuk kanë pasur shkencëtar të mëdhenj kanë nxjerrë bamirës të shenjtë, kur nuk kanë pasur shtetar të zotë kanë nxjerrë papë dhe perandorë, kur nuk kanë pasur shtetin e vet, kanë krijuar shtete të tjera, kur nuk kanë pasur liri në vendin e vet kanë shkëlqyer në vende të tjera”¹.*

¹ L Bashkurti, National and European Identity of Albanian, ADSh, GEER, Tiranë, 2006, ISBN:99943-854-7-X, pp 174-175

Kapitulli I: Metodologjia e punimit dhe bazat teorike të lidërshiptit.

1.1. Metodologjia e punimit, pyetja kërkimore, objektivat, modeli teorik, literatura, hipotezat kërkimore dhe kufizimet metodologjike të temës doktorale.

Tema e projektit doktorale me titull: Lidërshipti Shqiptar – Shqipëria Politike: 1912–1989 hulumton mbi një tezë me peshë dhe rëndësi themelore për historinë politike të popullit shqiptar në shek. XX. Për vetë specifikën e temës, studimi ka karakter historik, teorik dhe praktik të lidërshiptit, analizon bazat historike, modelet teorike më ndikuese, faktorët me impaktin më të madh mbi individin, komunitetin, kombin dhe politikën rajonale e ndërkombëtare.

Metodologjia e punimit diktohet nga vetë përmbajtja e temës, teza themelore dhe pyetjet kërkimore shkencore sikundër dhe nga objektivat që synon të realizojë studimi. Karakteri multidisiplinor dhe historiko – teorik i projektit doktorale dikton aplikimin e një metodologjie komplekse e të alternuar; analiza cilësore & metoda induktive, metodën analitike krahasuese dhe kalimin në metodën sintetizuese (deduktive) për të provuar hipotezën dhe pyetjen kërkimore. Studimi dominohet nga qasja ontologjike dhe përdor elementë të kësaj qasje si; objektivizmin, konstruktivizmin dhe realizmin.

Karakterit historiko – teorik i temës dikton përdorimin e metodologjinë së mbështetur tek të dhënat cilësore (metodën induktive). Me metodën induktive realizojmë mbledhje të dhënash, aktesh, faktesh, burime mediatike, autoriale të ndryshëm të brendshëm e të jashtëm bazuar në dokumentat arkivore të periudhës 1912–1989, të cilët janë grumbulluar, sistemuar, analizuar sipas periudhave e liderë të caktuar.

Shtrirja kohore e temës së projektit doktorale realizohet në periudha, sisteme, rende të ndryshme ndërkombëtarë, gjë që na obligon përdorimin e gërshetimit edhe me metodën analitike krahasuese. Metoda analitike krahasuese është bazuar në studime teorike, autoriale dhe mediatike sipas periudhave, sistemeve e rendeve të ndryshme, duke selektuar paralelet, pikat e përbashkëta, ngjashmëritë dhe kundërshtitë nga një periudhë e lider politik në një tjetër.

Synimi për të arritur në konkluzione përgjithësuese dhe rrisitë e studimit, bazuar mbi metodat e përdorura (induktive dhe analitike krahasuese) ka bërë domosdoshmëri aplikimin e metodës deduktive nëpërmjet të cilës arrijmë në përqasjen e teorive me analizën e situatave reale e praktike.

Në tërësinë e tyre kompleksja e metodave induktive, krahasimore dhe deduktive janë aplikuar duke ruajtur kohezionin multidisiplinor të tezës kërkimore shkencore.

Pyetja kërkimore lidhet me historinë dhe formimin e traditave të lidërshiptit shqiptar. Kjo traditë në periudha të caktuara ka pasur më shumë ndikim nga jashtë – brenda, sikundër në periudha të tjera ka pasur ndikim nga brenda – jashtë. Teza themelore synon të paraqesë variablat e ndikimit të faktorëve të ndryshëm të brendshëm e të jashtëm në profilizimin e tipareve dominuese të lidërshiptit politik shqiptar përgjatë shekullit XX-të.

Objektivat e studimit: Duke u bazuar në analizën teorike të fushës së studimit, të situatës reale dhe të trajtimit praktik i saj kemi synuar të arrijmë në konkluzione përgjithësuese. Përpilimi i objektivave është nisur nga vlefshmëria, besueshmëria, objektiviteti dhe përgjithësimi i gjetjeve ose risive. Mbi këto baza kemi përcaktuar objektivat e mëposhme:

- a. Analiza e gjërë dhe e thellë historiko – teorike e situatës reale dhe i praktikave.
- b. Evidentimi i problematikave karakterizuese, duke parë dhe ndriçuar lidhjet shkak-pasojë.
- c. Ndriçimi i të gjitha variablave që burojnë nga natyra e shkencave sociale.
- d. Arritja në vlerësime përgjithësuese, reflektimi në mënyrë deduktive nga teoritë themelore e rezultatet e analizës praktike, evidentimi i origjinalitetit dhe risitë e liderëve shqiptarë.

Objektivat e mësipërme janë të matëshme, të arritshme, realiste dhe brenda kuadrit kohor të studimit.

Modeli teorik dhe literatura ku bazohet studimi është kushtëzuar nga karakteri historik dhe teorik i tij. Shqyrtimi i modeleve teorike ndërkombëtare, stilet e lidërshiptit dhe të krahasuara me profilet e stilet e aplikuara nga liderët shqiptarë, kemi arritur në konkluzionin se modelet teorike më dominuese të lidërshiptit politik shqiptar janë; qasja tipar, qasja e modelit të aftësive, teoria e stileve të sjelljes të alternuara me lidërshiptin situacional. Kjo ndërthurje qasjesh na jep një tip lidërshipti të përzierë midis tradicionalizmit lokal dhe konjunkturalizmit ndërkombëtar.

Sa i takon literatures dimensionin historik është bazuar kryesisht në arkivat e aksesueshme nacionale, rajonale dhe dokumentat arkivore të periudhës 1912–1989. Dimensionin teorik ka bërë të domosdoshëm mbështetjen në teoritë dhe doktrinat e lidërshiptit, në teoritë politike dhe në burime parësore e dytësore. Tema, vendosur në kontekst rajonal dhe ndërkombëtar, ka patur të nevojshme edhe burimet mbi marrëdhëniet ndërkombëtare, sistemet politike ndërkombëtare, të historisë së diplomacisë si dhe të së drejtës së brendshme dhe ndërkombëtare.

Hipotezat kërkimore i përgjigjen në tërësinë e tyre qëllimit të studimit. Proçesi analitik ka sjellë në vetëvete edhe ndryshime e evoluime të disa prej tyre paraqitura në fazën fillestare. Studimi ka konsideruar me rigorizitet proçesin hulumtues shkencor duke mënjanuar hipotezat paragjyquese të fazës fillestare. Hipoteza kryesore e punimit provon në mënyrë të argumentuar bazuar në proçesin kërkimor shkencor se *traditat e lidërshiptit politik shqiptar janë krijuar nga evoluimi i identitetit shqiptar, i kulturës e mentalitetit dhe rrethanave gjeopolitike që kanë mundësuar ekzistencën, mbijetesën, zhvillimin deri në konsolidim në kohën moderne.*

Kufizimet metodologjike që kanë ndikuar në studim janë:

- a. Vështirësitë burimore nga jashtë – brenda.
- b. Botimet e kufizuara autoriale, monografike si dhe ato teorike mbi lidërshiptin politik shqiptar.
- c. Limitet ideologjike e politike në studimet e ndërmarra nga studiuesit dhe institucionet shqiptare gjatë periudhës së sistemit të kaluar, ndërhyrja ideologjike e politikës në histori. Këto kanë ndikuar në definicione, stereotipe dhe në kufizime paragjyquese.
- d. Mungesa e studimeve sintezë ka krijuar një zbrazëti burimesh të metodës hulumtuese krahasuese.

1.2. Bazat teorike të lidërshiptit.

Historiku i studimeve të lidërshiptit varionë nga teoria e “*njeriut të madh*” deri tek koncepti i universalitetit dhe detajimit të fushave e shkencave sociale. Qasja ndaj lidërshiptit u zgjerua si

cilësi e karakteristika, të cilat nuk janë tërësisht të lindura e trashëguara, por ato mund të fitohen edhe nëpërmjet proceseve mësimore dhe eksperiencave të ndryshme.

Evoluimi dhe *“zhvillimi i koncepteve të udhëheqjes është një fenomen historik, i lidhur ngushtë me strukturën organizative të shoqërisë”*². Evoluimi i shoqërisë dhe qeverisja në rinde të ndryshme demostroi një tërësi cilësish e tiparesh liderash të papërshtatshëm për situata të ndryshme. *“Udhëheqja është një subjekt i rëndësishëm me ide konfuze, terminologji të hapur për interpretime gjërësisht të ndryshme, ...përkufizimet dhe përshkrimet e lidershit ndryshojnë jashtëzakonisht shumë”*³.

Nga këndvështrimi tradicional aftësia për udhëheqje shihet si dhuratë dhe cilësi individuale e cila mishërohet te karizma ose pushteti i personalitetit. *“Një udhëheqës nuk ka detyrim më të madh se sa të sigurojë mbijetesën e vendit të vetë, ...udhëheqësit dhe popujt e tyre veprojnë në një botë ku mbështeten te vetja, në të cilën ata duhet të bëjnë çdo gjë që është e domosdoshme për të garantuar sigurinë e tyre”*⁴.

Katër faktorët mbi lidershipin; *Lideri, Njerëzit, Komunikimi dhe Situatat*, thellimi i studimeve të lidershit rreth *“tetë fusha kyçe të zhvillimit”*, studime në fushën e etikës në modernizëm dhe postmodernizëm, e vendosin lexuesin brenda zhvillimeve historike në filozofinë dhe teorinë sociale. Organizatat zakonisht janë të krijuar nga liderët. Udhëheqja e tyre është despotike, individuale ose kolektive. Mënyrat e tërheqjes, rrjetet, orientimi në detyrë, shqetësimet, statusi i paraqitur, zinxhiri komandues, stili i menaxhimit, motivimi i punonjësve dhe gjuha e menaxhimit dhe përdorimi janë funksionet kryesore të lidershit.

1.2.1. Përkufizimi i lidershit.

Kemi lidership në çdo lloj pune, aventurë, projekt pavarësisht nga shkalla, nga autoriteti financiar apo zyrtar. Mënyrat e shumta në të cilat lidershipi vepron e bënë të vështirë e të diversifikuar përcaktimin dhe përshkrimin e udhëheqjes. Pyetja se çfarë është lidershipi? Është një model lidershipi teknik? A është udhëheqja një sjellje? A është udhëheqja më shumë një çështje e stilit apo filozofisë? Kufizimi në përshkrimet e udhëheqjes thjesht si një model teknik, proces, stil ose filozofi na ndihmojnë të sqarojmë mënyrat kryesore të kuptuarit e të shpjeguarit se çfarë do të thotë udhëheqja. Qasja universale e lidershit e përcakton si *“një zonë hulumtimi dhe një aftësi praktike, në lidhje me aftësinë e një individi apo organizate për të "udhëhequr" ose udhëzuar individë të tjerë, ekipe ose organizata të tëra”*⁵. Lidershipi paraqet sfidë të kuptuarin e natyrës udhëheqëse. Stogdill (1974) në një përmbledhje të hulumtimit mbi udhëheqjen shprehet se *“ka shumë përkufizime të ndryshme mbi lidershipin, si ka njerëz që janë përpjekur për të përcaktuar atë”*⁶. Fleishman E. A. (1991) sipas hulumtimeve të fundit, citon rreth 65 sisteme të ndryshme klasifikimi të zhvilluara për përcaktimin e lidershit.

² R D. Levis: “When Cultures Collide – Leading Across Cultures, third edition”, Nicholas Brealey International, London 2013, ISBN:978-1-904838-02-9, pp 105

³ <http://www.businessballs.com/leadership-theories.htm>

⁴ John J. Mearsheimer: “Përse Gënjejnë Udhëheqësit”, AiiS Tiranë 2011, ISBN:978-9928-4062-1-7, fq 19

⁵ <https://en.wikipedia.org/wiki/Leadership>

⁶ Stogdill.R.M.(1974). Handbook of leadership: A survey of theory and research. New York: Free Press pp 7, (P G. Northouse,2013:4)

Disa autorë sugjerojnë lidërshtipin si *fokusin e proçeseve* të grupit, të tjerë nga një *perspektivë personaliteti*, në aspektin *e marrëdhënies* pushtetit që ekziston midis liderëve dhe pasuesit, fuqi të ushtruar e të patur ndryshim në të tjerët, nga një perspektivë e *aftësive*, të lidhur me *konceptin e fuqisë*, nga *spektri holistik* që mund të lindi nga nivelet e pushtetit, nga energjitë mendore, nga aftësitë e larta dhe niveli më të lartë i vlerave, urtësisë, spiritualiteti ku çdo lider buron nga një përzierje e veçantë të një ose nga shumë faktorë të mëparshëm. Shumë përkufizime për udhëheqësit dhe udhëheqjen nga autorë e shkolla të ndryshme nga “10 definicionet e lidërshtipit” deri tek përdorimi më i zakonshëm fokusohen; në proçes ndikimi shoqëror, një person ose një grup personash në synime të përbashkëta dhe i udhëheqin ato; një person ose grup personash, që organizojnë një masë të caktuar njerëzish në përmbushjen e qëllimeve të njëjta.

1.2.2. Teoritë e lidërshtipit.

Lidërshtipi është proçes kompleks, përshkruan qasjet e zgjedhura e të vlerësuara mbi udhëheqjen dhe se si mund të përdoren për të përmirësuar udhëheqjen në situata reale. Qasjet teorike dhe praktike e trajtojnë lidërshtipin një proçes kompleks me dimensione të shumëfishta. Teoritë e udhëheqjes politike paraqesin shumë polemika dhe debate. Samuel Johnson shprehet se *lëvizësit e mendjes njerëzore janë dëshira e mirë dhe frika e të keqes, ku lidërshtipet duhet të shkojnë përpara*. Debatet kryesisht përqëndrohen se; Ku përkon udhëheqja me lirinë dhe vlerat e demokracisë? Si është raporti midis inspirimit, motivimit, nënshtrimit e shtypjes? Udhëheqësit e fortë duhen admiruar apo duhen pasur frikë? Ku është fuqia dhe burimi i ushqimit për udhëheqjen?

Fokusi hulumtues lidhet me përcaktimin e efektivitetit udhëheqjes. Studiuesit janë përpjekur të evidentojnë se çfarë tiparesh, aftësitë, sjelljet, burime pushteti dhe aspekte të situatës, përcaktojnë se sa mirë një lider është në gjendje të ndikojë pasuesit dhe të realizojë objektivat e grupit.

Hulumtimi mbi udhëheqjen politike shqiptare 1912-1989 fokusohet në teoritë tradicionale e stilet e lidërshtipitë kushtëzuara nga sistemet, kohët, rrethanat, shoqëritë e situatat. Nga teoritë tradicionale veçojmë; Teoria e tipareve të veçanta, Teoria e qasjes së modelit, Teoria e stileve të sjelljes, Teoria situacionale e lidërshtipit, Teoria e përzierje, Teoria e modelit të liderit në ekip, Teoria psikologjike e integruar, Teoria emocionale, Teoria jo emergjente. Nga stilet e lidërshtipit veçojmë; stilin autokratik ose autoritarist, stili pjesëmarrës ose demokratik, stilin e drejtimit të lirë, stili narcizoid dhe stili helmatosës. Realiteti shqiptar përgjatë periudhës 1912 – 1989 të Shqipërisë politike ndikohet më tepër nga qasja tipar, qasja e modelit të aftësive, qasjet e stilit dhe qasjen situacionale.

Nga teoritë *tradicionale e situacionale* të lidërshtipit veçojmë!

Teoria e Tipareve të Veçanta shtrihet nga lashtësia me teoritë e shkruara nga Platoni te “Republika”, nga Plutarku te “Jetët”, duke përshkruar cilësitë e mbartura tek individi që mund

të gëzojë tipare lideri⁷. Kërkimi mbi tiparet, karakteristikat dhe fokusimi se "*çfarë cilësish e dallojnë një individ dhe e përcaktojnë si udhëheqës*" lidhet me njohjen e rëndësinë udhëheqëse dhe supozimin se udhëheqja është e rënjosur në karakteristikat që individë të caktuar posedojnë. Kjo ide mbi udhëheqjen bazohet në attribute individuale, njohur si "teoria tipar e udhëheqjes"⁸. Në kohët moderne, shekulli 19-të këtë teori e zhvilluan Thomas Carlyle (1841) dhe Francis Galton (1869)⁹. Këta autorë identifikuan talentet, aftësitë, karakteristikat fizike të njerëzve që i ngritën në pushtet. Teoria u zgjerua nga Cecil Rhodes (1853-1902) mbi "*udhëheqjen publike*" dhe "*fuqinë morale të karakterit dhe ngritjen e instikteve*". Vizioni mbi udhëheqjen u vendos në kontekste, mjedise që zhvilluan karakteristika të tilla dhe ndihmuan në krijimin e nocioneve udhëheqëse në 1903¹⁰.

Në gjysmën e shek. XX-të, teori u zhvillua nga autorët Bird, 1940; Stogdill, 1948; Mann, 1959¹¹. Këta autorë e rikonceptuan universalitetin e tipareve të lidërshiptit si një marrëdhënie midis njerëzve në një situatë sociale. Referuar studimeve bashkohore mbi tiparet e trashëguara nga "Teoria e Tipareve të Vecanta", ato karakterizohen nga Inteligjencia, Aftësia dominuese, Përshtatshmëria, Insistimi, Integriteti, Statusi social - ekonomik dhe Vetëbesimi.

Teoria e qasjes së modelit të aftësive. Sipas kësaj teorie, lideri zotëron një kompleks tiparësh që e bëjnë model të dallueshëm dhe ndikues mbi të tjerët. Modeli i krijuar konsiderohet si zotërim tërësor tiparësh individuale. Modeli nuk konsiderohet si shumëzimi i tipareve të shumë njerëzve tek një person. Modeli në vetevete përmban edhe tipare tërësisht individuale, po ashtu edhe si një simbiozë e tipareve kolektive të një kategorie ose shtrese të caktuar njerëzish. Qasja e aftësive është perspektivë e liderit të përqendruar në udhëheqje. Në ndryshim nga karakteristikat e personalitetit të parë si të lindura e fikse, kjo qasje fokusohet në aftësitë dhe që mund të mësohen dhe të zhvillohen. Personaliteti luan një rol integral në udhëheqje, ndërsa qasja e aftësive sugjeron se njohuritë dhe aftësitë janë të nevojshme për udhëheqje efektive. Studimi mbi aftësitë e udhëheqjes i takojnë shkollës Harvard (Robert Katz, 1955) me titullin "Aftësitë e një administratori efektiv". Qasja Katz (1955) kapërcen qasjen tipar, duke trajtuar lidërshiptin si një grup të aftësive të zhvilluara. Ajo sugjeron se udhëheqja efektive varet nga tre aftësi themelore personale; *teknike, njerëzore dhe konceptuale*¹². Aftësitë e lidërshiptit mund të fitohen, zhvillohen e trajnohen, ndërsa tiparet janë karakteristika të lindura. Qasja e aftësive thekson kompetencat e udhëheqësve dhe rëndësia e çdo aftësie ndryshon në nivele të menaxhimit.

⁷Benjamin Jowett's translation of Plato's Republic does not use the word "leadership"; Plato discusses primarily a "guardian" class. See Plato(1892). The Dialogues of Plato translated into English with Analyses and Introductions by B. Jowett, M.A.&Oxford University Press.Retrieved 2014-09-12.

⁸<https://en.wikipedia.org/wiki/Leadership>

⁹https://en.wikipedia.org/wiki/Great_Man_theory & https://en.wikipedia.org/wiki/Francis_Galton

¹⁰Donald Markwell, "Instincts to Lead": On Leadership, Peace, and Education, Connor Court: Australia, 2013, ISBN: 9781922168702

¹¹Bird, C. (1940).Social Psychology. New York: Appleton-Century.& Stogdill, R. M. (1948). "Personal factors associated with leadership: A survey of the literature". Journal of Psychology.25: 35–71.doi:10.1080/00223980.1948.9917362. PMID 18901913.&Mann, R. D. (1959)."A review of the relationship between personality and performance in small groups".Psychological Bulletin.56 (4): 241–270. doi:10.1037/h0044587

¹²Katz,R.L.(1955). Skills of an effective administrator.Harvard Business Review,33(1), 33–42. (PG.Northouse, 2013:44-46)

Teoria e stileve të sjelljes. Qasja stil (style) thekson sjelljen e liderit dhe fokusohet vetëm në atë që liderët bëjnë dhe se si ata veprojnë. Lideri definohet si tërësi sjelljesh që arrin të dominojë mbi të tjerët ose identifikohet nga të tjerët me sjelljet e tij. Autori David McClelland e konsideron liderin një person me një ego ndikimi pozitiv, jo aq si model ndikues sesa si tërësi sjelljesh ndikuese¹³, ndërsa Kevin Mick e definon këtë teori si stil që shpie në vetëbesim brënda liderit dhe si vlerësim të lartë nga të tjerët njëkohësisht¹⁴. Qasja stil përcakton se udhëheqja është e përbërë nga dy lloje të përgjithshme të sjelljes; nga *sjellje në detyrë* dhe *sjelljet në marrëdhënie*. Qasja stil synon të shpjegojë se si liderët kombinojnë këto dy lloje të sjelljeve për të ndikuar tek vartësit e të arrijnë qëllimin. Studimet u bazuan në gjetjet e Ralph Stogdill (1948), pjesë e studimeve të Shtetit Ohio-s¹⁵, në studimet Michigan dhe studimet nga Blake dhe Mouton (1964, 1978, 1985). Këto shkolla janë përfaqësues më të fuqishëm të kësaj qasje¹⁶. Kjo teori është zhvilluar më vonë edhe nga autorë të tjerë si Daniel Goleman & Riçard Boyatzis & Annie McKee në botimin “*Lidershipi Primal*” (2002)¹⁷ dhe Joseph S. Nye Jr. me botimet e tij mbi lidërsipin (2006, 2008).

Teoria situacionale (situational leadership theory) u formulua si një reagim ndaj teorisë së tipareve. Sociologët Herbert Spencer dhe Karl Marks (1884), ka thënë se *kohët prodhojnë personin dhe jo anasjelltas*¹⁸. Kjo teori supozon se në situata të ndryshme kërkohet stil lidërsipit që duhet të ndryshojnë. Sipas teorisë, “*çfarë në të vërtetë e bën një individ të veprojë si një lider, në pjesën më të madhe varet nga karakteristikat e situatës në të cilën ai funksionon*”¹⁹. Teoricienë të ndryshëm përcaktuan tri stilet e lidërsipit dhe identifikuan se në cilat situata secili stil punon më mirë. Teoricienët përcaktuan stilin autoritar, demokratik dhe laissez-faire të lidërsipit si kontigjentit të situatës. Teoria situacionale e lidërsipit u zhvillua nga autorë si Stogdill, R. M. (1948 & 1974), Mann, R.D. (1940-1959), James MacGregor Burns 1978²⁰. Sipas kësaj teorie *një person ose grup është i përshtatshëm si lider në një situatë të caktuar por me ndryshimin e situatave mund të mos jetë i tillë në situatë të tjera*. Liderët mund të jenë efektiv vetëm në kuadër të disa situatave të caktuara, por jo në çdo situatë të dhënë. Autorët Paul Hersey e Ken Blanchard (1969a) e zhvilluan teorinë mbi teorinë e stilit menaxhues 3-D të Reddin (1967). Hersey dhe Blanchard sugjerojnë *katër stile udhëheqje dhe katër nivele të zhvillimit të vartësve*. Sipas kësaj teorie efektiviteti i liderit do të varet nga domosdoshmëria e përputhjes së stilit udhëheqës me nivelin e zhvillimit të vartësve. Në këtë model, sjellja bëhet në funksion jo

¹³ <http://www.businessballs.com/davidmcclelland.htm>

¹⁴ <https://books.google.al/books?id=djz5FKXIp-cC&pg=PA26&lpg=PA26&dq=Kevin+Mick+and+style+approach&source=books>

¹⁵ <http://www.businessballs.com/leadership-theories.htm>

¹⁶ Peter G. Northouse: “Leadership Theory and practice · Sixth Edition”, Copyright © 2013 by SAGE Publications, Inc. Library of Congress Cataloging-in-Publication Data, United States of America, ISBN: 978-1-4522-0340-9, fq 75-76

¹⁷ Goleman, D. & Boyatzis, R. & McKee, A. *Primal Leadership: Learning to Lead with Emotional Intelligence*. Boston; Harvard Business School Press, 2002.

¹⁸ Spencer, Herbert (1841). *The Study of Sociology*. New York: D. A. Appleton. ISBN 0-314-71117-1, (Heifetz R, 1994:16)

¹⁹ Hemphill, John K. (1949). *Situational Factors in Leadership*. Columbus: Ohio State University Bureau of Educational Research.

²⁰ <https://www.amazon.com/...Leadership-James-MacGregor-Burns/dp/0802141188&https://www.amazon.com/Stogdills-Handbook-Leadership-Research-Expanded/dp/002901820X> & <https://www.gwern.net/docs/iq/1959-mann.pdf>

vetëm të karakteristikave të liderit por edhe nga karakteristikat e pasuesve²¹. Teoria sygjeron se *udhëheqësit efektive janë ata të cilët dinë se çfarë u nevojitet punonjësve dhe përshtasin stilin e tyre për të përmbushur këto nevoja*. Lidershipi i situatës është zhvilluar në modelin SLII të ndarë në dy pjesë: stil lidershipi dhe nivelin e zhvillimit të vartësve.

Teoria e përzierë. Definohet lidershipi përmes mpleksjes së teorisë së tipareve të trashëguara dhe të adoptimit situacional, nga teoricien si H Spenser (1840), F Fidler, V Vroom, F Yetton (1973), A Jago (1988)²². Tiparet e trashëgimisë si karakteristika të lindura te personi lider dhe si origjinë familjare e social-ekonomike. Përshtatshmëria në një situatë të dhënë në mënyrë individuale dhe në disa situata të dhëna me efikasitet. Kjo teori arsyeton lloje të ndryshme lidershipi nga autoritaristi deri te liberali, nga individualisti deri te ekipi.

Sistemet, kohët, rrethanat, shoqëritë dhe situatat kushtëzojnë stile të ndryshme lidershipi. Lidershipi shqiptar e periudhës 1912-1989 fokusohet rreth ***pesë llojeve të stileve*** të lidershipit.

Stili autokratik ose autoritarist i lidershipit karakterizohet nga centralizimi i procesit vendim-marrës në duart e personit lider. Stili autokratik historikisht ka karakterizuar gjithë sistemet totalitare. Kjo sjellje në kohët moderne ka veçoritë: stilin e centralizuar në çdo fushë të çdo lloj drejtuesi; dallohet nga filozofia e determinimit personal; shquhet për imponimin e personalitetit të vetë, mbivlerëson veten dhe nënvlerëson të tjerëve; bazohet në një eksperiencë të gjatë dhe të lidhur me totalitarizëm. Ky stil aplikohet në situata emergjente, ka dinamikë, fuqi e përvojë politikë-bërëse.

Stili pjesëmarrës ose demokratik favorizon procesin e vendim-marrjes në grup. Lideri jep instruksione vetëm mbasi është konsultuar me grupin ose ekipin e tij. Kjo sjellje lidershipi përfiton bashkëpunim në udhëheqje, motivim, efektivitet dhe pozitivizëm në punën e grupit. Proceset vendim-marrëse ngrihen mbi procese konsultative dhe përfshijnë grupet e punës.

Stili i drejtimit të lirë lidhet me liderë e lidershipe që nuk kanë prirje për të udhëhequr, por lënë tërë grupin të demostrojë aftësinë drejtuese. Kjo sjellje lejon maksimalizimin e lirisë së varësve dhe rritë energjinë krijuese të tyre. Lejon varësve duar të lira në procese vendim-marrje. Krijon varësve hapsira në bërje politikash. Krijon mundësi për aplikime metodash nga më të ndryshmet. Ky stil lidershipi përdoret për situata të qeta, të stabilizuara, të qëndrueshme e të standartizuara.

Stili narcizoid. Definicionin e këtij stili e ka dhënë më së miri Kets de Vries, Maccoby dhe Thomas. Këta studiues të lidershipit e përcaktojnë këtë stil për liderët të cilët mbivlerësojnë vetveten dhe nënvlerësojnë të tjerët. Këto liderë mbiçmojnë kapacitetin e tyre dhe nënçmojnë çdo lloj kapacitetit tjetër përrreth. Këto liderë pëlqejnë deri në ekstrem veten e tyre dhe me kalimin e kohës rrisin distancën midis vetes, njerëzve që rrethojnë dhe popullit.

²¹Hersey, Paul; Blanchard, Ken; Johnson, D. (2008). Management of Organizational Behavior: Leading Human Resources (9th ed.). Upper Saddle River, NJ: Pearson Education. ISBN 0-13-017598-6. (Hersey et al. (2008)

²²Spencer, Herbert (1841). The Study of Sociology. New York: D. A. Appleton. ISBN 0-314-71117-1. & Fiedler, Fred E. (1967). A theory of leadership effectiveness. McGraw-Hill: Harper and Row Publishers Inc. & Vroom, Victor H.; Yetton, Phillip W. (1973). Leadership and Decision-Making. Pittsburgh: University of Pittsburgh Press. ISBN 0-8229-3266-0. & Vroom, Jago (1988)

Stili helmatosës karakterizon liderin si një person me përgjegjësi mbi një grup njerëzish apo organizatë të caktuar dhe që e manipulon atë. Ky stil është natyrë abusive. Abuzon mbi besimin e të tjerëve dhe shfrytëzon makinerinë e fuqisë, statusit, ndikimit për imponimin e ideve të veta. Kjo sjellje provokon situata të vështira për njerëzit dhe organizatat. Në këto pozita vetëm lideri jep një zgjidhje. Përdor maksimalisht makinerinë mediatike e propogandistike për lartësimin e ideve të veta. Aplikohet në shoqëri me nivel të ulët, në njerëz me vështirësi për t'u ngritur.

Formatet e liderëve të mëdhenj variojnë në stilistikën e tyre, ata sjelljen e bazojnë në parime, filozofi, personalitet e përvojë dhe që kushtëzohet nga rrethanat e caktuara situacionale.

Situatat emergjente, krizat, luftrat, konfliktet, katastrofat falimentimet kërkojnë më së shumti një lidërsip autokrat, unitary, vendim-marrës, ekzekutues dhe personalitete të forta.

Situatat demokratike, të qeta e paqësore kërkojnë më së shumti liderë me frymë grupi, me stil, filozofi e personalitet demokratik gjithpërfshirës, që vendimet i kalon mbas një procesi konsultimi e konsiderimi të gjërë.

Situata shumë të zhvilluara, shoqëri tepër të kulturuar, vënde me stabilitet e zhvillim të qëndrueshëm, me kulturë pune e drejtimi, preferojnë stilin e drejtimit të lirë ku çdo njeri i grupit ndjehet i rëndësishëm, i konsideruar dhe i përgjegjshëm për punën e tij.

Kapitulli II: Rilindja Kombëtare Shqiptare

2.1. Ngritja e nacionalizmave Ballkanikë. Megali-Idea. Naçetania.

Rënia e Bonapartit në vitin 1815, u shoqërua me ndryshime në Europë e në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacinë e Fuqive të Mëdha. Evropa po futej në sistemin e Koncertit të Evropës, mbas atij të Vjenës, ndërsa Perandoria Osmane kishte filluar stanjacionin e saj, *fuqitë e tjera evropiane kishin filluar ta ndienin kërcënimin e Ruisë ndaj interesave të tyre në Lindjen e Afërt*²³. Evropa Qendrore dhe Lindore me lëvizjen rilindëse po i paraprinte procesit të krijimit të shteteve nacionale, ndërsa Ballkani do të niste rilindjen e vet të vonëshme, por një rilindje dinamike, të ashpër dhe plot kriza, e njohur si Kriza Lindore. Fuqizimi i Ruisë, rënia e Osmanëve, bashkimi i Gjermanisë e Italisë do të trazonin situatën e përgjithshme politike në kontinent dhe në botë duke e shëndërruar “Koncertin” e Vienës në një “Funeral” të përbotshëm.

Proçesin e ngritjes së lëvizjeve nacionaliste dhe shtet – formuese në Ballkan, fillon me lëvizjet autonomiste të Pashallëqeve në kuadër të Perandorisë Osmane, përfshinë lëvizjet e serbëve, grekëve, bullgarëve, rumunëve dhe shqiptarëve. Deri atëherë shumë rrugë e përpjekje iluministe, politike, ushtarake e diplomatike do t'i duheshin popullit shqiptar për krijimin e shtetit të vet të pavarur. Burimet arkivore, autoriale e publicistikë të kohës argumentojnë se shqiptarët kanë qënë kudo të pranishëm, fillimisht ato paralajmëruan këto proçese mëvehtësuese në Pashallëkun e Janinës, më tutje u bënë solidarë me serbët kundër Osmanëve, mbështetën revolucionin Grek për panvarësi dhe çdo lëvizje që i shërbente krijimit të shteteve nacionale kundër Perandorisë Osmane në rënie.

Shekulli i XIX-të ka qënë nga më dinamikët në historinë politike të popujve të Ballkanit, por edhe të popujve të tjerë sikundër ishin rusët, italianët e gjermanët. Ky shekull u karakterizua nga

²³ Norman Rich: “Diplomacia e Fuqive të Mëdha 1814-1914”, Tiranë, Toena 2006, ISBN:99943-1-199-9, fq 46

filozofi aristokratike, konservatore dhe synoi që të ruante me çdo kusht stanjacionin, pra të mos pajtohej me ndryshime politike. Koncerti i Vjenës u shoqërua me dinamika politike nga poshtë dhe tre lëvizje shumë të mëdha dhe të fuqishme: lëvizjen për liberalizimin, lëvizjen nacionaliste shtetformuese dhe lëvizjen imperialiste. Formimi i dy shteteve të mëdha unitariste me fuqi e ambicie imperialiste ndërkombëtare, Italisë dhe Gjermanisë, shpalojta e interesave imperiale të Rusisë në plan ndërkombëtar si dhe përplasja e Fuqive për tregje, lëndë të para e zona influenciale ndërkombëtare ishin indikatorë i lëvizjeve në Ballkan duke përfshirë lëvizjet nacionaliste shtetformuese përkundër Perandorisë Osmane. Në këtë proces për arsye politike, u ndërftua shumë thellë edhe Rusia, ndonëse nuk ishte pjesë gjeopolitike e Ballkanit, bazuar në interesa imperiale dhe anti-osmane si dhe e arsyetuar mbi baza racizmi e fanatizmi fetar.

Autorë të ndryshëm provojnë që shqiptarët nga populli më solidar me popujt e vegjël fqinjë për luftërat e tyre për panvarësi, kaluan gradualisht në mbyllje, neutral vetëm atëherë kur në Ballkan filluan të shfaqeshin interesat klienteliste Ruse, të cilat në çdo kohë e në çdo rrethanë i lanë shqiptarët dhe interesat e tyre jashtë vëmendjes. Bismarku donte një marrëveshje për ndarjen e Ballkanit ndërmjet Austrisë dhe Rusisë, por kjo ndarje nuk u materializua asnjëherë. *Udhëheqësit austriakë kishin frikë nga ndonjë zemërim i dukshëm i pushtetit të Rusisë në Ballkan dhe hungarezët nuk e pëlqenin prespektivën e përfshirjes të më tepër sllavëve në Perandorinë habzburgase, sepse kjo do të zvogëlonte rëndësinë e tyre*²⁴. Ngritja e Rusisë u bë mbi baza klientelizmi sllavo – fetar, duke mbështetur kryesisht popujt sllavë të jugut dhe me konfesion të njëjtë. Në këtë projekt Rus përfshiheshin kryesisht sllavët, ndërsa grekët disi më larg. Projekti Rus gjendej në *dëshirat e zjarra të serbëve të drejtuara ndaj bregdetit shqiptar të detit Adriatik, ...që në kohën e parë të çlirimit të saj nga sundimi turk Serbia nuk pushoi së synuari për një dalje të lirë në det*²⁵.

Dinamikat dhe kompleksiteti i zhvillimeve politike në Shekullin e XIX-të, pleksën nacionalizmin-shtetformues, liberalizmin-antimonarkist dhe imperializmin për rivalitete koloniale. Koncerti i Evropës paraqiste vështirësi ndarje të dukuritë, ngjarjet, lëvizjet, periudhat, faktorët dhe, natyrisht edhe rezultatet. Ballkani ka qenë shumë i nxehtë dhe i përfshirë në këto dinamika. Tipike Ballkanike mbetet dukuria e diversitetit etnik, religjioz, gjeopolitik. Ky diversitet i shndërroi gradualisht aleancat e mirëkuptimit shumë shekullor nën Perandorinë Osmane në një problem, konflikt e luftë mes vetë Ballkanasve për një periudhë shumë të gjatë.

Doktrinat ballkanike, Megali Idea e Naçetania u frymëzuan e para tek gjermanët e tjetra tek francezët. Megali Idea u frymëzua nga teoria gjermane e Volksgeist duke lidhur e me *kujtimet historike të Lashtësisë dhe të Bizantit*, ndërsa Serbët, *bashkuan vizionin unitar francez me solidaritetin sllav, duke i derdhur të dyja në “Projektin e Madh në Naçetanie*²⁶.

Naum Veqilharxhi në 1846 shprehej; *“Patriotë! Po i këshilloj bashkëatdhetarët tanë që e duan mëmëdhenë, që ta vështrojnë me kujdes një studim të ri filologjik, i cili u shkrua dhe u*

²⁴ Norman Rich: “Diplomacia e Fuqive të Mëdha 1814-1914”, Tiranë, Toena 2006, ISBN:99943-1-199-9, fq 46, fq 229

²⁵ Sergej Dmitrievič Sazonov: “Kujtime”, Tiranë, Helga’s Secret, ISBN:978-9928-4022-8-8, fq 99

²⁶ Georges Castellan: “Histori e Ballkanit”, Tiranë, Çabej 1991, fq 324

*botua nga gazetata greke, si një vepër që meriton vëmendje shumë të madhe, aq më tepër pasi kjo ka lidhje me shqiptarët*²⁷.

Nacionalizmi grek u bazua te feja dhe jo te kombi si identitet. Këtu i kishte rrënjët doktrina neobizantiniste e nacionalizmit grek në fillim të shekullit të XIX-të. Kjo doktrinë e quajtur shqip “Megali Idea” (Ideja e Madhe) qëndronte në themelin e nacionalizmit dhe politikës së jashtme greke. “Megali Ideja”, qysh nga lindja e saj deri nga viti 1854 kishte si synim strategjik ringritjen e Bizantit në mbarë hapësirën brenda kufijve politik të shtetit të ri grek. Baza lidhëse, sipas “Megali Idesë” qëndronte te feja, pra te ortodoksia. Sipas strategjisë greke, të gjithë popujt ortodoksë, dikur nën Perandorinë Bizantine, tani nevojitej të përfshiheshin në territorin dhe kufijtë politik nën sovranitetin e shtetit kombëtar modern grek. Identiteti helen dhe hapësira e Bizantit ishin asimetrike dhe filloi të shpalosë problemet e veta me gjithë popujt ortodoksë, por jo helenë, e sidomos me popujt e Ballkanit me fe ortodokse, por me identitet të ndryshëm.

Ekspansioni serb është më i hershëm se “Projekti i Madh” i Ilia Grashaninit dhe se “Shpërngulja e Arnautëve” dhe “Problemi i pakicave kombëtare në Jugosllavinë e Re” të Vaso Çubrilloviq e vitit 1937 dhe memorandumit “Manu”. Rreth viteve 1836-1837, Beogradi bashkëpunoi ngushtë me Lëvizjen Ilirjane të Kroacisë. Patriotët “jugosllavë” veç territoreve serbe të numëruara në Naçetania përfshinin edhe Sremin, Baçkën, Banatin që duhet ti shkëputeshin Hamburgëve, Sërbia të bashkohej me viset kroate dhe me Malin e Zi. Kalkulimet serbe për disballancë me perandorinë e Habsburgëve, rikthyhen Naçetanian në drejtim të territoreve osmane. Strategjia “Naçetania” e Garashaninit synonte formimin e një shteti të madh Jugosllav, në përbërjen e të cilit, do të përfshihej edhe Bullgaria.

Në kulisat politiko-diplomatike të Krizës Lindore, shqiptarët u mbajtën larg. Neutraliteti i tyre në Luftën Ruso-Osmane u quajt asokohe si qëndrim otomanist i shqiptarëve, ndërkohë shqiptarët vijonin të kontribuonin edhe për popujt të tjerë sikundër ishin rumunët në Lindje dhe italianët në Perëndim.

Ndërkohë që diplomacia konspirative po ecte kundër interesave të shqiptarëve, lëvizja kombëtare shqiptare po ngrihej me dinamikë të fuqishme. Mërgata shqiptare në qendra të mëdha si arbëreshët e Italisë, shqiptarët e Bukureshtit, intelektualët e Stambollit dhe në shumë qendrave të tjera dëshmojnë se lëvizja kombëtare shqiptare po konturohej ngadalë dhe dukshëm. Për Fuqitë e mëdha të kohës dhe përfqinjët e shqiptarëve, grekët e serbët, lëvizja kombëtare shqiptare përbente shqetësim real dhe në rritje.

2.2. Rilindja Kombëtare Shqiptare dhe Lidhja shqiptare e Prizrenit.

Rilindja Kombëtare Shqiptare ideologjikisht u konkretizua në programin e saj politik e kombëtar të përpunuar gradualisht duke filluar nga vitet 30-40 të shekullit të XIX-të dhe pasuruar gjatë zhvillimit të mëtejshëm të lëvizjes kombëtare. Konsolidimi i ndërgjegjes kombëtare kapërceu prirjet lokaliste dhe separatizmin patriarkal feudal. Ndjenja e bashkësisë dhe interesave kombëtare shqiptare prevaloi kundër sundimtarëve osmanë. Shqiptarët ishin aleatë me

²⁷ Blakaj S & Ismaili I; “Letërkëmbime të Rilindjes Kombëtare Shqiptare”. Prishtinë: ARBI Ltd; New York: Vatra, 2014, ISBN:978-9951-452-13-7, fq 117

peshë për Stambollin. Pozita gjeografike e shqiptarëve luante rol në përballimin e ekspasioneve të grekëve, malazezëve e bullgarëve, mjaftonte që Porta të arrinte t'i manipulonte me shkathësinë e duhur. Për interesa, *“Portës iu desh që të mos i lejonte shqiptarët të ndiqnin shembullin e fqinjëve e të mos krijonin lëvizjen e tyre kombëtare, ...Shqiptarët qenë të vetmit ndër popujt e Ballkanit, që e patën të ndaluar të shkolloheshin në gjuhën amëtare”*²⁸. Ndryshe nga fqinjët e tyre, shqiptarët nuk u ngritën kundër Sulltanit. Porta vepronte me sukses në Shqipëri.

Nisma *“Devshire”* ishte sukses i Perandorisë Osmane mbi shqiptarët, ndërsa për elitën shqiptare ishte *“depërtim në otomanizëm”* dhe gjunjëzim për breza e shekuj të territoreve shqiptare nga sundimi osman. Shqiptarët nga Osmanët u ndanë në fund nëntori 1912, ndërsa *“devshire”* mjerisht u trashëguar në periudhat e mëvonëshme të shtetit politik shqiptar.

Rilindja kombëtare Shqiptare solli elemente të reja në organizimin e drejtimin e lëvizjes çlirimtare shqiptare duke kaluar në formimin e organizatave udhëheqëse mbarëshqiptare. Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1880), Lidhja Shqiptare e Pejës (1899-1900) dhe Komitetet kombëtare në fazën e fundit të Rilindjes drejtuan lëvizjen në shkallë kombëtare. Veprimtaria politike e Komitetit të Janinës dhe Stambollit i paraprinë krijimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Liderët e rilindjes kombëtare udhëhoqën ngritjen e nacionalizmit shqiptar midis dy zjarresh: zjarrit të shteteve fqinjë dhe zjarrit osman në Ballkan. Ideologët rilindas përcaktuan rrugët nëpërmjet të cilave populli shqiptar do të arrinte të formonte shtetin e vet kombëtar e të bashkuar. Organizimin e shtetit shqiptar rilindasit e mendonin në të dyja format - të autonomisë dhe të pavarësisë. Autonomia dhe pavarësia janë konceptuar gjithmonë si dy etapa të zgjidhjes së çështjes shqiptare, të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Për një varg arsyes, që kishin të bënin më shumë me rrethanat e jashtme ndërkombëtare, raportin e forcave shoqërore e politike brenda vendit, *“platforma e autonomisë territoriale-administrative e Shqipërisë mbizotëroi gjatë gjithë Rilindjes Kombëtare Shqiptare, derisa u shndërrua në pavarësi në nëntor të vitit 1912”*²⁹.

Rilindja Shqiptare përbën një lëvizje të gjithanshme kombëtare, me përmbajtje ideologjike, politike, kulturore, ekonomiko-shoqërore dhe organizative. Ajo synonte të çlironte vendin nga sundimetarët e huaj osmanë, të bashkonte trojet shqiptare në një shtet të vetëm e të pavarur, t'i hapte rrugën zhvillimit e përparimit ekonomiko-shoqëror, politik e kulturor të Shqipërisë.

Ajo trashëgoi nga shekujt e mëparshëm një pasuri të çmuar historiko-kulturore, me vlera morale e politike, të cilën e zhvilloi më tej, me një platformë të re ideologjike e politike. Ideologët e Rilindjes Kombëtare e përdorën historinë si një mjet të fuqishëm në shërbim të kësaj çështjeje.

Lidershipi i pavarësisë është sintezë politike, diplomatike, kulturore dhe ushtarake. Përpara edhe pas Kongresit të Berlinit, shqiptarët u ndjenë të braktisur dhe shumë të kërcënuar. Ngjarjet e Mirditës, krijimi i dy Komiteteve Shqiptare në Janinë dhe në Stamboll do sillte themelimin e

²⁸Glenny M: “Histori e Ballkanit, 1804-1999, Nacionalizmi, Luftërat dhe Fuqitë e Mëdha”, Tiranë, Toena 2007, ISBN:97899943-1-231-3, fq 152

²⁹ Bashkurti L: “Koncerti dhe Funerali 1815-1914 Shqiptarët-Ballkani-Fuqitë e Mëdha”, Tiranë, Geer 2013, ISBN:978-9928-07-211-5, fq 185

Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në 1879, si *organizata e parë politiko - ushtarake mbarë shqiptare*³⁰.

Projekti i kryengritjes çlirimtare kundër-osmane nisi nga maji i vitit 1877 me Komitetin e Janinës që përfaqësonte pothuajse të gjitha krahinat e Vilajetit të Janinës, u pasua nga Komiteti i Shkodrës dhe Komiteti i Stambollit me platformë politike. Komiteti i Stambollit vendosi të formonte një lidhje shqiptare me karakter mbarë kombëtar, ku të përfaqësoheshin të gjitha shtresat shoqërore dhe të gjitha krahinat shqiptare që bënë pjesë në të katër Vilajetet Perëndimore të Gadishullit Ballkanik, Vilajetit të Janinës, të Manastirit, të Shkodrës dhe të Kosovës, thirjen e “Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit kishte dy qëllime: politike dhe ato kulturore. Lidhja u përpoq të bashkonte të katër Vilajetet, (Kosovës, të Shkodrës, të Manastirit e të Janinës) në një shtet vetëqeverisës brenda sistemit të Perandorisë Osmane, organizimin e lëvizjes për zhvillimin e gjuhës shqipe, letërsisë, arsimimit dhe kulturës.

Lidhja u godit nga Monarkitë fqinje dhe nga Perandoria Osmane. Këto dy faktorë, e izoluan Lidhjen Shqiptare, i goditën në akord fuqitë ushtarake të saj, vranë e likuiduan lidhshpirtin si dhe u përpoqën të shuanin jehonën ndërkombëtare mbi Shqipërinë e shqiptarët. Shkatërrimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e vonoi procesin shqiptar drejt pavarësisë, uli koncentrimin e energjive shqiptare dhe u krijoi terren revanshizmit të monarkive fqinje për të filluar pushtime të dhunshme në terren dhe për të nisur kalvarin e gjatë tragjik të spastrimeve etnike kundër shqiptarëve. Gjithçka ishte në platformë, në strategji dhe taktikë në akord të plotë midis grekëve në Jug dhe Serbo-Malazëve në Veri. Ndërkohë që grekët filluan spastrimin etnik të Çamërisë nga shqiptarët, nën epitetimin se janë turq myslimanë, në veri *serbo-malazët filluan spastrimin etnik nga Nishi deri në Kosovë*³¹.

Në 23 janar 1899 shqiptarët tentuan organizimin me Lidhjen e Pejës. Lidhja miratoi një platformë me njëmbëdhjetë pika, kryesisht për kundërshtimin e copëtimit të trojeve shqiptare ndërmjet fqinjëve territorialë, por konjunkturalisht, pa kërkuar autonomi nga Porta e Lartë. Lëvizja harmonizoi politikën, luftën, kulturën e diplomacinë. Lidhjen e Pejës, me në krye Haxhi Zekën mund të konsiderohet vazhdimi e zgjatimi i natyrshëm në kohë i projektit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në rrethanat e viteve të fundit të shekullit të XIX-të.

Kap. III. Profili i Ismail Qemalit dhe vendi i tij në shtetin e parë modern shqiptar.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881) ishte përpjekje për formimin e shteti kombëtar shqiptar në një kohë me popujt e tjerë të Ballkanit. Përpjekjet shqiptare nuk kishin reshtur gjatë epokës së Rilindjes, nga pavarësinë e Greqisë në 1829, u intensifikuar rreth viteve 50 të Shek 19-të dhe kulmoi me Krizën Lindore e viteve 1876-1881. Formimit të shtetit kombëtar shqiptar ishte domosdoshmëri e një detyrë konkrete, e ngutëshme dhe reflektim për fatet e kombit. Evoluimi

³⁰ Bashkurti L: “Koncerti dhe Funerali 1815-1914 Shqiptarët-Ballkani-Fuqitë e Mëdha”, Tiranë, Geer 2013, ISBN:978-9928-07-211-5, fq 237-241

³¹ Hoti R, “Gjenitë dhe Drama e Kosovës”, Prishtinë, 2011, ISBN:978-9951-8840-0-6, fq 423-427

dhe kordinimi i veprimtarive të atdhetarëve me karakter politik, ushtarak e diplomatik nga të gjithë krahinat shqiptare dhe atyre të mërgimit ishte padyshim përparësia e përparësive.

3.1. Ismail Qemali dhe fqinjët rreth shqiptarëve.

Kriza Lindore nxiti shumë iniciativa diplomatike të formateve të ndryshme. Fillimisht Austro-Hungaria, Rusia dhe Perandoria Osmane, më pas do hynte edhe Britania e Madhe e Gjermania. “Marrëveshja e Budapestit” (*Budapester Vertrag*) midis Austrisë-Hungarisë dhe Rusisë në vitin 1877, mbi të ashtuquajturën “Çështje Lindore” (*Orientalische Frage*), ishte tërësisht sekrete, dhe *do ishte prioritet i Fuqive Evropiane në shekullin e 19-të*. Në pikën e dytë të marrëveshjes përcaktohej se çfarë do të bëhej nga këto dy Fuqi, nëse Perandoria Osmane shpërbëhet tërësisht. Austro-Hungaria dhe Rusia së bashku do të garantonin që në Ballkan do të krijoheshin një numër i vogël shtetesh sllave, por jo bllok të lidhur që mund të prishnin “*balancat Evropiane*”; Kostandinopoja dhe zonat përreth saj mbeteshin “*qytete të lira*” (Freie Stadt); Rusisë do t’i jepej Besarabia; do t’i njëhej pavarësia Bullgarisë, Shqipërisë dhe Rumelisë; Greqia të fitonte Kretën, Selanikun dhe disa pjesë të Epirit.

Marrëveshja mbi “*Freie Stadt*” dhe “*Traktati Paraprak i Shën Stefanit*” (1878) ishin një goditje e rëndë për shqiptarët. Në “*Freie Stadt*” parashkoheshin qëllimet e Carit Rus, mbi idenë e vjetër Greke dhe shqiptarët u përjashtuan pasi nuk u panë si një komb i veçantë. “*Traktati Paraprak i Shën Stefanit*” (1878) e linte Shqipërinë shtet të pavarur, vetëm në pjesën qendrore, nga Shëngjini deri në Lumin Shkumbin.

Shqiptarëve iu morën territore të konsiderueshme dhe iu dhanë Serbisë, Bullgarisë, Malit të Zi dhe Greqisë. Shqiptarët ndërmorën veprimet dhe tërhoqën vëmendjen e Fuqive të Mëdha për neutralizimin e ndikimit Rus në Ballkan. Shqiptarët nuk ishin në “*listë*” për asnjë zhvillim të rëndësishëm, ata nuk kishin asnjë “*mik*” në fuqitë e mëdha të kohës, nuk kishin një shtet e as një perspektive për një gjë të tillë, *nuk kishin asnjë strukturë organizative të përbashkët, nuk kishin ushtri, nuk kishin asgjë*³². Kjo gjendje e rëndë nxitoi themelimin e Lidhjes së Prizrenit³³.

Në Shën-Stefan, Rusët shpërblyen miqtë sllavë me territore shqiptare. Kjo ishte e papranueshme si për Austro-Hungarinë, ashtu edhe për Anglinë. Shqiptarët ishin shpërfillur krejtësisht. *Ky traktat përbënte një tredhje për Turqinë dhe krijonte një “Bullgari të Madhe” i shtrirë në Detin Mesdhe, do të dominohej nga Rusia*³⁴.

Ky traktat krijoi krizë serioze diplomatike te Fuqitë e Mëdha të Evropës dhe *imponoi Kongresin e Berlinit në 1878*³⁵. Kongresi i Berlinit nuk e njohu “*Traktatin e Shën Stefanit*”, por la shteg të hapur për dinamikat e mëtejshme politike, ushtarake e diplomatike shqiptare të ndërmarra nga terreni e deri në Kancelaritë e Fuqive të Mëdha. Përpjekjet synonin krijimin e shtetit kombëtar shqiptar.

³² A Gjinaj & F Lila: “Lidershipi Shqiptar përmes Historisë së Ushtrisë”. Tiranë, Geer 2012, ISBN:978-9928-07-105-7, fq 67

³³ Gawrych, George. The Crescent and the Eagle. London: I.B. Tauris, 2006, pp. 44-49.

³⁴ Kissinger H: “Diplomacia”, Tiranë, Laert 1999, ISBN:99927-634-0-X, fq 153

³⁵ Holland, Thomas Erskine (1898), “The Execution of the Treaty of Berlin”, Studies in International Law, Oxford:Clarendon Press, p. 227, retrieved 2013-02-02.

Periudha që shoqëroi para e pas Kongresin e Berlinit, shqiptarët ishin të braktisur e të kërcënuar. Kolapsi i Perandorisë Osmane, nxitja e shteteve sllave të Jugut dhe Greqisë nga revanshi Rus, po e trysnonin jashtëzakonisht faktorin shqiptar. Shqiptarët, ishin jashtë çdo agjende ndërkombëtare, por reagan lokalisht. Mbështetja racore-fetare Ruse ndaj popujve të veçantë në Ballkan, i bëri shqiptarët për herë të parë në historinë e tyre të shkëputeshin gradualisht nga çdo lloj mbështetje politiko-ushtarake me popujt përreth tij në fazën e fundit të rënies së Perandorisë Osmane. Shqiptarët mbajtën qëndrim të tërhequr ndaj fqinjëve dhe lançuan projektet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

3.2. Sfidat diplomatike të shqiptarëve në fund të shek. 19-të dhe fillim të shek. 20-të.

Lëvizja shqiptare drejt pavarësisë në fund të shek. XIX-të dhe fillimi i shek. XX-të u intesifikua dhe ngriti peshë gjithë trevat shqiptare, ndërsa Monarkitë fqinje me mbështetjen Ruse e politika konspirative, vazhduan me *“Megali Idenë”* e *“Naçertanien”*. *“Shekulli pasues do shënonte lëvizje të tjera shqiptare drejt pavarësisë”*³⁶. Gradualisht po plekseshin politika e forcës me forcën e politikës dhe dëndësimi i aksionit politik shqiptar drejt kancelarive të mëdha vendim-marrëse të kohës. Në fillim shek. 19-të, diplomacia shqiptare ishte kontribut më së shumti nga jashtë brenda dhe mbas shpalljes së pavarësisë 1912 do kalonte nga brenda jashtë. Komuniteti i shqiptarëve në Stamboll, Bukuresht e më pas edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës do i jepnin zërin dhe zemrën kryengritjeve mbarë shqiptare. Përfaqësuesit shqiptarë *“nisën të kuptojnë që Shqipëria ishte vend me interesa të mëdha për fqinjët e fuqitë e kohës”*³⁷. Ndryshimet, përplasjet e konflikte interesash, faktori diplomatik shqiptar filloi t’i përdorte për herë të parë në favor të shpalljes pavarësisë së vendit dhe krijimit të shtetit shqiptar.

Për shqiptarët dy fuqitë kryesore të kohës, Austro-Hungaria dhe Italia, ndonëse ishin në rivalitet të dukshëm gjeopolitik në dete dhe në Ballkan, ishin mbështetëset kryesore. Këto fuqi kishin përkim interesash, herë paralelisht herë me kryqëzime të forta, por do të përkrahnin krijimin e shtetit të pavarur shqiptar.

Britania e Madhe si mbreti i deteve, filloi të rikonsideronte të gjithë ata faktorë bregdetarë, të cilët ishin në favor të kufizimit të pranisë dhe influencës sllavo-ruse në të gjithë rajonin. Faktori shqiptar ishte i fuqishëm dhe konsistent kundër çdo synimi strategjik sllavo-rus në detet e ngrohta. Konjunkturat krejtësisht të reja, të paparashikuara dhe mjaft të favorshme ishin sfidë për diplomacinë shqiptare.

Në Evropë njohja mbi shqiptarët ishte e dobët dhe plot keqinformime. Shqiptarët ndaj aleancës fetare e racore të Ruisë me sllavët e helenët, qëndruan neutralë. Rusia e Monarkitë fqinje përdorën argumentin kryesor të qenit e shqiptarëve shumicë myslimane, duke i quajtur myslimanë turq, ndërsa konfesion katolik e ortodoks e grekë e mbeturina romake. Evropa aristokratike, konservatore e fanatike kristiane, përfshirë edhe Rusinë, anti-myslimanizmi ishte modë dhe trashëgimi e politikave influencuese të kishës në Perëndim e Lindje.

³⁶ Sabri Maxhuni, *Konspiracioni antishqiptar Sllavo-Grek*, Prishtinë, 2011, ISBN:978-9951-585-29-3, faqe 30-32

³⁷ Bashkurti L, *Shqiptarët në Rrjedhat e Diplomacisë*, Tiranë 2002, ISBN:99927-832-9-X, fq 157

Shqiptarët kishin identitet të bazuar në një gjuhë, një komb, një flamur. Doktrina politike shqiptare ishte ngritur mbi konceptin e saj për një shtet laik, të tipit Perëndimor dhe të një shkolle e gjuhe të shkëputur nga institucionet fetare dhe me bazë indoevropiane latine. Mosinformimi, dezinformimi dhe keqinformimi europian ishte sfidë e nevojë për gjigandët shqiptarë të identitetit, gjuhës e kulturës shqipe si dallueshmëria themelore e shqiptarëve. Lartësimi i promovimi i harmonisë multi-fetare të popullit shqiptar ishte axhendë që përmbante aksion kulturor të brendshëm dhe *“diplomaci moderne Evropiane në kancelaritë dhe median më prestigjioze të kohës”*³⁸. Sfidë shqiptare qëndronte tek politika, fuqia, kultura. Në këtë kompleksitet të karakterizuar nga këto tre opsione, tre kultura dhe tre orientime gjeopolitike ndërkombëtare me raportet, balancat e zhbilancat ndërmjet tyre do të përcaktohej, ose më saktë do të vetëpërcaktohej pozicionimi i ndërgjegjes elitare të lartë të popullit shqiptar.

Përcaktimi i profilit të alfabetit shqip e rikthyen shqiptarët në idenditetin e tyre të mohuar për rreth pesëqind vjet nga regjimi otoman. Kongresi i Manastirit me në krye të debatit akademikun At Gjergj Fishta, personalitet i madh shoqëror, politik, shkencor e enciklopedik u shëndërrua një nga faktorët kryesorë vendimarrës mbi përcaktimin e alfabetit shqiptar të bazuar në gërma latine.

Përpjekjet e diplomacisë shqiptare në këto rrethana u lidhën vetëm me opsionin luftës për pavarësinë e Shqipërisë. Diplomacia shqiptare u përfaqësua nga personalitete si Ismail Qemali, Hasan Prishtina dhe Luigj Gurakuqi. Puna e tyre u fokusua duke konsideruar interesat e Austro-Hungarisë, Italisë me të shqiptarëve. Tezat kryesore të lançuara nga këto personalitete lidheshin me pavarësinë e vendit ndaj Portës së Lartë dhe mbrojtja territoriale ndaj pretendimeve ekspansioniste të monarkive fqinje ndaj Shqipërisë.

3.3. Ismail Qemali – lider drejt të ardhmes së Shqipërisë së pavarur.

Ajo që ishte paralajmëruar nga rilindasit shqiptarë në mesin e shek. 19-të po instalohet në dekadat e fundit të shek. 19-të. Naum Veqilharxhi (1846) shprehej; *“Është koha të hedhim poshtë të gjitha paragjykimet e vjetëruara, është koha të mbledhim veten dhe të gjykojmë më me pjekuri dhe më me burrëri, të ndërrojmë taktikë, duke marrë që tani e tutje si shembull kombet e përparuara të botës,...me vullnetin e Perëndisë, shpresojmë të vihemi në radhën e kombeve të qytetëruara,...le të shkojmë përpara me ballë hapur, me guzim, durim dhe me këmbëngulje”*³⁹. *“Protokolli Nr. 13”*, i Traktatit të Berlinit për Greqinë mbi Epirin; *“Neni 28”* i Traktatit të Berlinit për Malin e Zi lidhur me Plavën dhe Gucinë 170; dhe *“Protokolli i Stambollit”* për Hotin, Grudën, Kastratin dhe Kelmendin, ishin akte që dëshmuuan padrejtësinë ndaj popullit shqiptar⁴⁰.

Pashko Vasa (1879), shkruante; *“Të ngresh besimin fetar në parim kombësie dhe të marrësh dogmën për racë apo ritin për atdhe, nuk është aspak e pranueshme”*⁴¹, ndërsa kombet në kuadër të Perandorisë Osmane i gjeti në proces maturimi dhe shtetformimi. Abdyl Frashëri formuloi

³⁸ Bashkurti L: Bashkurti L : “Çamëria në rrugën e zgjidhjes”, Geer, Tiranë 2012, ISBN:978-9928-105-18-9, fq 161

³⁹ Blakaj S & Ismaili I; “Letërkëmbime të Rilindjes Kombëtare Shqiptare”. Prishtinë: ARBI Ltd; New York: Vatra, 2014, ISBN:978-9951-452-13-7, fq 119

⁴⁰ Treaty of Berlin, Protocol, No. 13, 1878. & Treaty of Berlin, Article 28, 1878. & Protocol of Istanbul, 1880.

⁴¹ P. Vasa, Përmbledhje shkrimesh, Tiranë, 1982.

konceptin filozofik për kombin shqiptar në prag të themelimit Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ishte formulim mjaft i plotë e që i qëndron edhe kohës sonë, jo vetëm për kombin shqiptar, por dhe për kombet në përgjithësi. Kombi dallohet nga elementë, siç janë gjuha e përbashkët, territori i përbashkët, historia e përbashkët dhe jeta shpirtërore e përbashkët. Definicioni mbi kombin dhe shtetin determinoi të gjithë mendimin filozofik e politik, arsimor e kulturor shqiptarë gjatë dhe pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Krahasuar me filozofinë e kohës, përcaktohet si një prej definicioneve më të qëndrueshme të kombit e shtetit deri në kohët moderne. Për krerët e Rilindjes *“feja e shqiptarit është shqiptaria”*⁴², ku Europa do bindej se *“shqiptarët i shërbejnë çështjes së njerëzimit dhe të qytetërimit më mirë se çdo popull tjetër i Lindjes”*⁴³.

Jeta dhe veprimtaria e Ismail Qemalit është një spirale e gjatë që fillon në Vlorë, rritet dhe formohet në Janinë, Selanik, investohet si shtetar i Perandorisë Osmane në dy anëve të Bosforit dhe përfundon themelues i shtetit shqiptar. Familja e Ismail Qemalit përfaqësonte një nga familjet më të pasura e patriotet të Vlorës. Ismail Bej Vlora, gjyshi i tij, ishte në favor të kryengritjes për panvarësinë e Greqisë dhe u *“vra nga turqit sepse nuk luftoi kundër revolucionit grek të viteve 1821-1829”*⁴⁴. I ati Mahmut bej Vlora mori pjesë në kryengritjet shqiptare kundër Tanzimatit, por kundërshimi ndaj këtij sistemi taksash e tatimesh të Portës së Lartë, solli largimin nga Vlora dhe *“internimin për disa vjet në Selanik dhe në Konjë të Azisë së Vogël”*⁴⁵.

Në Selanik familja e tij gjatë qëndrimit tre vjeçar, kishte mbrojtjen e përkujdesjen e konsullit francez dhe nëna e tij Hedija krijoi lidhje miqësore me familjet më të mira të Selanikut, myslimane, të krishtera dhe hebreje. Ismail Qemalin mësoi turqishten qysh i vogël dhe në Vlorë vazhdoi studimet në turqisht dhe mori mësim në italisht. Shkollimin në shqip e mori nën drejtimin e të atit dhe nënës së tij. I ati kishte marrë arsim evropian, dinte me shkrim e këndim turqishten, italishten dhe greqishten, kuptonte frëngjishten dhe që në vogëli e ushqente Ismailin me *“zell dhe shije për kulturën evropiane”*. Në vitin 1856, Ismail Qemali vazhdoi studimet në gjimnazin Zosimea të Janinës. Në maj 1860 u largua nga Janina dhe shkoi për në Stamboll, nën ndihmën e ministrit të Punëve të Jashtme Fuat Pasha, punoi *“në zyrën e përkthimeve të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe vazhdoi studimet për drejtësi”*⁴⁶. Hyrja në administratën osmane në moshë të re, kur kjo drejtohej nga personalitete si Mid’hat Pasha, Fuad Pasha, Aali Pasha e Rexhep Pasha do shoqëronin Ismail Qemalin gjatë gjithë jetës së tij statura prej shtetari dhe mbartës i vlerave liberale. Karriera ishte e shpejtë, e ndriçuar dhe veçanërisht kur *“bashkëpunoi me burrin e shtetit liberal, të famshmin Mid’hat Pashën”*⁴⁷.

Jeta politike e Ismail Qemalit u formua dhe zhvillua me fillimin e Krizës Lindore, me ekulibrat e rinj European dhe shpërbërjen e Perandorisë Osmane. Ai ishte dëshmitar i kulisave, ndryshimeve politike e territoriale të Gadishullit të Ballkanit dhe shpërbërjes së Turqisë

⁴² Pashko Vasa, Poezia, *“O moj shqypni”*, Historia e Letërsisë Shqipe, ASH e RPSSH, Tiranë, 1980.

⁴³ Historia e Shqipërisë, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, A. Frashëri, (Bashkurti L, 2013:402)

⁴⁴ Johannes Faensen: *“Die albanische national bewegung”*, Berlin, 1980, fq. 135

⁴⁵ AQSH, Fondi 20, Dosja 1

⁴⁶ Qemali I, *“Kujtime”*, Botimet Toena, Tiranë, 2009, ISBN:978-99943-1-558-1, fq 37-44

⁴⁷ Falaschi R, *“Ismail Kemal Bey Vlora – Mendimi dhe Veprimtaria nga Dokumentet Italiane”*, Bardi Editore, Roma, Luglio 1985, fq 278

Europiane. Eksperiencat e pafund për një periudhë rreth 40 vjeçare në poste të rëndësishme e mësoi dhe trashëgoi shumë dhunti në punë administrimi. Ismail Qemali ishte i ndikuar nga idetë liberale dhe modelet e administrimit dhe qeverisjes. Ismail Qemali projektoi edhe konceptoi rregullimin origjinal të Shqipërisë, ishte një luftëtar i paepur i çështjes kombëtare dhe luftoi me sukses “*interesat dhe synimet e ndryshme rajonale*”⁴⁸.

Gjatë qëndrimit në Greqi ambasadori francez në Athinë raportonte se Ismail Qemal bej Vlora u prit nga Mbreti Gjergj I-rë, politikanë grekë, Ministri i Marinës, një arvanitas dhe Lidhja Shqiptare e Athinës⁴⁹. Në Greqi u njoh me ambasadorin e Britanisë së Madhe me korrespondentin e gazetës Times e personalitete të huaja. Ismail Qemali, përballë qendrave kryesore në Shqipëri e bashkëatdhetarëve, shpjegoi arësyet që e detyruan të linte detyrën shtetërore në shërbim të Perandorisë dhe më tej skicoi programin politik, që duhet ndjekur për të shpëtuar Shqipërinë nga një katastrofë kombëtare. Në një përgjigje gjaku Ismail Qemalit ju shprehën; “*Bej, mos e lër veten të të marrin përpara këta kokënxehtë, bëj çmos të ngrësh një Shqipëri të lirë për ne, në mënyrë që ne të gjithë të bashkohemi atje*”⁵⁰.

Mbrojtja e kauzës shqipëtare ishte një nga dëshirat që mund të realizohej nga një organ shtypi. Bashkë me pronarin e gazetës *Albania*, bashkëatdhetarin Faik Konica botuan gazetën në Bruksel, drejtoi gazetën e shkruar në turqisht, përkthye e botuar në anglisht, frëngjisht dhe arabisht. Me largimin e Faikut hapi gazetën, *Le Salut de l’Albania* shtypur në shqip, turqisht e greqisht. Gazeta shërbeu për mbrojtjen e kauzës së përbashkët të popujve të lindjes dhe për mbrojtjen e interesave të popullit shqiptar.

Ismail Qemal bej Vlora ishte me kulturë greke, ishte reformator dhe kundërshtar i pansllavizmit, anonte në një marrëveshje shqiptaro-greke në rast të shpërbërjes së Perandorisë Osmane dhe pranonte mendimet në favor të një veprimi të përbashkët kundër sllavizmit që në atë kohë përfaqësonte një rrezik për të dy popujt. Disa interesa dukeshin të njëjta me ato të popullit grek, pranoi shprehjen e opinioneve në mbrojtje të interesave të dy popujve kundër sllavizmit. Ismail Qemali mendonte se përballë pansllavizmit, fati i Shqipërisë dhe ai i Perandorisë Osmane ishin të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin, “*rënia e Perandorisë do të sillte edhe atë të Shqipërisë; copëtimi i Shqipërisë do sillte humbjen e Rumelisë, dhe atë të Stambollit. Prandaj duhet të konsolidohej qeveria e pronvincave osmane*”⁵¹.

Referuar autorë të ndryshëm Greqia e mbështeti shqiptarizmin e Ismail Qemalin me qëllim të “*nxiste zhvillime të caktuara në Jugun e Shqipërisë në përshtatje me qëllimet e saj*”⁵². Ofertat nga Sulltani nuk munguan, ndërsa Ismaili krijoi bindjen se mund të siguronte gjithçka donte prej Sovranit, përfshirë karrierë personale, përfitime të ndryshme, por “*absolutisht asgjë për të mirën e vendit*”⁵³. Udhëtimet e Ismail Qemalit ishin shqetësim për Sulltanin. Ai ishte me mendje të

⁴⁸ Hoti I, “Qëndrimi i Diplomacisë Italiane ndaj Shqipërisë dhe Shqiptarëve 1930-1941”, Insituti i Historisë – Prishtinë, Prishtinë 1997, fq 166

⁴⁹ Clayer N, “Në fillimet e nacionalizmit shqiptar”, botimet përpjekja, Tiranë 2009, ISBN:978-99956-786-0-9, fq 448

⁵⁰ Qemali I, “Kujtime”, Botimet Toena, Tiranë, 2009, ISBN:978-99943-1-558-1, fq 336

⁵¹ ASMAE, Serie P.Politika, Pacco 665, Athens, 21/2/1902

⁵² Clayer N, “Në fillimet e nacionalizmit shqiptar”, botimet përpjekja, Tiranë 2009, ISBN:978-99956-786-0-9, fq 450

⁵³ Qemali I, “Kujtime”, Botimet Toena, Tiranë, 2009, ISBN:978-99943-1-558-1, fq 337

ngritur nga Europa dhe po mundohej të krijonte pengesa Ismail Qemalit ndërmjet përfaqësuesëve të tij. Në Napoli, Romë u njoh më shumë politikanë dhe bashkë atdhetarë shqiptarë me banim në Itali. Takoi Francesco Crispin, Ministrin e Punëve të Jashtme Emilio Visconti Venosta dhe statistin e ardhshëm Sidney Sonnino.

Sulltani përdori agjentë në mbarë Shqipërinë e zhvilloi propagandë kundër Ismail Qemalit. Ofertat nga njerëz të afërt deri tek djali i tij i madh, që shërbente si oficer marine, nuk munguan me porosi nga Sulltani, ndërsa Ismail Qemali vazhdoi vizitat në Egjipt, Greqi e në Londër. Ismail Qemali deklaronte se nuk kishte të bënte me politikën, ndërsa gjykata e Strambollit, e dënoi me vdekje në mungesë, humbjen e të drejtave civile, gradës, meritave, dekoratave dhe pronave.

3.4. Ndikimi i Monarkisë Austro-Hungareze dhe evoluimi i Ismail Qemalit nga autonomia drejt pavarësisë.

Shqiptarët përballë Aleancës Ballkanike ishin neutralë, por anti-osmanë. Në dekadën e parë të shek. XX-të *Koncertit të Evropës po i këndohej funerali*⁵⁴, aleancat zëvendësuan harmoninë me bazë interesat gjeopolitike të shteteve nacionale kryesore të Kontinentit. Ballkani, mbas bashkimit të Gjermanisë dhe Italisë u shndërrua në zonë interesi prioritar për Monarkinë Dualiste Austro-Hungareze, ndërsa Rusia synonte të dilte përmes kanaleve kryesore drejt Detit Mesdhe. Gjermania e Kajzerit fuqizoi aksine Evropës Qendrore me qëllim shtyrjen e Ruisë në Lindje dhe dobësimin e Francës në Perëndim ndërsa Rusia po mblidheshin gjithë popujt sllavë të Evropës Lindore dhe Ballkanit. Ballkani kishte qënë synimi i Krizës Lindore dhe do shpërthente Luftën e Parë Botërore. Italia po fuqizohej e hynte në Ballkan në fillim të shek. XX-të, me synim shtrirjen e pranisë së saj në Mesdhe. Fuqitë e Aleancës kishin interesa të përbashkëta por edhe mospërputhje e përplasje interesash lidhur me daljen në dete. Bashkëpunimi dhe rivaliteti Italo-Austriak do të linte gjurmët në atë kohë mbi zgjidhjen e çështjes shqiptare.

Revolucioni Xhon Turk nuk modernizoi Perandorisë Osmane, por provokoi lëvizje të fuqishme kundërshtuese anti-osmane, politike dhe ushtarake. Italia, Austro-Hungaria, Monarkitë fqinje, Serbia, Mali i Zi e Greqia synonin të godisnin drejtpërdrejtë mbi territoret Evropiane Turke, territore shqiptare.

Diplomatë të shquar si Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi dhe Hasan Prishtina u përfshinë në aksion diplomatik ndërkombëtar dhe riprovonin se shqiptarët kishin qënë të aftë për të fituar lirinë e tyre me armë, por *“nuk e kishin materializuar atë kur ishte vënë puna në tryezat diplomatike”*⁵⁵. Sfidat diplomatike synonin njohjen e identitetit shqiptar, paraqitjen e kërkesave legjitime, paraqitjen e lakmive territoriale të monarkive fqinje dhe njohjen ndërkombëtare të shtetit të pavarur shqiptar. Dinamika e mendimit diplomatik ndërmori ture diplomatike nga Stambolli, Vjena, Italia, Franca, Bukureshti, Budapesti deri në kurorëzimin e pavarësisë.

⁵⁴ Bashkurti L, “Koncerti dhe Funerali 1815-1914, Shqiptarët - Ballkani - Fuqitë e Mëdha”, Geer, Tiranë 2013, ISBN:978-9928-07-211-5, fq 514

⁵⁵ Gazeta “Liri e Shqipërisë”, datë 30, Vjeshtë III, 1912.

Diplomacia e Ismail Qemalit i informoi qartësisht Italinë dhe Austro-Hungarinë, se alternativat e tyre mbeteshin ose të mbështesnin sllavët në Ballkan, ose të mbështesnin osmanët, ose të siguronin *mbështetjen Austro-Italiane për një Shqipëri më vite*⁵⁶. Koncerti i Vjenës u nda përgjysmë lidhur me çështjen shqiptare. Vjena më herët kishte kërkuar Perandorisë Osmane *zbatimin e politikës së decentralizimit*⁵⁷, dhe konsiderimin e kërkesave të shqiptarëve. Shqipëria, po siguronte në avancë mundësinë e njohjes ndërkombëtare të pavarësisë së saj, që ishte kusht i Traktatit të Vjenës 1815. Rusia e aleatët e saj pranonin një Shqipëri kuadrate në qendër të saj, Franca anoi në anën e Rusisë dhe të aleatëve të saj ballkanikë kundër shqiptarëve. Britania e Madhe, ishte në idenë se në çdo formulë zgjidhje në Ballkan duheshin konsideruar shqiptarët. Britania nxiti Italisë drejt Ballkanit, për të dobësuar lidhjen Gjermani, Austro-Hungari, Itali dhe futi rivalitetin Italo-Austriak në territoret shqiptare; për të ulu rolin e saj në Afrikën e Veriut, ku Britania dhe Franca po ndërtonte sistemin para-kolonial.

Në pranverën e vitit 1912, në prag të Luftës së parë Ballkanike, dinamikat e lëvizjes shqiptare u shtrinë në dy dimensione: në dimensionin kryengritës dhe në dimensionin diplomatik. Dimensionin kryengritës zhvillohej brenda vendit, ndërsa ai diplomatik zhvillohej në terrenet ndërkombëtare. Kryengritjet filluan në Kosovë për t'u shtrirë hap pas hapi në të gjithë territorin e Shqipërisë, duke përfshirë të katër Vilajetet. Në trojet shqiptare, Qeveria Osmane, përsëriste tekstin "*për të bërë reforma*" dhe mbështete kandidatët e KBP të Xhonturqve për në Parlamentin Osman. Këto reforma ishin "*shtypje dhe shtrëngime të reja që ndezën një zjarr të ri*" në Shqipëri⁵⁸. Hasan Prishtina i kishte kërkuar shefit të diplomacisë së Perandorisë Osmane se ishte në interesin e shtetit osman që "qeveria t'i deklaronte zyrtarisht kufijtë e Shqipërisë". Hasan Prishtina ripërsëriste Sami Frashërin që ishte shprehur para një dekade; "*Duhet një orë e më parë të ndahet Shqipëria dhe të dihet që ku e gjer ku është. Të njihet vendi ynë për Shqipëri, dhe ta njohë edhe Evropa Shqipëri*"⁵⁹. Qeveria Xhonturke nuk e pranoi këtë kërkesë të përfaqësuesit të lartë të shqiptarëve. Në fillim të vitit 1911, deputetët shqiptarë deklarojnë largimin nga partia "*Bashkim e Përparim*" për shkak të mungesës së lirisë dhe persekutimet e qeverisë ushtarake ishin bashkatdhetarët e tyre. Esat Pasha në cilësinë dhe detyrën si deputet shqiptar, "*të protestoja energjikisht e të bashkohesha me kundërshtarët e qeverisë aktuale për të mbrojtur të drejtat e polpullit që kam nderin të përfaqësoj. Për këto pasoja të rënda vendosa të shkëputem nga grupi i Komitetit për t'iu kushtuar tërësisht mbrojtjes së të drejtave tona kombëtare*"⁶⁰.

Dështimi i përpjekjeve për të shmangur luftën shqiptaro-osmane dhe për të njohur pavarësinë e Shqipërisë, i hapën rrugë konfrontimit shqiptaro-osman. Të gjitha komitetet shqiptare, brenda dhe jashtë atdheut filluan organizimin, furnizimin e luftëtarëve për Kryengritjen e Përgjithshme Antiosmane. Kryengritja shqiptare shpërtheu në Kosovë, Manastir, Korçë, Çamëri, Vlorë, Dibër,

⁵⁶ Puto A, "Panvarësia Shqiptare dhe Diplomacia e Fuqive të Mëdha, 1912-1914", "8 Nëntori", Tiranë 1978, fq 94

⁵⁷ Cana Z, "Politika e Sërbisë kundrejt Çështjes Shqiptare 1903-1913", Insituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 2006, ISBN:9951-411-31-2, fq 223

⁵⁸ Luigj Gurakuqi, "Shkrime dhe Kujtime", Tiranë 1978.

⁵⁹ Sami Frashëri, Vepra, Tiranë 1978.

⁶⁰ Gazeta "Corriere d'Italia, 20.1.1911; Intervista col deputato hessad pascia, (Biblioteka Kombëtare Tiranë, nr 87 C 73).

Elbasan e gjetkë. Aksionit ju bashkuan edhe kolonitë shqëiptare në Sofje, Bukuresht, Kajro, Aleksandri, SHBA duke sensibilizuar edhe kryeqendrat e botës. Xhonturqit u përpoqën të likuidonin organizatorin kryesor të Kryengritjes, Hasan Prishtinën i cili në janar të vitit 1912 në Stamboll, ishte ngarkuar me përgjegjësinë e udhëheqjes së Kryengritjes Antiosmane. Hasan Prishtina u përpoq të sigurojë mbështetje antiosmane nga Britania e Madhe dhe Austria. Për këtë qëllim bisedoi me diplomatët e Londrës dhe Vjenës në Shkup, por Londra dhe Vjena nuk mund të përfshiheshin në këtë fazë, ato vijonin *status quo*-në me Portën e Lartë. Dukej qartë se shqiptarëve nuk u mbetej alternativë tjetër përveç mobilizimit të faktorëve të brendshëm kombëtar. Në maj 1912 shkoi në Kosovë dhe ndikoi në bashkimin e forcave kryengritëse nën një komandë brenda vendit, nën vendimeve të Kuvendit të Junikut. Ismail Qemali, në maj 1911 hyri në kontakt me krerët Mirditorë dhe me malësorët, dhe në qershor i shoqëruar nga Luigj Gurakuqi shkoi në Mal të Zi dhe *“pas negociatave i drejtua në frëngjisht një memorandum autoriteteve osmane, i njohur nën emrin memorandumit i Gërçes”*⁶¹.

Memorandumi me 12 pika ishte Programi Politik i Kryengritjes së Përgjithshme Shqiptare Antiosmane⁶². Ismail Qemali ishte shpirti i këtij teksti, ishte mbrojtës i territoreve e kombit shqiptar, por edhe i *“decentralizimit dhe kushtetueshmërisë së sistemit politik osman”*⁶³. Programi afirmonte unitetin mbarë kombëtar shqiptar. Kërkesat themelore ishin; njohja e autonomisë së Shqipërisë, përdorimi i gjuhës shqipe në administratë, përdorimi i alfabetit kombëtar të Manastirit, ngritja e flamurit kombëtar në të gjithë vendin, emërimi i një stërnipi të familjeve “princërore” shqiptare si guvernator të përgjithshëm dhe garancia e fuqive të mëdha për plotësimin e këtyre kërkesave. Ismail Qemali theksonte që Shqipëria nuk dëshiron shkëputjen nga Perandoria Osmane, por ruajtjen e karakterit të saj kombëtar, kundërshtonte dhe mbronte shqiptarët, pa dallim feje e ndasie. Aspiratat e shqiptarëve janë të ligjshme dhe jo të tepërta. Kërkohej zbatimi i ligjit, liria e garantuar me Kushtetutë dhe reforma të rendit administrativ e ekonomik.

Pak para shpërndarjes së Dhomës së deputetëve, në fund të vitit 1911, Hasan Prishtina kishte deklaruar në Asamble se nëse qeveria nuk ndryshonte politikën qeverisëse ndaj shqipëtarëve e ndaj të drejtat e tyre, *do të kishte një kryengritje dhe ai i pari do të mbante në dorë flamurin e revolucionit*⁶⁴. Zgjedhjet e pranverës të vitit 1912, KBP kishte marrë masa të nxirrte fitues në zgjedhje kundërshtarët e udhëheqësve kryesorë shqiptarë. Ismail Qemali përballë njeriut të tij Syrja bej Vlora pësoi një humbje të rëndë, ndërsa dy prej udhëheqësve kryesorë të vilajetit të Kosovës, Hasan Prishtina dhe Ferhat Draga, kishin kërcënuar me kryengritje nëse qeveria ndërhynte në procesin elektoral. Ismail Qemali u kërkoi *mbështetësve të tij të përgatisin çeta të armatorura*⁶⁵, dhe bashkë me Luigj Gurakuqin, krahu më aktiv diplomatik kryesuan udhëtimin nëpër kancelaritë Evropiane.

⁶¹ Clayer N, “Në fillimet e nacionalizmit shqiptar”, botimet përpjekja, Tiranë 2009, ISBN:978-99956-786-0-9, fq 625

⁶² Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë & Instituti i Historisë, “Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912”, Kombinati Poligrafik, Shtypshkronja “Mihal Duri” – Tiranë 1978, fq 223-226

⁶³ G. W. Gawrych 1980:327-329 & Stavro Skëndi 1967:416-417 (Clayer N, 2009:626)

⁶⁴ Prishtina H 1921:5; Kondis 1976:65; Gjukë 1991:20

⁶⁵ Clayer N, “Në fillimet e nacionalizmit shqiptar”, botimet përpjekja, Tiranë 2009, ISBN 978-99956-786-0-9, fq 628-629

Në memorandumun e Gërçës, në thirrjet e Ismail Qemalit, Hasan Prishtinës e patriotë të tjerë shqiptarë, deri në verën e vitit 1911, shprehni zotimin për lidhje me Perandorinë Osmane. Shfaqja e qëllimeve të Turqve të Rinj dhe konflikti me Italinë do të sillte një luftë të përgjithshme në Ballkan e përfshirje edhe të Shqipërisë. Ismail Qemali nga Nica i drejtohej qendrave shqiptare, duke ju kujtuar detyrën e ngutshme e qëndrimin në gadishmëri. Në dhjetor 1911 deputetët shqiptar në Stamboll i paraqitën përsëri qeverisë memorandumun me kërkesa për *“reforma politike, ekonomike dhe kulturore në Shqipëri”*⁶⁶. Ndërsa Xhonturqit më janar 1912 shpërndanë parlamentin me qëllim që pas zgjedhjeve të reja në parlamentin e ri të kishin shumicën, Ismail Qemali u nis për në Shqipërinë e Jugut, Esat Toptani në Shqipërinë e Mesme, ndërsa Hasan Prishtina në Kosovë. Dobësia e Turqisë dhe premtimi për konçesione shqiptarëve në katër vilajete, i bëri Aleatët Ballkanikë të mendonin se kërcënoheshin direkt kombet e krishterë. Protestat shpërthyen në Bullgari, Serbi, Greqi e në Rusi. Arsyetimi ishte se *“këto konçesione përbëjnë rrezik për të krishterët e gadishullit ballkanik, duke qënë se ato sjellin më pas autonominë e katër vilajeteve shqiptare”*⁶⁷. Serbët kundërshtuan planin e një *“Shqipërie të Madhe”* duke nxjerrë planin e tyre *“Naçetania”*, ndërsa Greqia në mënyrë sekrete vazhdoi politikën tradicionale të saj, atë të *“Megali Idesë”*. Sipas Berchtold, Turqia kishte ndërmend t’u jepte shqiptarëve privilegjet e tyre tradicionale dhe lejimin e gjuhës shqipe si gjuhët e tjera. Konçesioni turk ndaj shqiptarëve nuk dëmtonte interesat e popujve ballkanikë dhe të atij turk.

Kuvendi i Junikut u mbajt në 21-25 maj 1912 për unifikim të aksionit politiko-ushtarak mbarë shqiptar, ndërsa shtetet fqinje organizuan Aleancën Ballkanike Greko – Serbo - Bullgare e mbështetur politikisht, diplomatikisht dhe ushtarakisht nga Rusia. Neutralitetin e shqiptarëve, Monarkitë fqinje e konsideruan besnikëri ndaj Portës dhe *“provë e paaftësisë së tyre për vetëqeverisje”*⁶⁸, ndërsa xhonturqit ndërmorën një ofensivë damkosjesh kundër vendimeve të Junikut. Hasan Prishtina iu drejtua shqiptarëve liridashës dhe botës së qytetëruar, me thirrjen se shqiptarët *“pas përpjekjeve të pafrytshme për sigurimin e të drejtave kombëtare me mjete ligjore, përmes zbatimit të kushtetutës, shqiptarëve nuk u mbeti rrugë tjetër veç asaj të rrëmbimit të armëve. Është momenti kur vendoset fati i Shqipërisë: vdekja ose liria e saj”*⁶⁹.

Me fillimin e luftës shqiptarët nuk ishin të unifikuar në një qëndrim. Përfaqësuesit e kolonive shqiptare në SHBA, në 6 tetor 1912 në Boston, theksonin se *“...duke marrë parasysh faktin se po thyhet Turqia, shtetet ballkanike do ta copëtojnë Shqipërinë. Detyra e patriotëve shqiptarë është të bashkohen plotësisht me qeverinë otomane kundër armiqve të perandorisë”*⁷⁰ dhe malësorët katolikë mendonin se bashkëpunimi me Malin e Zi synonte çlirimin nga turqit, ndërsa *“Shoqëria e Zezë për Shpëtim”*, në mbledhjen 14 tetor 1912 në Shkup, shkëputi malet e Shkodrës prej lidhjes e bërë me Malin e Zi dhe apelon kapjen e armëve për t’i dalë zot tërësisë tokësore e lirisë së Shqipërisë. Në apelin drejtuar Fuqive të Mëdha theksohej se shqipëtarët luftojnë jo për të mbrojtur Turqinë në Ballkan, por për ti dalë zot territoreve dhe lirisë së

⁶⁶ Historia e Shqipërisë, Tiranë 1965, vëllimi II, fq 318

⁶⁷ Korespondenca diplomatike e Austro-Hungarisë 23 korrik 1908 – 12 tetor 1912”, fq 67.

⁶⁸ Puto A, Pavarësia Shqiptare dhe Diplomacia e Fuqive të Mëdha, 1912-1914, Tiranë, 1978, Faqe 77.

⁶⁹ Hasan Prishtina. Vepra, ASH e RPSSH, Tiranë, 1984.

⁷⁰ Historia e Shqipërisë, vëllimi II, Tiranë 1965, fq 353

Shqipërisë. “Pra, qysh prej sodit po Ju deklarojm se sido që të jet fati i armëve, shqiptarët nuk kan me pranue për katër vilajete veçse një formë politike e një formë sundimi”⁷¹. Ismail Qemali mendonte se shqiptarët nuk duhet të merrnin pjesë në luftën që Serbia dhe aleatët i kishin shpallur Turqisë, dhe kur hynë trupat serbe në Durrës u shpreh se; “Shqipëria duhet konsideruar si territor neutral që vetë Fuqitë e mbrojnë në bazë të parimit: Ballkani, popujve ballkanikë”⁷².

Mbi krijimin e Aleancës Ballkanike, Franca dhe Austro-Hungaria u përpoqën diplomatish për moslejimin e saj por dështuan përballë etheve të nacional-shovinizmit që kishte molepsur politikat e monarkive Ballkanike. Monarkitë Ballkanike kishin një objektiv madhor; thyerjen e Perandorisë Osmane, por prapa saj “kishin synime mjaft të ndryshme dhe shpesh kontradiktore midis tyre”⁷³. Perandoria Osmane në vitin 1912 ishte e angazhuar në luftë me Italinë dhe pa u mbyllur konflikti me Italinë plasi lufta në Ballkan. Revolucioni Xhonturk, grushtet e shtetit, përçarjet, grupet rivale që luftonin për dominime politike dhe mosreformimi e mosmodernizimi i armatës osmane, dislokimi në Jemen bënë që osmanët nuk iu përgjigjën dot me shpejtësi shpërthimit Ballkanik. Forcat bullgare në 31 tetor triumfuan në Lule Burgas⁷⁴, Selaniku u pushtua nga forcat greke, serbe, malazeze, izoluan trupat osmane dhe këputi lidhjen me Trakën. Ky ishte momenti dhe ora e shqiptarëve. Lufta e Italo-Turke për Tripolin dhe kokëfortësia e Turqëve të Rinj kishin detyruar shqiptarët të kalonin në kryengritje të përgjithshme. Hyrja e kryengritësve shqiptar në Shkup dhe në Manastir, në maj 1912 i dha fund pushtetit fodull e kriminal otoman dhe shkaktoi shpërndarjen e dhomës së deputetëve.

Serbia, Mali i Zi, Greqia dhe Bullgaria kishin rënë dakord në avancë që të shpërthenin luftën kundër Perandorisë Osmane, përpara se të nisnin shqiptarët kryengritjen e tyre. Serbia e përdori këtë situatë për të arsyetuar shpalljen e luftës nga ana e saj. Palët i trembeshin fuqisë ushtarake të shqiptarëve, nëse do kishte zona të debatueshme, palët kishin rënë dakord që të arbitroheshin nga Cari i Rusisë. Për Ismail Qemalin kishte ardhur koha që shqiptarët të merrnin masa energjike për shpëtimin e tyre, të cilëve ia kishte borxh t’i shërbente deri në fund. Aleanca Ballkanike ishte në luftë me Turqisë, ndërkohë që qeveria osmane mendonte se me masa të buta do të qetësonte shqiptarët. Referuar autorit Mishel de Gres tek libri “Sulltani i fundit”, Ismail Qemali nga viti 1909 refuzoi dy herë rresht postin e Ministrit të Drejtësisë dhe me pas atë të Ministrit të Brendshëm të Perandorisë.

Fillimi i luftës Italo-Turke (fund shtatori 1911) dhe kokëfortësia e xhonturqëve mblodhi në fillim janari 1912 në Stamboll krerëve të lëvizjes kombëtare nga të katër vilajetet. Mbledhja vendosi që në të gjithë trevat shqiptare të organizohej një kryengritje e përgjithshme, fillimisht të ndizej në Kosovë e të zgjerohej edhe në trevat e tjera shqipëtare. Hasan Prishtina u ngarkua të organizonte kryengritjen e përgjithshme, ndërsa Ismail Qemali mbështetjen diplomatike nga Fuqitë e Mëdha. Ismail Qemali do të siguronte edhe armë, municion e të holla për mbështetjen e

⁷¹ Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë & Instituti i Historisë, “Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912”, Kombinati Poligrafik, Shtypshkronja “Mihal Duri” – Tiranë 1978, fq 255-256

⁷² Vico Montegazza, “Questioni di Politica Estera”, Milano 1914, pg 263

⁷³ Bashkurti L, “Koncerti dhe Funerali 1815-1914, Shqiptarët - Ballkani - Fuqitë e Mëdha”, Geer, Tiranë 2013, ISBN:978-9928-07-211-5, fq 541

⁷⁴ Konica F, “28 Vjesht’e Tretë 1912”, Gazeta Kuvendi, Romë, 30 nëntor 1919, fq 7

kryengritjes së armatosur. Hasan Prishtina i hapi rrugë paraqitjes së një memorandumit në emër të të gjithë shqiptarëve në Ferizaj në fillim gushti 1912. Kërkesat e kryengritësve shqiptarëve në memorandumit me 14 pika për autonomi pajtoheshin me politikën ballkanike të Vjenës. Në takimin e Ismail Qemalit me përfaqësuesin serb në Londër qershor 1912, ky i fundit kishte deklaruar se *“Serbia nuk ka asgjë kundër idesë së autonomisë së Shqipërisë dhe se është e gatshme të përkrah kryengritjen shqiptare në të holla, armatim dhe municion”*, por serbët donin ti hapnin rrugë ekspansionit të tyre në drejtim të *“Serbisë së Vjetër”, Shqipërisë së Veriut dhe të Mesme*⁷⁵.

Ismail Qemali, gusht 1912, ju përgjigj ftesës së princit Mirko të Malit të Zi mbi angazhimin kundër osmanëve, e arsyetonte të parakohshmë dhe më e mira ishte kontakt me kabinetin e ri qeveritar. Ismail Qemali synonte arritjen e një marrëveshje dhe se *kishte ardhur koha që shqiptarët të merrnin masa energjike për shpëtimin tonë*⁷⁶. Ismail Qemali ishte i bindur se mbi shpëtimin e Shqipërisë çfarëdo kombinacioni politik mund të merrej me mend, por jo një bashkim me shtetet ballkanike.

Tetori 1912 përbën kulmacionin e lëvizjes kombëtare shqiptare dhe moment i zgjidhjeve të mëdha historike. Lufta ballkanike i imponoi shqiptarëve *“shkundjen nga zgjedha turke”* dhe krijimin e shteti shqiptar më vete, provë e pjekurisë së lëvizjes kombëtare shqiptare. Mbledhja e Komitetit *“Pshtimi”* dhe *“Shoqëria e Zezë”*, 16 tetor në Shkup, ngriti një komision dhe nënshkroi një akt përfaqësimi ku theksohej se nuk do të pranonin kurrë sundimin e serbëve dhe malazezëve. Kërkonin që territoret shqiptare të kishin atë sundim që kishin patur në katër Vilajetet e Shqipërisë. Më 30 tetor, përfaqësia e Kosovës la Gjakovën, përshtoi Hasin, Lumën, Mirëditën, Kurbinin e Milotin me aktin e përfaqësimit mbërritën në Shqipëri të Mesme. Paria e Dibrës e e Krujës u vunë në dijeni se Kosova kishte mbaruar dhe kërkonte ta prisnin në Durrës. Kumanova ra më 24 tetor 1912, e vetmja zgjidhje për çështjen shqiptare mbeti zbatimi i planit *“Akordi shqiptar”*. Referuar korespondencave italo-austriake, *“Akordi shqiptar”* ishte *“krijimi i një organizmi të gjallë,... duke pasur parasysh kriteri nacional për të mbajtur të bashkuara territoret shqiptare, ndërsa markezi San Xhuliano i trembej pretendimeve greke dhe një zgjerimi të serbëve*⁷⁷. Monarkia Austro-Hungareze synonte; mospërzjerje në luftë, ndarje territoriale midis Shteteve Ballkanike dhe krijimi i një Shqipërie më vete të lidhur me Vjenën. Vjena donte *“të kompesonte mungesën e përfitimeve territoriale Austro-Hungareze”*, ndërsa në politikën ballkanike të Italisë bënte pjesë integriteti territorial shqiptar dhe shpallja e pavarësisë.

Skena politike shqiptare evidentoi figura e personalitete të lëvizjes sonë kombëtare të përgatitjes së pavarësisë si Ismail Qemali. Formatit prej diplomati dhe shtetari dhe njohës i afërt i ngjarjeve politike brenda Perandorisë por edhe asaj europiane, në momentin e duhur vendosi gjithçka për të mirën e çështjes kombëtare shqiptare. Aktiviteti i Ismail Qemalit përfshinte iniciativa në kuadrin e Perandorisë, kontakte me grupime nga kombësi të tjera brenda Perandorisë Osmane, bisedime me përfaqësues të vendeve fqinje, prezantimin në Europë të

⁷⁵ Cana Z, “Politika e Sërbisë kundrejt Çështjes Shqiptare 1903-1913”, Insituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 2006, ISBN:9951-411-31-2, fq 218-220

⁷⁶ Qemali I, “Kujtime”, Botimet Toena, Tiranë, 2009, ISBN:978-99943-1-558-1, fq 415

⁷⁷ “L’albania nei rapporti italo-austriaci 1897-1913”, Milano-DOTT. GIUFFRÈ EDITORE-1983, pg 292-293

çështjes shqiptare dhe sigurimin e përkrahjes së tyre. Ismail Qemali ishte i bindur se krahas kryengritjeve mbarë shqiptare kërkohej edhe shfrytëzimi i kontraditave dhe rivaliteteve të faktorëve ballkanikë e europianë. Kërkesave të vazhdueshme të Ismail Qemalit, nga 1909 deri në themelimin e shtetit shqiptar 28 nëntor 1912 ndaj përfaqësuesëve të shteteve ballkanike e europiane, pasqyrojnë evoluimin e mendimit të tij politik nga autonomia tek pavarësia edhe evidentimin e qartë të partnerëve të ardhshëm të shtetit shqiptar.

Përpyekjet e personaliteteve të Rilindjes Shqiptare dhe loja diplomatike e tyre ndikoi tek diplomatët Austro-Hungarezë të marrin në konsideratë faktorët e rinj të skenës ballkanike. Zgjedhjet e pranverës 1912 në kuadrin e Perandorisë Osmane në Shqipëri u shoqëruan me veprime arbitrare të qeverisë xhonturke. Ismail Qemali u angazhua në kryengritjet në Jug dhe siguroi “*transportime të rëndësishme armësh e municioni prej Italie në Shqipëri*”⁷⁸. Diplomacia Dualiste po jepte shenjat e daljes nga qëndrimi i saj i rezervuar. Më 10 gusht 1912 diplomacia Austro-Hungareze shprehej se nuk do “*pengonte me trupin e saj evolucionin e procesit historik në Turqi*”⁷⁹. Shpërthimi i luftës I-rë Ballkanike dhe pozicioni indiferent i Portës së Lartë ndaj shqiptarëve se “*me masa të buta*” se do qetësonte shqiptarët, për Ismail Qemalin ishte momenti për masa energjike për shpëtimin e trojeve shqiptare. Në fund të tetorit 1912, Berchtold arriti në Romë dhe u takua me mbretin dhe markezin San Xhuliano. Evoluimi i ngjarjeve ballkanike ishte i madh por pozicioni i tyre në raport me Shqipërinë nuk ndryshoi. Konsultimet midis Vjenës e Romës vijuan për fizionominë e ardhshme të Shqipërisë dhe caktimin e kufijve, përfaqësuesi rus pranonte idenë e formimit të një Shqipërie autonome nën sovranitetin e Sulltanit, por “*kërkonte njëkohësisht daljen e Serbisë në Adriatik*”⁸⁰. Ambasadori i Austro-Hungarisë në Stamboll, Pallavicini u takua me Ismail Qemalin, i cili mori “*instruksionet e nevojshme e u nis me vrap për në Vjenë, e prej andej në Durrës*”⁸¹.

Sipas gazetës Le Matin, Ismail Qemali në 2 nëntor u nis për Shqipëri⁸² dhe lajmi ju përcoll Vjenës nga Pallavicini⁸³. Pallavicini ishte një vëzhgues i hollë e mirë informuar dhe burim kryesor i informacionit të Vjenës për Ismail Qemalin. Gjatë rrugës për Shqipëri u ndal në Bukuresht dhe bashkë me pesëmbëdhjetë bashkatdhetarë vendosën të ktheheshin në Shqipëri.

Mbrëmjen e 3 nëntorit në një intervistë në frëngjisht, Ismail Qemali mes të tjerave citonte se; “*ne kërkojmë që,...territori i vogël që kemi të mos na pakësohet*”, ju drejtua për mbrojtje ndërkombëtare Qeverisë Rumune, vëmendje maksimale për moslejimin e copëtimit të territorit shqiptar, por “*më tepër për këtë çështje do flas së shpejti Kuvendi ynë*”⁸⁴. Ismail Qemali ishte praktik dhe si diplomat kujdesej që të mos krijonte pakënaqësi, të ardhmen e shqiptarëve e shihte në një aleancë antisllave⁸⁵. Mbledhja e Bukureshtit mori tre vendime; shqiptarët me fuqitë e veta të themelonin një komitet drejtues për qeverisjen e vendit, të ngrihej një komision prej

⁷⁸ Raport i ambasadorit Pallavicini dt.5.VII.1912 HHStA. PA.XIV/39, Albanien XXXIV

⁷⁹ E.C.Helmreich; “Politika ballkanike e Austro-Hungarisë”, pg 185, (Puto A, 1978:99)

⁸⁰ Puto A, “Panvarësia Shqiptare dhe Diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914”, Mihal Duri, Tiranë 1978, fq 101

⁸¹ Gazeta “Populli”, 6 shkurt 1919

⁸² Stephane Lauzanne, “Les Beneficiaires de la guerre” Le Martin, 4 dhjetor 1912.

⁸³ Pallavicini për Ministrinë e Jashtme, Pera, 2 nëntor 1912. HHStA, PA XIV, Albanien V6, Nr.549

⁸⁴ Konomi I, “Panvarësia – Udhëtim i paharruar i Ismail Qemalit”, UET Press, 2012, ISBN:978-99956-39-76-1, Fq 69

⁸⁵ Sir F.Cartwright to Sir Edëard Gray, Vienna, British Documents on the Origins of the War, Vol 9, Part 2

shqiptarësh të ditur e të njohur që të dalin në Evropë për të mbrojtur të drejtat kombëtare e vendore të popullit shqiptar, të zgjedhin një komitet prej disa vetësh në lidhje me komitetin e brendshëm e me qendrat e tjera shqiptare. Ismail Qemali theksoi se lufta e sotme kërkonte lirimin e të krishterëve të Turqisë dhe rrëzikun për kombin shqiptar, *“të lidhen sot edhe për më tepër njëri me tjetrin e të mendohen, të përpiqen, të luftojnë e të mbrojnë vetëm si shqiptarë e për shpëtimin, njohjen e forcimin e kombësisë së tyre”*⁸⁶. Bukureshti ishte përkrahje morale dhe financiare, mundësi kontakti me zyrtarët austriakë. Referuar bashkëjetuesëve të Ismail Qemalit lidhur mbi shqetësimin e kufive të Shqipërisë ai mendonte; *“...problem më i rëndësishëm për ne shqiptarët ishte të ngrinin flamurin shqiptar dhe t’ua bëjmë të njohur këtë gjithë gjithë shteteve të Europës, pastaj të shikonim punën e kufijve”*⁸⁷. Në intervistën dhënë gazetës rumune Universul, Ismail Qemali pohonte se nuk kishte pasur kohë për të arritur një mirëkuptim me bashkë atdhetarët e tij në Bukuresht, dhe *“në qoftë se Maqedonisë i jepet autonomia, duhet t’i jepet autonomi edhe Shqipërisë dhe iu shmang përdorimit të fjalës pavarësi”*⁸⁸. Në 5 nëntor takoi ambasadorin e Austrisë në Rumani Furstenberg, ndërsa Ministria e Jashtme Austriake paralajmëronte hapur Serbinë. *“Serbia nuk duhet t’u hyjë telasheve, duke mos përfillur një faktor kaq të rëndësishëm të situatës ballkanike, siç është ndjenja shqiptare e panvarësisë, drejtësia elementare kërkon që edhe shqiptarët të përfitojnë nga parimi serb Ballkani për ballkanasit”*⁸⁹. Ministri i Jashtëm grek Koromilas, ishte shprehur përfaqësuesit të Vjenës në Athinë, Braun, se *“Greqia ua ka vënë syrin atyre viseve të Epirit, që janë në jug të asaj vije, e cila në përfundim nis në Himarë apo në Vlorë dhe shkon në lindje deri në Maqedoni”*⁹⁰. Takimin e fundit e bëri me kryediplomatën turk në pasditen e 6 nëntorit⁹¹, ku delegacioni i Bukureshtit u nis për Trieste ndërsa Ismail Qemali me Luigj Gurakuqin shkoi në Vjenë. Austro-Hungaria ishte shembulli sesi kombësitë e ndryshme mund të bashkëjetonin në harmoni në qendër të Evropës, ndërsa Ismail Qemali luante kartën e diplomacisë. Ai kërkonte përkrahjen për sipërmarrjen e tij, konfirmimi i Austrisë përballë grupit rivalë të Syrja Vlorës, ndihmë për të hyrë në Shqipëri ndërmjet detit dhe ishte qyteti më i përshtatshëm për të ndikuar ndërmjet shtypit. Kryeministri serb Pashiç në 7 nëntor në gazetën franceze Le Temps do shprehej se *“Serbia pa dalje në det nuk ka asnjë garanci për ekzistencën dhe zhvillimin e vetë ekonomik. Serbia kërkon portet e Shëngjinit, Lezhës, Durrësit,...ne kërkojmë ndarjen e Turqisë Europiane, duke ia lënë fatin e Stambollit vendimit ndërkombëtar të fuqive”*⁹², ndërsa Ismail Qemali, po atë ditë, nga gazeta Neue Freie Presse përgjigjet; *“krejt ndryshe do të jetë gjendja e Serbisë kur shqiptarët të jenë zotër të vetes. Shqipëria do të ketë ambicjen për t’u bërë shtet i qytetëruar dhe do të dëshirojë marrëdhënie të mira me Serbinë. Nëse Serbisë i duhet një mushkri për të marrë frymë, atëherë Shqipëria e panvarur, me portet e saj të Adriatikut, sigurisht që nuk do të jetë pengesë për zhvillimin e saj të*

⁸⁶ AQSH, FO.99, Viti 1912, Dosja 195, fl.4; procesverbal i mbledhjes së Bukureshtit, më 23/5 vjeshtë e tretë 1912

⁸⁷ Konomi I, “Panvarësia – Udhëtim i paharruar i Ismail Qemalit”, UET Press, 2012, ISBN:978-99956-39-76-1, Fq 73

⁸⁸ L.Iliescu, “Interview cu Ismail Kemal bey”, Universul, 6 nëntor 1912, fq2

⁸⁹ “Statement by Count Berchtold”, Times, 6 nëntor 1912, fq 7

⁹⁰ Braun për Berchtold, 8 nëntor 1912, HHStA, PA, Nr,4315. 7

⁹¹ Raport i agjentit të Policisë dhe Sigurimit të Përgjithshëm, Bukuresht, 25 tetor/7 nëntor 1912. AQSH, F.20, D2/3, fl.296

⁹² Declarations de M.Pachitch”, Le Temps, 8 nëntor, 1912, fq 6,

ardhshëm ekonomik” (Konomi I, 2012:95). Pyetjes se si i shikon marrëdhëniet e ardhshme mes Shqipërisë dhe Austro-Hungarisë, Ismail Qemali i përgjigjet diplomatikisht midis rivalitetit Vjenë – Romë. I Qemali shprehej për marrëdhënie të mira me Austro-Hungarinë dhe Italinë që këto shtete të mbështesin nevojat kulturore dhe ekonomike të shqiptarëve. Në datë 9 nëntor takohet me shefin e shtabit Austro-Hungarez, Blasius Schemua, dhe pas këtij takimi dërgon një telegram në frëngjisht; “arrij me anijen e parë. E ardhmja e Shqipërisë është siguruar”.

Ismail Qemali përballë zyrtarëve të Ballplatzit njihej si person me “*besueshmëri të ulët*”, si lojëtar e “*sjellje tipike orientale*”, si “*matrapaz politik*”, se “*merrte një subvencion të rregullt nga Greqia dhe herë pas here nga Italia*”, “*ai ishte një kameleon politik dhe oportunist, ai nuk e donte vënien e Shqipërisë së ardhshme nën Austrinë*”⁹³. Budapesti për Ismail Qemalin nuk ishte i panjohur, ishte në vendin e kohën e duhur. Gazeta Neue Freie Presse në datë 14 nëntor citonte se; “*shqiptarët inkurajoheshin të shpallin, jo autonominë por pavarësinë*”, ndërsa datë 13 nëntor kishte takuar kontin Andrassy, Kontin Hadik dhe në takim informal Kontin Berchtold. Berchtold e kishte diskutuar me ministrin e jashtëm Italian, San Giuliano, i cili nuk ushqente besim ndaj Ismail Qemalit dhe “*nuk kishte në plan t’i jepte ndonjë rol të veçantë në drejtimin e punëve në Shqipëri në të ardhmen*”⁹⁴.

Konti Berthold e miratoi pikëpamjen e Ismail Qemalit mbi çështjen kombëtare, qe i gatshëm të plotësonte të vetmen kërkesë, vendosjen në dispozicion një anije me të cilën mund të arrinte në portin e parë shqiptar para se të mbërrinte ushtria serbe. Qeveria Vjeneze shprehej mos hyrje në diskutim të hollësishëm të kësaj çështje, pasi “*Austro-Hungaria duhej ti përmbahej neutralitetit dhe se lufta po vazhdonte, ishte akoma herët të merrej një qëndrim për këto çështje*”⁹⁵. Bertholdi thekson opinionin që mbizotëronte në Ballplatz mbi Ismail Qemalin. “*Ne këtu evituum të hapemi më shumë Ismail Qemalit, për arsye se edhe unë kam të njëjtin mendim të disfavorshëm për këtë politikan sikurse edhe markezi San Xhuliano dhe nuk kam ndërmend, po ashtu si ministri i Jashtëm i Italisë, t’i caktoj ndonjë rol të veçantë I.Qemalit në transformimin e ardhshëm të gjërave në Shqipëri*”⁹⁶. Në Vjenë Ismail Qemali takoi edhe ambasadorët e Italisë dhe Anglisë. Referuar arkivave britanike theksohet qëllimi i Ismail Qemalit për të shkuar së shpejti në Vlorë për shpalljen e Panvarësisë së Shqipërisë nga një mbledhje e parisë shqiptare dhe vendosmërinë e shqiptarëve për të mbrojtur tokat e tyre, gjithë ato krahina ku flitet përgjithësisht gjuha shqipe (Puto A, 1978:107). Ismail Qemali theksoi rreziqet e Aleancës Ballkanike dhe planin e tyre mbi copëtimin e trojeve shqiptare dhe ndërlikimet në nivelin europianë. Ismail Qemali sqaronte diplomacinë angleze se; “*në qoftë se Serbia merrte një pjesë të madhe të Shqipërisë Veriore, do të kishte trazira të mëdha dhe kryengritje të vazhdueshme, gjë*

⁹³ Pallavicini, “Bericht aus Konstaninopel”, 30 maj 1910, osterreich-Ungarns Aussenpolitik, vëll.2, f.880. Nr.2187 & Pallavicini për Aehrenthal, 13 shkurt 1912, HHStA,PA XIV, Albanien V6, Nr.10 & Pallavicini, “Privatschreiben aus Konstantinopel”, 3 dhjetor 1912, Osterreich-Ungarns Aussenpolitik, vëll.5, f.21. nr.4755 and Weinzl për Aehrenthal, Cetinë, 14 qershor 1911,HHStA,nr.128 (Konomi I, 2012:120-121)

⁹⁴ Berchtold, telegram i shifruar për von Merey, Romë 22 nëntor 1912, Nr.196, HHStA, 3438.

⁹⁵ Buletini ditor i Ballplatzit dt.12.XI.1912, HHStA.PA.XII. Turkey XXXXV/b karton 417.

⁹⁶ Tel. i Berchtold-it, dt.22XI-1912, HHStA.PA.XII Turkey XXXXV/b Karton 417.

*që mund t'i hapte rrugën ndërhyrjes Austro-Italiane në Ballkan*⁹⁷, ndërsa mbi ekulibrat ballkanik rekomandonte pavarësinë e Shqipërisë si element i nevojshëm ekulibri të ri në Ballkan.

Përparimi i shpejtë i trupave të Aleancës Ballkanike në territorin shqiptar u shoqërua me lëvizje mbarëkombëtare për shpalljen e panvarësisë. Në mjaft qendra forcat e Monarkive Ballkanike u vunë përballë faktit të kryer, me flamur të ngritur e delegatë të caktuar për Kuvendin e madh të Vlorës. Ismail Qemali në Bukuresht gjeti një mbështetje të plotë dhe *“një çek prej 500.000 franga ari për shpenzimet e rastit”*. Në 19 nëntor, mbas takimeve në Vjenë me përfaqësuesit e Austro-Hungarisë dhe ambasadorët britanikë dhe italian, deklaronte se *“me të mbërritur në vend do të shpallej Panvarësia e Shqipërisë dhe do të formohej një qeveri e përkohshme”*⁹⁸. Situata në planin diplomatik shqiptar ishte e qartë ndërsa diplomacia e Fuqive të Mëdha për të ardhmen e Shqipërisë ishte ende e paqartë. Situata ushtarake e krijuar në territoret shqiptare imponoi ndryshimin e kërkersave nga autonomia tek shkëputja përfundimtare nga Perandoria Osmane. Përballë ngritjes së flamurëve në disa qytete shqiptare, caktimin e përfaqësuesëve për Kuvendin e Vlorës, qeveria Austro-Hungareze portosiste përfaqësuesin e saj në Durrës që të tregojë i afrueshëm me Ismail Qemalin dhe udhëheqësve të tjerë shqiptarë, të ndihmoheshin në kohën e zbritjes së tyre në Durrës dhe si kundërpeshë me qëndrim mosbesues i kërkonte *“të tregojë shumë i matur me udhëheqësin shqiptar, pasi siguria e tij politike nuk është jashtë çdo dyshimi”*⁹⁹. Pyetjes, gazetës Il Piccolo në 20 nëntor Trieste, mbi arritjen në Shqipëri se ç'farë do të ndodhë, Ismail Qemali i përgjigjet se; *“një gjë fare e thjeshtë, por që ne e dëshirojmë me zjarr: Shpallja e pavarësisë së mëmëdheut tonë. Duam ta vëmë Europën para faktit të kryer”*¹⁰⁰. Ismail Qemali parashtroi hapat e mëtejshme, formimin e një qeveri të përkohëshme me kryetarin i saj, garanton se për idenë e pavarësisë gjithë shqiptarët janë dakort. Kryeredaktori i gazetës u *“largua me përshtypjen se kishte biseduar me një njeri brilant, energjik dhe ihtar të zjarrtë të çështjes së vet”*¹⁰¹.

Përballë bllokimit të bregut të Vlorës nga flota greke anija zbarkoi në Durrës *“në agim të 21 nëntorit”*¹⁰². Popullsia e Durrësit nuk dinte asgjë për situatën, ndërsa serbët ndodheshin para portave të tyre. Ndjesia lokaliste e Durrësit kishte caktuar delegatët e vetë për në kuvendin kombëtar dhe u nisën për në Vlorë bashkë me grupin e shqiptarëve të Bukureshtit. Në Vlorë pritja ishte e ndryshme nga Durrësi. *“Qyteti ishte ndezur i tëri nga flaka e patriotizmit dhe kudo populli përshëndeste me gaz e hare”*¹⁰³. Në sezonin e I-rë të gjithë delegatët vendosën që *“Shqipëria me sot të bahet në vehte, e lirë e e mosvarme”*¹⁰⁴. Në fjalën e mbajtur nga Ismail Qemali insistohet për realizimin e qëllimeve finale të lëvizjes kombëtare. Ismail Qemali në një moment historik e delikat demonstron maturim të madh, takt të jashtëzakonshëm, frymë të lirë dhe

⁹⁷ British documents on the origins of the War (1898-1914), vol.IX part II,d. nr.173, fq 107

⁹⁸ Histori e Shqipërisë, vëll. II-të, 1965, fq 358

⁹⁹ Puto A, “Panvarësia Shqiptare dhe Diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914”, Mihal Duri, Tiranë 1978, fq 109-110

¹⁰⁰ Intervistë e I.Qemalit për gazetën Il Piccolo, Trieste, 20 nëntor 1912,

¹⁰¹ Konomi I, “Panvarësia – Udhëtim i paharruar i Ismail Qemalit”, UET Press, 2012, ISBN:978-99956-39-76-1, Fq 269

¹⁰² HHSTA,PA,Karton 417, Liasse XIV/60, 6b,6c.(Tel.i konsullit austro-hungarez Rudney nga Durrësi,dt 21.11.1912)

¹⁰³ Qemali I, “Kujtime”, Botimet Toena, Tiranë, 2009, ISBN:978-99943-1-558-1, fq 417

¹⁰⁴ Instituti i Historisë & ASH“ Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912”, Kombinati Poligrafik, Shtypshkronja “Mihal Duri” – Tiranë 1978, fq 261

pa paragjykimëve ndaj fqinjëve. Ismail Qemali shprehej se fillimisht Mbretëritë Ballkanike kërkonin përmirësimin e të drejtave për vëllezërit e tyre të një kombi e të një bese, por më vonë me ndarjen e zotërimeve të Perandorisë Turke në Ballkan, përfshinë edhe tokat shqiptare. Shqiptarët “vrapuan të merrnin masat” e duhura dhe se e vetmja rrugë shpëtimi ishte ndarja nga Turqia. Ky mendim u pranua nga qeveritë e Austrisë dhe Italisë, “*vetëm Rusia mund të mbahet pak si e ftohtë nga shkaku i sllavëve, por edhe ajo nuk e mohon Shqipërinë dhe kombin shqiptar*”¹⁰⁵. Ismail Qemali përcakoi edhe rendin e detyrave emergjente të Kuvendit; “*të bëhej Shqipëria më vete nën një qeveri të përkohëshme, të zgjidhet një pleqësi për ndihmë e kontroll të qeverisë, të dërgohet një komision në Evropë për të mbrojtur çështjen shqiptare përpara Mbretërive të Mëdha*”¹⁰⁶.

Në mbledhjen e parë Kuvendi shpalli panvarësinë dhe vendosi krijimin e qeverisë së parë kombëtare. Kuvendi zgjodhi Ismail Qemalin si Kryetar i Qeverisë së Përkohëshme dhe e mandatoi për të formuar kabinetin. Ismail Qemali veç funksionit të kryetarit të qeverisë u ngarkua edhe me detyrën e Ministrit *ad interim* për Punët e Jashtme. Kuvendi zgjodhi edhe një organ tjetër, pleqësinë. Pleqësia kishte funksion *këshillimor*¹⁰⁷. Mbas miratimit të përbërjes së qeverisë dhe zgjedhjen e tetëmbëdhjetë vetë anëtarë të Senatit u njoftuan shpallja e shtetit të ri Fuqive të Mëdha e Britanisë së Madhe dhe Portës së Lartë. Referuar Ismail Qemalit dhe Proçes-Verbalit të Mbledhjes së I-rë të Kuvendit Kombëtar, Kuvendi Kombëtar përbëhej prej delegatësh e të gjitha anët e Shqipërisë e pa dallin feje, shpallën pavarësinë politike të Shqipërisë, formuan një Qeveri të Përkohëshme, theksuan se shqiptarët bëjnë pjesë në familjen e popujve më të vjetër të Europës, dhe qëllimi i vetëm është të jetojnë në paqe me të gjitha shtetet e Ballkanit dhe të bëhen aty një element ekuilibri.

Ismail Qemali ishte “*burrë dhe diplomat i formatit shumë të lartë, që edhe sot Shqipërisë i mungon*”¹⁰⁸. Emërimi i Ismail Qemalit Kryeministër dhe Ministër i Jashtëm si dhe caktimi i komisionit për në Evropë, dëshmonte qartësisht se shqiptarët e ndjenin se lufta për Shqipërinë e pavarur tani kishte kaluar nga Stambolli në Evropë dhe nga politika e forcës te forca e diplomacisë. Ismail Qemali si kreu i komisionit, shkante në Evropë për të mbrojtur çështjen shqiptare përpara Fuqive të Mëdha. Sfida më emergjente ishte nga Monarkitë Fqinje. Në krah të shqiptarëve qëndronin Austro-Hungaria dhe Italia mbi Rajonin dhe hapësirën detare, të cilat mbështetnin krijimin e shtetit të pavarur shqiptar. Referuar studies shqiptarë dhe Akademikes Bullgare Antonina Zheliaskova mbi atë periudhë thyerje të Perandorisë Osmane, rreziku e ndarja e Shqipërisë ndërmjet Serbisë, Greqisë dhe Malit të Zi, “*...Diplomacia e Vjenës dhe e Romës, sikundër edhe e Londrës i dhanë sinjal Ismail Qemalit se shpallja e deklaratës për Shtetin e Pavarur Shqiptar nuk do të ndeshte në rezistencë*”¹⁰⁹. Mbi këtë taban të mbështetjes ndërkombëtare filloi veprimtarinë e vet diplomatike Qeveria e Vlorës në Konferencën e

¹⁰⁵ Proçes-verbal i Mbledhjes I-rë të Kuvendit Kombëtar në Vlorë më 28.XI.1912

¹⁰⁶ “Qeveria e Përkohëshme e Vlorës”, dosje nr 16, fq 34.

¹⁰⁷ Puto A, “Shqipëria Politike”, Toena, Tiranë 2009, ISBN:978-99943-1-467-6, fq 38

¹⁰⁸ Bashkurti L, “Koncerti dhe Funerali 1815-1914, Shqiptarët - Ballkani - Fuqitë e Mëdha”, Geer, Tiranë 2013, ISBN:978-9928-07-211-5, fq 548

¹⁰⁹ Antonina Zheliaskova, “Albania and Albanian Identities”, IMIR, Sofia, 2000, Page 52.

Ambasadorëve në Londër, në gjysmën e dytë të dhjetorit të vitit 1912. Shqipëria gradualisht do të vihej në qendër të bisedimeve dhe vendimeve. Territoret shqiptare konsideroheshin “*Territore Evropiane Turke*”, si një mall i humbur i Turqisë që mund të blihej e shitej, ose mund të rrëmbehej nga më i forti ose më të fuqishmit e Ballkanit.

3.5. Konkluzion!

Profili politik i *Ismail Qemalit* shënon kulmin e historisë së Rilindjes Shqiptare dhe fillimin e historisë politike moderne shqiptare. Ismail Qemali është sintezë e idealizmit rilindas dhe e pragmatizmit politik, e recidivave osmane dhe e ndikimeve europiane, ëndrave shqiptare dhe realiteteve gjeopolitike konjunkturale. Ismail Qemali siguroi mbështetjen pan-shqiptare dhe siguroi dhe realizoi një Shqipëri londineze. Produkti i tij final, Shqipëria e pavarur e neutrale ishte një pakt i sakrificës kombëtare dhe i kompromisit ndërkombëtar. Ismail Qemali qëndron në panteonin e Abdyl Frashërit, At Gjergj Fishtës, Luigj Gurakuqit, Hasan Prishtinës duke arritur majën më të lartë si pasojë e gërshetimit brenda tij të vlerave patriotike, vizioneve europiane si dhe kapacitetit të lartë diplomatik me origjinë osmane por me kulminacion europian.

Ismail Qemali përfaqëson liderin e dilemave të mëdha, këto dilema buronin nga diversiteti i ideve romantike të rilindasve dhe parimeve politike të Lidhjes Prizrenit. Këto trashëgimi ideologjike dhe politike mbarë shqiptare Ismail Qemali i shëndërroi në projekt politik nëpërmjet përlllogaritjesh të realiteteve politike dhe diplomatike, ballkanike dhe ndërkombëtare.

Ismail Qemali me ide, si dhe me veprimet e tij politiko-diplomatike e tejkaloi background osman. Hapi i shkëputjes nga trashëgimia diplomatiko-politike e tij ishte heqja dorë nga projekti autonomist brenda Perandorisë Osmane dhe mbështetja tek alternativa e pavarësisë, me mbështetjen, kompromisin nga fuqitë e kohës, Austro-Hungarisë, Italisë, Britanisë së Madhe.

Vepra e Ismail Qemali shënon hap të madh shkëputje nga trashëgimia osmane dhe orientale, por mbeti një hap prapa vizionit të Rilindjes dhe projektit politik të Lidhjes Prizrenit. Si një produkt të një kapërcyelli të madh të Shqipërisë nga periferia e Perandorisë Osmane në shtet politik European e bëri figurën e Ismail Qemalit tranzitive por në vlerën themeltare të themelimit të shtetit të pavarur shqiptar. Vepra politike e Ismail Qemalit ishte akt i madh formal, sfidant por që do përballej me një periudhë stanjimi për shkak të Luftës I-rë Botërore.

✚ Kap. IV. Fan Noli misionari shqiptar në SHBA dhe në Lidhjen e Kombeve. Fan Noli , klerik, alternativë, opozitë, qeveri dhe dështim.

4.1. Ngritja e shtetit shqiptar, 1919-1923. Noli misionari shqiptar në SHBA dhe në Lidhjen e Kombeve.

Shqipëria dhe shqiptarët në prag të Konferencës së Paqes ndodheshin përballë mjaft sfidave. Sfidat në planin e brendshëm lidhej me kontrollin e gjithë territorit, ndërsa në plan të brendshëm me njohjen e Shqipërisë në marrëdhënie ndërkombëtare si subjekt i së drejtës së saj.

Përfundimi i Luftës I-rë Botërore kurorëzoi fitoren e grupit të Atantës me një sërë traktatesh paqeje. Shqipëria ju rikthye sovranitetit në kufijtë e Konferencës së Londrës të vitit 1913. Arritja më e madhe e Shqipërisë mbas Luftës I-rë Botërore ishte pranimi i saj në Lidhjen e Kombeve (17

dhjetor 1920). Largimi i trupave franceze nga Korça dhe nënshkrimi i portokollit italo-shqiptar, nënshkruar në Tiranë pas Luftës së Vlorës ku italianët tërhiqeshin nga gjithë territori me përjashtim të ishullit të Sazanit, krijoi kushtet që në Shqipëri tani e tutje kishte një Qeveri që ushtronte praktikisht autoritetin e saj mbi pjesën më të madhe të territorit të përcaktuar nga Konferenca e Londrës e vitit 1913. Ushtrimi i autoritetit qeverisës ishte kusht juridik ndërkombëtar i nevojshëm për “njohjen e saj në bazë të së drejtës ndërkombëtare”¹¹⁰.

Një rol të pazëvendësueshëm realizoi Kryetari i Delegacionit Shqiptar për Shqipërinë, Fan S. Nolit. “Programi me 14 pika” i shpallur nga Wodrow Willson ishte një rregullim i ri i pasluftës mbi bazën e parimeve të reja në marrëdhëniet ndërkombëtare. Programi ishte përbërje me “murin e kanuneve të vjetra të diplomacisë evropiane”¹¹¹. Përpara nisjes së delegacionit Shqiptar, Noli thoshte... “Me shpresën e Zotit, do të kthehem në Tiranë duke sjellë me vete edhe vendin e Shqipërisë në bashkësinë e përparuar dhe duke i siguruar asaj një vend në atë tavolinë që i takon prej kohësh”¹¹².

Më 20 nëntor nga Gjeneva, Noli informonte Tiranën se klima që gjeti nuk jepte shumë optimizëm, “disa delegatë donin ta hidhnin poshtë kërkimin tonë kur çështja e pranimit të Shqipërisë u vu në rendin e ditës të mbledhjes së Lidhjes”¹¹³. Noli diplomat u takua me anëtarin francez të Sekretariatit të Lidhjes, Lordin R. Cecil, me delegatin e Belgjikës, delegatët e Zvicrës, përfaqësuesin e Japonisë dhe diplomatin e lartë britanik H. Nicolson duke marrë edhe përkrahjen anglese. Noli në kontakte me gazetën “Journal de Geneve” ngriti çështjen shqiptare përbërje kundërshtimit të delegacionit grek e jugosllav. Argumentat dhe provat e paraqitura nga F. Noli sollën rezultate pozitive, pranimin e Shqipërisë njëzëri në Lidhjen e Kombeve dhe vlerësimin nga opinioni ndërkombëtar. Që nga ditët e para, Noli la përshtypje të thella në Gjenevë. Ai u cilësua, njeri i shquar në çdo vend, diplomat i përkryer, ekspert në politikën ndërkombëtare dhe debatues i zoti. Gazeta londineze “The Manchester Guardian” citonte aftësitë e Nolit për aftësitë diplomatike ndaj kundërshtarëve ballkanikë, aftësi vetëpërmbytje të mrekullueshme, kurdoherë me buzë në gaz. “Është një burrë me kulturë të gjërë, që ka lexuar gjithçka që meriton të lexohet në frëngjisht dhe anglisht”¹¹⁴.

Fan Noli si pjesë e komunitetit shqiptar që jetonin në Amerikë, drejtonte organizatën “Vatra”, “diti t’i tërheqë vëmendjen Presidentit Willson”¹¹⁵. Fan Noli vlerësonte precencën amerikane në Konferencën e Paqes si një mundësi për shqiptarët. Noli solli kauzën shqiptare si pjesë të agendës amerikane. Noli e bëri më së miri punën e tij në dobi të Kombit Shqiptar. Ai mbetet panteoni i diplomacisë moderne shqiptare dhe modeli i saj edhe për dekadat që do pasonin. Pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve mbarte rëndësi të madhe për shtetin shqiptar, riafirmoi pavarësinë e shtetit shqiptar dhe vijoi të mbante të bllokuar përfaqësuesit e tij në arenën ndërkombëtare. Proceduralisht çdo shtet kalon nga gjendja *de facto*, fillimisht, në

¹¹⁰ Georges Castellan, “Histori e Ballkanit”, Çabej, Tiranë 1991, fq 451

¹¹¹ Margaret Macmillan, Paris 1919. Gjashtë muaj që ndryshuan botën, Tiranë 2006, fq 555-556

¹¹² Jorgaqi N, Jeta e Fan S. Nolit, Vol. I, OMBRA GVG, 2005, ISBN:978-9928-123-48-0, fq 395

¹¹³ Puto A “Shqipëria Politike 1912-1939”, Toena, Tiranë 2009, ISBN:978-99943-1-467-6, fq 292

¹¹⁴ Jorgaqi N, “Jeta e F S. Nolit”, Vol. I, OMBRA GVG, Tiranë, 2005, ISBN:978-9928-123-48-0, fq 399

¹¹⁵ Georges Castellan: “Histori e Ballkanit”, Tiranë, Çabej 1991, fq 450

gjendjen *de jure*. Mbi këtë njohje *de jure* kolektive, studiuesi i së drejtës ndërkombëtare publike i fillim shek. 20-të, Paul Fauchile shkruante se; “*pranimi i një organizmi në Lidhjen e Kombeve sjell për pasojë juridike njohjen e tij si shtet*”¹¹⁶.

Falë aftësive të tij universale si politikan, diplomat, poet, kronikan, studiues, ispirues, Fan Noli bënte pjesë në elitën e komunitetit shqiptar në Boston të Amerikës. Në ditën e Panvarësisë së SHBA, korrik 1918, ishte përfaqësues zyrtar i shqiptarëve, insistoi dhe takoi Presidentin Amerikan Willson. Noli në bisedë me Presidentin Wilson i kërkoi përpjekje për rivendosjen e pavarësisë së Shqipërisë, e cila ishte shkelur nga ushtritë e huaja gjatë Luftërave Ballkanike dhe I-rë Botërore. Presidenti Wilson e dëgjoi me vëmendje dhe mjaft pozitivitet kërkesën e tij dhe “*e siguroi atë për simpatinë dhe shprehu vendosmërinë e tij soleme për ta ndihmuar Shqipërinë*”¹¹⁷. Shtetet e Bashkuara të Amerikës në fillim të shek. 20-të dolën nga izolacioni dhe Presidenti i dinte faktet që lidheshin me Shqipërinë, i bindur për drejtësinë e çështjes së saj. Willson “*do të ngrinte pa dyshim zërin e tij në Konferencën e Paqes në përkrahje të të drejtave të Shqipërisë*”¹¹⁸.

Lidhja e Kombeve kishte mbi tryezë shumë probleme njëherësh e të komplikuar, ndër to edhe Shqipëria. Njohja ndërkombëtare e Shqipërisë ballafaqohej me doktrinat “*Vorio Epirit*” dhe “*Naçetania*”. Doktrina helenike greke avancoi në synimin e mëtutjeshëm drejt kufijve më të thellë të Jugut të Shqipërisë. Marrëveshje greke-turke nisi të zbatohet në praktikë një prej faqeve më të errëta të historisë së popullit shqiptarë të Çamërisë: të bëhej këmbimi i popullsisë midis dy vendeve, Greqisë dhe Turqisë. Qeveria e Venizellosit po vepronte në dy rrafshet në mënyrë shumë të integruar dhe me një synim strategjik: në rrafshin e brendshëm, duke spastruar etnikisht Çamërinë, ndërsa në rrafshin ndërkombëtar, duke krijuar probleme me kufirin gjithnjë e më të avancuar drejt Jugut të Shqipërisë, në tokë dhe në det.

Shteti nacional modern perëndimor shqiptar u formua mbi filozofinë e politikën, përfshiu humanizmin, shembi dogmat e Mesjetës dhe gërreu gradualisht bazat e doktrinave nacionaliste greke e serbe të “*Naçertanies*” dhe të “*Megali Idesë*”.

Çështja e Adriatikut në përgjithësi dhe Jugut nuk mund të kalonte si një pakt dypalësh Italo-Grek, por objekt debati në Konferencën e Paqes. Kryeministri shqiptar, Turhan Pasha iu drejtua Presidentit të SHBA. Woodrow Willson qëndroi i palëkundur në mbrojtje të Shqipërisë, reagoi demokratikisht e principalisht duke rikthyer çështjen shqiptare sërish në axhendën e diplomacisë ndërkombëtare. Qasja amerikane ndryshoi qëndrimin francez dhe anglez. Ndryshe nga periudha e pas pavarësisë, 1912-1913, shteti u rimëkëmb nga forcat e veta kombëtare, “*pa ndërhyrje të faktorit ndërkombëtar*”¹¹⁹.

Formimi i Qeverisë Kombëtare të Durrësit, dhjetor 1918, mbronte pavarësinë territoriale të vendit dhe “*hidhte poshtë të gjitha dispozitat sekrete të Traktatit të Londrës bashkë me të gjitha përfitimet që kishte Italia nga ky traktat*”¹²⁰. Delegacioni i kërkoi SHBA të pranonte mandat mbi

¹¹⁶ P. Fauchile, *Traite de droit international public*, I partie, Paris, 1922, pp. 331, (Bashkurti L, 2012:222)

¹¹⁷ Fan S. Noli, “The Adriatic Review”, september 1918

¹¹⁸ Fan S. Noli, “Faqe të panjohura-artikuj dhe shënime publicistike, 1915-1919”, Tiranë 2002, fq 304-305

¹¹⁹ Puto A “Shqipëria Politike 1912-1939”, Toena, Tiranë 2009, ISBN:978-99943-1-467-6, fq 216

¹²⁰ Shqipëria më 1927, Tiranë 1928, fq 16, (Puto A, 2009:224)

Shqipërinë. Idea mbi *mandatin amerikan* ishte hedhur në korrik të vitit 1918 nga dy rrymat që mbizotëronin brenda shoqërisë “Vatra”. SHBA ishte “*i vetmi shtet tek i cili shqiptarët mund të kishin besim të plotë*”¹²¹, një fuqi e madhe dhe nuk kishte synime politike. Përfaqësuesi shqiptar Mehmet Konica, ishte një intelektual brilant, modern, njohës i shkëlqyer i historisë, politikës, diplomacisë, i gjuhëve të huaja dhe shumë patriot i lartë. Ai ngriti çështjen e Çamërisë përballë stereotipeve të rrëzikshme nga diplomacia greke. Në fund Komisioni *ad hoc* përpiloi një raport përfundimtar, por pa vendime përfundimtare. Debati Shqipëri-Greqi ngeli i papërcaktuar, moment i hapi rrugën një normalizimi relativ të marrëdhënieve të Shqipërisë me fqinjët.

Vendimet e Lidhjes së Kombeve dhe ato të Konferencës së Ambasadorëve në periudhën historike 1920-1921, 1921-1923 përmbyllën kapitullin e çështjes shqiptare mbas përfundimit të Luftës I-rë Botërore. Fqinjët tonë të jugut, Greqisë, Konferenca e Paqes e vendosi *përfundimisht në dimensionin e saj real Ballkanik*¹²². Shqiptarët në përfundim të Luftës I-rë Botërore, në Lidhjen e Kombeve dhe në Konferencën e Ambasadorëve u treguan vitalë e realistë, u orientuan drejt, kryesisht ndaj SHBA, toleruan me arsytim kryesisht Italianët ndërsa fqinjët territorialë u tkurrën në aksionet e tyre. Greqia humbi “*Megali Idenë*”, por edhe “*Mikri Idenë*”-“*Vorio Epirin*”, ndërkohë në Stamboll po ngrihej dimensionin e një kombi Turk tërësisht të ri e modern.

4.2. Alternativat politike shqiptare. Fan Noli – themelues i Kishës Ortodokse Shqiptare dhe i alternativës së parë liberale e demokratike shqiptare.

Pranimi i Shqipërisë si anëtare e 43-të e Lidhjes së Kombeve do të përcaktonte orientimet e ardhshme gjeopolitike shqiptare. Detyrat e ngutshme në planin e brendshëm kombëtar lidhej me kompozicionin multi-fetar të vendit. Reformat fetare duhet të preknin dy besimet më të mëdha dhe të forconin identitetin kombëtar të besimit, të karakterit laik të shtetit tonë. Shqipëria kishte një kompozicion fetar të përbërë nga shumica myslimanë, nga besimi ortodoks i dyti dhe i treti besimi katolik. Kjo strukturë po bëhej faktor frenues në proceset e ndërgjegjes unitare shtetformuese të shqiptarëve dhe si pasojë e pozicionit gjeografik dhe trashëgimisë historiko-politike të rajonit tonë. Hapi i parë u kalua në Kongresin e Manastirit (1908) për alfabetin, me kulturën dhe argumentimin akademik të personaliteteve të kohës. Përvoja dhe nevoja për krijimin e shtetit unitar shqiptar dhe përpilimin e një strategjie gjeopolitike afatgjatë kërkonte si domosdoshmëri reforma në besimin fetar. Fqinjët tanë territorialë ishin të gjithë të besimit ortodoks, një pjesë nga etniteti sllav dhe pjesa tjetër greke. Këto grupime popujsh kishin përdorur politikën, ushtrinë ekonominë dhe diplomacinë për të arritur synimet e tyre aneksioniste. Në fillim të shek. 20-të fqinjët ortodoksë, filluan të përdorin strukturën fetare të popullsisë shqiptare për qëllimet e veta, sidomos atë ortodokse. Politikat fqinje filluan të paraqesnin gjithnjë e më shumë popullsinë ortodokse shqiptare, historinë dhe simbolet e saj si dëshmi të origjinës etnike të tyre, sllave apo greke. Përballë skepticizmit evropian dhe mungesës së institucioneve dhe diplomacisë shqiptare, elita ortodokse shqiptare, klerikale dhe jo klerikale nisi procesin e reformacionit shqiptar. Qëllimi i reformacionit ishte që të krijonte identitetin e panvarur të besimit ortodoks shqiptar dhe

¹²¹ W. Bland, J. Price, A. Tanged Web, pp 8, (Puto A, 2009:240)

¹²² Puto A “Shqipëria Politike 1912-1939”, Toena, Tiranë 2009, ISBN:978-99943-1-467-6, fq 242

të shkëpuste besimin nga punët politike dhe të shtetit. Mbas një përpjekje titanike, kulturore, intelektuale, klerikale dhe diplomatike u arrit që në gusht 1922, “*Patriarkana Ikumenike e Stambollit të njihje autoqefalinë e Kishës Ortodokse Shqiptare*”¹²³. Kongresi Ortodoks, i mbledhur më 12 shtator 1922, shpalli Kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare, ndërsa qeveria shqiptare, pas 6 ditësh, vendosi njohjen e vendimeve të Kongresit të Beratit dhe “*pranimin e Kishës Autoqefale të mbështetura plotësisht në parimet e panvarësisë së shtetit shqiptar*”¹²⁴. Një nga kontributorët kryesorë të këtij reformimi i takon klerikut dhe themeluesit të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, Fan Stilian Noli.

Kongresi i Lushnjes i mbledhur në janar 1920 zëvendësoi Qeverinë e Përkohshme të Durrësit, cilësuar “*kukull në dorë të italianëve*”, me një administratë të re e njerëz të ndershëm e që gëzonin besim në popull. Qeveria e re do të organizonte zgjedhjet e përgjithshme mbi kuvendin kombëtar ligjvënës dhe do të riformatohej dhe delegacioni pranë Lidhjes së Kombeve. Stafi i ri shqiptar “*ngarkohej me misionin për të kërkuar pavarësinë e plotë të Shqipërisë brenda kufijve të saj etnografikë*”¹²⁵. U krijua qeveria me Sulejman Delvinën Kryeministër, Mehmet Konica Ministër i Jashtëm dhe Ahmet Zogu Ministër i Brendshëm. U krijua Këshilli Kombëtar ose Senati me 37 anëtarë, të cilit i besoheshin kompetencat parlamentare deri në organizimin e zgjedhjeve të përgjithshme. Organet e pushtetit u transferuan në Tiranë, e cila u bë kryeqyteti i Shqipërisë.

Ndërsa delegacioni shqiptar në Paris vazhdonte pa sukses përpjekjet e tij, Ahmet Zogu vendoste kontrollin e tij në ministrinë më të rëndësishme të qeverisë. Kjo ministri ishte përgjegjëse për kryerjen e shumë reformave të shumë kërkuara dhe kontrollonte forcat ushtarake. Zogu “*u tregua i suksesshëm në sigurimin e përkrahjes së xhandarmërisë dhe ftoi të gjithë prefektët shqiptarë t’i bashkoheshin regjimit të tij*”¹²⁶. Kongresi i Lushnjes ruajti formën e Monarkisë, ndonëse shumica e delegatëve donin Republikë, hodhi themelet e një shteti mirëfilltë kombëtar, ndryshe nga krijesa e fuqive të Mëdha në vitet 1912-1914.

Mbi “*Statutin e Lushnjes*” duhej ngritur administratë në të gjitha nivelet, duhej përpunuar një legjistacion sa më të plotë, duhej rregulluar rregullorja e brendshme mbi veprimtarinë e parlamentit dhe nxjerrja e ligjit mbi zgjedhjet. Shpërfillja e “*Statutit të Lushnjes*”, acaroi gjendjen brenda qeverisë dhe i dha shkas përplasjes së forcave politike. Konflikti i S. Delvinës me Ministrin e Brendshëm A. Zogu do sillte rënien e qeverisë dhe vendin S. Delvinës do e merrte Ahmet Zogu. Zgjedhjet e pranverës 1921 dolën në favor të të rrymës konservatore, si vazhdim i rendit feudal dhe një vend iu la përfaqësuesit të shqiptarëve të Amerikës, “*deputet i të cilëve u zgjodh Fan Noli*”¹²⁷.

Ambjenti shoqëror në Shqipërinë e viteve 20-të karakterizohej nga bizantizmi, konservatorizmi, dhe ndasi të mëdha shoqërore. Vizioni liberal dhe demokratik i Nolit u

¹²³ L. Bashkurti: “Shqiptarët në rrjedhat e diplomacisë”, Tiranë, Geer 2003, ISBN:99927-832-9-X, fq 188

¹²⁴ Teki Selenica, “Shqipëria më 1927”, Tiranë 1928, fq 46

¹²⁵ Nicola C. Guy, “Lindja e Shqipërisë – Nacionalizmi Etnik, Fuqitë e Mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Panvarësisë Shqiptare”. Botime Pegi, Tetor 2012, ISBN:978-9928-162-17-5, fq 254-255

¹²⁶ “The Assembly of Lusnia”. n.d., Herbert MSS, DD/DRU; O.Pearson, Albania, I, fq 139

¹²⁷ Omari L, “Sistemi parlamentar”, Tiranë 1994, fq 174-175

ballafaqua me forca konservatore, të cilat favorizonin ruajtjen e statukuonë shoqërore. Noli ishte për reforma të gjëra dhe vetëm “*organizimi i fshatarësisë do ta lejonte Shqipërinë të kapërcente prirjet shpërbërëse që shqetësonin vendin*”¹²⁸. Noli si politikan qe një enigmë. Vizioni i tij për zhvillimin afatgjatë të Shqipërisë ishte i qartë, por thirrja për reforma të përgjithshme i mungoi një program konkret për vënien në zbatim të planit të tij. Ardhja me vonesë në Shqipëri me një të kaluar më tepër jashtë territorit shqiptar dhe pa një bazë politike të veten, soli tek Noli moskrijimin e një lëvizje me rrënjë të thella dhe të ndryshonte ligjërimin e mendimit se ai më parë se figurë kombëtare, ishte “*një figurë shqiptare ndërkombëtare*”¹²⁹.

Në “*sëmundjet e brendshme*”, Noli neveriste shtresën e quajtur “*klasë sunduese osmane*”, mendonte se shoqëria shqiptare e kohës duhet të “*çlirohej nga regjimi i vjetër*”. Në planin e jashtëm evidentonte si “*sëmundje*”, imperializmin e pas Luftës së Parë Botërore të mishëruar tek ambicjet territoriale dhe politikën ekspansioniste të Sërbisë, Greqisë dhe Italisë.

Krahas ndarjen zyrtare nga Kalifati në aspektin shoqëror Shqipëria nuk kishte një strukturë të qartë klasore, klasë të vërtetë bejlerësh, fshatarësh apo borgjezësh. Noli besonte se ecja përpara e Shqipërisë do realizohej nga zhdukja e “*pesë anarkive së bashku me pronësinë e çifligarëve dhe imperializmin modern*”¹³⁰.

Noli mendonte se shteti i ri shqiptar do të shfaqet diçka tjetër nga qenia e një province osmane. Në raportin Veri-Jug, vërehej një mosbalancë zhvillimi dhe peshe tek taksat. Jugu ishte i pakënaqur nga mungesa e ndikimit në Tiranë, ndërsa bejlerët të vazhdonin mbizotërimin në qeveri e administratë. Jugorët ishin superiorë në përvojë ekonomike, politike dhe kulturore. Noli gradualisht u bë zëri i pakënaqësisë. Në krahun tjetër politik ishte Ahmet Zogu me ndikim më të madh në Verilindje të vendit e krahinën e Matit, dhe “*falë ndikimit të zellit për intriga, forcës së pakufijshme dhe etjes së jashtëzakonshme për pushtet*”¹³¹.

Beteja midis Zogut dhe Nolit u shfaq si betejë ndërmjet rregullave të vjetra dhe të reja. Diferencat thelloheshin edhe nga gjendja e ndërlikuara që ekzistonte në Shqipëri, “*veçanërisht ndërmjet grupeve liberale*”¹³². Liberalët donin të thyenin fuqinë e aristokracisë myslimane, mbështetës të monarkisë dhe republikës, kundërshtonin njëri tjetrin, elementë të majtë e liberalë kërkonin lidhje të forta me Britaninë e Madhe, Francën dhe SHBA ndërsa të tjerë besonin në bamirësitë e Italisë. Shqipëria ngeli e ndarë nga mbështetjet krahinore dhe shpesh “*patën përparësi mbi programet politike*”¹³³.

Sistemi politik dhe vendimi i parlamentit të Lushnjës nuk përputhej me vendimet e Lushnjës. Sistemi elektoral linte fuqinë aristokracisë tradicionale myslimane, dhe ktheu votuesit në spektatorë të procesit nga votimet e fshehta korruptive. Krahu liberal e quajti jodemokratik dhe në interes të çifligarëve. Të dyja partitë politike, Partia Popullore dhe Përparimtare fillimisht reklamonin programe pothuajse të njëjta, bënin thirrje për reforma politike dhe ekonomike, për

¹²⁸ Fan S. Noli, Autobiografia, Prishtinë 1968, fq 79-80

¹²⁹ Pipa A, “Fan Noli as National and International Albanian figure”, pp 246

¹³⁰ R. C. Austin, “Shtegu i pashkelur i Fan Nolit”, Albin, Tiranë 2003, ISBN:99927-32-59-8, fq 34

¹³¹ B J.Fischer, King Zog and the Struggle for stability in Albania,1984, (R C. Austin, 2003:35)

¹³² Shpuza S, “Revolucioni Demokratiko-Borgjez i Qershorit 1924 në Shqipëri”, Tiranë 1959

¹³³ R. C. Austin, “Shtegu i pashkelur i Fan Nolit”, Albin, Tiranë 2003, ISBN:99927-32-59-8, fq 38

arsimim dhe zhvillim ekonomik. Asnjëra prej tyre nuk ishte parti e vërtetë politike me “programe të përcaktuara mirë dhe organizata masash”¹³⁴.

Fillimisht parlamenti shqiptar kishte dy parti: Partia Popullore, e përbërë kryesisht nga elementë demokratë me orientim pro-perëndimor dhe Partia Përparimtare (Konservatore) me mbështetës kryesorë bejlerët dhe pronarët e tokave. Fan Noli ishte pjesë e Partisë Popullore dhe aty bënin pjesë edhe konservatorët, fillimisht edhe Ahmet Zogu. Programi i Partisë Popullore fliste për “*reforma moderne*”, luftë kundër feudalizmit dhe klasës së bejlerëve. Zogu dhe Noli u shfaqën si simbole të dy rrymave politike të kohës. Noli përfaqësonte reformën ndërsa Zogu mbronte rendin konservator. Shqipëria përjetoi një betejë midis liberalizmit dhe feudalizmit. Këto subjekte politike paraqiteshin “*njëra si parti qeveritare dhe tjetra si parti opozitare*”¹³⁵.

Zogu në postin e ministri të Punëve të Brendshme ushtronte pushtetin në trajtë të një diktature, masa e njerëzve i bindeshin urdhërave të kryetarit të tyre. Kushtetuta e miratuar disa ditë pas ardhjes në fuqi të Ahmet Zogut, ishte vegla e parë e sundimit të tij. Parlamenti paraqitej pa ngjyra të qarta, pa kufi dallues midis forcave dhe grupeve të ndryshme, orientimet e partive niseshin jo nga qëllimet e shpallura, por nga anëtarët e nga krerët e tyre. Noli në programin fillestar të Partisë Popullore fliste për “*reforma moderne*”, “*parmenda të shkante përpara*”, për “*luftën kundër feudalizmit dhe klasës së bejlerëve*”. Rigrupimi i forcave në fund të 1921 solli epërsinë e Zogut dhe përkrahësve të tij në Partinë Popullore, e cila do përfaqësonte krahun e djadhtë, ndërsa deputetët demokratë, pjesë në Partinë Popullore dhe në Partinë Përparimtare, formuan grupin e Opozitës. Një vit më vonë Noli shkëputi lidhjet politike dhe deklaronte se “*pas një bashkëpunimi të shkurtër me Ahmetin e Co, i njoha ç’njerëz janë, u shkëputa prej tyre dhe nisa t’i luftoja*”¹³⁶.

Mbas shpërndarjes së Partisë Përparimtare, Partia Popullore e reformuar do të përfaqësonte të djadhtën dhe opozita u kristalizua si *forcë e majtë*¹³⁷. Në radhët e opozitës bënin pjesë figura të ndryshme si F. Noli, L. Gurakuqi, S. Delvina, figura me prirje radikale si S. Vinjau dhe figura me pikëpamje të moderuara e liberale si Ali Këlcyra. Grupi i opozitës përkrahej edhe nga figura jashtë parlamentit si Bajram Curri dhe Avni Rustemi. Ahmet Zogu po forconte pozitën dhe u bë figura kryesore e krahut të djadhtë. Zogu u mbështej nga grup deputetësh nga veriu dhe jugu dhe nuk kishte kritere përkatësie krahinore. Debatet politik u përqëndrua rreth kontrollit të qeverisë, Këshillit të Lartë (Regjencës) dhe përpunimit të legjislacionit të ri. U arritën disa rezultate mbi të drejtën financiare, administrative, penale. U ngritën gjykata në tri shkallë; nënprefekturat, prefekturat dhe gjykata e apelit. U parashikuan gjykatat e posaçme; Gjyqi i lartë dhe gjykatat ushtarake, gjykatat fetare. U botuan procesverbalet e mbledhjeve në parlament.

4.3. Shqipëria dhe shqiptarët (1923-1925). Noli si opozitë

Harku kohor 1923-1925 përkon me një periudhë plot trazira, revolucione e ndryshimeve të sistemit, të qeverive shqiptare deri në fillimin e stabilitetit të brendshëm. Dinamikat politike

¹³⁴ Skendi S, “The Political Evolution of Albania”, New York, 1954, fq 6

¹³⁵ Mousset A, “Shqipëria përballë Europës”, Dituria, Tiranë 2004, ISBN:99927-59-42-9, fq 47

¹³⁶ Gramoz Hysi, “Organizimi i shtetit shqiptar dhe lufta politike rreth tij në vitet 1920-1924, Tiranë 1988, fq 100

¹³⁷ Puto A “Shqipëria Politike 1912-1939”, Toena, Tiranë 2009, ISBN:978-99943-1-467-6, fq 317

përfshinë Shqipërinë, Ballkanin dhe marrëdhëniet e qeverive shqiptare me Fuqitë e Mëdha dhe në kuadër multilateral të Lidhjes së Kombeve. Dinamika politike shqiptare u dallua me plot ulje- ngritje, kthesa, trazira e dinamika të formës së regjimit politik. Dinamikës rajonale fundi i Luftës Turko-Greke, adoptimi i Traktatit të Lozanës dhe pasojat e tij, marrëdhëniet dypalëshe shqiptaro- greke, marrëdhëniet midis fqinjëve territorialë dhe Italisë. Mbas Kongresit të Lushnjës, klima e brendshme politike e Shqipërisë ndryshoi së tepërmi, konfliktet ishin bërë më të fuqishme dhe pushteti i Zogut vinte në rritje. Ai po shihej nga ndërkombëtarët si i vetmi politikan që mund të ruante stabilitetin e brendshëm, ndërsa Noli nga marsi i vitit 1922 “*u pa si forcë politike e lodhur*”¹³⁸. Noli qëndroi larg politikës për rreth 18 muaj ndërsa shancet e Zogut vinin në rritje. Vrasja e dy *qytetarëve amerikanë*¹³⁹ u pasua me vrasjen e Avni Rustemit. Kjo vrasje u konsiderua politikisht shumë provokative dhe një diskurs i ashpër politik të kohës si viktimë e zakoneve shqiptare. Ngjarjet e qershorit 1924, Noli u rishfaq si një forcë e vështirë politike ndërsa Zogu kontrollonte Shqipërinë. Opozita me Fan Nolin dhe Luigj Gurakuqin nuk ishin për kryengritje, por më vonë i *përfshiu edhe ata rryma e marrisë kolektive*¹⁴⁰.

Opozita e kohës dhe nolistët e përdorën fort këtë ngjarje duke akuzuar Ahmet Zogun e qeverinë e tij për tradhti të lartë dhe se kishin goditur me plumb një atdhetar të madh, ndërsa irredentistët kosovarë shkaktuan thyerjen përfundimtare midis Zogut dhe Nolit, pasi ata mendonin se Zogu kishte bërë pazarllëqe me serbët. Në mars 1922 i kishin kërkuar Zogut dorëheqje, ndërsa Noli mbante detyrën e Ministrit të Jashtëm dha dorëheqjen duke deklaruar “*prirjet diktatoriale të Zogut*”, denoncoi politikat reaksionare të qeverisë dhe dështimin e lëvizjes drejt një asambleje Kushtetuese¹⁴¹. Në vjeshtë të 1923 kundërshtarët e Zogut kërkuan zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese. Mbi dyshime të thella të sistemit votimit indirekt, progresistët u grumbulluan rreth Nolit dhe thelluan polarizimin dhe “*dha të gjitha shenjat se shoqëria shqiptare ndodhej në prag të revolucionit*”¹⁴². Divergjencat në mesin e vetë përparimtarëve nuk lejonin rrëzimin e Zogut, ndërsa Zogu evitoi komentet, qëndroi mbi polemikat krahinore dhe bëri thirrje për disiplinë, qeverisje të mirë, përparim të ngadaltë dhe të qëndrueshëm. Zogu deklaroi “*nevojë parësore për Shqipërinë ishte disiplina dhe stabiliteti*”¹⁴³. Spektri politik shqiptar përpunoi programe të qarta elektorale, për vendosjen e një demokracie të plotë konstitucionale, reformë mbi tokën, industrializimin dhe sigurinë kombëtare të bazuar mbi sigurinë kolektive nën Lidhjen e Kombeve.

Zogu mbështetjen më të madhe e kishte në pjesën verilindore dhe zonat fushore qëndrore të Shqipërisë, ndërsa Noli tek popullsia e pakënaqur në krahinat e Korçës dhe Gjirokastrës. Kryengritësit nuk frymëzoheshin të gjithë nga të njëjtat qëllime. Zogu e cilësonte Nolin kundërshtar shumë serioz, ndërsa veprimtarinë e opozitës e cilësonte si minim të stabilitetit politik dhe pengesë për ardhjen e kapitalit të huaj. Noli po ngrihej me hapa seriozë përpara dhe

¹³⁸ R. C. Austin, “Shtegu i pashkelur i Fan Nolit”, Albin, Tiranë 2003, ISBN:99927-32-59-8, fq 61

¹³⁹ K. Dako, Ahmet Zogu, mbret i shqiptarëve, Tiranë 1937, faqe 126

¹⁴⁰ Vllamasi S, “Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942”, ISBN:978-9928-140-54-8, fq 354

¹⁴¹ Fane Veizi, “Mbi Lëvizjen Kombëtare dhe Demokratike Shqiptare në vitet 1918-1924”, Tiranë 1966

¹⁴² Department of state, Merrit-Swift to Secretary of State, 30 November 1923. 875,00/107. (R. C. Austin, 2003:67)

¹⁴³ Gazeta e Korçës, 1 dhjetor 1923

shtoi ndikimin më të madh në jug të vendit. Qeveria e Zogut angazhoi struktura policie “për të kontrolluar veprimtarinë e Nolit”¹⁴⁴. Zgjedhjet nuk i siguruan asnjë grupimi shumicën, por bejlerët konservatorë i bashkuan forcat me Zogun duke i dhënë shumicën në asamble dhe të mbante postin e Kryeministrit, një kabinet i ndërtuar mbi një themel të paqëndrueshëm dhe nxorrën në shesh ndasitë krahinore. Rezultati i zgjedhjeve u pranua nga forcat përparimtare, ndërsa mbështetësit e Nolit bënë thirrje për luftë e për ardhje në pushtet.

Në tentatin kundër Zogut në parlament, shkurt 1924, opozita e quajti “e shtëna e parë e revolucionit” ndërsa Noli e quajti “krim për gjakmarrje”. Zogu u tërhoq nga qeveria dhe Shefqet Verlaci e zëvendësoi në postin e Kryeministrit dhe Ministrit të Brendshëm, ndërsa opozita e denoncoi si “vegël e Zogut”. Beteja po ashpërsohej në një luftë klasash, demokraci kundër feudalizmit, liberalizëm kundër konservatorizmit dhe nacionalizëm kundër reaksionit. Qeveria po përballlej me kundërshtarë të mbledhur rreth Nolit dhe Komitetin e Kosovës.

Vrasja e dy qytetarëve amerikanë ndikoi në rrjedhën e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane, acaroi qëndrimin ndaj Zogut dhe qeverisë së Verlacit dhe siguroi mbështetjen amerikane për Nolin kryeministër¹⁴⁵. Qeveria e Verlacit përfshiu opozitën, Luigj Gurakuqin si ministër i Financave, por ndjenja antiqeveritare e Nolit dhe përkrahësve nuk ndalonte. Qeveria ishte e papërgatitur kundër kryengritjes dhe rrënimi financiar po jepte efektet e veta. Ushtria nga kriza financiare po i linte rrugë të lirë opozitës, ndërsa nga Këshilli Regjent u larguan tre anëtarë duke lënë vetëm anëtarin ortodoks Sotir Peçi. Progresistë si Fan Noli, Komiteti i Kosovës, ushtria, bejlerët e pakënaqur dhe protoganzimi i shkodraanëve i dhanë tonin kësaj periudhe dhe mbajtën peshën kryesore. Politika e Nolit dhe Zogut në qershor 1924 janë jo të qarta. Zogu u bë viktimë e rrëzimit me dhunë dhe domosdoshmëri ndryshimesh në Shqipëri me masa revolucionare.

4.4. Noli si qeverisje.

Triumfi i kryengritjes së qershor 1924 solli qeverinë me Fan Nolin Kryeministër të Shqipërisë. Llogaritjet e SHBA flasin për “20 të vrarë e 35 të plagosur në Veri dhe 6 të vrarë e 15 të plagosur në Jug”¹⁴⁶. Zogu dhe grupi i tij nuk bënë rezistencë ndërsa pjesa më e madhe e popullsisë mbajti qëndrim indiferent. Autorë të kohës shprehen se Zogu e la qeverinë të binte në krizë hutimi politik dhe absurditet ushtarak. Referuar Andon Logorecit, kryegritja ishte “një grusht ushtarak i dobët i organizuar nga të dy regjimentet e ushtrisë”¹⁴⁷.

Qeveria demokratike e kryesuar nga Fan Noli ishte qeveria e 12-të e formuar në Shqipëri pas qeverisjes së parë të kryesuar nga Ismail Qemali. Gjatë viteve 1921– qershor 1924, cilësuar nga histografi shqiptare si periudha e Lëvizjes Demokratike, përgjithësisht proceset e ndjekura kanë qënë të rregullta e parlamentare, ndërsa qeveria e qershorit 1924 u ngrit në situata të tjera në krahasim me qeveritë e mëparshme. Ajo erdhi si rezultat i ashpërsimit të luftës politike nisur në vitin 1921, luftë e cila pas rreth tre vjetësh u shëndërrua në kryengritje e armatosur. Kjo përplasje forcash nga forcat demokratike u konsiderua si domosdoshmëri reformash me karakter

¹⁴⁴ AQSH, M.P.B. –Periudha e Zogut, V. 1923, D.6, fq 157

¹⁴⁵ Swire J, “Albania-The Rise of a Kingdom”, New York: Arno Pree, 1971, fq 428

¹⁴⁶ Department of State, Grand-Smith to the Secretary of State, no.287, 16 June 1924, 875.00/151

¹⁴⁷ Logoreci A, “The Albanians: Europe’s Forgotten Survivors”, London: V Gollancz, 1977, fq 55, (R. C. Austin, 2003:94)

antifeudal, nga gjendja e ndryshme ekonomike, shoqërore ndërsa nga forcat konservatore si ruajtje e rendit të vjetër trashëguar nga Perandoria Osmane. Tek forcat demokratike qëndronte forca intelektuale e shoqërisë shqiptare ndërsa konservatorët u dalluan me Ahmet Zogun dhe çifligarët që ishin pronarë tokash.

Ndërkohë që Zogu ndodhej në Beograd, Fan Noli, i diplomuar në Harvard dhe themelues i Kishës Ortodokse shqiptare në Amerikë, krijoi qeverinë. Fan Noli më 19 qershor u shpall si Kryetar i Qeverisë dhe shpalosi vizionin e tij politik dhe programin qeverisës me 20 pika në dimensionin e politikës së brendshme dhe dimensionin e politikës së jashtme. Noli hartoi një program idealist për reforma radikale dhe me orientim perëndimor. Programi ishte ngjallje shpresash për pjesën më të madhe të vendit fshatarësinë dhe i futi frikën pronarëve të tokave. *“Pesë anarkitë”*, ishin bazë e revolucionit, Noli u mundua ti artikulonte në një program qeverisës. Noli vinte në dukje buxhet të shkallmuar e deficit të papërbalueshëm, çorganizim të shtetit, prishje të qetësisë, anarki shtetërore, krijimi i fuqive personale përbri shtetit, atentate e vrasje ndaj të huajve e shqiptarëve, diskretitimin e brendshëm dhe ndërkombëtar dhe karakterin dyshues ndaj vitalitetit të shtetit shqiptar. Noli merrte përsipër drejtimit të punëve shtetërore në kushte të rënduara nga paraardhësit dhe premtonte përmirësim gradual të situatës me zbatimin e programit qeverisës¹⁴⁸.

Shqipëria e kësaj kohe *“përjetoi qeverisjen deri-diku demokratike të një kryeministri si Fan Noli”*¹⁴⁹. Fan Noli shpalli qeverisje me një program evropian, me parlamentarizëm dhe demokraci, se do të luftonte feudalizmin dhe do të bënte reformë agrare. Në plan ndërkombëtar u fokusua në njohjen e regjimit të ri nga shtetet e tjera dhe në marrëdhënie miqësore me të gjitha shtetet e veçanërisht me fqinjët. Programi qeverisës i Nolit përfaqësonte triumfin progresiv mbi elementët konservatorë, ai *“synonte të vendoste një demokraci ëillsoniane humaniste dhe pacifiste”*¹⁵⁰. Programi ambicioz synonte rikthimin e stabilitetit dhe kushteve normale në vend. Pas qetësisë së brendshme, Noli do të organizonte zgjedhjet e përgjithshme me votim të fshehtë dhe direkte për sigurimin e mbështetjes në popull. Noli i vetëdijshëm në kushtet në të cilat erdhi, *“u përgatit të qeverisë me dekrete për dhjetë deri në dymbëdhjetë muaj”*¹⁵¹. Noli arriti të bindë shtesa e ulëta shoqërore duke siguruar shumicën kur në program futi reformën agrare, por ngeli *“pakicë kur erdhi puna për ta zbatuar atë”*¹⁵². Programi qeverisës ishte deklarim vizioni i Nolit por disa nga mbështetësit prisnin kohën e përshtatshme për të kundërshtuar atë. Qeveria e Nolit, në raport me qeveritë e mëparshme, dallohet si qeveri progresiste dhe si *“qeveri demokratike e majtë”*¹⁵³.

Pika kryesore e programit qeverisës ishte çrrënjësja e feudalizmit dhe reforma agrare, por në përbërjen e qeverisë nuk kishte unitet mendimi dhe veprimi. Sistemi i pronësisë mbi tokën ishte një nga sëmundjet kryesore dhe kërkonte zbatim të reformës së tokës, të pronësisë nëse do të

¹⁴⁸ AQSH, Fondi Personal-Fan Noli, F. 14, D.89, fq 1 (Programi i Kabinetit Noli)

¹⁴⁹ Bernd J. Fisher, “Diktatorët e Ballkanit”, AIIS, Tiranë 2009, ISBN:978-99956-736-0-4, fq 5

¹⁵⁰ Georges Castellan, “Histori e Ballkanit”, Çabej, Tiranë 1991, fq 452

¹⁵¹ R C. Austin, “Shtegu i pashkelur i Fan Nolit”, Alpin, Tiranë 2003, ISBN:99927-32-59-8, fq 101

¹⁵² Kodra M, “Fan Noli-Në rrjedhat politike të shoqërisë shqiptare, 1905-1945”, Prishtinë 1989, fq 40

¹⁵³ Puto A “Shqipëria Politike 1912-1939”, Toena, Tiranë 2009, ISBN:978-99943-1-467-6, fq 354

bindte klasën e fshatarësisë. Rreth 50% e fshatarësisë punonin çifliqet e çifligarëve e në shkëmbim merrnin drith. Kjo pikë e programit Noli kishte mbështetjen e plotë të forcave përparimtare në vend dhe shtypit liberal të kohës, ndërsa disa anëtarë të qeverisë nuk ishin për masa radikale kundër bejlerëve. Shtypi opozitar iu kundërvu qeverisë duke bërë qeverinë fajtorë për anarkinë në vend. Rasti i gazetës “*Tirana*” paditur nga qeveria “*për trajtime tendencioze dhe antiqeveritare*” tregoi intolerancë e në kundërshtim me pikën tetë të programit dhe në përgjithësi nga parimet bazë të një qeverie demokratike. Qeveria adoptoi kursin e dorës së fortë dhe shkoi deri në masa të jashtëzakonshme si shtettrrethim, ndjekje operative.

Shoqëria “*Bashkimi*” e rriti peshën e vetë politike. Kjo shoqëri bënte thirrje për “*çrrënjosje të feudalizmit*”, bëri thirrje për “*luftë klasash*”. Kjo shoqëri në planin e vetë prej *pesë pikash* argumentonte se reforma agrare duhej të zbatohet e para dhe më pas qeveria të vepronte “*për legalizimin e vetes përmes votimit të fshehtë dhe direkt*”¹⁵⁴.

Kjo periudhë dominohej nga dy parti politike; nga Partia Nacional-Demokratike me elementë konservatorë e kundërshtarë të reformave dhe Partia Radikal-Demokrate, ku bënte pjesë opozita e pararevolucionit që bënte thirrje për realizimin e planit qeverisës. Këto subjekte politike u vendosën përballë njëra-tjetrës, zhvilluan një luftë të hapur, ngritën tensionet e acaruan situatën dhe penguan seriozisht “*marrjen e masave konkrete për zbatimin e programit*”¹⁵⁵.

Në fillim të korrikut qeveria kishte krijuar një Gjykatë politike për vëllavrasjet dhe dënimin e atyre që kishin kundërshtuar ushtarakisht revolucionin. Gjykata mund të caktonte edhe dënime me vdekje, burgim të përjetshëm, dëbim dhe konfiskim pasurie. Gjykata politike urdhëroi burgosjen e armiqëve të regjimit të Nolit.

Heqja e mbajtjes së armës, ndalimi i mbledhjeve të fshehta, kalimi gazetave para botimit në censurë ishin stil diktatorial i Nolit përballë premtimit si kryeministër për demokratizim dhe modernizimin e shoqërisë shqiptare. Masat e ashpra ishin në asimetri me amnistinë e përgjithshme të kërkuar nga Noli në gusht 1923, dhe shumë vëzhgues “*gjykonin qeverinë e Nolit si më autokrate se paraardhëset e saj*”¹⁵⁶.

Shtypi perëndimor kritikoi kthimin pas tek censura dhe masat e rrepta, kundërshtoi metodat e Nolit, dhe bënte thirrje për maturim dhe vetëpërmbytje të anëtarëve të kabinetit. Atmosfera e spastrimeve kishte molepsur pafund politikën shqiptare që nga viti 1920 dhe “*nuk përputhej me traditat më të mira të demokracisë dhe tolerancës që Noli pretendonte se i ndiente thellë*”¹⁵⁷.

Noli ndjente presion edhe nga aleatët qeverisës e mbështetësit kryesorë. Me programin prej 20 pikash, gazetat *Bashkimi*, *Politika* dhe *Shqiptari* i Amerikës ankoheshin se “shumë zyrtarë me mentalitetin e vjetër mbanin ende vendet e tyre”, “ngadalësim të gjykatave politike dhe hakmarrje e shpejtë ndaj ish-qeverisë”, “vrulli i qershorit kishte rënë dhe qeveria kishte dështuar në vendosjen e grushti të hekurt kundër disfatistëve, hipokritëve dhe parazitëve”, deri në thirrje

¹⁵⁴ R C. Austin, “Shtegu i pashkelur i Fan Nolit”, Alpin, Tiranë 2003, ISBN:99927-32-59-8, fq 104

¹⁵⁵ Vllamasi S, “Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942”, ISBN:978-9928-140-54-8, fq 376

¹⁵⁶ Swire J, “Albania - The Rise of a Kingdom”, New York: Arno Pree, 1971, fq 436

¹⁵⁷ R C. Austin, “Shtegu i pashkelur i Fan Nolit”, Alpin, Tiranë 2003, ISBN:99927-32-59-8, fq 110

për braktisje të qëllimeve të vërteta të qershorit dhe se “*duheshin bërë zgjedhje të menjëhershme*”¹⁵⁸.

Me mungesë dëshire për tu vënë në provë mbi mbështetjen popullore ndaj programit qeverisës, me reformën agrare e cila kërkonte konfiskimin e pasurive dhe rishpërndarje fshatarësisë, mungesë të tokës, nevojës për kapital, me një koalicion të copëzuar e nevojë për drejtim qeverisës, Fan Noli dhe Luigj Gurakuqi në fund gushti 1924 ju drejtuan Lidhjes së Kombeve për mbështetje financiare për trajtimin e kufijve të mbetur pezull dhe “*të mbronin çështjen kosovare*”¹⁵⁹.

Mungesa e gjatë e Nolit në Shqipëri i dha krahë komplotimeve dhe ndarjes në katër fraksione; Bashkimi, Demokratët Nacionalë, Partia demokratike Radikale dhe në pak besnikë që rrethonin Nolin. Shoqëria Bashkimi ishte jashtë qeverisë dhe i konsideronte zgjedhjet e reja si fatalitet dhe çuarje të vendit “*nga një kaos në tjetrin*”¹⁶⁰, ndërsa elementët konservatorë të përfshirë në Partinë Nacional Demokratike dhe forcat liberale në Partinë Radikale nga fundi i gushtit ishin futur në betejë të hapur dhe të parakohëshme elektorale.

Mosbesimi i qeverisë si jashtë dhe brenda vendit, shqetësimet nga shkurtimeve financiare, hartim planesh nga disa individë në ushtri dhe në qeveri, u duk se forcat e Zogut në mërgim së bashku me mbështetjen jugosllave, po përgatiteshin të rihynin në vend. Mungesa e Nolit deri në mes të tetorit 1924, e kishte dëmtuar shumë imazhin e tij dhe ndihej frika se qeveria nuk do të ishte në gjendje të mbronte pavarësinë e Shqipërisë. Noli u quajt thjesht një figurë kalimtare që në udhën e gjatë mund të injorohej¹⁶¹.

Kundër dëshirës së tij e para trysnisë së brendshme, në pamundësi sigurimi huaje nga jashtë, përballë kërkesës nga fuqitë e huaja për legjitimim dhe përballë rrezikut nga Jugosllavia me Ahmet Zogun, Noli pranoi zgjedhjet duke hedhur programin e vetë në votim në zgjedhjet e reja nga 20 dhjetor deri në 20 janar 1925. Noli e hodhi hapin kundër dëshirës së tij duke zgjedhur dorëheqjen ose zgjedhjen, ndërsa *Shoqëria Bashkimi denoncoi spostimin*. Noli nuk siguroi mbështetje për votim të drejtpërdrejtë, “*nga nëntori shtyllat kryesore të programit të qershorit tashmë ishin hedhur në tej*”¹⁶².

Përballë sfidave të brendshme, Noli i kushtoi rëndësi shumë të madhe sigurimit të mbështetjes ndërkombëtare. Sipas Nolit, mbështetja financiare dhe njohja ndërkombëtare do çonte në realizimin e disa pikave kryesore të programit qeverisës dhe do të qetësonte kritikët e tij brenda vendit. Noli i dha prioritet mbështetjes nga jashtë para legjitimitit dhe stabilizimit të situatës së brendshme.

Kryeministri Noli dhe Luigj Gurakuqi, si përfaqësues shumë të lartë dhe intelektual multidimensional ndër morën një turne jashtë vendit prej dy muajsh. Qëllimi ishte për të informuar qeveritë Evropiane dhe për të promovuar lëvizjen politike të qershorit 1924,

¹⁵⁸ Gazeta e Korçës, 6 shtator 1924 & Selim Shpuza, “Lufta e Brendshme”, fq 206

¹⁵⁹ R C. Austin, “Shtegu i pashkelur i Fan Nolit”, Alpin, Tiranë 2003, ISBN:99927-32-59-8, fq 113

¹⁶⁰ Gazeta Bashkimi, 17 tetor 1924

¹⁶¹ Department of State, Trojan Kodding’s dispatch to the Secretary of State. No.323, 30 august 1924, 875.01/250, (R. C. Austin, 2003:116)

¹⁶² R C. Austin, “Shtegu i pashkelur i Fan Nolit”, Alpin, Tiranë 2003, ISBN:99927-32-59-8, fq 117

programin e saj të brendshëm dhe politikën e jashtme. Situata në Rajon dhe Evropë ishte tejet e papërshtatshme për mbështetjen e demarshit diplomatik të dyshes Noli-Gurakuqi. Shqetësimi i krijuar nga Revolucioni Bolshevik në Rusi dhe forcat e djathta konservatore Evropiane, shikonin prapa çdo lëvizje revolucionare e radikale të Evropës së kohës ndikimet e lëvizjes së majtë të tipit Bolshevik. Konjuktura ndërkombëtare dhe klima në Ballkan ishte e pafavorshme do të sillte një qëndrim pasiv, indiferent, hezitant dhe në mjaft raste kundërshtues për lëvizjen e qershorit 1924 në Shqipëri dhe për Qeverinë Noli të dalë prej saj.

Noli ishte i ditur, me formim e sens shumë të mprehtë diplomatik. Noli si kalkulues raporte forcash dhe pozitën gjeopolitike të vendit, përpjekjen e nisi për njohje diplomatike ndërkombëtare nga Italia. Italia ishte fqinj, fuqi Evropiane, Rajonale dhe Perëndimore. Noli synonte të merrte mbështetje Rajonale, Evropiane, Ballkanike si dhe të Fuqive të Mëdha. Lëvizja ishte diplomatikisht e drejtë dhe logjike, përgjithësisht pro-italiane, por ai nuk arriti të siguronte njohjen diplomatike të Qeverisë Italiane. Italia përjetonte “*marshimin mbi Romë*” të Duçes, triumfin e fashizmit, doktrinë me pak ide e ekzaltim populist euforik për të rimëkëmbur “*Perandorinë e Diellit*”, Romën Antike. Kryeministri i Shqipërisë Fan Noli qëndroi i palëkundur në refuzimin e protektoratit Italian mbi Shqipërinë.

Ndërsa Zogu “*përpiquej të kënaqte jugosllavët*”, pasuesit e tij në Itali diskretitonin qeverinë e Nolit. Beogradi hidhte hap me synimin të mbante sa më larg Italinë nga punët e Ballkanit. Jugosllavia i shfrytëzoi më së miri diplomatikisht luhatshmëritë dhe paqartësitë e Romës, sikundër edhe kontradiktat e thella midis Fan Nolit e Ahmet Zogut. Studiuesi R. C. Austin mendon se fillimisht në Beograd sundoi mendimi se Noli ishte produkt Italian dhe orientim strategjik italo-fil. Sipas R. C. Austin, qëndrimi i Beogradit ndaj Nolit është ndikuar kryesisht dy faktorë: Kosova dhe ndikimi i Ahmet Zogut mbi qarqet e Beogradit.

Për Nolin, Kosova dhe rikthimi i Shën Naumit meritonte të trajtoheshin shumë më mirë në kuadër të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene. Noli para Fuqive të Mëdha këmbëngulte që të respektohej vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare për rikthimin e Shën Naumit Shqipërisë, por pa pretendime irredentiste. Studiues të tjerë shqiptarë, referuar korespondencës diplomatike serbe të vitit 1923 dërguar nga Tirana për Pashiçin, mendojnë se Beogradi mbështeste Zogun dhe jo Nolin sepse Ahmet Zogu konsiderohej në Beograd si një lider, i cili nuk dëshironte që çështja e Kosovës “*të turbullonte marrëdhëniet miqësore midis dy vendeve*”¹⁶³.

Konfuz dhe kontradiktor ishte edhe qasja e Qeverisë së Nolit ndaj qëndrimit zyrtar të Athinës. Diplomatët grekë në fillimisht u shprehën pozitivisht ndaj Qeverisë së Nolit, por ndryshoi qasje, ishte tërësisht negative dhe në akord të plotë me qëndrimin e Beogradit.

Ishin katër arsye themelore që kundërshtojë vendosmërisht Qeveria e Nolit nga Athina. Shpalljes së *Kishës Autoqefale Ortodokse Shqiptare*. Noli kishte rrëzuar lidhjen joreale përmes unifikimit të gjithë krishterëve me nacionalitetin grek dhe të gjithë shqiptarëve myslimanë me nacionalitetin turk. Kjo kundërvënie e madhe dhe jashtëzakonisht e suksesshme rrëzonte

¹⁶³ Milo P, Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927, Tiranë 1992, faqe 158

përpjekjet shekullore fanatike ortodokse e politike helene kundër identitetit multikonfesional të popullit shqiptar. Athina, klerikale e politike *nuk do ia falte kurrë Fan Nolit*¹⁶⁴.

Qeveria e Nolit i dha zgjidhje të ashtuquajturës “*Vendome të Himarës*”. Himara ishte i përfshirë në hartën e ambicieve territoriale të “Vorio Epirit” për aneksim, ndërsa Noli i quajti “vendomet himarjote” si kërcënim të sovranitetit shqiptar, si një mbeturinë anakronike dhe duhet ti nënshtrohej ligjeve shqiptare.

Qeveria e Nolit mbajti qëndrim patriotik e realist mbi *Kazanë e Korçës*. Nolit e njihte mirë politikën helenike dhe iu kundërvu qartazi dhe më vendosmëri. Kjo kundërvënie krijoi acarim të konsiderueshëm të marrëdhënieve greko-shqiptare.

Qeveria e Fan S. Nolit, nuk anashkaloi *problemet e popullsisë greke në Shqipëri dhe problemin e popullsisë Çame në Greqi*. Ministri Fuqiptotë i Nolit në Athinë, M. Frashëri, informonte vazhdimisht qeverinë në Tiranë mbi zhvillimet që po ndodhnin gjatë kësaj periudhe në politikën greke ndaj Shqipërisë, pakicës greke në Shqipëri dhe ndaj popullsisë shqiptare në Greqi. Qeveria Greke po realizonte fuqishëm politikën e saj të vitit 1913, spastrimin etnik të shqiptarëve nën argumentin se “*janë myslimanë që duan të zhvendosen në Anadoll*”¹⁶⁵.

Qeveria e Nolit në gusht të vitit 1924, parashtrroi në Këshillin e Lidhjes së Kombeve problemin e zhvendosjes me forcë të popullsisë shqiptare myslimane për në Anadoll me pretendimin se janë turq. Këshilli i Lidhjes së Kombeve në terren u vu përballë manipulimeve të përgatitura nga qeveria greke, nga disa liderë klerik, fanatik myslimanë shqiptarë, disa mjeranë të mashtruar, njerëz të bindur në fanatizmin osman por, “*gjithsesi përbënin një numër të papërfillshëm*”¹⁶⁶. Ringritja e këtyre problemeve në Lidhjen e Kombeve nga Fan S. Noli solli reagimin pozitiv nga i ngarkuari reporter lidhur me problemet shqiptaro-greke. Ai deklaroi se manipulimet dhe abuzimet kishin ndikuar që investigimet e bëra nga disa prej anëtarëve të Komisionit,... *propozoi që në dy nënkomisionet e ngritura të përfshinin edhe përfaqësues shqiptar*¹⁶⁷.

Qeveria e Nolit i kërkoi Këshillit të Lidhjes së Kombeve që të ushtronte autoritetin e tij mbi qeverinë Greke, për të mos i trajtuar shqiptarët si turq dhe për të ndaluar përzënien e tyre dhe kolonizimin e trojeve e banesave shqiptare me kolonë grekë të ardhur nga Azia e Vogël. Lidhja e Kombeve reagoi e dërgoi një Komision miks në terren dhe u pajtua kështu me shkëmbimet e popullsisë. Shqiptarët rezistues *u depërtuan forcërisht, u burgosën ose u izoluan*¹⁶⁸.

Pozitën ndërkombëtare të qeverisë Noli e dobësuan shumë edhe qëndrimet e fuqive të mëdha Perëndimore. Britania e Madhe nuk e njohu qeverinë e Nolit. Arsyetimi juridik i Londrës ishte se Qeveria e Nolit kishte ardhur në mënyrë jo legjitime e legale, por “*me revolucion të dhunshëm*”. Mbi përcaktimin Anglo-Francez sipas M. Konicës, ministër i Shqipërisë në Londër e Paris, vinte

¹⁶⁴ N. Dragoj, Shqiptarët dhe Grekët, Realitete historike, Vesso, 2009, ISBN:978-9928-05-027-4, fq 365-368

¹⁶⁵ Bashkurti L: “Çamëria në rrugën e zgjidhjes”, Geer, Tiranë 2012, ISBN:978-9928-105-18-9, fq 271

¹⁶⁶ AMPJ, F. 251, year 1924, file 84, pp. 28-30, Information of the Legation of Albania in Athens for the Ministry of Foreign Affairs, May, 25, 1924

¹⁶⁷ Bashkurti L: “Çamëria në rrugën e zgjidhjes”, Tiranë, Geer 2012, ISBN:978-9928-105-18-9, fq 273

¹⁶⁸ Beqir Meta, Cham Tragedy, vepër e cituar, faqe 41, (Bashkurti L, 2012:273)

në dukje se Parisi ishte konsultuar me Londrën dhe kishin rënë dakord që “*të mbanin një qëndrim të përbashkët në këtë çështje*”¹⁶⁹.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kishin qenë fuqia kryesore që patën mbështetur njohjen e shtetit të pavarur shqiptar, pranimin e tij në Lidhjen e Kombeve. Përfaqësuesi amerikan Blake bëri raport pozitiv dhe pa e vonuar, ndërsa Ministri i SHBA në Tiranë, U. Grant-Smith arsyetoi mungesën e njohjes me argument juridik. Qeveria me Kryeministër F. S. Noli humbi edhe aleatin fillestar më të rëndësishëm historik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shanset e mbijetesës së qeverisë së qershor 1924 po ngushtoheshin kështu si nga jashtë ashtu edhe nga brenda. Përballë Qeverisë së Nolit, diplomacia amerikane po shkonte gradualisht drejt mendimit se gjendja që ishte Shqipëria, me kaosin e brendshëm dhe situatën e rëndë ndërkombëtare, *Ahmet Zogu, ndonëse diktator do të ishte i vetmi që do të mund të qeveriste këtë vend*¹⁷⁰.

Prezantimi i Fan Nolit në Lidhjen e Kombeve në 10 shtator 1924¹⁷¹, ishte shumë realist dhe mbrojtje dinjitoze e interesave të popullit shqiptar, por nga pikëpamja e emocionit dhe etikës vuajti shumë nga mllefi, nervozizmi dhe zhgënjimi i thellë. Zemërata e rrallë në natyrën e tij shumë diplomatike dhe etike, Noli ia provokoi dështimi i përpjekjes titanike të tij për të siguruar një mbështetje financiare për vendin në atë gjendje shumë të rëndë ekonomike ku gjendej. Lidhja e Kombeve i kishte ofruar ndihmë të plotë Austrisë dhe Hungarisë, por “*një gjë të tillë ia refuzoi Shqipërisë*”¹⁷².

Noli i veshur nga mllefi nuk kurseu me akuza ndaj Lidhjes së Kombeve, e cila sipas Nolit kishte pas qenë pasive, e mbushur me debate shterpë, me fjalë boshe, merrej me gjëra në erë dhe kishte nisur të degradonte si Organizatë Ndërkombëtare. Noli kishte mjaft të drejtë në kritikën që i bënte Lidhjes së Kombeve.

Noli iu përgjigj kritikave për mungesën e parlamentit në Shqipëri me fyerje të rëndë për parlamentarizmin shqiptar duke tingëlluar në atë frymë si filozofi antiparlamentariste e me reagime aspak pozitive në Asambleshën e Lidhjes së Kombeve. Studiuesi A. Puto shprehet se Noli mund të kishte akumuluar negativitet nga “*parlamentarizmi shqiptar i tipit otoman*”. Liderët kombëtar kur dalin në arenën ndërkombëtare është gjithnjë e këshillueshme që të çlirohen nga *brengosjet e mllefet e brendshme* dhe të shpaleshin një vijë sjellje, një kod etik, një kulturë që të lërë pas deformimet e brendshme për hir të një promovimi sa më të lartë të identitetit kombëtar, lartësimit të imazhit të kombit dhe reputacionit të shtetit të vet në arenën ndërkombëtare. Për lidhshiptaret shqiptarë, kjo dukuri me përjashtime të rralla ka qenë një pikë e dobët e politikës shqiptare, e cila mllefet e brendshme në mjaft raste i ka shndërruar në qarje të jashtme.

Noli nuk i shpëtoi sindromit të vjetër të lidhshiptarëve politikë shqiptarë. Goditja ndaj institucionit themelor të regjimit demokratik, siç ishte parlamenti, është shpjeguar shpesh me pikëpamjet konfuze në vizionin e tij dhe në mungesën e taktit politik. Kjo vijë sjellje politike ishte e dëmshme përpara një mjedisi të tillë multilateral sikundër ishte Asambleja e Lidhjes së Kombeve. Brengosja, zhgënjimi dhe nervozizmi përballë indiferentizmit cinik të një pjese të

¹⁶⁹ AQSh, Fondi 251, d. 140, viti 1924, M. Konica, Raport nga Parisi e Londra, qershor-gusht 1924

¹⁷⁰ Bashkurti L: “Çamëria në rrugën e zgjidhjes”, Tiranë, Geer 2012, ISBN:978-9928-105-18-9, fq 279

¹⁷¹ G. Demorgny, Danube et Adriatique Italie et Albanie, Paris, 1934, pp. 104-127, (Bashkurti L, 2012:280)

¹⁷² The Times, September, 1924, ose “Dajti”, date 24 shtator 1924

Lidhjes së Kombeve e shtyu Nolin të mbante një fjalim, i cili krijoi idenë se Noli thuajse e “*mohonte fare vendin e rolin e kësaj organizate universale*”¹⁷³. Nga turbullirat kombëtare dhe shqetësimet e brendshme, Noli harroi e zhvlerësoi nën peshën e emocioneve, faktin që Lidhja e Kombeve pati luajtur role historike për shqiptarët dhe shtetin e tyre. Noli harroi ose nënçmoi interesat kombëtare në qasjen ndaj Lidhjes së Kombeve. Një sjellje e tillë, prodhoi injorim për Nolin dhe qeverinë e tij, për rajonin që filloi ta etiketonte Nolin si “*peshkopi i kuq*”, ndërsa opinioni shqiptar e priti në mënyra të ndryshme këtë situatë.

Në situatë shumë të trazuar për Shqipërinë, Noli dhe qeveria e tij, hodhi hapa për t’u njohur nga Bashkimi Sovjetik. Inisiativa erdhi nga një grup oficerash që i kërkojnë Nolit se “*do të ishte mirë të njihnin qeverinë sovjetike*”¹⁷⁴. Kjo ishte një iniciativë e guximshme, vazhdim i çështjes së hapur nga qeveria shqiptare që pas vitit 1920, mbi “*rihapjen e një konsullate shqiptare në Odesë, ku kishte prej kohësh një koloni të vogël shqiptare*”¹⁷⁵. Moska e vlerësoi politikisht çështjen e në favor të vendosjes së marrëdhënieve duke shtuar se “*mund të paraqesë interes si bazë territoriale në Ballkan*” dhe “*si një pikë vrojtimi*”¹⁷⁶. Ministri i Jashtëm S. Delvina shfaqti rezerva dhe “*i kërkoi mendimin e Londrës e të Parisit*”, këto të fundit i kërkuan qeverisë shqiptare “*që të mos lejonte bolshevikët në Ballkan*”¹⁷⁷.

Njohja e Bashkimit Sovjetik ngjalli dyshime në qëllimet e Nolit. Nëse qeveria e Nolit do kishte më shumë njohuri dhe aftësinë e duhur mbi kërcënimin sovjetik, mund të shmangej. Noli përfundoi punën e nisur nga vetë Ahmet Zogu. Zogu ishte “*politikan më finok se Noli, shumë më i vetëdijshëm për pozitën e Shqipërisë jo vetëm në Ballkan, por edhe në arenën e gjërë europiane, nuk ishte nga ata që merrte vendime të nxituara*”¹⁷⁸. Qeveria e Ahmet Zogut në periudhën e parë të marrëdhënieve shqiptare-sovjetike kishte treguar vetëpërmbytje dhe aftësi menaxhuese të kësaj çështje.

Noli, “*kokëfortë dhe i paduruar*” nuk u konsultua me legatat jashtë vendit, ndërsa Zogu e shfrytëzoi kthimin e Nolit nga Bolshevizmi duke rritur pozitën e tij në Beograd. Vendimi i Nolit ishte i nxituar dhe i keqkonceptuar, përputhej me stilin e tij autoritar qeverisës. Noli e shihte BRSS me një farë simpatie dhe si mbrojtës të kombeve të vegjël, veçanërisht mbas publikimit të traktateve të kohës së luftës. Noli e shihte iniciativën në përputhje me tendencat në çështjet ndërkombëtare. Ballkani ishte shumë i trazuar nga problemet e brendshme dhe nga rivalitetet e Fuqive Perëndimore, çka e bënte aspak të preferuar futjen e Ruisë Bolshevike. Ishte iniciativë e menduar jo mirë në kohë dhe hapësirë, në konjunkturë dhe perspektivë.

Njohja e BRSS ishte një nga gabimet e Nolit që ndërlikoi gjendjen e qeverisë së tij në planin e brendshëm dhe ndërkombëtar por nuk ishte përcaktuesja e fatit të tij qeverisës. Fuqitë Perëndimore kërkonin vazhdimisht stabilitetin e jetës së brendshme si primare dhe praninë sovjetike jo me sy pozitiv dhe jashtë profilit dhe aleancave të shqiptarëve.

¹⁷³ Puto A “Shqipëria Politike 1912-1939”, Toena, Tiranë 2009, ISBN:978-99943-1-467-6, fq 375

¹⁷⁴ Vllamasi S, “Ballafaqime politike në Shqipëri, 1897-1942”, Vllamasi, Tiranë 2012, ISBN:978-9928-140-54-8, fq 383

¹⁷⁵ Puto A “Shqipëria Politike 1912-1939”, Toena, Tiranë 2009, ISBN:978-99943-1-467-6, fq 377

¹⁷⁶ Shqipëria në dokumentat e arkivat ruse, Tiranë 2006, d. nr. 8 /39, 18.7.1924 dhe 9/44, 22.7.1924, fq 35-37

¹⁷⁷ N. S. Smirmova, vep. cit., fq 133, (Puto A, 2009:378)

¹⁷⁸ R C. Austin, “Shtegu i pashkelur i Fan Nolit”, Alpin, Tiranë 2003, ISBN:99927-32-59-8, fq 206

Fuqitë Perëndimore, Londra, Parisi e Uashingtoni nuk do e mbështesnin iniciativën e Nolit për marrëdhënie diplomatike me Bashkimin Sovjetik. Loja diplomatike e Fuqive të Mëdha diktohet nga raportet, balancat e konjunkturave botërore, ndërsa e vendeve të vogla u nevojitet më tepër kujdes, nisur më shumë nga gjendja, mundësitë, dinamikat e brendshme, mjedisi rajonal dhe kapaciteti për administrim të marrëdhënieve me Fuqitë Botërore, raportet, balancat dhe konjunkturat ndërmjet tyre. Përpjekja për vendosje marrëdhëniesh diplomatike shqiptaro-sovjetike nuk u realizua, ngeli thjesht tentativë.

4.5. Dështimi i Nolit.

Noli, qershor 1924 erdhi si rezultat i përpjekjeve shumë komplekse. Shqipëria e viteve 20-të dallohej për një luftë të hapur ndërmjet statukuosë dhe progresistëve. Dalja e alternativave politike dhe marrja e pushtetit u shoqërua edhe me luftë të individëve, karrierizmin dhe daljen në dukje të antagonizmave krahinorë. Pozita sunduese e Zogut në vitet 20-të zemëroi një pjesë të bejlerëve dhe një pjesë të elitës së pakët nga zbehja e privilegjeve të tyre. Kjo kategori të realitetit shqiptar të kohës, ndërthurur edhe me politikën e egër të Zogut si anëtar qeverie dhe si Kryeministër, ishin faktor në ndryshimin e balancës në favor të Nolit. Shqipëria e dalë nga Lufta e I-rë Botërore, i ngjante karakterit osman, dallohen edhe pakënaqësitë e popullsisë katolike, ortodokse dhe osmane. Noli e shfrytëzoi këtë realitet dhe u mbështet fillimisht tek pjesa jugore, ortodokse dhe mbështetur edhe nga ajo katolike. Vrasja e Avni Rustemit, përshpejtoi Revolucionin e Qershorit por gjeti të papërgatitur opozitën për një program të unifikuar dhe të artikulonin një program sistematik. Vendimi i Nolit përballë me realitetin e brendshëm si *destabilizim të vendit, mungesës financiare* dhe ardhja në qeverisje si imponues dhe jo i zgjedhur. Agjenda ndërkombëtare e Nolit synonte *njohjen ndërkombëtare*, mbrojtjen nga *politika shoviniste e fqinjëve* dhe sigurimi i një huaje *mbështetje financiare*.

Noli dallohej për familjarizim në fushën e diplomacisë ndërkombëtare dhe larg botës së turbullt rajonale e politikës së brendshme shqiptare. Fundi i nëntorit 1924 tregoi se koalicioni i fillim revolucionit ishte çarë në mënyrë të pariparueshme. Gazeta Politika, mbështetëse e qeverisë, bënte thirrje për *“besnikëri ndaj programit”, “mungesë tolerance, ...eliminim të sahan-lëpirësve dhe disfatistëve, ...zbatim të deklaratës së vërtetë revolucionare të qershorit”*¹⁷⁹.

Noli ndeshej me dështimin e brendshëm dhe i acaruar nga prirjet jashtë Shqipërisë. Masat drastike dhe shkurtimet financiare, përçoi tek mjaft njerëz në humbjen e besimit tek aftësitë qeverisëse të Nolit. Grupi koheziv që mbështeti Nolin ishte përçarë dhe kampet kryesore përgatiteshin për zgjedhjet e reja. Revolucioni Demokratik ishte i rrethuar nga fronti i brendshëm dhe i jashtëm. Programi qeverisës linte pak arësye për optimizëm e realizim. Koha ishte e shkurtër dhe goditja nga brenda e jashtë nuk i dhanë Nolit periudhën për tu legjitimuar dhe futjen e programit qeverisës në shinat e duhura.

Më mes të dhjetorit ndërhyrja e armatosur u bë e njohur publikisht dhe rreziku ishte tek dera. Partitë politike: “Demokrate Nacionale” dhe “Demokrate Radikale” vendosën të bashkoheshin me Shoqërinë Bashkimi. Në shpalljen e përbashkët zotoheshin të luftonin së bashku *“kundër*

¹⁷⁹ Gazeta Politika, 6 Nëntor 1924

rrezikut që i kërcënohet sot Atdheut”, ndërsa Shoqëria Bashkimi vendosi të bashkonte forcat me ushtrinë kombëtare¹⁸⁰. Qeveria e Fan Nolit dekretoi mobilizimin e përgjithshëm dhe shpalli shtetrrëthim në vend, por nuk qe në gjendje të ndryshonte situatën.

Kundërshtari i tij politik A. Zogu, i ndodhur në Beograd, punonte për sigurimin e mbështetjes dhe priste momentin për tu rikthyer. Lëvizja e fundit e Nolit drejt sovjetikëve e ndërlikoi pozitën e Nolit dhe forcoi më tepër pozitën e Zogut. Mungesa e stabilitetit dhe situata kaotike në Shqipëri shihej me sy pozitiv nga fqinjët shqiptarë. Noli kishte thyer ambicjet greke mbi kishën Ortodokse dhe vendimet e “Himarës”, kishte reaguar ndaj Jugosllavisë për ambicjet territoriale si Shën Naumi dhe në përkrahje të çështjes së Kosovës, kishte kuptuar qëllimet afatgjata imperiale të Italisë në Shqipëri. Noli besonte tek përkrahja e SHBA dhe Britanisë së Madhe.

Ndërhyrja nga Jugosllavia në Veri dhe nga Greqia në Jug do shihej me indeferentizëm nga Italia, Fuqitë e Mëdha dhe Lidhja e Kombeve. Thirrjet e qeverisë shqiptare drejtuar Lidhjes së Kombeve ishin të kota përballë burokracive të saj. Përballë argumentave të fqinjëve të Jugut dhe Veriut se në Shqipëri ishte një reagim i brendshëm, Noli theksonte se nuk kishim të bënim me një luftë civile por me një forcë e huaj që kërkonte të sfidonte sovranitetin e Shqipërisë. “...*kjo betejë ishte luftë për liri e panvarësi*”¹⁸¹. Qeveria Jugosllave theksonte se lëvizja revolucionare ndaj Qeverisë Shqiptare është një reaksion kundër qeverisjes së keqe të Tiranës. Trazirat në Shqipëri ishin rezultat e “*propogandës bolishevike, qendra e së cilës dihet në Vjenë, e gjithë kjo me dijeninë dhe aprovimin në heshtje të kryeministrit Fan Noli, i cili u ka marrë me forcë pronat të gjithë bejlerëve që nuk kishin pranuar sundimin e tij dhe i ka dëbuar nga Shqipëria...*”¹⁸². Jugosllavia mbështeti forcat e Zogut, ndërsa Greqia deklaronte se trazirat në Jug të vendit ishin të izoluara dhe “*nuk do të përsëritej më*”, ndërsa Italia nuk rriste kredibilitetin shqiptar me një “*marrëveshje të fshehtë armësh*”, kërkonte të siguronte përfitime¹⁸³. Gjithçka mbi rezistencën brenda territorit shqiptar do të varej nga rezistenca e qeverisë së Nolit.

Ndërhyrja nga jashtë ndërpreu procesin normal të zgjedhjeve parlamentare iniciuar në nëntor 1924. Qeveria i pranoi zgjedhjet si pasojë e presionit të brendshëm dhe ndërkombëtar, për legjitimim, panvarësisht se po shkelte programin e saj të qershorit. Qeveritë e Fuqive të Mëdha dhe ato fqinje insistonin për legalizimin e qeverisë demokratike dhe nuk prisnin zhvillimin e zgjedhjeve e 20 dhjetor 1924 – 20 janar 1925. Këto qeveri nxitën e pranuan alternativën “Ahmet Zogu” dhe të pasuesëve të tij për tu kthyer në pushtet dhe për të vendosur “*legalitetin*” me dhunë kundër revolucionare¹⁸⁴. Pritja e ftohtë e Nolit në Lidhjen e Kombeve nuk e ndihmoi qeverinë e tij për të kuruar plagët dhe rritur imazhin e saj ndërkombëtar. Qëndrimi jo dashamirës, madje armiqësor ndaj qeverisë, cilësuar nga shtypi i huaj dhe aktorët e tjerë të interesuar, si një qeveri “*komuniste*” dhe Nolin si “*peshkop i kuq*”, çoi në mbyllje të qeverisë dhe në mosreagim energjik ndaj ndërhyrjes së armatosur në dhjetor 1924.

¹⁸⁰ Çami M, “Shqipëria në Rrjedhat e Historisë 1912-1924”, Tiranë, Onufri 2007, ISBN:978-99943-42-19-8, fq 367

¹⁸¹ Proklamata e Kryeministrit, AQSH, Fondi Personal-Fan Noli, F.14, D.89, fq 2

¹⁸² Department of State, Secretary of State, no.2510, 16 December 1924, 875.00/174

¹⁸³ AQSH, F.251, V.1924, D.264, fq 108, & D.255, fq 13 & D.251, fq 2

¹⁸⁴ Çami M, “Shqipëria në Rrjedhat e Historisë 1912-1924”, Tiranë, Onufri 2007, ISBN:978-99943-42-19-8, fq 373

Rezistenca e qeverisë së Nolit ishte e dobët dhe pa mbështetje masive. Qeveria demokratike e Fan Nolit u përmbys dhe figurat kryesore antizogiste u arratisën jashtë vendit. Dështimi i sigurimit të mbështetjes nga jashtë, me një ushtri të armatosur keq e me probleme financiare, me popullsi të painteresuar e detyruan Nolin të largohet nga Tirana më 23 dhjetor. Zogu hyri në Tiranë më 24 dhjetor. Duke u larguar për në Itali më 25 dhjetor Noli i drejtohej Zogut të formonte një *“kabinet të përcierë dhe pajtues”* për ti dhënë fund trazirave politike në vend, ndërsa Zogu shtonte se në Shqipëri do mbizotërojë qetësia e *“do të kthehej qeveria e vjetër dhe... ai do të drejtonte punët e shtetit”*¹⁸⁵.

Në kryeartikullin e gazetës Dielli, 6 janar 1925, Faik Konica rendiste arritjet e dështimet e Qeverisë Noli. Ndër arritjet pozitive ishin çlirimi i fshatrave në Shqipërinë e Jugut, siguria nga grekët se asnjë shqiptar nuk do të dëbohej me forcë nga Greqia e Veriut, fitorja në Hagë mbi Shën Naumin dhe një buxhet i balancuar. Konica shtonte se *“kontriboi për demokratizimin e ushtrisë që si rrjedhim i ktheu oficerët e saj në kryengritës, la të lirë kriminelët, bëri emërimet jo të mira në qeveri, premtoi reforma, por i harroi të gjitha dhe qeverisi pa parlament”*¹⁸⁶.

4.6. Konkluzione!

Personaliteti i *Fan Nolit* erdhi nga formimi intelektual, kulturor, enciklopedik. Ky format ndikoi në profilin e tij shumë të lartë intelektual, pranë elitave perëndimore të kohës, por mjaft larg realiteteve politiko-sociale ekonomike të Shqipërisë dhe shqipëtarëve. Format dhe backgroundi i tij e orientoi atë drejt idealizmit më tepër se realizmit. Dilema themelore e profilit të tij lidhej me dualitetin brenda tij, ku do të bashkëjetonin ide liberale të avancuara perëndimore, me veprime, praktika e sjellje radikale, revolucionare lindore.

Nolin si fenomen politik e prodhoi në mënyrë të ndjeshme konjunktura politike ndërkombëtare. Ai ju afrua procesit politik shqiptar dhe erdhi në krye të tij mbas Luftës I-rë Botërore. Në këtë periudhë ndesheshin ndërkombëtarisht liderë të mëdhenj idealistë me në krye liderin amerikan Ëillson dhe liderë të dominuar nga idetë e realizmit që do karakterizonte lidërshtipin tradicional të fuqive europiane dhe BRSS.

Në rrafshin e brendshëm, Nolin e nxiti drejt projektit politik kaosi dhe anarkia që kishte prodhuar destabilitet të madh të vendit pas Luftës I-rë Botërore. Gjthashtu projektin e tij e nxiti varfëria ekonomike dhe plagët sociale që po brenin së brendshme Shqipërinë osmane. E vendosur midis veprës së Ismail Qemalit dhe trashëgimisë agresive të Monarkive Fqinje, Noli erdhi në politikë për të lidhur fatin e Shqipërisë me Perëndimin, me ideologjitë, politikat, institucionet liberale, por pa konsideruar realitetet shqiptare, ballkanike, ndërkombëtare.

Noli ishte një produkt dhe vazhdues i kauzës së Rilindasve Shqiptarë, por jetuar dhe kontribuar larg realitetit ballkanik e shqiptar të kohës. Noli ishte vizioni i së ardhmes së parakohshme për realitetin shqiptar. Noli mbeti i huaj për ambjentin në të cilin tentoi të implementohet, por shumë i preferuar për ardhmërinë e lidërshtipit. Projekti i Nolit ngeli i porealizuar sepse u investua për ardhmërinë ndërsa rivalet e tij u investuan për kohën. Noli u

¹⁸⁵ Gazeta “The Times”, 30 dhjetor 1924 & AQSH, F.251, V.1924, D.264, fq 130

¹⁸⁶ Gazeta Dielli, 6 janar 1925

ngrit si profil mbi realitete orientale, konsevatore, autoritare, revolucionare dhe fare pak liberale. Noli qeverisi në ditë të vështira, erdhi në mënyrë të parakohëshme dhe iku nga konjuktura e mbështetur nga forca regresive të brendshme dhe mbështetje antishqiptare të fqinjëve.

Noli parashtrroi një program demokratik, perëndimor dhe liberal, por Noli injoroi legjitimitetin e zgjedhjes dhe preferoi revolucionin, shpërfilli pluralizmin dhe preferoi autoritarizmin, sfidoi Fuqitë Perëndimore dhe u afrua me BRSS. Noli u karakterizua nga kontradita midis vizioneve dhe programeve politike, midis programit politik dhe mënyrës qeverisëse, midis mënyrës qeverisëse dhe qasjes kombëtare e ndërkombëtare.

Noli u udhëhoq nga një projekt ambicioz, por që shpërfillte tërësisht klasat sociale tek të cilat duhet të mbështetej. Idetë liberale e nxitnin drejt Perëndimit ndërsa klasat shoqërore dhe çifligarët e tërhiqnin drejt orientalizmit, ndërsa fshatarësia drejt sjelljeve radikale revolucionare. Idealizmi nolian u kryqëzua midis vizionit Perëndimor, orientalizmit çifligar dhe radikalizmit fshatar.

Duke u vënë në këtë trekëndësh papajtueshmërisë qeverisja e Nolit krijoi një vakum të plotë qeverisëse. Vendi kërkonte idealizëm ndërsa Noli u tërhoq drejt realizmit. Shqipëria kërkonte reforma Noli u frenua drejt tyre. Populli kërkonte bashkim, Noli nuk e siguroi atë. Konjuktura ndërkombëtare kërkonte qartësi e orientim politik, Noli humbi në konjuktura ndërkombëtare.

Fan Noli erdhi meteor shpresdhënës së brendshmi por që solli zhgënjime tek të gjitha shtresat dhe kategoritë e brendshme. Ai e nisi rrugëtimin si lider perëndimor dhe humbi në dilema ndërkombëtare pa bindur Fuqitë e Mëdha dhe pa arritur kompromise me shtetet fqinjë.

Në mënyrë të veçantë sjellja politike dhe veprimet praktike të Nolit pasqyrojnë trashëgiminë e tipareve të lidërshiptar. Goditja e parlamentit dhe parlamentarizmit si institut i themelimit demokratik, ndjekja dhe dënimi i kundërshtarëve politik, stili autoritarist i qeverisjes si dhe simpatitë për lëvizje revolucionare Ruse pasqyronin profilin kontravers politik të Fan Nolit, qeverinë e tij si dhe mjedisin në të cilën u ngrit dhe u shua. Noli la dilemën të mëdha por nga pikëpamja idealiste ai mbeti në profil me tendencë proeuropiane dhe liberale.

Kapitulli V: Alternative e Ahmet Zogut – rruga drejt suksesit.

5.1. Rrymat e kohës dhe ndikimi i tyre! Legaliteti – alternative politike dhe konstituive.

Shqipëria e viteve 1925-1926 ishte shumë më ndryshe nga ajo e viteve 1921. Regjenca ishte zëvendësuar dhe Ahmet Zogu kishte kryer një *coup d'état*, duke u vetëshpallur si President i parë (1925) dhe si Mbret i shqiptarëve (1928). Ai u bë *“i pari dhe i vetmi mbret mysliman i Evropës”*. Rënia e qeverisë së S.Delvinës dhe destabilizimi i Regjencës u shoqërua me ngritjen e Ahmet Zogut. Në planin e jashtëm ekzistonte rivaliteti Italo-Jugosllav, i cili do të ndikonte negativisht në funksionimin dhe konsolidimin e shtetit shqiptar.

Refleksionet e rrymave politike në Ballkan u reflektuan në politikën e jashtme dhe diplomaci. Ndarja e Ballkanit në komunizëm dhe fashizëm, ndikimi i pakët i sistemit dhe vlerave demokratike ishte vijimi i politikës së ashpër të konfontimit midis shteteve ballkanike duke e thelluar më shumë dhe shtrirë atë brenda vetë shteteve. Diplomacia Ballkanike gradualisht u shëndërrua në diplomaci kukull, mendonte dhe vepronte nga orientimet politike-gjeostrategjike

të dy poleve kryesore të Luftës së II-të Botërore, Berlinit dhe Moskës. Shtetet Ballkanike humbën disa herë sovranitetin pa u pushtuar ushtarakisht, por ideologjikisht dhe politikisht. Krijimi i shteteve kukull dhe politikave të ndjekura nga ato, implikimet në besimet fetare do ishin si baza potencialisht të gatshme për të shpërthyer në kushtet më delikate të Jugosllavisë dhe të Rajonit në tërësi. “*Periudha midis dy luftërave ishte e vetmja periudhë e shkurtër kohore për përpjekjet shqiptarëve për të ndërtuar shtetin e tyre të panvarur dhe për të hedhur bazat e filozofisë dhe të praktikës integruese kombëtare*”¹⁸⁷.

Periudha 1920-1928 kemi një periudhë me lëvizje eksperimentale, të ndryshme e shpesh kontradiktore. Organizimi i shtetit shqiptar dhe forma qeverisëse e tij do të ishin pjesë trajtimi tek dy rrymat kryesore, ndërsa Europa do të gjendej ndërmjet demokracisë, fashizmit dhe komunizmit. Realiteti shqiptar do ballafaqohej nga rryma me prirje liberale, që synonin të ndërtonin në Shqipëri një model perëndimor republikan dhe rryma konservatore që synonte të ndërtonte një model monarkist të afërt me atë të monarkive fqinje që zotëronin të gjitha shtetet e Ballkanit.

Modeli Republikan Perëndimor u udhëhoq nga Noli, i bazuar në përvojat e shteteve perëndimore demokratike pluraliste, si përpjekja më e avancuar në rajon për kohën. Disa faktorë bënë që përpjekjet noliste të mos zbatoheshin me sukses. Vendi vinte nga një mungesë e plotë e traditave demokratike, nga kolonizimi perandorak e nga perandoria më e prapambetur në historinë e kohës Europiane. Shqipëria e kohës dallohej për trashëgimi të dobët, inerci të mentalitetit dhe një psikologjie orientale, prapambetje ekonomike dhe sociale, dizintegrim urban dhe komunikues. Faik Konica, mbi modelin qeverisës të Nolit shprehej se ato janë “*një çështje e temperamentit kombëtar. Forma republikane kaq të suksesshme në disa vende ka dështuar në Shqipëri dhe ka çuar në një shtet të anarkisë mizerabël*”¹⁸⁸.

Modeli i Monarkive tradicionale rajonale bënte presion që Shqipëria të merrte atë rrugë. Monarkitë rajonale ishin unitariste, autoritariste dhe militare. Ato kishin demonstruar dhe vazhdonin të demonstrojnë agresivitet ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve. Në një mjedis rajonal jodemokratik e kërcënues, ndërtimi i modelit perëndimor demokratik ishte rrëzik për vendin. Modeli Nolian në Ballkanin e asaj kohe ngjante me një “*ishull paqaje në një det të trazuar*”¹⁸⁹. Demokracitë nuk mund të lulëzojnë në mjedise rajonale jodemokratike.

Modeli i Monarkisë Kushtetuese u mbrojt dhe u realizua nga rryma konservatore shqiptare me në krye Ahmet Zogun. Zogu ishte një nga figurat politike më të spikatura, aktive dhe e njohur për kohën ndërkombëtarisht. Periudha e Princ Vedit, Lufta I-rë Botërore dhe Qeveria e Lushnjes e kishin evidentuar Ahmet Zogun si një nga eksponentët kryesorë të skenës politike shqiptare. Zogu vinte nga një karrierë ushtarake si drejtues i forcave austriake, si Ministër i Brendshëm, Kryeministër, President dhe Mbret i Shqiptarëve. Ahmet Zogu pati një trajektore relativisht në ngritje të admirueshme.

¹⁸⁷ A.Zhelyazkova, “Albanian and Albanian Identity”, IMIR, Sofia, 2000, pg 54

¹⁸⁸ F.Konica, “Bisedë në Radio Washington Times”, datë 17 janar 1932

¹⁸⁹ L.Bashkurti: “Shqiptarët në rrjedhat e diplomacisë”, Tiranë, Geer 2003, ISBN:99927-832-9-X, fq 192

Zogu qeverisi vendin për pesëmbëdhjetë vjet. Konjunktura e Luftës së II-të Botërore ndërpreu shancin historik të zhvillimit të mëtejshëm të Mbretërisë Shqiptare. Pushtimi i Shqipërisë nga Italia fashiste në 7 prill 1939 i dha fund sovranitetit të Shqipërisë ndërsa Mbreti Zog u largua nga vendi. Zogu bënte pjesë tek grupi më i rëndësishëm që anonin nga austriakët. *Që në moshë të re kishte nisur të shfaqej si forcë e rëndësishme në politikën shqiptare*, ...dhe kishte qënë pjesë e një delegacioni shqitar *“për të kërkuar autonominë e menjëherëshme nga Perandori i ri Austriak”*¹⁹⁰. Zogu gjatë Luftës Ballkanike, ishte pjesë e forcave ushtarake në zonën e pushtimit austriak, në Shqipërinë e Mesme e në Elbasan. Tërheqja e forcave të Esat Pashës gjatë dimrit të 1915-1916 u shfrytëzua nga forcat nën drejtimin e Zogut. Zogu i shkruante Auguste Kral-it se Austria duhet t'i garantonte Shqipërisë *“shtrirjen e vijës kufitare në përputhje me parimin e nacionalitetit”*¹⁹¹. Kjo nënkuptonte bashkim të shqiptarëve të Kosovës, Çamërisë me shtetin shqiptar të ngjelur nga Traktati i Londrës.

Gjatë qëndrimit në Vjenë, Zogu u njoh me shoqërinë dhe kulturën perëndimore. Ai u njoh me sistemet politike perëndimore, *“sesi mund të respektohet nga jashtë kushtetueshmëria dhe çështjet e formës në politikë”*. Zogu kishte inteligjencë natyrore dhe aftësi njohje në thellësi të shqiptarëve, dinte të fshihte për mrekulli ndjenjat e veta deri sa të vinte çasti për të goditur. Ai ishte *“i qetë e dinjitoz, ...kontrollonte vetveten në gjithëfarësoj rrethanash, ...pasionant dhe xheloz për rivalët potencialë”*¹⁹². Zogu dallohej për cilësitë të jashtëzakonshme, *“aftësinë për të thurur intriga si dhe për t'i shtënë të tjerët që t'i shërbenin”*, dallohej për dredhakëri dhe nga *“oportunizmi i tij i vazhdueshëm”*¹⁹³. Zogu në moshën pesë vjeçare filloi të mësojë shkrimin dhe këndimin në gjuhën amëtare dhe atë turke, mësimet mbi historinë dhe gjeografinë. Në Galata Saraj, Turqi *“ndoqi Shkollën e Oficerave”*¹⁹⁴. Në fillim të vitit 1910, iu bashkua klubit “Ittihad-I Osmani Arnavud maarif mahfili (rrethi arsimor shqiptar i bashkimit osman), në Stamboll. Mungesa e skrupujve politikë nuk e pengoi të bënte aleancë e të luftonte me Serbët, Turqit, Austro-Hungarezët, Princ Eied-in dhe Esat Pashën. Vetëm përballja me italianët do ishte ngritje, mbështetje por edhe nxjerrja përfundimisht nga politika dhe territori shqiptar.

Zogu vuante nga mosbashkërendimi dhe mosdelegimi i punëve. Paaftësia e tij më e madhe lidhej në gjykimin i vartësve dhe mungesa e vullnetit për të ndërshkuar besnikët e vetë. Zogu kishte natyrë arbitrare dhe vetësiguri, dhe i *“pajisur me një sërë cilësish që lypseshin për të pasur sukses në atë situatë krejt të veçantë që paraqiste Shqipëria në vitin 1919”*¹⁹⁵.

Në fillim të vitëve 1920 Shqipëria ishte ndër vendet më të prapambetura të Rajonit Ballkanik. Rreth 90% e popullsisë merrej me bujqësi e mbarështrimin e bagëtisë dhe 9% e tokës ishte e punueshme. E gjithë pasuria motorrike e vendi përbëhej nga *tre forda të vjetër*¹⁹⁶. Zogu si pjesë e

¹⁹⁰ Nicola C. Guy, “Lindja e Shqipërisë – Nacionalizmi Etnik, Fuqitë e Mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Panvarësisë Shqiptare”. Botime Pegi, Tetor 2012, ISBN:978-9928-162-17-5, fq 162

¹⁹¹ Swire J “Albania - The Rise of a Kingdom”, New York: Arno Pree, 1971, fq 260-262,

¹⁹² Bernd J. Fisher, “Diktatorët e Ballkanit”, AIIS, Tiranë 2009, ISBN:978-99956-736-0-4, fq 24-25

¹⁹³ Konica F, “Albania, the Rock Garden of Europe”, Boston: G.M.Panarity, 1957, fq 138

¹⁹⁴ K. Dako, Ahmet Zogu, mbret i shqiptarëve, Tiranë 1937, fq 16-19

¹⁹⁵ FO 371/11209 (C929/929/90) Durrës, 16 janar 1926 & FO 371/7330 (C1599/818/90) Durrës, 18 janar 1922

¹⁹⁶ Skëndi S, 1958:152 & Marcel W. Fodor, “Plot and Counterplot in Central Europe”, Boston: Houghton Mifflin 1937, fq 96, (Fischer B, 2009:23)

Qeverisë së dalë nga Kongresi i Lushnjes, me Kryeministër Sulejman Delvina, mbajti postin e Ministrit të Brendshëm. Ashtu si Esat Pasha nën Vilhelm Vidit, Zogu vendosi kontrollin mbi ministrinë më të rëndësishme të qeverisë, si përgjegjëse për reformat e shumëkërkuara dhe kontrollin e forcave ushtarake. Zogu si komandant i ushtrisë shqiptare dhe në sajë të lidhjeve fafëfisnore krijoi një bërthamë me njerëz të tij, dhe do merrte kryesimin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Zogu në sajë të lëvizjeve të kujdesshme siguroi mbështetjen e xhandarmërisë dhe ftoi të gjithë prefektët shqiptarë t'i bashkoheshin regjimit të tij. Në përpjekjet ndërmjet Qeverisë së S. Delvinës dhe forcave të Esat Pashës, Qeveria e Tiranës veprroi energjikisht dhe shpejt. Në përpjekje për negociim me Esat Pashën, me nënshkrimin e një marrëveshjeje me një pjesë të këtyre forcave, *“forcat e Zogut kishin mundur të shpartallonin forcat e mbetura”*¹⁹⁷. Konfigurimet politike të viteve 1920, Zogun e vendosën si përfaqësues të rrymës konservatore shqiptare. Sipas E.Vlorës ky grupim ishte kundër atyre që kishin qënë në pushtet me synimin përparësor *“pasurimi dhe fuqizimi i anëtarëve të tij me të gjitha mjetet e mundshme”*¹⁹⁸.

Ahmet Zogu në 16 dhjetor 1922, në moshën 24 vjeçare, zëvendësoi Xhaferr bej Ypin si Kryeministër dhe pjesë e antagonizmave në Partinë Popullore dhe mbajti edhe postin e Ministrit të Brendshëm. Sipas S.Vllamasi, Zogu në postin e Ministrit të Brendshëm pas lojërave dhe intrigave *“dinte të fshihej pas shpinës së kryeministrit, duke ia mbështetur atij pasojat e dredhitë që bënte vetë”*. S.Vllamasi *“për të ruajtur unitetin në parti”* propozoi një ndryshim në qeveri e në Këshillin e Lartë, duke zëvendësuar Xhaferr Ypin si kryetar qeverie me Zogun, partia përkrahu mendimin e tij dhe *“votoi për Zogun si Kryeministër”*¹⁹⁹. Në programin qeverisës, Zogu Kryeministër kishte një listë të reformave që do ndërmerre, thirrja e Asamblesë Kushtetuese, heqja e masave kufizuese të lirisë së shtypit, shkurtimi i buxhetit dhe shpenzimeve të ushtrisë, thirrja e ekspertëve të huaj për degë të ndryshme të administratës dhe ekonomisë. Thelbi i programit ishte *“themelimi i një shteti oksidental e plot qytetërim”*²⁰⁰. Zogu mbi politikën e jashtme ripohonte qëndrimin e tij antiirredentist (kundër Komitetit të Kosovës) *“duke iu shmangur komplikacioneve më Greqinë dhe Jugosllavinë”*²⁰¹. Në lidhje me politikën me shtetet fqinje deklaroi se marrëdhënie fqinjësie e respekti reciprok, të pavarësisë, integritetit territorial e shtetëror dhe *“respektimin e independencës së plotë ekonomike”*²⁰².

Zogu do dallohej për politikën ndaj kërreëve të fiseve, *“të paqes së blerë me para”* dhe shpërndaren e gradave. Zogu ndërtoi marrëdhënie të acaruar e *“mungesë të entuziazmit”* ndaj përfaqësuesëve të Kosovës dhe nuk pajtohej me irredentizmin e tyre.

Në një eksperiencë dy vjeçare qeverisëse dhe pjesë e politikës shqiptare të kohës krijoi një eksperiencë të ndërturur nga aftësia për intriga dhe burrëria në veprime ushtarake. Zogu ishte në

¹⁹⁷ Pearson “Albania, I,f.143-144, (Nicola C.Guy, 2012:259)

¹⁹⁸ Eqerem bej Vlora, “Kujtime 1885-1925”, Botimi i II-të, IDK, Tiranë, ISBN:99927-780-6-7, fq 140

¹⁹⁹ Vllamasi S, “Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942”, ISBN:978-9928-140-54-8, fq 299-300

²⁰⁰ “Zog I, Me jetue në shekullin e sotëm”, Shtëpia Botuese “Dardania”, Tiranë 1995, Fq 34

²⁰¹ Puto A “Shqipëria Politike 1912-1939”, Toena, Tiranë 2009, ISBN:978-99943-1-467-6, fq 133

²⁰² “Zog I, Me jetue në shekullin e sotëm”, Shtëpia Botuese “Dardania”, Tiranë 1995, Fq 34

shkallën më të lartë për të tërhequr njerëz dhe ndër “*të paktët shqiptarë të aftë për të luajtur një rol në shkallë kombëtare*”²⁰³.

Zogu ka qënë realist, ndjenja dhe morali për të nuk kishin kuptim. Ai shprehej se vrasjen e pranonte si një mjet jo të keq kur shtërngohej ta përdorte atë kundër rivalëve të rrezikshëm që pengonin qëllimet e tij, më vonë e ka përdorur edhe kundër patriotëve, ku eliminimi i tyre sillte përfitime të mëdha për veten e tij²⁰⁴. Kryeministri Zogu gjatë vitit 1923 *synonte ti jepte fund sistemit të përçarjeve partiake* dhe u ballafaqua me një luftë politike edhe brenda partisë së tij. Divergjencat brenda partisë së tij lidheshin me kanidaturat e zgjedhjeve të dhjetor 1923. Zogu kërkonte *vënien nën kontroll të xhandarmërisë për sigurimin e zgjedhjeve* dhe orvatjes për grusht shteti. Përplasja u evitua nga Ministri Britanik, ku secila palë filloi përgatitjet për zgjedhjet në dhjetor. Zgjedhjet e nëntor-dhjetor 1923 për në Asamble Kushtetuese nga 95 vende, i dhanë bllokut qeveritar 40 vende, ndërsa 35 vende opozitës²⁰⁵. Zogu në kërkim të një mazhorance të sigurtë tërhoqi pas shumicën e bejlerëve duke e identifikuar veten me ata. Zogu në fillim ishte *“bashkuar me “bej-ngrënësit” e ndryshëm demokratikë, i kishte shfrytëzuar ata me mjeshtëri për aq kohë sa iu desh të fitojë emër dhe pozitë në shtet”, ...ndërsa në vitin 1923 arriti “t’i bëjë pak a shumë për vete të gjithë bejlerët brenda dhe jashtë parlamentit e qeverisë”*²⁰⁶.

Me ardhjen e Zogut kryeministër qeveria u ndodh në vështirësi të mëdha ekonomiko-financiare. Përballë refuzimit nga Lidhja e Kombeve dhe rekomandimit për Italinë, qeveria shqiptare shihte si alternativë për zhvillimin e vendi edhe shfrytëzimin e pasurive mbi tokë dhe nëntokë të vendit me anë të kapitalit të huaj. Ministri i Britanisë së Madhe i bënte presion Qeverisë shqiptare për favorizim të shoqërisë Anglo-Persian Oil Company (APOC) mbi të drejtën e një sipërfaqe toke prej 200.000 ha dhe akordimin e një sipërfaqe prej 50.000 ha për akordimin e vajgurit. Propozimi kishte ardhur në fund të vitit 1920 nga Britania e Madhe si shpërblim që Qeveria e Britanisë së Madhe do të përkrahte pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, ndërsa Partia Popullore dhe Zogu si Kryeministër e konsideronte një rast të lumtur t’ia akordojë shoqërisë Anglo-Iraniane konçesionin e vajgurit dhe në këmbim kërkonte mbrojtjen e shtetit më të fortë në Evropë në atë kohë, kundër qëllimeve grabitqare të fqinjëve tanë.

Politika e dyerëve të hapura ndaj kapitalit të huaj solli edhe amerikanët “Standart Oil Company”, shoqëri franceze e italiane etj. Shoqëritë Anglo-Amerikane përbënin rivalitet në burimet e vajgurit dhe ky rivalitet u shoqërua edhe në Shqipëri. Sipas interesave “Standart Oil Company” kishin opozitën me vete, ndërsa shoqëria Anglo-Persiane (APOC) mbështetej nga qeveria dhe Partia Popullore. Në këtë rivalitet qeveria shqiptare siguroi kushte të barabarta për të dy kompanitë, ndërsa shteti shqiptar si dobi ekonomike shënonte vetëm 15-20 të punësuar. Një shoqëri franceze kërkonte nga qeveria shqiptare të drejtën për të ndërtuar urat kryesore të Shqipërisë, një shoqëri italiane donte *“konçesion për 99 vjet për shfrytëzimin e fermave të shtetit në Myzeqe”*, shoqëria gjermane *“Mannesman”* kërkonte rregullimin e një rruge hekuri me kusht që *“t’i njihej asaj e drejta e shfrytëzimit të minierave që ndodheshin 40 km në të djathtë dhe në*

²⁰³ Bernd J. Fisher, “Diktatorët e Ballkanit”, AHS, Tiranë 2009, ISBN:978-99956-736-0-4, fq 29-31

²⁰⁴ Vllamasi S, “Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942”, ISBN:978-9928-140-54-8, fq 300-313

²⁰⁵ Selenica T, “Shqipëria më 1927”, Ministria e Brendshme, Tiranë, 1928, fq 112-113,

²⁰⁶ Eqerem bej Vlora, “Kujtime 1885-1925”, Botimi i II-të, IDK, Tiranë, ISBN:99927-780-6-7, fq 199

të majtë të rrugës". Në bisedë me ish-konsullin britanik dhe përfaqësues i Inteligjencës Sevice-it Eden, ky i fundit pohonte se *"vajguri ju përzuri juve nga Shqipëria dhe pruri Zogun në fuqi"*²⁰⁷.

Ahmet Zogu u shqua veçanërisht në dy fusha; në fushën ushtarake dhe atë diplomatike. Fusha ushtarake e ndihmoi Zogun të ndërtonte shumë shpejt një shtet të qëndrueshëm dhe rezistues ndaj politikave agresive të Monarkive fqinje të asaj kohe, ndërsa fusha e diplomacisë për të ndërtuar ekulibër të kujdesshëm midis Lindjes dhe Perëndimit që do të sillte stabilitet të vendit për një periudhë pesëmbëdhjetë vjeçare. Mbi rrymat politike kryesore në Shqipëri midis dy luftërave botërore dhe mbi formën qeverisëse të vendit ish-ambasadori i SHBA në Shqipëri 1935-1939, Hugh Grand shprehej; *"kundërshtimi ndërmjet Zogut dhe Peshkop Nolit nuk ishte vetëm ndërmjet dy personaliteteve rivale, por në të vërtetë përbënte një konflikt mbi bazat themelore ideologjike për qeverisjen e vendit"*. Zogu dhe mbështetësit e tij mendonin se duhej një qeveri e fortë me një prijës dinamik në krye të saj, ishte domosdoshmëri për të vendosur qetësinë dhe eleminuar kaosin, ku e kishte zhytur vendin lufta. *"Filozofia politike e Zogut ishte ajo e përparimit dhe e ndryshimit evolucionar të mendimeve, dokeve e zakoneve mesjetare të vendit për t'iu përshtatur kohërave moderne"*, ndërsa *"Noli dhe pasuesit e tij ishin të padurueshëm. Ata kërkonin ndryshime të shpejta radikale, ekonomike dhe shoqërore"*²⁰⁸.

Krahas lojës diplomatike të zhdërvjelltë për sigurimin e mbështetjes ndërkombëtare, Ahmet Zogu ishte shumë realist në modelin që duhej zbatuar në formën e regjimit në Shqipëri dhe ritmet e ndryshimeve që duheshin ndërmarrë në vend. Zogu si aristokrat progresiv, *"besonte në zhvillimin gradual dhe të natyrshëm të vendit të tij"*, në kundërshtim nga rivali i tij Noli, i cili *"besonte në ndryshime të menjëhershme radikale. Ai ishte thelbësisht një njeri Perëndimor me prirje të forta për ligjin dhe rregullin"*²⁰⁹.

Në vitin 1925, ish Ministri i Brendshëm i qeverisë së Lushnjës, Ahmet Zogu erdhi në fuqi. Qeveria e Ahmet Zogut ishte përfaqësuese e krahut konservator. Më 1 shtator 1928, Ahmet Zogu u shpall Mbret i Shqiptarëve. SHBA e njohën Mbretin në datën 13 shtator 1928. Mbas SHBA-ve e njohën Mbretërinë Shqiptare njëri pas tjetrit shumë shtete të botës, përveç Jugosllavisë. Mbreti Zog ndërtoi një shtet eficient, administratë funksionale, sistem drejtësie të suksesshëm, shërbim diplomatik modern. Mbreti Zog krijoi stabilitet të plotë brenda vendit si dhe në marrëdhënie të balancuara Adriatiko-Ballkanike, me prirje drejt perëndimit, posaçërisht drejt Italisë. Në bisedën e mbretit Zog me J.S.Barnes, ish Komisioneri i Lartë për Shqipërinë në Këshillin e Regjencës Italiane, rezulton qysh herët visioni pro perëndimor i tij, Italia për Mbretin Zog ishte porta e Shqipërisë drejt Perëndimit.

Zogu mendonte se një Shqipëri e fortë dhe e mirëorganizuar ishte gjithëçka Italia do kërkonte, Shqipëria do të bëhej për Italinë, as më shumë as më pak, siç ishte Belgjika për Anglinë, *"...Unë nuk kam frikë nga një Itali e fuqishme...Ne kemi frikë Jugosllavinë e cila kurrë nuk ka reshtur së kërkuari Shkodrën dhe bllokun idealin tonë për një Shqipëri në kufijtë e saj gjeografikë etnikë"*. Zogu shtronte domosdoshmëri për kapital financiar dhe mbështetje kulturore

²⁰⁷ Vllamasi S, "Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942", ISBN:978-9928-140-54-8, fq 304-321

²⁰⁸ Hugh Grand, "Mbreti Zog, siç e kam njohur", Tiranë 2002, fq 18

²⁰⁹ Robinson V, "Albania's Road to Freedom", London 1941, page 39

nga Italia. Ai shtonte se “*duam të jetojmë në origjinën tonë dhe të largojmë ndikimin lindor. Ne jemi popull perëndimor dhe na duhet kultura perëndimore. Pra ne kemi vetëm për të fituar dhe shumë pak për të humbur nga forcimi i marrëdhënieve tona me Italinë*”²¹⁰.

Me ardhjen në pushtet Zogu nxitoi të kënaqte mbështetësit e tij. Një nga aktet e para të tij ishte “*tërheqja zyrtarisht e thirrjes për ndihmë që ishte drejtuar Lidhjes së Kombeve*” dhe njoftimi nga Ministri i jashtëm (M. Libohova), se akuzat e ngritura nga qeveria Noli kundër mbretërisë serbe-kroate-slllovene, ishin “*pa bazë dhe ne nuk pajtohemi me to*”²¹¹.

Zogu në diskutimet e tij me Pashiqin, bëri ndryshimin e kufijve rreth Shën Naumit dhe Vermoshit në favor të Jugosllavisë, ndërsa anëtarët e Komitetit të Kosovës u arratisën dhe më vonë një pjesë e tyre u eliminuan. Mbi konçesionin e vajgurit, APOC mori konçesionin mbi 200.000 hektarësh, megjithëse gjatë vitit 1925, Zogu dhe APOC qenë të detyruar, për shkak të presionit nga SHBA, Franca dhe Italia, t’i jepnin nga një rol edhe protagonistëve të tjerë kryesorë. Njohja ndërkombëtare të cilën Noli nuk e arriti, erdhi më 15 janar, Zogu rimblodhi përkohësisht Asamblenë e shpërndarë dhe bëri Vrionin përsëri kryeministër, duke i dhënë ardhjes në pushtet një pamje të ligjshme. Ringjallja e qeverisë së Vrionit qe një fasadë e përkohshme. Zogu u tregua mendjehollë në marrjen e vendimeve, “*ai diti të marrë pushtetin mbi vete më mirë se Noli*”. Priti deri në shkurt përpara se të kërkonte aprovimin e parlamentit për krijimin e një republike presidenciale dhe të vinte veten si të parin president të vendit. Ky ishte një hap i përkohshëm në rrugën drejt monarkisë, mbasi vitet që pasuan deri në 1928 i përdori për të vënë themelet e kultit të vetë të individit. Zogu u “*përkul para ‘dëshirave’ të popullit dhe mori përsipër titullin Mbret i shqiptarëve*”²¹². Anglia, Franca dhe Italia e trajtuan sundimin e Nolit si një “*fazë e ndërmjetme*”. Ambasadori britanik duke i shkruar Foreign Affairs nuk e fshinte kënaqësinë për rikthimin e Zogut. Ai shkruante se Zogu ishte i vendosur të krijonte një “*qeveri të denjë*” dhe se ishte duke “*rivendosur rendin dhe populli e mirëpret dorën e tij të fortë*”²¹³, ndërsa autori shqiptar A.Puto pohonë se njohja e shpejtë ishte rezultat i gadishmërisë së Zogut për të plotësuar konçesionin e vajgurit në favor të Britanisë dhe se “*APOC i kishte ofruar atij ndihmë financiare*”²¹⁴. Sipas A.Putos, Standard Oil në marrëveshje me APOC kishte financuar kthimin e Zogut në pushtet, ndërsa R. C. Austin mendon se “*kjo akuzë është qesharake sepse dy kompanitë ishin konkurrente të forta*”. SHBA fillimisht nuk morën asgjë nga Zogu, ku edhe interesat amerikane për vajgurin u injoruan vazhdimisht. Përfaqësuesi amerikan në Shqipëri G.Smith, 5 janar 1925, shprehej për “*qëndrim ndaj ardhjes së Zogut në pushtet sepse ky ishte dënuar nga një gjykatë shqiptare*”, ndërsa Zogu kërkonte me ngulm gjetjen e përgjegjësve për “*vrastjet e dy amerikanëve*”. Duke marrë gjendjen në kontroll, Zogu eliminoi gjurmët e trashëguara nga Noli dhe shumë nga “*nxitësit e revolucionit u vranë*”²¹⁵. Fan Noli u end nëpër Europë deri në vitin 1932 duke kërkuar përkrahës dhe aleatë në çdo vend dhe në fund u rikthye

²¹⁰ J.S.Barnes, “Ahmet Zogu, King of Albanians”, English Review, mars 1929, fq 319, (R. J. Stevenson, 1954:52-54)

²¹¹ League of Nations—official Journal, May 1925, V.6, No.5, p.642

²¹² R. C. Austin, “Shtegu i pashkelur i Fan Nolit”, Albin, Tiranë 2003, ISBN:99927-32-59-8, fq 228

²¹³ DBFP, Series I, V.XXVII, no.3.pp 6 & DBFP, Series I, V.XXVI, no.308.pp 466,

²¹⁴ Puto A, “Demokracia e rrethuar”, 8 Nëntori, Tiranë 1990, faqe 239

²¹⁵ Buda A, e të tjerë, “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”, ASH e RPS të Shqipërisë, Tiranë 1985, fq 145, 328, 867-868

në SHBA duke u përqëndruar në pasionin e tij, Kishën Ortodokse Shqiptare. A.Zogut sipas B.Fischer dhe J.Sëire, i atribuohet roli kryesor në ndërtimin e kombit, ndërsa R.C.Austin mendon se “*bashkoi vendin nga ana administrative*”, por bëri pak mbi zbutjen e “*pengesave kryesore fetare dhe krahinore drejt bashkimit*”. Zogu u përqëndrua në krijimin e stabilitetit të vendit dhe ruajti gjithmonë mundësi për reforma. Reforma e tokës nuk u realizua kurrë. Nevoja monetare e qeverisë së Nolit u zgjidh nga Ahmet Zogu kur i ktheu kurrizin përkrahësve jugosllavë dhe lejoi atë që nuk dëshironte qeveria e Nolit, lejimin gradual të kontrollit italian. Zogu në ndryshim nga Noli “*nuk tregoi interes në zhdukjen e prirjeve disintegruese që goditën Shqipërinë dhe në krijimin e një vendi të bashkuar e të reformuar, por në përdorimin e mungesës së unitetit në favorin e tij*”²¹⁶. Në “Autobiografinë” e tij Noli cilësonte Revolucionin e Qershorit 1924 një kthesë në historinë e Shqipërisë, ai krijoi një epokë²¹⁷. Periudha 1920-1924 ishte periudhë kaosi por demokratike, shënoi fundin e eksperimentit mbi pluralizmin politik në Shqipëri dhe reformën dhe çëshjet e jashtme. Kjo periudhë do ti hapte rrugën autoritarizmit të qëndrueshëm dhe varësisë nga një fuqi e huaj.

5.2. Ardhja e Zogut nga Jugosllavia. Rruga drejt pushtetit.

Ndërsa qeveria Noli ballafaqohej me sfidat e brendshme e të jashtme, Ahmet Zogu me lojën politike të një këmbe në Itali dhe tjetrën në Jugosllavi siguronte mbështetjen për rikthim nga Jugosllavia. Gjatë qëndrimit në Jugosllavi kishte marrë mbështetjen e Beogradit, ndërsa aleati i tij Shefqet Verlaci në Itali fitonte simpatinë e Romës për çështjen e tyre.

Shtetet fqinje të Shqipërisë, pjesëmarrëse në Konferencën e Paqes, u shfaqën herë si rivale dhe herë si aleate me synim të përftonin sa më shumë në kurriz të saj jo vetëm gjatë punimeve të Konferencës, por edhe mbas saj. Në këtë rivalitet të hapur Italia kristalizoi pa rezerva pretendimet e saj ndaj Shqipërisë dhe Ballkanit duke mos fshehur interesin për copëtimin e saj. Lufta e Vlorës, Kongresi i Lushnjës dhe Qeveria e re e Tiranës me platformën e saj kombëtare ishin një konflikte të hapura me Italinë. Italia nuk hiqte dorë nga synimi i saj për bregdetin Lindor të Adriatikut. Krahas ofensivës ushtarake, Italia përdorte edhe “*politikën e butë ose ofensivën paqësore*”²¹⁸.

Ardhja e fashizmit për politikën e jashtme italiane ishte dhënie hapësirë tendencave të tyre ekspansioniste. Në fillim të viteve 20, Lidhja e Kombeve e konsideroi si partnerin kryesor politik dhe ekonomik, ndërsa marrëdhëniet italo-shqiptare dhanë rezultat nga nënshkrimi i disa marrëveshjeve dypalëshe në fusha të ndryshme ekonomiko-financiare.

Përfaqësuesi italian në Durrës e identifikonte Zogun si përkrahës të Jugosllavisë, por më pas Musolini “*u bind që Zogu mund të blihej*”²¹⁹. Ndërsa Zogu kënaqte jugosllavët, mbështetësi i tij në Itali, ish-ministri Myfit Libohova bindte qeverinë e Musolinit se ardhja e Zogut ishte në të mirë të Italisë dhe “*premtoi konçesione qeverisë italiane*” me kthimin në pushtet²²⁰.

²¹⁶ R. C. Austin, “Shtegu i pashkelur i Fan Nolit”, Albin, Tiranë 2003, ISBN:99927-32-59-8, fq 228-229

²¹⁷ Fan Noli “Autobiografia”, Prishtinë 1968, fq 86

²¹⁸ V Toci, “Ndërhyrja e kapitalit të huaj në Shqipëri dhe qëndrimi i qarqeve demokratike, 1921-1925”, Tiranë 1974, fq 17

²¹⁹ Alan Cassels, “Mussolini’s Early Diplomacy”, Princeton 1970, pg 243

²²⁰ Raport i Ministrisë së Jashtme të Romës datë 20 shtator 1924 & AQSH, F.251, D.246, F.21

Jugosllavia ishte e para që e shkeli marrëveshjen “*me përkrahjen e trupave jugosllave dhe të Rusëve të Bardhë*”²²¹ për kthimin e Zogut nga territori i saj. Jugosllavët e identifikuan qeverinë Noli si “*produkt të ndikimit Italian*” por pas saj qëndronte çështja e Kosovës. Elita jugosllave ishte e kënaqur me regjimet paraardhëse, sidomos atyre të drejtuara e të kontrolluara nga Zogu. Këto qeveri nuk kishin pasur pretendime e ndryshime kufish, ushtrim presioni mbi Beogradin për përmirësimin dhe trajtimin e popullsisë shqiptare në Kosovë. Noli nuk kërkonte rishikim kufijsh por shpresonte që “*kosovarët të trajtoheshin më mirë brenda shtetit jugosllav*”²²². Distancimi i Zogut, kur kryesonte qeverinë, nga irredentizmi kosovar se nuk donte “*të turbullonte marrëdhëniet miqësore midis dy vendeve*” shihej avantazh i Zogut përballë Nolit.

Ekziston debate se ç’lloj marrëveshje arriti Zogu me Pashiqin në Beograd dhe për kohën kur është bërë. Studiues si Zh.Avramovski provojnë se u arrit një “*marrëveshje xhentëlmenësh*” dhe asgjë me shkrim. Disa të tjerë e lidhin *me pesë pikat* e rënë dakort nga Zogu, ndërsa të tjerë shprehen se ishte shumë *e definuar dhe me shkrim*²²³. Informacioni i dalë nga arkivat italiane sipas diplomatit Italian të kohës në Durrës flasin për një marrëveshje me 16 pika²²⁴. Marrëveshja Nikolla Pashiq – Ahmet Zogu, gusht 1924, ka si objekt mbështetjen për rikthimin e Zogut dhe kundër qeverisë së Fan Nolit.

Marrëveshja përmban 16 pika si më poshtë; bashkim personal Shqipëri-Jugosllavi, njohje dinastisë Karagjorgjeviq, njohje të A. Zogut si kryetar shteti, heqje dorë nga Ushtria Kombëtare Shqiptare dhe mbajta e një xhandarmërie me oficerë rusë dhe jugosllavë, bashkim doganor, Jugosllavia do përfaqësojë edhe Shqipërinë në arenë ndërkombëtare, tërheqja e pretendimeve mbi Manastirin e Shën Naumit dhe lokalitetet e Vermoshit dhe Kelmendit, tërheqja e Kishës Ortodokse Shqiptare nga Patriarku i Kostandinopojës dhe bashkim me Hierarkinë Ortodokse dhe varësia e Myftinisë Myslimane Shqiptare nga ajo Jugosllave, heqja dorë nga politikat kombëtare shqiptare mbi elementin shqiptar jashtë kufijve të veta, refuzim të segmendeve kundërshtuese të politikës jugosllave, marrja e pëlqimit jugosllav mbi konçesionet, në situatë lufte në Jugosllavi e drejtë rekrutimi në Shqipëri një ushtri prej 25 mijë vullnetarësh, mosdeklarimi luftë asnjë shteti pa pëlqimin e Jugosllavisë. Pika e fundit citonte: “*Ky traktat është sekret dhe nuk mund të zbulohet e të shtypet pa pëlqimin e të dy palëve*”²²⁵.

Marrëdhëniet me **Greqinë** kishin ngarkesën dhe skepticizmin e vetë. Me portokollin e Korfuzit, maj 1914, dhe portokollin e Kapshticës 1920, qeveria greke dhe klerikët ortodoksë grekë vazhdonin me doktrinën e tyre të Megali Idesë. Greqia dhe Jugosllavia kishin mbetur të zhgënjue nga pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve dhe njohjen si shtet i panvarur. Ardhja e Nolit përkeqësoi qasjen ndaj këtyre vendeve, ndërsa Zogu me aftësinë për të evituar përplasjen me Greqinë dhe Jugosllavinë, *kishte bërë aleatë në Athinë dhe në Beograd*. Qëndrimi

²²¹ Bernd J. Fisher, “Diktatorët e Ballkanit”, AIIS, Tiranë 2009, ISBN:978-99956-736-0-4, fq 5-6

²²² Milo P, “Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927, Tiranë 1992. Fq 158

²²³ Zivko Avranovski, fq 131-132 (R. C. Austin, 2003:139) & Milo P, “Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927, Tiranë 1992. Fq 300-303

²²⁴ Diplomati A.T.Aneriti, Memorandum drejtuar Romës dt 9 janar 1925, (AQSH, f.251, V.1925, D.105, fq 3-5)

²²⁵ <http://fishmedia.info/lajme/marreveshja-mes-zogut-dhe-pashiqit/#sthash.XMUjZgfY.dpuf> & AQSH, fondi 251, dosja 105, viti 1924 & F. Mehmetaj, “Veprimtaria kriminale e ‘Dorës së Zezë’ serbe në trojet shqiptare, Prishtinë, 2004, fq 207

i Nolit për çështjen e Kosovës ishte kërcënim për Jugosllavinë, ndërsa me Ahmet Zogun në Beograd, Jugosllavia kishte rast të mirë *për të arritur disa konçesione konkrete*. Duke u nisur në bazë të marrëveshjes Zogu-Pashiq, Noli nuk mund ti ofronte asgjë Jugosllavisë. Greqia si qeveria e Beogradit jetonte në një gjendje se *“kthimi i klikës së Zogut ishte i mirëpritur”* dhe do krijonte një mundësi për ligjës së pretendimet territoriale.

Britania e Madhe konsiderohej një nga vendet perëndimore me tradita të lashta demokratike. Programi qeverisës i Nolit frymëzohej nga parimet e demokracisë liberale perëndimore.

Britania e Madhe, para qeverisë së Nolit, me përfaqësuesin e saj, Hary (Ejers), kishte krijuar me Ahmet Zogun marrëdhënie që funksiononin mirë. Përfaqësuesi britanik pohonte se Zogu *“kishte krijuar stabilitetin e shumëpritur”*, ndërsa Noli nuk paraqitej i pranuar sidomos në marrëdhënie me fqinjët. Qeveritë para asaj të qershorit ishin ndodhur në vështirësi të mëdha ekonomiko-financiare. Përfaqësuesit britanikë kishin arritur të bënin presion qeverisë në favor të shoqërisë Anglo-Persian Oil Company (APOC). Propozimi vinte si shpërblim që qeveria e Britanisë së Madhe do të përkrahte pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve. Pozita me Zogun Kryeministër, konsiderohej rast i mirë nga Britania e Madhe dhe në këmbim, Zogu kërkonte mbrojtjen e shtetit më të fortë në Evropë, *...kundër qëllimeve grabitqare të fqinjëve tanë*²²⁶.

Përfaqësuesi britanik Ejers kishte punuar për regjimin paraardhës. Noli e identifikonte si partizan të Zogut dhe si reaksionar, ndërsa më herët diplomatët amerikanë si *“njeri që kishte ndikim të thellë tek Zogu”*, dhe e kishte ndihmuar të fitonte mbi elementët disidentë *“mbas zgjedhjeve të vitit 1923”*²²⁷. Përfaqësuesi britanik nisej nga prespektiva e stabilitetit të Shqipërisë e të Ballkanit në raport me qeverisjen e Nolit. Programi qeverisës i Nolit kishte karakter përparimtar në politikë të brendshme dhe *“anti-imperializmi i deklaruar”* shihej në një kontekst rajonal. Qëndrimi britanik ishte kundra reformave gjysmake, mbështeste një qeveri e fortë qendrore dhe që të impononte bashkimin mbi një popullsi të përçarë. Zogu shihej si qeverisje e *dorës së fortë, si bajraktar, si sundimtari më i përshtatshëm* në përputhje me nivelin e zhvillimit e nevojat e Shqipërisë së kohës.

Franca me ardhjen në fuqi të qeverisë Noli, ndërmjet Kryeministrit francez të kohës i shprehu përgëzime dhe përkrahje morale. Qëndrimi zyrtar ishte ndryshe, të mos pranonin të hynin në marrëdhënie zyrtare me autoritetet shqiptare. Parisi në konsultë me Londrën kishin rënë dakort në një qëndrim të përbashkët mbi këtë çështje. Qëndrimi francez nuk ishte i ndryshëm edhe nga ai i Beogradit me të cilin *“kishte lidhje të ngushta tradicionale”*²²⁸. Një shoqëri franceze, verën e 1923, kishte kërkonte për të ndërtuar ura kryesore në Shqipëri, ndërsa për konçesionin e vajgurit ishte në krah të SHBA dhe Italisë për të bllokuar kontratën e APOC-ut.

SHBA në raport me britanikët *“vazhdonin të mbeteshin violinë e dytë”*²²⁹. Politika e SHBA ndaj Shqipërisë dhe Nolit do mbështetej në aspektin e interesave ekonomike. Interesi fillestar kishte ardhur nga presioni i misionarëve amerikanë për të mos humbur asnjë konçesion të

²²⁶ Vllamasi S, “Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942”, ISBN:978-9928-140-54-8, fq 304-317

²²⁷ R. C. Austin, “Shtegu i pashkelur i Fan Nolit”, Albin, Tiranë 2003, ISBN:99927-32-59-8, fq 163

²²⁸ Puto A “Shqipëria Politike 1912-1939”, Toena, Tiranë 2009, ISBN:978-99943-1-467-6, fq 371

²²⁹ R. C. Austin, “Shtegu i pashkelur i Fan Nolit”, Albin, Tiranë 2003, ISBN:99927-32-59-8, fq 183

fuqishëm. Misionari amerikan M.Blake, ashtu si kolegët britanikë, ishte shumë i impresionuar nga Zogu dhe e vlerësonte si “*personalitet i shquar në vend*”, i cili kishte “*forcën e duhur shpirtërore dhe kurajo, si hero popullor i ditës, nuk ka frikë, është i ndershëm, i papajtuës dhe i pamëshirshëm ndaj armiqve të tij*”²³⁰. SHBA vërenin se anglezët po trajtoheshin më me përparësi se politika e dyerëve të hapura amerikane dhe gjatë viteve 1922-1923 i kërkonin autoriteteve shqiptare mospranimin e kontratës me APOC. Gjatë pranverës së vitit 1924, SHBA nuk ishin në gjendje të ndikonin në ndryshime politike, ndërsa ardhja e Nolit në pushtet “*ngjalli shpresën për ndryshime positive*”²³¹. Përfaqësuesi amerikan, G.Smith me “*njohjen de jure*” nga SHBA mbi qeveritë shqiptare, para qershorit 1924, e përbuzte Zogun por priti nga Noli sesi do ti trajtonte marrëdhëniet shqiptaro-amerikane. Qëndrimi amerikan lidhej me legalizimin e ardhjes së Nolit në pushtet, gjetjen dhe dënimin e vrasësve të dy qytetarëve amerikanë. SHBA do ta kishin njohur qeverinë Noli nëse do të “*kishte pranuar të mbledhte parlamentin dhe të ishte përparësi të siguronte shumicën e deputetëve*”²³². Në parim qeveria amerikane ishte në unison me atë angleze e ardhjes në fuqi në rrugë jo konstitucionale.

Rikthimi i Zogut në Tiranë u bë me mbështetjen Jugosllave dhe të Italisë. Musolini dëshmoi gatishmëri për të mbështetur ushtarakisht forcat e Zogut me fshehtësinë më të madhe²³³. Strategjia u përpilua në mirëkuptim edhe me qeverinë greke, prandaj u parashikua që trupat e Zogut të hynin nga Jugosllavia prej Veriut, nga drejtimi i Prizrenit dhe nga Greqia prej Jugut, drejtimi i Kakavijës. Nga Jugosllavia Zogut iu dhanë para, armë, municione, mercenarë të Gjeneralit Vrangeli, nën komandën e shtabit bjellogardistë dhe trupa mercenare madje edhe të rregullta greke në Jug²³⁴. Ndërhyrja nga vendet fqinje ishte tërësisht e papranueshme, flagrante dhe në kundërshtim me normat juridike ndërkombëtare, por faktori ndërkombëtar nuk reagoi, vonoi ngritjen e kësaj çështje në nivelet e Lidhjes së Kombeve, derisa të bëhej *fact accompli*, restaurimi i Ahmet Zogut në terrenin shqiptar.

5.3. Kryeministri, Presidenti – tranzicioni drejt Monarkisë.

Ardhja e Zogut me mbështetje të fqinjëve territorialë dhe miratim në distancë nga italianët, krijoi një mjedis shumë të përshtatshëm për autoritetet e të dy vendeve fqinje, Greqinë dhe Jugosllavinë kundër popullsisë shqiptare. Kompromiset politike për pushtetin e brendshëm të Ahmet Zogut shkaktuan dëmtim të interesave kombëtare dhe prodhuan probleme të rënda, sidomos për popullsitë shqiptare që inkuadroheshin si pakica në shtetet e lartpërmendura.

Data 24 dhjetor u shpall si “*Triumfit të Legalitetit*”, shpalli veten kryekomandant të operacionit “*për të sjellë normalitetin në shtet*”. Me rikthimin në Tiranë, “*vuri ligjin në vend dhe ristabilizoi qetësinë*”²³⁵. Në 27 dhjetor në vend u shpall shtetrrithimi, prefekturat u vendosën nën

²³⁰ Department of State, Grand-Smith to the Secretary of State, no.288, 13 June 1924, 875.00/150.

²³¹ R. C. Austin, “Shtegu i pashkelur i Fan Nolit”, Albin, Tiranë 2003, ISBN:99927-32-59-8, fq 187

²³² Department of State, Maxwell Blake to the Secretary of State, 16 september 1922, 875.00/78.

²³³ Telegram i Legatës nga Beogradi, datë 3.12.1924, AQSH, Fondi 251, viti 1924, d. nr. 257P. & Pastorelli, Italia e Albania 1924-1927, Firenze 1967, faqe 69-70

²³⁴ J. Swire, King’s Zog Albania, New York, 1937, faqe 445

²³⁵ K. Dako, Ahmet Zogu, mbret i shqiptarëve, Tiranë 1937, faqe 128

urdhërave të komandantëve të operacionit, u suprimuan institucionet penguese ndaj Zogut, u shpërndanë të gjitha organizatat dhe shoqatat pjesëmarrëse të Lëvizjes së Qershorit që kishin “qëllime revolucionare dhe bolshevike”. U censurua liria e shtypit dhe fjalës, u vendos censurë mbi shtypin dhe letërkëmbimin privat²³⁶.

Për të “rimëkëmbur vazhdimësinë legale” të regjimit të tij, Zogu thirri kryeministrin e dëbuar nga revolucioni i qershorit në 3 janar, për të rikryesuar qeverinë. Zogu ishte i “vetëdijshëm se duhet të legjitimonte pozitën e vetë sa më parë të qe e mundur”²³⁷. Disa ditë më pas në 6 janar 1925, thirri Këshillin e Lartë me numër anëtarësh të kufizuar, shkarkoi Ilias Vrionin dhe përqëndroi në duart e veta drejtimin e qeverisë. Qeveria e re me Ahmet Zogun kryeministër, një ditë më pas parashtronte programin qeverisës duke i dhënë përparësi problemeve më emergjente. Programi përmbante prishje të “sistemit të vjetër”, suprimim të Ministrisë së Luftës në një “Komandë e përgjithshme armate”, organizimin e Xhandarmërisë, çarmatimin e popullsisë dhe rikthim të rendit, shkurtim shpenzimesh edhe në administratë publike, kursimet do të përdoreshin për “nevojat botore”, mbajtja e zgjedhjeve të reja dhe përfundonte me politikën e jashtme. Mbi politikën e jashtme citonte se “ka me qënë mbrojtje e independencës dhe integriteti i shtetit tonë”²³⁸.

Mbi formën qeverisëse të shtetit ishte në fuqi Monarkia nga Shqipëria e viteve 1914 me Princ Vidin, dhe në mungesë të monarkut vendin e zinte Këshilli i Regjencës ose Këshilli i Lartë. Mbi ndryshimi i formës së shtetit, më 17 janar 1925, u thirr Kuvendi Kushtetues i zgjedhur në vitin 1923. Mungesa e opozitës në një Kuvend Kushtetues të cunguar u shoqërua edhe me heqjen e “mandatit 23 anëtarëve” të Kuvendit²³⁹. Zogu me “detyrat emergjente” dhe sistemin “para në këmbim të paqes” siguronte vazhdimin “sipas planeve të veta dhe sipas realiteteteve të jetës politike shqiptare”²⁴⁰.

Kuvendi Kushtetues më 21 janar shpalli Shqipërinë Republikë si një formë e re e shtetit shqiptar. Kuvendi Kushtetues më 31 janar miratoi nenet e para të statutit dhe zgjodhi Ahmet Zogun President. Në nenin 69 i miratuar pa radhë nga Kuvendi Kushtetues përcaktonte; Kryetari zgjidhet prej mbledhjes së përbashkët të Senatit e të Dhomës së Deputetëve për shtatë vjet me shumicë absolute votash, ndërsa për këtë herë do zgjidhet prej Kuvendit Kushtetues. Kryetari i Republikës u zgjodh nga Kuvendi Kushtetues në bazë të procedurës së veçantë “sa për këtë herë”²⁴¹. Hapi i radhës ishte përpunimi dhe miratimi i Kushtetutës së re si reflektim të ndryshimeve. Përparësi ju dha neneve që kishin të bënin mbi ndryshimin e formës së shtetit. Në mars 1925 hyri në fuqi statuti themeltar i Republikës së Parë Shqiptare. Kushtetuta e rishikuar përmbante 142 nene dhe synonte vendosjen e Regjimi Republikan. Neni 1 Statutit Themeltar theksonte; “Shqipëria asht Republikë Parlamentare e kryesume prej një Kryetari. Sovrani buron prej popullit”. Me Statutin Themeltar, Shqipëria ishte Republikë Parlamentare por me një veçori:

²³⁶ Historia e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri, Tiranë 2001, fq 361

²³⁷ Bernd J. Fischer, “Diktatorët e Ballkanit”, AIIS, Tiranë 2009, ISBN:978-99956-736-0-4, Fq 36

²³⁸ Teki Selenica, “Shqipëria më 1927”, Tiranë 1928, fq 142-144

²³⁹ Puto A “Shqipëria Politike 1912-1939”, Toena, Tiranë 2009, ISBN:978-99943-1-467-6, fq 393

²⁴⁰ Bernd J. Fischer, “Diktatorët e Ballkanit”, AIIS, Tiranë 2009, ISBN:978-99956-736-0-4, Fq 35

²⁴¹ Teki Selenica, “Shqipëria më 1927”, Tiranë 1928, fq 146

Presidenti i Republikës ishte edhe Kryeministër. Neni 8 i Statutit citonte se: “*pushteti përmbartues (ekzekutiv) i përket vetëm Kryetarit të Republikës, i cili e ushtron atë me anë të Ministrave*”. Republika Shqiptare ngjante si “*Republikë Presidenciale Parlamentare*”, por komponenti “*parlamentar*” mbeti vetëm në letër. Qeveria ishte “*një bërthamë pranë Kryetarit për të ushtruar pushtetin ekzekutiv*”²⁴². Forma e shtetit “Republikë Parlamentare” që shpalli Zogu nuk qe as presidenciale, as parlamentare, as demokratike. “*Ajo ishte një Republikë despotike, ku të gjitha fijet e pushtetit përqëndroheshin në duart e A. Zogut*”²⁴³.

Ndarja e pushteteve sanksiononte modelin klasik të Republikës me ndarjen e tre pushteteve, legjislativ, gjyqësor dhe ekzekutiv. Pushteti legjislativ ushtrohet prej Senatit dhe Dhomës së Deputetëve. Pushteti ekzekutiv përcaktohej tek neni 8, ndërsa pushteti gjyqësor ushtrohet prej gjykatave dhe vendimet e tyre jepen në emër të Republikës Shqiptare. Struktura e pushtetit legjislativ me dy dhoma ishte formale. Kjo strukturë vendoste Senatit në pozita mbizotëruese, ruante balancat e zgjidhte problemet kur mund të lindnin midis legjislativ dhe ekzekutiv. Senati synonte vendosjen e kontrollit mbi dhomën e deputetëve. Presidenti në këtë model kishte mjaft përqendrim pushtetesh mbi të tre degët e pushtetit. Bazuar në këtë përqendrim pushtet, Presidenti dekretoi akte ligjore mjaft të forta, me karakter theksues represiv politik kundër kundërshtarëve të tij.

Dhoma e Deputetëve kishte 57 anëtarë dhe me moshë mbi 30 vjeç, një në 15 mijë frymë për 4 vjet me votim jo të drejtpërdrejtë (neni 11). Senati kishte 18 anëtarë me mandat 6 vjeçar, me moshë mbi 40 vjeç, 2/3 e senatit zgjidheshin nga elektorati dhe 1/3 (6 senatorë) emëroheshin nga Kryetari i Republikës, i cili ishte “*element moderator, zbutës dhe paqëtues*”. Kryetari i Senatit zgjidhej nga Kryetari i Republikës, me argumentin se “*ai ishte në pozitën e zëvendësimit të tij kurdoherë që ai mund të mungonte*” (neni 49)²⁴⁴. Projektligjet e propozuara nga A. Zogu si Kryeministër, ktheheshin në dekrete vetëm nëse i nënshkruante A. Zogu si President i Republikës. Ndryshimet e bëra nga Dhomat legjislative duhet të miratoheshin nga Presidenti i Republikës. Presidenti kishte kompetenca të zgjeruara jo vetëm për ekzekutivin por edhe për pushtetin legjislativ. Në statusin e tij, atij i jepej e drejta e vetos në miratimin e ligjeve. Ai ishte njëkohësisht edhe komandant i forcave të armatosura, krahas ministrave, emëronte dhe ç’emëronte nënëpunësit e lartë të shtetit dhe oficerët e forcave të armatosura. Ai kishte të drejtën e faljes, shpall luftën me miratimin e dy dhomave, shpall gjendjen e jashtëzakonshme dhe më pas e dërgon për aprovim para dhomave të parlamentit. Kishte të drejtë të bënte traktate dhe marrëveshje me shtetet e tjera me përqimin e dy dhomave.

Në mars 1925 u miratua edhe ligji i zgjedhjeve me liritë e detyrimet për subjektet dhe qytetarët. Ky ligj do të ishte më shumë veprimtari administrative sesa politike. Ligji i zgjedhjeve kufizonte të drejtat disa shtresave të popullsisë. Lejoheshin meshkujt mbi moshën 18 vjeç, por përjashtoheshin gratë nga e drejta e shprehjes së vullnetit popullor, çka tregonte nivel shumë të ulët të emancipimit shoqëror. Përjashtoheshin nga pjesëmarrja në votime ushtarakët, xhandarët,

²⁴² Statuti Themeltar i Republikës Shqiptare, botuar në Fletoren zyrtare, datë 7 mars 1925, nr 8 & Ligje, Dekret ligje e Rregullore të vitit 1925, Tiranë 1938, fq 1-18 & Puto A, 2009:393-397

²⁴³ Frashëri K, “Ahmet Zogu – vështrim historik”. Botime “M&B”, Tiranë 2014, ISBN:978-9928-172-22-8, fq 69

²⁴⁴ Historia e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri, Tiranë 2001, fq 362-366

policët, të burgosurit, të falimentuarit dhe lupësit. Sipas ligjit të zgjedhjeve “çdo komunë caktonte dhjetë zgjedhës, të cilët mblidheshin në prefekturë për të bërë zgjedhjen e deputetëve”²⁴⁵. Reduktohej numri i votuesve dhe thuajse ishte një *elektorat qartësisht i orientuar politikisht drejt legalitetit, forcës politike të Ahmet Zogut*²⁴⁶.

Në statut trajtoheshin të drejtat e qytetarëve në përgjithësi. Siguroheshin të drejtat dhe liritë personale, por në fakt *nuk kishte asnjë hapësirë për një opozitë politike*. Statusi Themeltar përjashtonte pluralizmin ndërsa “*opozita u mposht dhe u detyrua të heshtë*”²⁴⁷. Një dispozitë e veçantë përmbante ligjin ndëshkimor për fajet politike.

Ndër aktet ligjore u morën masa të menjëhershme për të ndjekur “fajtorët” dhe çdo zë opozitar kundër regjimit. Karakteri represiv dhe diktatorial krijoi një gjykatë ushtarake në Shkodër me kompetencë “*të gjykonte oficerët që kanë luftue kundër fuqisë legale të operacionit, të kontrollonte banimin ditën e natën, të internonte njerëz të dyshimtë dhe të ndalonte gazetat që prishnin qetësinë*”²⁴⁸. Brenda muajit mars dolën e dy dekrete, mbi “internimin e autorit të propogandës” dhe “internimin dhe konfiskimin e pasurive së t’arratisurve”. Në fund të vitit 1925 u miratua “ligji ndëshkimor për fajet politike”. Ligji parashikonte deri 15 vjet burg për propogandë kundër regjimit, kundër Kushtetutës dhe Presidentit, dhe për atentate kundër kryetarit të Shtetit deri 101 vjet ose me vdekje²⁴⁹.

Konsolidimi i pushtetit të Ahmet Zogut shkoi paralelisht me përpjekjet e tij për të mënjeluar, larguar apo eliminuar mjaft prej kundërshtarëve të tij të mëdhenj si Fan Noli, Dr. M. Turtulli, Bajram Curri, Luigj Gurakuqi, Hasan Prishtina e të tjerë personalitete politike me shumë ndikim brenda dhe jashtë vendit. Zogu ngriti gjyq të veçantë kundër Nolit dhe bashkëpunëtorëve të tij. Noli dhe të tjerë u dënuan me vdekje në mungesë me akuzën “*për tradhëti kundër Shtetit*”, ndërsa legjistacioni penal përmbante në formulim parime demokratike si; “*askush nuk mund të dënohet për një vepër që ligji nuk e ka parashikuar shprehimisht si krim dhe as të dënohet me ndëshkime që nuk janë të caktuara me ligj*”²⁵⁰. Ndërtimi i modelit, disa ligje e dekrete, vija politike e sjelljes po e shpinin natyrshëm vendin drejt diktaturës. U eliminua gradualisht çdo frymë e lirisë, mendimit politik alternativ dhe në përgjithësi u intimidua në ekstrem fryma politike opozitare. Këtë e konstatonin edhe dokumentet diplomatike të kohës, të cilat theksonin se vendi po eliminonte çdo element të republikanizmit dhe po instalonte monarkinë.

Hap pozitiv u bë në përpunimin e legjistacionit penal. Si bazë për kodin penal u mor modeli italian i plotësuar me akte ligjore, praktika të vendeve evropiane. Kodi Penal dhe ligji mbi aplikimin e tij i vitit 1927, hynë në fuqi në janar 1928. Legjistacioni Penal orientohej nga legjistacionet klasike evropiane. Kjo normë drejtohej kundër arbitraritetit, kundër të drejtës së vjetër zakonore dhe vendoste ndjekje penale mbi baza ligjore. Legjistacioni Penal i plotësuar me akte e praktika ligjore, nga përmbajtja dhe fryma e tij, ishte “*në kontrast të dukshëm me aktet*

²⁴⁵ Mousset A, “Shqipëria përballë Europës”, Tiranë, Dituria 2004, ISBN:99927-59-42-9, fq 68

²⁴⁶ B. J. Fischer, King Zog and the struggle for stability in Abania, New York, 1984, pp. 79

²⁴⁷ Mousset A, “Shqipëria përballë Europës”, Tiranë, Dituria 2004, ISBN:99927-59-42-9, fq 69

²⁴⁸ Fletore Zyrtare, dt 18.2.1925, nr 8.

²⁴⁹ Historia e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri, Tiranë 2001, fq 393

²⁵⁰ Fletore Zyrtare, dt 17.3.1925

ligjore të ndërmarrja jashtë kuadrit të tij”²⁵¹. U strukturua dikasteri përkatës dhe mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të gjykatave në vend. U hartuan ligje të reja në fushën civile, penale, tregtare dhe të shërbimit tregtar. Komisioni përbëhej nga juristë të aftë dhe mbi përvojën dhe jurisprudencën e vendeve europiane.

Një hap i rëndësishëm mbi legjitimitimin e pushtetit ishte shpallja e zgjedhjeve parlamentare dhe të pushtetit lokal në prill dhe në dhjetor të vitit 1925. Në prezantimin e programit qeverisës, Zogu citonte se “*një nga qëllimet tona kryesore është me fillue sa më parë zgjedhjet e reja, me liri të plotë e me paanësi të vërtetë që kështu të ndihet e të merret vesh sovranit ynë ku kam respektin tim më të madh*”²⁵².

Në 19 janar 1925 në Kuvendit Kombëtar, Zogu Kryeministër parashtronte vizionin e tij qeverisës. Për realizimin e politikave qeverisëse e ngritjen e strukturave të larta shtetërore, Zogu kërkonte ngritjen e një administrate qëndrore dhe lokale efektive. U hartuan dhe miratuan një sërë ligjesh, vendime, rregullore, akte zyrtare në funksion të administratës shtetërore dhe lokale. Administrata u konsiderua si organizëm i rëndësishëm në shërbim dhe konsolidimin e shtetit. Zbatimi i akteve, normave dhe praktikave administrative u pa si hap dhe mundësi mbi krijimin dhe konsolidimin e shtetit ligjor. U përcaktuan strukturat e institucioneve qëndrore dhe lokale, organika qeverisëse, numri i të punësuarëve dhe niveli i pagave. U bë përpjekje për tërheqje të personelit të shkolluar e kualifikuar, të specialistëve shqiptarë e të huaj që banonin jashtë.

Mbi administratën dhe mirëfunksionimin e saj u ngritën struktura mbi kontrollin financiar dhe realizimin e detyrave, u ngrit *këshilli kordinues i financave të shtetit*. Në vitin 1927 u krijua “*inspektoria e përgjithshme*” me rregullore mbi kontrollin e zbatimit të ligjit nga administrata, normat disiplinore nga nënpunësit. Në maj të vitit 1928, u miratua *ligji i ri për administratën civile*. Ky ligj nga ana administrative e ndante Shqipërinë në “*prefektura, nënprefektura dhe katunde*”. Zogu theksonte se “*pozicioni politik i yni ka me qënë i bazum në mëvetësinë e shtetit t’u mbrojt indipendencën e zhvillimin administrativ e ekonomik të shtetit tonë*”²⁵³. Tirana u konfirmua si kryeqytet i Shqipërisë, 2 mars 1925, dhe si *rend dite* ishte përshtatja e qytetit për nevojat e reja si qendër politike dhe administrative.

Reforma në fushën e Arsimit transformoi strukturën arsimore në një drejtori të përgjithshme nën varësinë e Ministrisë së Drejtësisë. Krahas largimit dhe pushimit nga puna të shumë arsimtarëve, u bë përgatitja e bazës ligjore për reformën në fushën arsimore.

Neni 141 i Kushtetutës Shqiptare e vitit 1925 parashkruante që forma Republikane e Shtetit Shqiptar në asnjë rast nuk mund të ishte objekt i një propozimi për ta ndryshuar atë. Rregullimet kushtetuse “*bënë që të rritet presligji dhe autoriteti i diktatorit, ...mbivlerësoi së tepërmi frymën e ndëshkimit dhe besnikërisë së njerëzve*”²⁵⁴. Zogu u instalua në Tiranë si zot absolut i vendit dhe shpresonte se me strukturën e re republikane do të arrinte lehtësisht stabilitetin e vendit.

²⁵¹ Puto A “Shqipëria Politike 1912-1939”, Toena, Tiranë 2009, ISBN:978-99943-1-467-6, fq 397

²⁵² K. Dako, Ahmet Zogu, mbret i shqiptarëve, Tiranë 1937, faqe 131

²⁵³ Universiteti i Tiranës & Instituti i Historisë, “Panvarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shek.XX-të”, Përmbledhje studimesh, Tiranë 2008, ISBN:978-99956-648-1-7, fq 269-270

²⁵⁴ Mousset A, “Shqipëria përballë Europës”, Tiranë, Dituria 2004, ISBN:99927-59-42-9, fq 68

“Triumfi i Legalitetit” krahas nismave të legjistacionit ndërmori operacione ushtarake në vende e rajone të cilat kishin qënë baza të lëvizjes demokratike në jug e veri. Këto operacione ndeshën në rezistencë nga opozita që nisë të nxjerrë krye dhe nga paria dhe bajraktarët e malësisë. Fushata krahas ndëshkimit të “*vatrave opozitare*” u shoqërua me aksionin e çarmatimit të përgjithshëm të popullsisë. Ahmet Zogu, qershor 1925, do angazhohej personalisht në një ndër arritjet më të mëdha të konsolidimit të qetësisë në vend. Zogu u kujdes të ftojë gjithë “*parinë dhe bajraktarët e malësisë*” nën “*besën shqiptare*”, mbi “*besnikërinë ndaj ligjit*” dhe “*mostradhëti ndaj atdheut*”. U mblodhën bashkë rreth 540 krerë tradicionalë në një ditë, “*të veshur e të ngjeshur me armë, bajraktarë dhe krerë të fiseve malore. ...secilit i dukej vetja një sundimtar, një kryetar, ...njëri pas tjetrit, ata i afroreshin Zogut, zgjatnin dorën dhe i jepnin besën*”²⁵⁵.

Rikthimi i Ahmet Zogut në dhjetorit 1925 u shoqërua me largime të mjaft emigrantëve jashtë kufijve të Shqipërisë, kryesisht në Itali, Vjenë, Amerikë etj. Një pjesë u kthyen para dhe pas amnistisë së shpallur nga qeveria e Zogut, ndërsa *shumica e emigracionit mbeti në mërgim, në raport me evoluimin e ngjarjeve*. Prezenca e emigrantëve në Itali ishte shqetësim për Zogun. Italia i shfrytëzonte dhe përdorte emigrantët shqiptarë në maksimum për marrëveshjet që bënte me Zogun. *Përçarja dhe kundërthëniet mes Zogut dhe të tjerëve i përshtateshin shumë diplomacisë italiane*²⁵⁶. Pas tentativave për marrëveshje dhe dështimeve edhe me kërcënime, Zogu arrinte qëllimin me anë të atentateve. Atentati kundra Luigj Gurakuqit në Bari, 2 mars 1925 ishte i pari, u pasua me vrasjen e Bajram Currit, Ceno Beg Kryeziut etj. Luigj Gurakuqi u bë viktimë e italo-filizmit, nga frika se ky, “*me influencën që ka patur pranë qeverisë italiane, mos e pengonte marrëveshjen që Zogu ishte duke bërë me Italinë*”²⁵⁷.

Regjimi filloi të përballej me goditje edhe nga qarqet nacionaliste, siç ishin ato të Komitetit Nacional Revolucionar (Konare) dhe Komitetit të Çlirimit Nacional (KÇN), të cilët filluan kthimin në Shqipëri dhe organizimin e tyre të brendshëm. Në shtator 1927 anëtarëve të “Konare” ju kërkua nga “Kominterni” dhënia e ndihmës me kondicionim në “*transformim ideologjik të anëtarëve të saj drejt së majtës*”. “Konare” u shpërbë, një pjesë që nuk pranonin “*të majtën e Kominternit*” kaluan me shoqërinë “*Bashkimi Kombëtar*”. Në këtë periudhë lindi në Shqipëri lëvizja komuniste me orientim e drejtim nga Kominterni, (Internacionalja Komuniste)²⁵⁸.

Zogu në fillimet e karrierës së vetë është quajtur një autokrat me prirje diktatoriale. Shokët e bashkëpunëtorët e tij “*kur panë se ai synonte të sundonte vendin me një diktaturë personale*”, u larguan nga Shqipëria. Pas konsolidimit të pozitive të tij Zogu, insistonte në kthimin në Shqipëri të një pjese të emigrantëve, e sidomos të krahut të tij të vjetër, ish-anëtarët e Krahut Kombëtar. Zogu nëse do të ishte treguar modest në pretendimet e tij të një republike me një demokraci autoritare, shokët e vjetër e shumë patriotë të tjerë do të kthehesh në atdhe. Ataturku ishte shembull, por Zogu nuk mori parasysh vullnetin e popullit, vendosi diktaturën personale dhe e

²⁵⁵ Eqerem bej Vlora, “Kujtime 1885-1925”, Botimi i II-të, IDK, Tiranë, ISBN:99927-780-6-7, fq 251

²⁵⁶ Hoti I, “Qëndrimi i Diplomacisë Italiane ndaj Shqipërisë dhe Shqiptarëve 1930-1941”, Insituti i Historisë – Prishtinë, Prishtinë 1997, fq 163

²⁵⁷ Vllamas S, “Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942”, ISBN:978-9928-140-54-8, fq 424

²⁵⁸ K. Frashëri, “Historia e të majtës në Shqipëri”, Tiranë 2006, fq 28

bëri fakt të kryer. Zogu u largua nga parimet Republikane Demokratike të Krahut Kombëtar, u “deklarua diktator dhe mori një përgjithësi të madhe përpara historisë”²⁵⁹.

Autorë e studiues të ndryshëm të kësaj periudhe nga ata shqiptarë deri ata të huaj përcaktojnë se: “Zogu mori kryesinë e qeverisë në realitet më shumë si diktator sesa si kryeministër parlamentar”, qarqet italiane mendonin se “Zogu vendosi një diktaturë tipike ballkanike”, u rikthye në pushtet si “diktator dhe komandant të përgjithshëm. Përfaqësuesit e Departamentit Amerikan të Shtetit në vitin 1926 krijuan bindjen se Zogu po shkonte drejt pushtetit absolut. Në raport mbi pushtetin e Zogut nënvizohej se “Presidenti Zogu po e shtonte dukshëm kontrollin e tij në të gjithë Shqipërinë” dhe se “nuk kishte mbetur asgjë nga atmosfera republikane dhe regjimi po shkonte drejt monarkisë”. Idea fillestare për të ndërtuar një “demokraci me orientim të mirëfilltë demokratik të tipit perëndimor”, kishte marrë fund dhe në “realitetin shqiptar nuk mund të funksiononte veçse një regjim autokrat”²⁶⁰. Tek Zogu, pushteti personal zuri vendin e pluralizmit politik.

Janari i vitit 1925 do sillte “reflektim” edhe për Faik Konicën. Në shkrimet e tij botuar tek gazeta “Dielli” shtronte disa dilema dhe alternativa. Ai bashkohet me qeverinë “për të siguruar paqe dhe rend”, shtonte se mbështetja në popull është mundësi qeverisje. Duke referuar qeverisë së Nolit, Konica sqaronte se; “populli shqiptar nuk do reforma dhe reformatorë, nuk do gjëra të reja, as njerëz që përpiqen të sjellin gjëra të reja”²⁶¹.

Politika e jashtme e qeverisë së Ahmet Zogut ishte një nga pikat e programit të tij qeverisës. Ahmet Zogu, në 19 janar të vitit 1925, në fjalën e tij para Kuvendit Kushtetues theksoi rëndësi ruajtjes dhe forcimit të marrëdhënieve me fqinjët, marrëdhënie të mira me fuqitë e Mëdha dhe zgjerim të marrëdhënieve diplomatike me shtetet e tjera.

Me ardhjen e Ahmet Zogut Kryeministër-President, bisedimet shqiptaro-jugosllave mbi çështjen e Shën Naumit, Velipojën e Vermoshit u shtruan në mbledhjen e dy dhomave legjislative, Senat dhe në Parlament (17-19 korrik). Sipas autorit Kaloti Naska dhe historianit Kristo Frashëri, përfaqësuesi shqiptar Mehdi Frashëri nuk kishte pse të diskutonte vendimin e Gjykatës së Hagës përciellë Konferencës së Ambasadorëve që ishte në favor të Shqipërisë, por theksohej shqetësimi jugosllav. Mehdi Frashëri i drejtohej parlamentit se qeveria shqiptare mbas këshillave dy herë të përsëritura të qeverisë jugosllave, mbi Shën Naumin dhe një pjese të Velipojës në zonën e Vermoshit. Kuvendi pranoi të autorizojë qeverinë shqiptare “që të fillonte bisedimet me palën jugosllave për zgjidhjen e çështjes së kufirit”, ndërsa Shqipëria do përfitonte “lehtësira tregëtie dhe komunikacioni”. Kryetari i Kuvendit Eshref Frashëri rikujtonte se shkelej neni 2 i statutit ku thuhej se “kufinj të Shqipërisë ishin të paprekshëm”, dhe “ndërrimi i statutit bëhet me 2/3 e votave të mbledhjes legjislative duke përfshirë të dyja Dhomat bashkë”. Votimi u hodh në dy Dhomat legjislative, ku nga 65 kuvendorë (18 senatorë dhe 47 deputetë) në sallë ishin 54 kuvendorë. Në favor të shtojcës së nenit 2 të Statutit votuan 43 kuvendorë, 8 kuvendorë

²⁵⁹ Vllamasi S, “Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942”, ISBN:978-9928-140-54-8, fq 430

²⁶⁰ A.Simonard, “Essai sur l’indépendance albanaise”, Paris 1942, p 440 & M.Borgogni, “Tra continuita e incertezza. Italia e Albania (1914-1939), Milano 2007, p 85 & J.Swire, “The Rise of a Kingdom”, London 1929, p 451 & Arkiva diplomatike e SHBA-së, O.Pearson, “Albania and King Zog”, London 2004, p 257, (Puto A, 2009:399)

²⁶¹ Gazeta “Dielli”, dt 8 janar 1925

kundërshtuan haptas dhe 2 kuvendorë abstenuan duke u larguar. Shtojca u miratua dhe në datë 18 korrik, Myfit Libohova me një mocion drejtuar të dy dhomave shprehej se; “...mbi çështjen e kufijve shqiptaro-jugosllav, pranon në parim ad referendum një shkëmbim toke midis dy shteteve dhe autorizon qeverinë të hyjë në marrëveshjet e duhura në përputhje me interesat e shtetit dhe të popullit shqiptar”²⁶².

Ndërsa Zogu si autoriteti më i lartë shqiptar vazhdonte flirtin me Jugosllavinë për shkëmbim territorësh dhe nuk kishte hyrë plotësisht në tratativa me Italinë, emigrantët shqiptarë me banim në Itali, me insistimin Italian, u detyruan të dërgonin një komision në Romë për një marrëveshje shqiptaro-italiane. Kjo e trembi Zogun dhe e shtyu “të shpejtonte bisedimet me Musolinin”²⁶³. Këto ishin sipërmarrje italiane, “një mënyrë e rrënimt të autoritetit të mbretit Zog” dhe në funksion të ambicjes së saj mbi Shqipërinë²⁶⁴. Pamundësia e Jugosllavisë për t’ju përgjigjur pozitivisht kërkesave të Zogut për ndihma të rëndësishme, sidomos financiare, bënë që ky i fundit pas rrëzimit të qeverisë së Nolit dhe shpalljes së Republikës, të ndërmernte hapa direkte drejt përmirësimit dhe forcimit të marrëdhënieve me Italinë. Zogu iu largua Jugosllavisë, e cila e kishte mbështetur ushtarakisht dhe financiarisht për t’u rikthyer në pushtet. Ahmet Zogu midis Jugosllavisë dhe Italisë bënte kalkulimet e veta. Jugosllavia synonte të kishte një qeverisje projugosllave, ndërsa rritja e ndikimit jugosllav në Shqipëri nuk do përquehej nga Italia. Zogu e kuptonte se fryma antiserbe tek qarqet shqiptare do të bënte përpjekje për ta rrëzuar nga pushteti dhe në bashkëpunim me nxitjen italiane do përkrahnin një person me orientim proitalian.

Ahmet Zogu bëri përpjekje të vazhdueshme për të minimizuar rreziqet që dëmtonin sovranitetin e vendit. Diplomati Italian në Shqipëri, Aliosi shprehej mbi Ahmet Zogun se dëshironte të forconte lidhjet me Italinë por nuk dëshironte të asfiksohej prej tyre. “...pavarësia është themeli mbi të cilën ai ka vendosur aspiratat e tij të ardhme në një Shqipëri ndoshta të dobët, të varfër, të rrethuar me armiq kërcënues, por formalisht e barabartë me të gjitha shtetet në sovranitetin e saj të plotë”²⁶⁵.

Diplomacia italiane ndaj Shqipërisë ishte shumë efektive dhe e kujdeshshme. Eksperiencia italiane në Shqipëri tregonte se “Shqipëria u bë kopështi shkëmbor i Italisë me dyqind milje bregdet pranë ujërave italiane”²⁶⁶. Italia, bazuar në deklaratën e Këshillit të Ambasadorëve mbi Shqipërinë (Paris nëntor 1921), mendonte se me marrëveshje ndërkombëtare predominonin në mbrojtjen dhe zhvillimin e Shqipërisë. Sipas deklaratës së ambasadorëve, panvarësia, integriteti dhe paprekshmëria e kufijve të Shqipërisë ishte një çështje e një rëndësie ndërkombëtare dhe mund të përbënte rrezik për sigurinë strategjike të Italisë. Pika 2 e deklaratës citonte se

²⁶² Naska, K, “Shën Naumi dhe diplomacia e kohës”, Tiranë 2012, fq 606-612, (Frashëri K, 2014:85-90)

²⁶³ Vllamasi S, “Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942”, ISBN:978-9928-140-54-8, fq 422

²⁶⁴ Hoti I, “Qëndrimi i Diplomacisë Italiane ndaj Shqipërisë dhe Shqiptarëve 1930-1941”, Insituti i Historisë – Prishtinë, Prishtinë 1997, fq 164

²⁶⁵ Universiteti i Tiranës & Instituti i Historisë, “Panvarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shek.XX-të”, Përmbledhje studimesh, Tiranë 2008, ISBN:978-99956-648-1-7, fq 272

²⁶⁶ S.Beach, “The President is Dead, Long Live the King”, The Independent, 8 shtator 1928, pg 239, (Robert J. Stevens, 2004:54)

“...rishikimi i kufijve territorial të Shqipërisë duhet t’i besohet Italisë” dhe në fund të pikës 4, “çdo motivim i kufijve të Shqipërisë përbën rrezik për sigurinë strategjike të Italisë”²⁶⁷.

Strategjia e depërtimit Italian në Shqipëri u përgatit nga Salvatore Contarini (Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme italiane). Kjo strategji synonte “dobësimin e epërsisë politike të Jugosllavisë në Shqipëri nëpërmjet forcimit të epërsisë ekonomike të Italisë, negociata të reja me Beogradin për një sistem politik të çështjes së shqiptarëve nëpërmjet një marrëveshje dypalëshe”²⁶⁸. Për S. Contarinin, “panvarësia shqiptare vlente vetëm në funksion të marrëveshjes që do përfundohej me Beogradin”²⁶⁹. Zogu përballë strategjisë së depërtimit ekonomik Italian u kujdes të mos cënonte interesat ekonomike britanike, por periudhat në vazhdim do karakterizoheshin nga ndërhyrje e fuqishme ekonomike në Shqipëri²⁷⁰. Në 14 janar 1925, Ahmet Zogu iu rikthye dialogut të ndërprerë të gushtit 1924 me Romën. Salvatore Contarini (Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme italiane), në 20 janar i paraqet Musolinit planin e këtij veprimi. Gjatë bisedimeve me ministrin Italian në Shqipëri, Durazzo, Zogu arriti të bind përfaqësuesit italianë se “nuk hezitonte të njihje epërsinë absolute të interesave ekonomike dhe tregtare italiane në Shqipëri në raport me çdo shtet tjetër”. Plani “Contarini” do ti shërbente rrugën së “depërtimit me epërsi të kapitalit Italian në Shqipëri”²⁷¹.

Salvatore Contarini preferoi tezën e depërtimit Italian në Shqipëri të mos prekte për momentin pavarësinë politike të Shqipërisë. Në mars 1925 u emërua ministri Lojacommo, drejtor i zyrës për Shqipërinë. Lojacommo njihej si “përkrahës i ideve të Contarinit dhe njeri i besuar i tij dhe i partisë fashiste”. Musolini nuk hezitoi por detyroi Drejtorin e Përgjithshëm të Kreditit Italian mbi depërtimin ekonomik në Shqipëri si mundësi e mirë për të shfrytëzuar deri në fund “burimet e dobëta ekonomike shqiptare”. Sipas autorit italian G. Garocci plani përmbante; ratifikimin e Traktatit të Tregëtisë dhe të Lundrimit firmosur në Romë në vitin 1924, marrja nga Italia e terreneve mbi kërkim dhe shfrytëzimin e naftës në Shqipëri, pjesëmarrja italiane vepra publike, shfrytëzimin e pyjeve, zgjatja e lejës mbi shfrytëzimin e peshkut, dhënia në shfrytëzim e minierës së Memaliajt, rikonfirmimi i shoqërive italiane mbi shfrytëzimin e minierave të Selenicës, çështjen e sharrave në Llogara dhe themelimi i Bankës së Shtetit Shqiptar²⁷².

Zogu fillimisht nuk pranoi kërkesën e për dhënien e konçesioneve për kërkimin e shfrytëzimin e fushave vajguore në Shqipëri. Zogu i ishte premtuar përfaqësuesit anglez në Shqipëri mbi përkrahjen angleze në Lidhjen e Kombeve një shumë “hua prej 3 milionë lira stërlina” dhe prioritet shoqërisë anglo-persiane “premtimin për konçesionin vajguor në Shqipëri”²⁷³. Rivaliteti Anglo-Italian në Shqipëri hyri në një fazë ku kërkohesh një zgjidhje e shpejtë dhe në favor të marrëdhënieve dypalëshe Italo-Angleze. Qeveria angleze pranoi të bënte

²⁶⁷ Robert J. Stevens, “Zhvillimet politike në Shqipëri, 1920-1939”, Tiranë, Geer 2004, ISBN:99927-946-4-X, fq 54-55

²⁶⁸ Arben Cici, “Marrëdhëniet Shqiptaro-Italiane në vitet 1920-1934, Afërdita, Tiranë 2002, ISBN:99929-37-98-0, fq 9

²⁶⁹ G. Garocci, La politica estera dell’Italia fascista, 1925-1928, Bari 1969, fq 35

²⁷⁰ M. Belegu, “Politika Zogiste e detyrës të hapura në 1925-1926”, Studime historike, Tiranë 1964, nr.3, fq 35

²⁷¹ P. Pastorelli, Italia e Albania 1924-1927, Firenze 1967, fq 97, 101-102

²⁷² G. Garocci, La politica estera dell’Italia fascista, 1925-1928, Bari 1969, fq 36-38

²⁷³ DDI, serie VII, vol 3, dok. 701, fq 434-438

tërheqje. Në 25 janar 1925, autoritetet e Londrës udhëzonin përfaqësuesin e saj në Shqipëri se “*Anglia nuk ka kurrëfarë interesash të tjera në Shqipëri, përveç ruajtjes së paqes*”²⁷⁴.

Musolini duke njohur mirë gjendjen e vështirë në të cilën ndodhej Zogu porositi lëvrimin e huasë italiane për Zogun “*shumën 500 mijë fr.ari para përfundimit të marrëveshjes përkatëse ekonomike*”²⁷⁵. Qeveria italiane mundi të bindte Zogun në përfundim të disa marrëveshjeve, midis së cilave edhe dhënien e konçesionit vajguror Hekurudhave të shtetit Italian dhe shoqërisë italiane SIMSA.

Faza e parë e depërtimit italian ishte ekonomike. Në 12 mars u nënshkrua në Tiranë një marrëveshje, ku shoqërisë së hekurudhave të Italisë i jepej e “*drejta ekskluzive e kërkimeve dhe e shfrytëzimit të naftës, gazit natyror, bitumit dhe shkëmbijve bituminozë në një sipërfaqe prej 50.000 hektarësh*”²⁷⁶. Ratifikimi i Traktatit të Tregëtisë dhe Lundrimit me Shqipërinë, u pasua edhe me konçesionin e Bankës Shqiptare në 29 mars 1925 dhe të krijimit të shoqërisë SVEA, 23 prill 1925, ose të huasë SVEA. Banka Kombëtare e Shqipërisë ishte me seli në Romë dhe “*ishte vendosur praktikisht nën kontrollin e plotë të bankave italiane*”²⁷⁷. Nga 595.000 aksione gjithsej, 320.000 aksione i kishin italianët. Fondet depozitoheshin në Banca di Credito Italiano dhe të përcaktuara për *punimet botore* (punë publike) në Shqipëri, por ishin grupet e sipërmarrësve italianë që vendosnin për këto punime dhe për firmat që do t’i kryenin ato, ndërsa Banka Kombëtare e Shqipërisë “*shërben si një perde për këto veprime*”²⁷⁸.

Jugosllavia reagoi shumë ashpër ndaj Zogut, ajo përdori gjithë rrjetin agjenturor jugosllav në Shqipëri, “*për të nxitur lëvizje antiqeveritare e separatist, për të mbjellë konfuzion e panik*”²⁷⁹. Politika e depërtimit Italian në Shqipëri me përparësi ndaj atij jugosllav u mbështet në heshtje edhe nga Anglia²⁸⁰. Në raport me rritjen e tensioneve në marrëdhëniet me Beogradin, Musolini në korrik të 1925 vendosi të hapë *negociatë politike me Tiranën*. Përballë presionit jugosllav ndaj Zogut, ky i fundit nënshkroi në gusht të vitit 1925 protokollin e fshehtë në bazë të të cilit ishte “*mbrojtja e pavarësisë së Shqipërisë në kontekstin e marrëdhënieve të këqija italo-jugosllave*”. Kjo marrëveshje sipas projektuesëve ideatorëve italianë ishte realizim i planit politik, vendoste “*Shqipërinë në një protektorat të vërtetë*” dhe do t’i hiqte Zogut mundësinë të vepronte në mënyrë të panvarur. Ahmet Zogu i ndodhur nën presionin e brendshëm argumentonte se problemet me fqinjët e detyruan të nënshkronte nëpërmjet shkëmbimit të notave portokollin e fshehtë me Italinë (26 gusht 1925). Pozita politike e Zogut u lëkund nga pakënaqësitë e popullsisë dhe diskreditimi në shtyp i politikës së ndjekur prej tij. “Pakti sekret” ishte marrëveshje ekonomike dhe politike. Pakti parashikonte edhe një pikë ku angazhohej Italia ndaj një agresioni kundër Shqipërisë. Ushtria shqiptare do vepronte “*nën drejtimin e Shtabit të*

²⁷⁴ V.Vinaver, “Anglia dhe pozita ndërkombëtare e Shqipërisë në periudhën midis dy Luftërave Botërore”, Gjurmime Albanologjike, nr 2, Tiranë 1968, fq 206

²⁷⁵ Cici A, “Marrëdhëniet Shqiptaro-Italiane në vitet 1920-1934, Afërdita, Tiranë 2002, ISBN:99929-37-98-0, fq 71

²⁷⁶ Revue Pétrolifere, dt 11 korrik 1925, (Mousset A, 2004:70

²⁷⁷ Mousset A, “Shqipëria përballë Europës”, Tiranë, Dituria 2004, ISBN:99927-59-42-9, fq 70

²⁷⁸ New York Herald Tribune & Gazeta Le Matin, 6 janar 1927

²⁷⁹ P. Milo, “Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927, Tiranë 1992. Fq 341

²⁸⁰ V.Vinaver, “Anglia dhe pozita ndërkombëtare e Shqipërisë në periudhën midis dy Luftërave Botërore”, Gjurmime Albanologjike, nr 2, Tiranë 1968, fq 210

Përgjithshëm Italian”, dhe në rast ndryshimesh kufijsh në Ballkan, “*krahinat me popullsi shqiptare do të bashkoheshin me Shqipërinë*”²⁸¹. Negociatori Italian, Lessona thekson se pas shkëmbimit të dokumentave i “*dha presidentit shqiptar tre million fr.ari që i ish in premtuar dhe ai nuk kishte lëshuar rreçevutën përkatëse, si kishte bërë edhe në rastet e derdhjeve të mëparshme*”²⁸². Qeveria u akuzua për “*abuzime dhe vjedhje financiare*”, ndërsa Zogu iu përgjigj me “*formimin e një komisioni parlamentar kundër abuzimeve*” (shtator 1925) dhe me mundësi ndaj miqëve të tij të vjetër jashtë kufijve të Shqipërisë. Zogu me këtë marrëveshje politike synonte të forconte pozitat e tij të jashtme dhe të brendshme. Sipas autorit Vuk Vinaver, cituar nga autori M. Belegu, në shtator të vitit 1925 “*qeveria jugosllave mori një plan të Italisë për ndarjen e Shqipërisë*”, por Beogradi hezitoi nga aktiviteti Italian dhe e refuzoi këtë ofertë²⁸³.

Në kuadrin e bashkëpunimit Italo-Shqiptar, hapja e Shqipërisë filloi si marrëveshje ekonomike, u vazhdu me “*paktin sekret*” dhe përforcohej përditë e më tepër në planin politiko-diplomatik. Ministri i ri Italian në Tiranë, Aloisi në 24 prill 1926 i kërkoi Shqipërisë të konsideronte deklaratën e nëntorit 1921 e cila i njihte Italisë të drejtën ekskluzive për t’i ardhur në ndihmë Shqipërisë në rast agresioni me mandat të paracaktuar të Lidhjes së Kombeve. Zogu nuk u nxitua me këtë hap dhe kërkoi mendimin e Londrës. Përgjigja zyrtare e Londrës ishte ndryshe nga sygjerimet e ministrit O’Reilly dhënë Zogut. Londra tregoi mirëkuptim për afrimin e Zogut me Italinë si “*kundërballancë e influencës mbyhtëse të Jugosllavisë*” dhe i atribonte Romës një “*rol të rëndësishëm për ruajtjen e ekuilibrit ballkanik*”²⁸⁴. Kontaktet Italo-Britanike ripohonin politikën e respektimit të integritetit territorial dhe të pavarësisë së Shqipërisë ndërsa sekretari i Foreign Office pohonte mirëkuptim të interesave italiane në Shqipëri.

Zogu, pasi likujdoi angazhimet kundrejt Jugosllavisë me anë shkëmbimesh territoriale, u shkëput nga Jugosllavia për t’u lidhur me Italinë, politikisht e financiarisht, për t’u pasuruar dhe qëndruar në pushtet “*si diktator me anë të forcës*” së tij²⁸⁵. Kjo nuk i përqente Jugosllavisë dhe veçanërisht frymëzuesit dhe ekzekutuesit së politikës për rikthimin e Zogut në pushtet, ministrit të Jashtëm jugosllav Ninçiq. Diplomati jugosllav ndihej në disfatë personale e i prerë në besë me orientimin e Zogut nga Italia. Ninçiq i propozoi Francës traktat miqësie franko-jugosllave, ndërsa përfaqësuesi francez propozoi të ftohej edhe Italia. Ninçiq shkoi në Romë e i propozoi Musolinit një pakt që “*do të sillte një garanci më shumë për pavarësinë e Shqipërisë*”, ndërsa Musolini nuk e pranoi. Studiues pohojnë se Beogradi vendosi të nxisë trazirat për të destabilizuar situatën e brendshme në Shqipëri (Puto A, 2009:310).

“Kryengritja e Dukagjinit” (20 nëntor 1926) filloi me rreth 1000 vetash, por u shtyp shpejt nga forcat qeveritare. Jugosllavia ia hidhte fajin Italisë pasi ajo “*synonte ta përdorte si mjet presioni ndaj Zogut për të kapërcyer lëkundjet për lidhjen e traktatit politik me Italinë*”²⁸⁶. Mbi këtë ngjarje J.Sëire shprehet se “*implikimi i Jugosllavisë ishte jashtë çdo dyshimi*”, ...dhe në anë

²⁸¹ P. Pastorelli, Italia e Albania 1924-1927, Firenze 1967, fq 153-160 & (Puto A, 2009:407-411)

²⁸² DDI, VII serie, vol.6, d.nr.457, (Puto A, 2009:408)

²⁸³ M. Belegu, “Politika zogiste e dhyerëve të hapura në 1925-1926”, Studime historike, Tiranë 1964, fq 206

²⁸⁴ A. Biagini, Storia dell’Albania dalle origini di nostri giorni, Milano 1998, p. 117

²⁸⁵ Vllamas S, “Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942”, ISBN:978-9928-140-54-8, fq 422

²⁸⁶ P. Milo, “Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927, Tiranë 1992. Fq 407-410

të tjetër të kufirit detar “mbërrinin gjithnjë lajme mbi përgatitje goditjesh kundër territorit shqiptar”²⁸⁷, ndërsa B.Fischer shprehet mbi “revoltë në shkallë të gjërë të financuar nga Musolini”²⁸⁸.

Traktati i 27 nëntorit 1926 ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë ishte ndarje e plotë e përfundimtare e Zogut nga Jugosllavia. *La spinsta verso l’Oriente* për Romën është e njëjta gjë si *Drag nach Osten* për politikën gjermane. Italia e dinte mirë se të gjitha regjimet shqiptare që janë mbështetur tek të huajt janë përballur me reagim dhe “fshesë nga lëvizjet popullore”.

Italia duhet të bënte dy lëvizje në një kohë, të sigurohej që “diktatori ishte i lidhur pa kushte” dhe i gatshëm të sillej më vendin “sikur ta kishte pronë vetjake”, ndërsa Italia do të garantonte gjendjen e diktatorit nga “sulmet e atdhedashurisë ose paqëndrueshmërisë së nënshtetasve të tij”. Italianët kujdeseshin mirë për Zogun. Ata i krijonin “lehtësira” me eksportin e njerëzve pranë tij dhe duke ju siguruar fitime të majme. Garantimi vetjak i Zogut bëhej në mënyrë që “të mos zgjojë dyshime në vendet e tjera”²⁸⁹.

“Traktati i aleancës offensive” ose “traktati i miqësisë dhe sigurisë” shërbeu për italianët për të riorganizuar dhe për të shtënë në dorë ushtrinë shqiptare. Pika kryesore e këtij traktati midis Italisë dhe Shqipërisë ishte se “çdo kërcënim ndaj statukosë politike, juridike dhe territoriale e Shqipërisë është në kundërshtim me interesin e ndërsjellë politik”²⁹⁰. Neni 1 garantonte statukonë politike, juridike dhe territoriale të Shqipërisë. Me këtë lëvizje Italisë i lindte e drejta të “ndërhynte edhe në politikën e brendshme për të mbrojtur regjimin e Zogut”. Zogu përfitonte nga garancia italiane sepse “statukoja politike dhe juridike” përforconte pozitën e tij personale dhe ruajtjen e regjimit e tij. Mediat italiane deklaroronin se Zogu ishte njeri që garantonte siguri dhe qeverisje të qëndrueshme. Traktati parashikonte “riorganizimin dhe modernizimin e ushtrisë shqiptare për të garantuar rendin e brendshëm dhe kufijtë”²⁹¹. Nëse në Tiranë, Dhoma e deputetëve Zogun u quajti “shpëtimtar i kombit”, në Beograd u shpreh pakënaqësi. Beogradi e quanti traktatin instrument që të çonte në “vendosjen e protektoratit Italian mbi Shqipërinë” dhe rindezje të rivalitetit Italo-Jugosllav. Traktati me afat 5 vjeçar ishte i njëanshëm pasi bëhej fjalë për statukonë politike dhe juridike të Shqipërisë dhe jo të Italisë. Italia ishte ajo që do të vepronte për ruajtjen e statukuosë politike, juridike dhe territoriale të Shqipërisë. Traktati u regjistrua në Lidhjen e Kombeve në 8 shkurt të vitit 1927 dhe Musolini para parlamentit Italian shprehej se panvarësia dhe integriteti territorial i Shqipërisë ishin garanci për pozitën e Italisë në Adriatik.

Traktati i dytë i nëntorit 1927 erdhi pas një viti nga ai i parë dhe kishte më tepër karakter ushtarak. Rreth 10 ditëshit të dytë të shkurtit 1925, Italia pretendonte se kishte zbuluar një komplot jugosllav për rrëzimin e qeverisë shqiptare. Përballë mohimit të jugosllavëve, italianët nuk do qëndronin indiferentë por kërkonin arsye të forconin pozitën e tyre në Shqipëri. Paktet italo-shqiptare e lejonin Italinë të “mbronin” Shqipërinë, dhe Zogu mund të kërkonte ndihmë italiane në qoftë se italianët e dëshironin. Gjetja e spiunit jugosllav nga qeveria shqiptare çoi në 4

²⁸⁷ J.Swire, Albania: the Rise of a Kingdom, f. 475-476

²⁸⁸ Bernd J. Fischer, “Diktatorët e Ballkanit”, AIIS, Tiranë 2009, ISBN:978-99956-736-0-4, Fq 39

²⁸⁹ Mousset A, “Shqipëria përballë Europës”, Tiranë, Dituria 2004, ISBN: 99927-59-42-9, fq 75

²⁹⁰ AMPJ, fondi i marrëveshjeve dypalëshe, dosja 8, viti 1926

²⁹¹ M.Borgogni, “Tra continuita e incertezza. Italia e Albania (1914-1939)”, Milano 2007, p 92

qershor ndërprerje të marrëdhënieve diplomatike shqiptaro-jugosllave dhe tërheqjen e personelit e të dy legatave. Ky incident do përcaktonte edhe fatin e Ceno Kryeziut, ministër i Shqipërisë në Beograd dhe kunat i Ahmet Zogut. Ceno Kryeziu kishte kontribut në rikthimin e Zogut në dhjetor 1924 në pushtet dhe si njeri që ngrinte lart “*miqësinë midis Shqipërisë e Jugosllavisë*”²⁹². Sipas Çetin Saraçit, lëvizja e Zogut drejt Italisë nuk ishte pritur mirë nga C.Kryeziu duke e cilësuar Zogun tradhëtar përkundrejt atyre që e kishin ndihmuar me bujari për të ardhur në pushtet, ndërsa “*Zogu e qau me lot*” dhe “*hoqi një pengesë që mund të cënonte programin e tij, të traktativave me Italinë*”²⁹³.

Traktati i dytë italo-shqiptar erdhi menjëherë pas tentativave për një marrëveshje tre palëshe me Jugosllavinë dhe Francën. Refuzimi Italian çoi në nënshkrimin e traktatit të miqësisë më 11 nëntor franko-jugosllav ndërsa 11 ditë më vonë u nënshkrua në Tiranë, Traktati i Aleancës Mbrojtëse midis Italisë dhe Shqipërisë. Me nënshkrimin e traktatit 7 nënesh, Musolini do shprehej: “*Italia gjen kushtet e nevojshme për lirinë e tregëtisë dhe sigurinë e bregdetit të saj, pra kushtet e nevojshme për të vendosur ekulibrin, lirinë dhe sigurinë e saj në detet e tjera*”²⁹⁴. Traktati i ri do të mbetej në fuqi për 20 vjet dhe ripohonte solemisht për të “*zhvilluar më tej marrëdhëniet e solidaritetit që ekzistojnë fatmirësisht midis tyre*”²⁹⁵. Traktati u nënshkrua një vit më vonë dhe vërtetoi synimet e Italisë për ta konsideruar Ballkanin sferë legjitime të influencës së saj duke definuar “*Shqipërinë në orbitën italiane*”²⁹⁶. Aleanca e dytë me Italinë i dha Zogut më tepër siguri brenda dhe jashtë vendit por e ktheu de-fakto këtë të fundit në administrator të interesave italiane. Politika jugosllave vazhdonte me presione dhe veprimtari të shumëllojshme për të destabilizuar gjendjen në Shqipëri, ndërsa Italia vetëm përfitonte duke e tërhequr më tepër afër vetes Shqipërinë. Zogu nga kryeministër, president i shqiptarëve po përfundonte si vasal i Musolinit dhe ambicjes së tij fashiste.

Në konjunkturën e kompromisit e jashtëm politik mbi rikthimin e Ahmet Zogut në Tiranë, Qeveria Greke, kishte kontributin e saj. Në vitin 1925, kur Ahmet Zogu ishte përqendruar tërësisht në punët e brendshme të organizimit të shtetit, në Greqi u ndërmorën fushata represive ndaj shqiptarëve të Çamërisë. Shqiptarët u përzunë nga shtëpitë, u grabitën pasuritë, u përballën me dhune, me spastrim etnik dhe kolonizim. Shqiptarët nuk kishin asnjë portë të hapur drejtësie, ndërkohë që “*Tirana ishte e okupuar me axhendën e brendshme*”²⁹⁷.

Në mungesë të autoriteteve zyrtare të Tiranës, shqiptarët do të ngrinin zërin me intelektualët dhe patriotët e mëdhenj në mërgim. Patrioti e intelektual i madh Mit’hat Frashëri argumentonte se “*këto reprezalje bëhen që t’i shtrëngojnë shqiptarët që të thonë se janë turq dhe, pasi t’i marrin gjithë pasurinë, t’i zbojnë në Anadoll, në një vend të huaj, me të cilin, as nga gjuha, as nga raca, as nga zakonet s’kanë ndonjë marrëdhënie*”²⁹⁸.

²⁹² Puto A “Shqipëria Politike 1912-1939”, Toena, Tiranë 2009, ISBN:978-99943-1-467-6, fq 417

²⁹³ Saraçi Ç, 2006:102-103 & M.Dogo, “anno 1927. Propoganda, spionaggio e sovversione nella partita italo-jugoslava per l’Albania”, Studi Balcanici, Roma 1989.

²⁹⁴ Robert J. Stevens, 2004:66-67 & MacColl. R, “Albania and British Mission”, The Quarterly review, tetor 1938.

²⁹⁵ AMPJ, fondi i marrëveshjeve dypalëshe, dosja 9, viti 1927,

²⁹⁶ J. Swire, King’s Zog Albania, New York, 1937, faqe 512

²⁹⁷ Gazeta “Zëri i Popullit”, 5 gusht, viti 1949

²⁹⁸ M. Frashëri, (N. Dragoj, 2009:308)

Ahmet Zogu, përballë Jugosllavisë dhe Greqisë prioritzoi në radhë të parë marrëdhëniet me Italinë. Italia sundohej nga fashizmi i Musolinit i cili e përkrahu Zogun për qëllimet e tij mjaft të qarta ekspansive kryesisht mbi Shqipërinë por edhe mbi vende të tjera të Ballkanit. Këto marrëdhënie Shqipëri-Itali gjatë kohës së Ahmet Zogut kishin një karakter jo të qëndrueshëm, por me ulje-ngritje, me tensione e kriza permanente.

Gjatë viteve të para të sundimit të Ahmet Zogut, të kalimit nga Republika në Monarki kemi ndryshime të rëndësishme në sistemin dhe politikën e jashtme të Greqisë ndaj Shqipërisë dhe ndaj popullsisë shqiptare në Greqi, përfshirë edhe Çamërinë. *Greqia nuk kishte marrëdhënie të mira me Shqipërinë*²⁹⁹. Thelbi i çdo ndryshimi politik në Greqi reflektohej në lidhje direkte ose tërthore me qëndrimin ndaj popullsisë shqiptare në Greqi dhe të minoritetit grek në Shqipëri. Pra, çështja e minoriteteve ishte e një rëndësie të veçantë në marrëdhëniet midis dy shteteve dhe u ngrit si shqetësim ndërkombëtar mbas Luftës së Parë Botërore dhe në kuadër të Lidhjes së Kombeve. Por, ndonëse u vu një bazë e mirë juridike për mbrojtjen e pakicave kombëtare, sërish u dëshmuua se dhunimi i të drejtave të këtyre pakicave dhe injorimi i regjimit juridik ndërkombëtar lidhur me to do ishin tronditës.

Ardhja e regjimeve nacionaliste e raciste diktatoriale dhe përfshirja e Evropës dhe botës në krizën ekonomike të viteve 1929-1930, mjerisht favorizoi zbehjen në dështim të plotë të rolit të Lidhjes së Kombeve në periudhën midis dy luftërave botërore. Ndikimet Evropiane ishin të ekstremizuara në Ballkan ndërsa politikat ballkanike kopjonin Evropën në mënyrën më të keqe të mundshme.

Gjenerali Pangalos, me origjinë shqiptare ardhur me grusht shteti themeloi Republikën, dhe mori masa kundër zhvendosjes së popullsisë shqiptare, shpërndau shoqatat Vorio Epirote si dhe respektoi vijën politike korrekte të kufirit midis dy vendeve. Ministri i Jashtëm i Pangalos, për herë të parë, në mars të vitit 1926 u deklarua përpara Këshillit të Lidhjes së Kombeve se *ankesat e Shqipërisë për trajtimin e pakicës shqiptare ishin të arsyeshme* dhe deklaroi se *Greqia po punon për reflektimin e gjendjes me prirje pozitive*³⁰⁰. Mediumet greke të kohës vlerësonin me tone të mira qëndrimin pozitiv të qeverisë së Ahmet Zogut përkundër pakicave greke në Shqipëri.

Përmbysja e Pangalosit dhe ardhja në pushtet e një klike të re nacionaliste greke ndërpreu menjëherë këtë klimë përmirësimi. Rinisën goditjet mbi pakicat shqiptare dhe valët e refugjatëve filluan të vinin sërish në Shqipëri dhe me aksionin e shkëmbimit të popullsisë shqiptare myslimane dhe çame të Greqisë me grekë që vinin nga Azia e Vogël prej Turqisë.

Diplomacia shqiptare reagoi sërish në Këshillin e Lidhjes së Kombeve në qershor 1928. M. Frashëri parashtrroi përpara Këshillit të Lidhjes, shkëmbimin e popullsisë shqiptare të Çamërisë dhe sekuestrimin e padrejtë të pronave e të shpërngulurve forcërisht e popullimin e tyre me refugjatë grekë. Shifrat flisnin për 20.000 shqiptarë të shpërngulur nga Greqia vetëm midis viteve 1924-1925 nga Epiri dhe të mbi 40.000 të tjerëve nga Maqedonia Greke³⁰¹, ndërsa

²⁹⁹ J.B.Duroselle & A.Kaspi, "Historia e Marrëdhënieve Ndërkombëtare", vëllimi I-rë, Lira, Tiranë 2011, ISBN:978-99956-801-3-8, fq 129

³⁰⁰ Bashkurti L : "Çamëria në rrugën e zgjidhjes", Geer, Tiranë 2012, ISBN:978-9928-105-18-9, fq 298

³⁰¹ A.Tartari, "Një rrugë pa krye", debat i Lidhjes së Kombeve i përkthyer, botim Tiranë 2000, faqe 1-154

problemet e pronave injoroheshin tërësisht nga gjykatat greke dhe nga administrata helene e kohës. Të drejtat e tjera të çamëve e shqiptarëve, sikundër ishin besimi, gjuha e shkollimi në shqip as që mendoheshin.

Në Shqipëri situata e pakicave greke ishte e ndryshme. Qeveria Shqiptare u kishte krijuar kushte normale jetese, besimi dhe shkollimi pakicave greke në Shqipëri dhe përpiquej të respektonte standardet që Lidhja e Kombeve kishte vendosur për pakicat mbas Luftës së Parë Botërore. Në Shqipëri respektoheshin standardet, ndërsa politika greke vijonte të vuante nga retorika megalomane e me tone fobie dhe nga superioriteti ndaj politikës shqiptare në parlamentin grek.

Sërish, politika e jashtme dhe diplomacia shqiptare iu drejtua tryezave diplomatike të Lidhjes së Kombeve³⁰². Përfaqësuesi i Këshillit të Lidhjes së Kombeve, polaku Zaleski, nxirrte përfundime të njëanshme, anonte nga pala greke dhe jo nga pala shqiptare. Edhe Ministri i Jashtëm Britanik, Chamberlein asokohe deklarohet haptazi kundër qeverisë shqiptare lidhur me qëndrimin ndaj pakicave. Përpjekjet e mëdha personale të Mithat Frashërit për të mbajtur në axhendë çështjen e çamëve në Greqi, politika ndërkombëtare asnjëherë nuk e konsideroi seriozisht.

Konkluzioni themelor që del nga korpusi i Mithat Frashërit për Çamërinë dhe çamët në periudhën midis dy luftërave botërore dëshmon në mënyrë autentike dhe të pakundërshtueshme se strategjia greke për shpopullimin e shqiptarëve dhe çamëve është shumë më e hershme sesa Lufta e Dytë Botërore.

Të dy shtetet fqinje Greqia dhe Mbretëria Serbo-Kroato-Sllovene kishin të njëjtën strategji e të njëjtën taktikë ndaj shqiptarëve. Strategjia ishte e qartë; shpopullimin e trojeve shqiptare nga banorët autokton shqiptar dhe kolonizimin e tyre me popullsi të ardhura nga Azia e Vogël në Greqi, ose nga pjesë të tjera sllave si Mali i Zi, Serbia apo gjetiu në Kosovë.

Diplomacia Ballkanike, ndryshe nga diplomacia aristokratike, kishte të bënte me lëvizje masive, aktivitete sekrete dhe udhëheqës revolucionarë, të cilët nuk kishin status të qartë zyrtar dhe aq më pak vlera aristokratike. Qeveritë e vendeve ballkanike binin dakord me urdhrat e fuqive të mëdha, serish, aparatet e tyre shtetërore ishin kaq të dobëta e të pafuqishme sa që nuk përballeshin dot me nacionalizmin e vrullshëm popullor, shpirtin rebel Ballkanik dhe me veprimtaritë e shpeshta konspirative e kontrabandistike paralelisht.

Ndërkohë, ashtu sikundër pati vepruar me iniciativë patriotike individuale M. Frashëri për ngritjen e zërit ndërkombëtarisht për mbrojtjen e shqiptarëve dhe çamëve në Greqi, jashtë dhe pavarësisht pasivitetit të Ahmet Zogut, po ashtu edhe diplomati i shquar e patriot shqiptar, Rauf Fico, ngriti problemet e shqiptarëve në Kosovë disa herë dhe në shumë nivele. Mirëpo raportet, analizat dhe propozimet e Rauf Ficos në mbrojtje të të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi nuk gjetën asnjë reagim pozitiv nga qeveria e Ahmet Zogut.

Pavarësisht, pozicionit pasiv të Qeverisë së Ahmet Zogut, shqiptarët në Ballkan u frymëzuan jashtëzakonisht nga vetë ekzistenca e shtetit të tyre si dhe nga çdo hap progresiv që ai bënte.

³⁰² J.B.Duroselle & A.Kaspi, "Historia e Marrëdhënieve Ndërkombëtare", vëllimi I-rë, Lira, Tiranë 2011, ISBN:978-99956-801-3-8, fq 129

Pragmatikisht shqiptarët në Ballkan nuk arritën dot që të përfitonin nga ekzistenca e shtetit të vet për një kohë shumë të gjatë. Sikundër theksohet dekada më vonë nga politikologu ynë i madh Ukshin Hoti, *“ekzistenca e shtetit të pavarur shqiptar ishte dhe mbeti i vetmi faktor i fuqishëm që do të ringrinte ndërgjegjen kombëtare dhe aksionin politik mbarë shqiptar në Ballkan”*³⁰³.

Dekadat në vijim tregojnë se shqiptarët nuk u ndalën as nga brutaliteti e barbarizmi serb, as nga sofistikimi e bizantinizmi Helen, madje as nga klientelizmi i tyre në Kontinentin e vjetër.

5.4. Zogu I-rë – Mbreti i shqiptarëve. Dritëhijet e tij, 1929-1939

Me shpalljen president, Zogut iu dha pothuajse pushtet diktatorial, por ai nuk u mjaftua me kaq dhe mbas një periudhe 3 vjeçare e shëndërroi shtetin nga presidencial në monarki. Kalimin nga presidencë në monarki, Zogu dhe përkrahësit e tij e arsyetonin se *“një mbret e ka më të lehtë të mbajë të lidhur pas vetes një popull të mësuar me sulltanë, pashallarë dhe kryetarë fisesh”*³⁰⁴.

Ahmet Zogu përballë krizave dhe dinamikave politike në një periudhë, arriti të krijonte një qëndrueshmëri të brendshme, ekuilibroi politikën e jashtme me Italinë dhe me vendet fqinjë. Kjo situatë favorizoi konjunkturalisht Ahmet Zogun ndërmarrjen e ndryshimeve përkatëse kushtetuese dhe të shndërronte shumë shpejt sistemin politik nga Republikë në Monarki Kushtetuese. Kjo ishte *“lëvizje marramendëse që nuk do kalonte pa lënë gjurmë në historinë e re të Shqipërisë”*³⁰⁵. Koncepti i Monarkisë, i të drejtuarit me centralizëm të fortë dhe të kontrolluar nga lart nuk ishte i panjohur për shqiptarët. Ky koncept ishte aplikuar nga Fuqitë e Mëdha në dërgimin e Princ Ëdit menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, por ai nuk mishëronte aprovimin dhe ligjshmërinë si sovran mbi ushtrimin e pushtetit në vend. Krijimi i Monarkisë Shqiptare ishte një ide italiane. Propozimi italian u hodh në tryezën dypalëshe të bisedimeve Italo-Shqiptare gjatë mesit të korrikut të vitit 1927. Sipas diplomatëve italianë figura e Ahmet Zogut ishte mjaft e ndërlikuar dhe me të papritura të ndjeshme. *“Nuk mohoheshin aftësitë e tij të veprimit politik me kthesa të mëdha e të pamarra me mend për kohën”*³⁰⁶. Kjo ide theksonte synonte domosdoshmëri e qëndrueshmëri politike afatgjatë në Shqipëri. Musolini ndryshimin e rendit kushtetues nga Republikë në Monarki e quante faktor konsolidues të pushtetit të Zogut i konsideruar si *“të vetmen garanci për realizimin e politikës italiane në Adriatik dhe në Ballkan”*³⁰⁷. Rezultati ekonomik, politik e ushtarak i arritur në Shqipëri gjatë viteve të fundit për Romën ishte primare dhe plotësonte ambicjen e Zogut për të qeverisur dhe mbretëruar. Çdo tronditje apo luhatje të stabilitetit politik sillte pasoja negative për interesat italiane. Në propozimin italian të korrik 1927, përfshihej mundësia e *“krijimit të Mbretërisë Shqiptare”* dhe *“problemi i martesës së Zogut”* që të siguronte vazhdimësinë e regjimit³⁰⁸.

³⁰³ L. Bashkurti: “Çamëria”, Tiranë, Geer 2012, ISBN:978-9928-105-18-9, fq 332

³⁰⁴ Bernd J. Fisher, “Diktatorët e Ballkanit”, AIIS, Tiranë 2009, ISBN:978-99956-736-0-4, fq 6

³⁰⁵ L. Bashkurti: “Çamëria”, Tiranë, Geer 2012, ISBN:978-9928-105-18-9, fq 333

³⁰⁶ Hoti I, “Qëndrimi i Diplomacisë Italiane ndaj Shqipërisë dhe Shqiptarëve 1930-1941”, Insituti I Historisë – Prishtinë, Prishtinë 1997, fq 162

³⁰⁷ M. Borgogni, “Tra continuita e incertezza. Italia e Albania (1914-1939)”, Milano 2007, p 94

³⁰⁸ P. Pastorelli, Italia e Albania 1924-1927, Firenze 1967, faqe 457

Midis Zogut dhe Italisë kishte përputhje qëndrimesh, mbi shëndërrimin e republikës në mbretëri. Ambicjet personale të Zogut dhe të mbështetësve të tij, mënyra sesi ushtrohej pushteti aktual nga ana e tij ishin afër konceptit të sistemit monarkist. Sjellja mbretërore, shenjat e shumta dalluese të uniformës së tij, riprodhim të portretit në pulla dhe ndërtesa, lidhja e origjinës së tij me familjen e Skënderbeut ishin produkt i hedhur në mendjen e tij gjatë qëndrimit të tij në Konstandinopojë dhe më vonë në Vjenë. Zogu admironte veçanërisht dy figura monarkësh, “*Jul Qezarin dhe Napolonin*”, ndërsa “*sedra e tij e etur për lavdi ledhatohej jo vetëm nga përqëndrimi i pushtetit në duart e veta*”, por edhe nga “*madhështia dhe ceremoniali që rrethon një fron Monarku*”³⁰⁹. Propozimi i hapur italian lidhej me formën qeverisëse dhe synonte kapërcimin e autoritetit të pushtetit të Zogut të kufizuar ligjërisht. Vendosi e një pushteti absolut në planin e brendshëm, krijonte një unitet dhe stabilitet në popull. Mentaliteti shqiptar i kohës mendohej se ishte larg idealeve të një Republike. Intrigat, luftrat ndërfaqësi si traditë e pushtimit osman ishin të kundërta në raport me qeverisjen përfaqësuese parlamentare. Roma i njohu ambicjet e Zogut, shfrytëzoi nevojat ekonomike dhe politike të tij ndaj Italisë, shikonte tek personi i tij figurën më të përshtatshme për të mbrojtur dhe garantuar interesat italiane në Shqipëri. Forcimi i pushtetit personal të Ahmet Zogut, i dha mundësi Italisë zgjerimin e depërtimit të gjithanshëm italian në Shqipëri në vijim. Pas firmosjes së Traktatit të Aleancës Mbrotjtjes (nëntor 1927), etapa e dytë e këtij traktati ishte transformimi në Mbretëri i regjimit shqiptar. Pallati Chigi synonte sundim të “*pa kundërshtueshëm të Italisë mbi Shqipërinë*”³¹⁰. Zogu mendonte si ti zgjidhte problemet paraprake dhe sesi të hiqte qafe ato “*persona që mund të pengonin në marshin e tij drejt fronit*”³¹¹.

Ahmet Zogu në qershor 1928 inicioi ndryshimet kushtetuese drejt Monarkisë. Legjislativi, tërësisht në duart e tij përgatiti ndryshimet përkatëse dhe me 1 shtator 1928 Asambleja Kombëtare shpalli Ahmet Zogun “Mbret të Shqiptarëve”. Emri, “Mbret i Shqiptarëve”, ishte mjaft domethënës për një vend si Shqipëria, pasi shumica e popullsisë shtrihej përreth kufirit, brenda territoreve të shteteve fqinjë dhe me diasporë mjaft të madhe nëpër botë. Brenda vendit shpallja e Mbretërisë u prit përgjithësisht mirë. Ministri italian në Shqipëri, Ugo Sola në telegramin përshëndetës shprehej: “*...qeveria ime pa me kënaqësi ndërrimin e regjimit, i cili pruri Nalt-Madhërinë e Juaj në fronin Gjergj Kastriot Skënderbeu, kishte lënë vakand qysh prej pesë shekujsh. ...Unë jam i sigurtë se Nalt-Madhërija e Juaj do të frymëzohet nga traditat e këtij udhëheqësi të madh, për të mbajtur dhe forcuar më tepër një aleancë*”³¹². Shtetet si Greqia, Jugosllavia, Anglia, SHBA e mirëpritën ndryshimin e formës së regjimit. Padyshim ishte një model politik dominues i kohës, sidomos në Ballkan, por Shqipëria e çliruar ishte “*organizuar si republikë demokratike, kishte një qeveri, një parlament të zgjedhur, parti politike*”³¹³.

³⁰⁹ Deutsche Allgemeine Zeitung, 21 gusht 1928 & Konica F, 1957:96

³¹⁰ DDI, Serie VII, vol. V, dok. 439, fq. 426 & Tel. me korrier, 9 gusht 1928, Musolini-Solas, DDI, Serie VII, vol VI, nr. 543

³¹¹ Cici A, “Marrëdhëniet Shqiptaro-Italiane në vitet 1920-1934, Afërdita, Tiranë 2002, ISBN:99929-37-98-0, fq 151

³¹² Dako K: “Ahmet Zogu – mbret i shqiptarëve”, Tiranë 1937, Shtëpia Botonjese “Kristo Luarasi” 1896, fq 148-149

³¹³ Kuaroni P, “Valiçja Diplomatike”, Albinform, Tiranë 1993, fq 97

Diktaturat Monarkiste të kohës kishin më shumë gjëra “të përbashkëta me regjimet Monarkike të shekullit 19-të ndërtuar prej paraardhësve të tyre sesa me Italinë fashiste dhe Gjermaninë naziste”³¹⁴.

Vetëm Turqia e Ataturkut reagoi negativisht kundër këtij ndryshimi të brendshëm politik. Turqia jo vetëm nuk e njohu Monarkinë Shqiptare, por ndërpreu marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë. Ishte rast unik kur një shtet mban qëndrime diplomatike për shkak të ndryshimeve, të karakterit tërësisht të brendshëm dhe të kryera në rrugë kushtetuese. Në 1931 do rivendoseshin marrëdhënie diplomatike por “nivele i marrëdhënieve dhe përfaqësimit ngeli i ulët”³¹⁵.

Dy akte kushtetuese themelore; Statuti Themeltar i Republikës Shqiptare (1925) dhe Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare (1925) ishin arritjet më të mëdha të asaj periudhe. Legjistacioni i ri e vendos jetën e shoqërisë dhe veprimtarinë e shtetit mbi një bazë ligjore kushtetuese. Tipari më karakteristik i legjistacionit kushtetues të periudhës zogiste (1925-1939) është mohimi i çdo pluralizmi politik, “kushtetutat ose u shfuqizuan, ose u rishikuan për ta përqëndruar plotësisht pushtetin në duart e të fortëve. Partitë politike dhe parlamentet shpesh u shpërndanë, pa një pa dy, ose siç ndodhi në rastin e Shqipërisë së mbretit Zog, u shëndërruan në kukulla për t’u manipuluar sipas qejfit...”,³¹⁶. U hodhën themelet e administratës shtetërore në mbarë vendin. Administrata, ndonëse fillimisht e vogël, nisi të funksiononte normalisht në të dy nivelet, nivel qendror dhe lokal. U plotësuan institucionet e brendshme dhe ato të shërbimit të jashtëm, si dhe u konsolidua sistemi i sigurisë me xhandarmëri dhe ushtri, të cilat fuqizuan shumë rendin e brendshëm dhe sigurinë kombëtare. U hodhën bazat për themelimin e sistemit arsimor laik dhe të mjaft institucioneve bamirëse. Në tërësi u krijua klimë e mirë për zhvillimin ekonomik dhe bashkëpunimin me jashtë. Mbas hedhjes së bazave themelore të shtetit, Mbreti Zog ndërmori hapa edhe në fushën e ekonomisë. Masa të tilla si reforma agrare ndikuan dukshëm në nivelin ekonomik të mirëqenies së popullit. Vendi nisi të përparonte gradualisht në të gjitha fushat.

Përgjatë viteve 1927-28, situatat ndërkombëtare në aspektin ekonomik dhe në atë të sigurisë, përgjithësisht ishin të qëndrueshme. U krijua bindje dhe një lloj perceptimi ndërkombëtar se Sistemi i Versajës po funksiononte mirë dhe frytet e tij po shpaloseshin në dimensionin e ekonomisë në ngritje dhe qëndrueshmëri të sigurisë botërore. Kjo klimë e atmosferë pozitive dominuese u formalizua me firmosjen e Paktit Briand-Kellog, përfunduar jashtë Lidhjes së Kombeve, njëkohësisht mbeti *instrument i detyruar i së drejtës ndërkombëtare*³¹⁷. Pakti karakterizohej nga një frymë pacifiste, *përcaktonte frymën dhe mekanizmat paqësor si rruga më e drejtë për zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare*³¹⁸, sanksiononte shmangien e politikës së forcës në zgjidhjen e problematikave në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ndër shtetet firmëtare të Paktit Briand-Kellog u bë edhe Shqipëria, por periudhat e mëvonëshme treguan që pakti Briand-Kellog *nuk arriti të parandalonte politikën e forcës, ndërhyrjet ushtarake dhe pushtimet*

³¹⁴ Bernd J. Fisher, “Diktatorët e Ballkanit”, AIIS, Tiranë 2009, ISBN:978-99956-736-0-4, fq 5

³¹⁵ Shpuza G, 1994:66-70 & Sh. Hysi, “Rauf Fico, shtetar dhe diplomat i shquar”, Tiranë 2007, faqe 86

³¹⁶ Bernd J. Fisher, “Diktatorët e Ballkanit”, AIIS, Tiranë 2009, ISBN:978-99956-736-0-4, fq 4

³¹⁷ Text in League of Nations Treaty Series, vol. 93, pp. 344-363, (Bashkurti L, 2012:337)

³¹⁸ Briand-Kellog Pact, also called General Treaty for the Renunciation of War, or World Treaty Pact, (Bashkurti L, 2012:336-340 & J.B. Duroselle & Andre Kaspi, 2011:113-116)

*ndërkombëtare*³¹⁹. Kriza e 29-30 do të provokonte pashmangësisht shpërthimin e Luftës së II-të Botërore. Borxhet e Aleatëve që i kishin marrë nga Shteteve të Bashkuara të Amerikës mbas Luftës së I-rë Botërore, dominimi Amerikan në tregun financiar ndërkombëtar, borxhi i madh i shkaktuar prej dëmeve të luftës, reparacionet e imponuara Gjermanisë nga Traktati i Versajës dhe borxhet që Aleatët kishin marrë nga njëri-tjetri do përbënin krizën që çoi në Luftën e II-të Botërore. Sipas amerikanëve kishte *tre lloje zgjidhjesh: deflacion, zhvlerësim dhe shkëmbimi i kontrolleve*³²⁰.

Në atë kohë kishte mjaft mendime politike e diplomatike, sipas të cilave largimi i Perandorisë Osmane nga Ballkani nevojitej të zëvendësohej me krijimin e një federate Ballkanike. Pavarësisht se mbeti tentativë e parealizuar, përpjekja për krijimin e një blloku të përbashkët Ballkanik në thelbin e vet hodhi baza të një filozofie politike e diplomatike krejtësisht të re³²¹. Por, shekulli i XXI-të do të ringrihej si filozofi e rendit të pas Luftës së Ftohtë, por tanimë nën ombrellën e filozofisë politike të integritimit Evropian dhe Euro-Atlantik. Në këto rrjedha Ballkanike u përfshi edhe shteti Shqiptar i kohës.

Përfshirja e Shqipërisë në proceset ballkanike kishte dy vështirësi; së pari nga pozicioni gjeopolitik e gjeostrategjik i Shqipërisë, midis Italisë e shteteve ballkanike, së dyti Shteti shqiptar rrethohej nga komuniteti shqiptar i shpërndarë në formë pakicash etnike në gjithë shtetet Ballkanike e që ndanin kufij territorialë me Shqipërinë. Jugosllavia nga Lindja dhe Italia nga Perëndimi luftonin për hegjemoni Ballkanike, kryesisht nëpërmjet përpjekjes për të rritur kontrollin mbi Shqipërinë. Jugosllavia mbështetej nga Franca ndërsa Italia kishte si mbështetëse ndërkombëtare Mbretërinë e Bashkuar për të depërtuar në Evropën Juglindore. Franca mbështeste Jugosllavinë për të kufizuar hapësirat e Italisë si pjesë e boshtit të Evropës Qendrore dhe aleate potenciale e Gjermanisë. Anglia mbështeste Italinë drejt Evropës Juglindore me qëllim që të shmangte çdo përpjekje të saj për tu shtrirë në Mesdhe. Mesdheu kontrollohej rigorozisht nga flota Britanike dhe përbënte zonë strategjike të interesave të saj dhe për të shtrirë sa më shumë Evropën Qendrore drejt kufijve të Bashkimit Sovjetik.

Politika me fqinjët ndihmon stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e brendshme, ndërsa referimi dhe aktivizimi nëpërmjet Organizatave Ndërkombëtare i jep shkas të qënurit të barabartë në institucione të tilla ndërkombëtare. Marrëdhëniet Italo-Shqiptare-Jugosllave-Greke në periudhën midis dy luftërave botërore ngërtheheshin në një *“raport shumë të komplikuar të nevojës për mbrojtje të interesave kombëtare, ruajtjes së ekuilibrave rajonal dhe sensibilizimit të opinionit ndërkombëtar përmes marrëdhënieve dhe diplomacisë multilaterale”*³²².

Traktati II-të midis Italisë dhe Shqipërisë në vitin 1926, shtonte masat e sigurisë së pavarësisë dhe të tërësisë territoriale të Shtetit Shqiptar. Shqipëria ishte e ekspozuar midis interesave nacionale shqiptare dhe ekuilibrave rajonalë. Shqipëria po luante midis Italisë, Jugosllavisë dhe Greqisë, ndërsa përforcimi i pozitave properëndimore të Shqipërisë u bë më e evidente me firmosjen e Konkordantit midis Vatikanit dhe Shtetit Shqiptar në fund të vitit 1927.

³¹⁹ J. B. Duroselle, “Europe: A History of Its People”, ISBN:9780670829224, London, Viking, 1990. pp. 97-104

³²⁰ Po aty, pp 363

³²¹ L. S. Stavrianos, 1942:218-221 & L. Bashkurti: “Çamëria”, Tiranë, Geer 2012, ISBN:978-9928-105-18-9, fq 340

³²² Bashkurti L: “Çamëria”, Tiranë, Geer 2012, ISBN:978-9928-105-18-9, fq 344

Evoluimi i marrëdhënieve diplomatike të Shqipërisë me Italinë dhe Vatikanin ecte në kah të kundërt me marrëdhëniet diplomatike me fqinjët territorial. Lëvizjet politike Evropiane filluan gjithnjë e më shumë të japin reflekse ideologjike në shtetet e Ballkanit, ndërsa ndikimi ideologjik Evropian ngadalë do të jepte impakte negative në marrëdhëniet rajonale, dypalëshe dhe shumëpalëshe.

Ndryshimet rëndësishme kushtetuese të vitit 1928, mbi formën e regjimit të Monarkisë kushtetuese parlamentare, synonin stabilizimin e mëtejshëm të institucioneve të brendshme të shtetit shqiptar dhe t'i jepnin më shumë iniciativë ligjore Zogut në politikën e jashtme dhe diplomaci. Këto ndryshime të brendshme në Shqipëri u pritën në mënyra shumë kontradiktore. Sejfi Vllamasi, citon se *“ne hallin nuk e kemi te Zogu si mbret, por te Zogu diktator, që e futi Shqipërinë nën zgjedhën italiane dhe populli vuan nga një varfëri e pashembulltë”*³²³.

Në plan ndërkombëtar Italia, Anglia, Vatikani dhe shtete të tjera Evropiane në lindje e përshëndetën ndryshimin, ndërsa vendet fqinjë, Jugosllavia e Greqia, e përshëndetën Monarkinë Shqiptare, por e pritën me shqetësim atë në marrëdhëniet dypalëshe. Kryetari i shtetit Turk, Qemal Atatürk, shpалosi haptazi kundërshtimet kushtetuese në Shqipëri, deri në ndërprerje të marrëdhënieve diplomatike Shqiptaro-Turke gati për afro 3 vjet.

Përkeqësimi i situatave në Ballkan merrte gjithnjë pamjen e lëvizjeve agresive greke kundër pakicës shqiptare dhe Çamërisë. Përpjekjet shqiptare mbi keqtrajtimin çamëve ngritur në Lidhjen e Kombeve, sërish kjo çështje ngeli nën administrimin e qeverisë greke. Lidhja e Kombeve po shkonte drejt kolapsit ndërsa marrja forcërisht e pasurive të shqiptarëve krijuan në mjediset shqiptare një ndjenjë armiqësie të madhe kundër grekëve. Ky frustrim dhe *këtë klimë e krijoi vetë qeveria greke*³²⁴. Qeverinë greke e favorizuar edhe nga mosnjohja e Mbretërisë Shqiptare nga Turqia, vijoi spastrimit etnik të zonave shqiptare të Greqisë. Greqia me Turqinë bënë shkëmbime popullsie, konkretisht të shqiptarëve myslimanë e çamë nga Çamëria me grekë ortodoks të ardhur kryesisht nga Azia e Vogël. Kuadri propagandistik manipulativ grek synonte argumentimin se shumica e *çamëve kërkonin vetë që të këmbeshin me grekët për të shkuar në Turqi, ku shpresonin për një jetë më të mirë*³²⁵.

Shqipëria vijonte përpjekjet në Lidhjen e Kombeve mbi keqtrajtimin e çamëve dhe spastrimin etnik të Çamërisë, Italia shfrytëzoi situatën e vështirë për të realizuar ekspansionin e saj në Ballkan. Gjithë arkitekturën politike, juridike, ekonomike të ndërtuar me Shqipërinë për garantimin e kësaj të fundit, politika e jashtme e Italisë filloi ta përdorte në funksion të strategjisë së vetë ekspansioniste. Italia do të ndeshte në rezistencë të fuqishme të politikës dhe diplomacisë shqiptare dhe diplomacisë rajonale. Shqipëria për Italinë konsiderohej *“si një bazë e domosdoshme për politikë force në Ballkan”*³²⁶. Sigurisht, politika dhe diplomacia e shtetit Shqiptar ishte e dobët për të penguar këtë agresivitet fashist Italian drejt Ballkanit dhe një ndër arsytet që Mbreti Zog do e rendiste Shqipërinë përkrah lëvizjes ballkanistike të kohës. Kjo lëvizje

³²³ Vllamasi S, “Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942”, ISBN:978-9928-140-54-8, fq 436

³²⁴ Meta B, Cham Tragedy, vep. e cit, fq 44-45, (Bashkurti L, 2012:348)

³²⁵ Basilis Kondis, The Greeks of Northern Epirus and Greek - Albanian Relations, published by HESTIA, pp. 14, (Bashkurti L, 2012:349)

³²⁶ Kuaroni P, “Valiçja Diplomatike”, Albinform, Tiranë 1993, fq 157

do të institucionalizohej nëpërmjet disa konferencave Ballkanike shumëpalëshe. Pala shqiptare do përfaqësohej me diplomatën e shquar Mehmet Konica, ish-Ministri i Jashtëm dhe këshilltar i Mbretit Zog për politikën e jashtme.

Konferenca e I-rë Ballkanike u mbajt në Athinë mbi ndalimin e avancimit fashist në Ballkan. Pjesëmarrëse ishin Turqia, Bullgaria, Jugosllavia, Rumania dhe Shqipëria. Konferenca e Athinës kishte si objektiv që shtetet e Ballkanit të ruanin së bashku *status quo*-në në frymën e përgjithshme liridashëse të Lidhjes së Kombeve, ndërsa Jugosllavia hodhi tezën e njohur me moton "*Ballkani i popujve të Ballkanit*". Synimin jugosllav, si Shteti më i madh me ekskluzivitet mbi shtetet e tjera të Ballkanit, e kundërshtoi delegacioni Shqiptar. Parimisht Shqipëria nuk ishte kundër të qenit *Ballkani për popujt e vet*, por me kusht që të gjithë shtetet të ishin sovranë dhe me të drejta të barabarta ndërmjet tyre. Qëndrimi i diplomacisë Shqiptare zuri vend në Konferencën e Athinës.

Konferenca e II-të Ballkanike u mbledh në Stamboll nga 19 tetor 1931 me objekt përpilimin e një pakti Ballkanik midis shteteve të Ballkanit, e të shkonte drejt një Antante Ballkanike. Delegacioni Shqiptar u shpreh dakord për aderimin në paktin Ballkanik, por në një pakt të ngritur mbi barazinë dhe drejtësinë ndërmjet popujve Ballkanik e pakicave të tyre kudo që ndodheshin. M Konica kërkoi që të shqyrtoheshin para së gjithash situatat e pakicave Shqiptare që jetonin në Greqi dhe në Jugosllavi. Synohej përfshirja në statusin e pakicave brenda shteteve të Ballkanit të pakicave shqiptare në Greqi dhe popullsinë shqiptare në Kosovë dhe në viset e tjera brenda shtetit Jugosllav. Diplomacia Jugosllave për kundërvënien ndaj diplomacisë shqiptare, u përpoq që të spostonte debatin në çështje ekonomike dhe të fillonte të përdorte insinuatat diplomatike kundër delegacionit Shqiptar edhe me akuza se prapa delegacionit qëndronte politika Italofile e shtetit shqiptar. Diplomacia shqiptare dëshmoi pavarësi të plotë të politikës së jashtme të Shtetit Shqiptar dhe jashtë çdo lloji ndikimi të politikës dhe diplomacisë Italiane. Konferenca e Dytë Ballkanike shënoi fillimin e normalizimit të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Turqisë dhe në ringjalljen e marrëdhënieve diplomatike midis dy palëve. Dështimi i Konferencës së Dytë Ballkanike ndikoi në përkeqësim të gjendjes së pakicave shqiptare në të dy fqinjët tokësor, Jugosllavinë dhe Greqinë.

Jugosllavia ndërmori fushatë të vërtetë fashiste kryesisht prej qarqeve të larta Serbe kundër popullsisë shqiptare të Kosovës dhe të ashtuquajturës Serbi - Jugore në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc. Mbi situatën e shqiptarëve në Kosovë dhe në Luginën e Preshevës, konsulli Italian nga Manastiri i shkruante Romës se; "*janë të njohura metodat violente dhe të shkombëtarizimit nga ana e autoriteteve Jugosllave ndaj popullsisë shqiptare që jeton në Jugosllavi, në të ashtuquajturën Serbi Jugore, të cilët i zëvendësojnë me malazezë e boshnjakë, dhe shumë familje kanë shfaqur dëshirën të shkojnë në Shqipëri ku kanë mundësi më të mëdha për t'u sistemuar, por policia refuzon t'u japë pasaporta*"³²⁷.

Metoda të përafërta por më të rafinuara u përdoren paralelisht në Greqi, sidomos ndaj pakicave të Çamërisë. Shtypi i kohës jep tablo jashtëzakonisht realiste për këtë situatë. Gazeta

³²⁷ AQSH "F.Legata Italiane, D.91, viti 1932", fq 96-97 (Legata Italiane në Beograd-MPJ e Italisë, Nëntor 1932& Bashkurti L, 2005:318-320)

“Demokracia”, shkruan se “Në Greqi minoriteti Çam po vuan. Të drejtat e tij janë marrë nëpër këmbë, jo vetëm që s’gëzojnë asnjë të drejtë shoqërore, por mbi të gjitha kanë edhe jetën në rrezik. Rrjepje, ndjekje, vrasje, tortura - ja tabloja e zezë e gjendjes së djeshme dhe të sotme të Çamërisë, tabloja që lyhet me gjakun e shqiptarëve të mjerë e të pafajshëm! Çamërit po shfarosen, po ndiqen, po detyrohen të lënë me zor vatrat e tyre dhe të shkojnë tutje, larg në një vend të huaj, me të cilin as nga gjuha, as nga zakonet nuk kanë ndonjë lidhje...”³²⁸.

Situata nga zhvillimet politiko-diplomatike ballkanikeme dinamikat në terren dhe rritja e ndikimit fashist në Ballkan penguan realisht projektin Ballkanik. Pakti Ballkanik nuk u përfundua dot në Konferencën e II-të Ballkanike të Stambollit. Konferencën e III-të Ballkanike mbahet nga 22-28 tetor 1932 në Bukuresht. Delegacioni Shqiptar u përplas me delegacionin Grek e Jugosllav për çështjen e pakicave shqiptare. Në një situatë intolerante, sidomos nga diplomacia brutale e delegacionit Jugosllav, kryetari i delegacionit shqiptar, Mehmet Konica tha se “Delegacioni Shqiptar ka deklaruar që në Konferencën e Parë Ballkanike dhe qëndron akoma në mendimin se zgjidhja e të drejtave të pakicave kombëtare ka qenë dhe mbetet kushti sine qua noni bashkimit të Ballkanit. Një bashkim pa garanci për të drejtat e tyre do ishte jetëshkurtër. Nëse pakti i Ballkanit s’do të aprovohej para tetorit të ardhshëm nga qeveria jonë, vijonte Mehmet Konica, them me keqardhje se grupi kombëtar Shqiptar s’do të marrë pjesë në vazhdimin e punimeve të kësaj konference, duke e konsideruar se kjo nuk ka asnjë arsye që të ekzistojë”³²⁹. Veprimi i delegacionit Shqiptar u pasua dhe nga delegacioni bullgar, i cili kishte probleme analoge me Jugosllavinë.

Me 9 shkurt 1934, u firmos Pakti Ballkanik nga Greqia, Turqia, Jugosllavia dhe Rumania, ndërsa shtetet që e patën refuzuar atë, Shqipëria dhe Bullgaria, nuk u ftuan fare për ta firmosur atë dhe të dy këto vende mbetën jashtë Paktit Ballkanik³³⁰. A Puto thekson se Italia me synimet e saja ndaj Shqipërisë, ishte e vëmendshme dhe ndiqte nga afër situatën, “bëhej pengesë për qëllimet e saj”³³¹. Pakti Ballkanik ishte një bluf politik dhe juridik. Lidhur me Paktin Ballkanik synohej qartazi nënshtrimi i Shqipërisë me Bullgarinë, duke injoruar padrejtësisht pretendimet e Shqipërisë e Bullgarisë për popullsitë dhe për pakicat e mbetura në shtetet e tjera të Ballkanit. Shqiptarët u ndienë të fyer dhe të cënuar në ndjenjat kombëtare nga Pakti Ballkanik pasi shtetet firmëtare njohën proktetoriatin e Italisë mbi Shqipërinë (R.J.Stevens, 2004:83). Turqia filloi përpjekjet e saj diplomatike që të bindte Shqipërinë dhe Greqinë për të krijuar format të ri grupimi tresh Turqi-Shqipëri-Greqi përkundër përpjekjes për dominim të sllavëve të jugut në Ballkanin Perëndimor.

Diplomacia Shqiptare nuk ra në propozimin tendencioz të propozuar nga Turqia, një qëndrim politik të bazuar në ndarje racore (lufta kundër sllavëve), që përbënte një doktrinë politike të papranueshme për politikën dhe orientimin diplomatik perëndimor të shtetit Shqiptar. Shqiptarët kërkonin të mbronin pakicat e veta dhe të rishikonin padrejtësitë historike mbi kufijtë e vet në

³²⁸ Gazeta “Demokracia”, Gjirokastër, 18 qershor 1932

³²⁹ Ushtelenca I, Diplomacia e Mbretit Zogu I-rë, 1997, faqe 249

³³⁰ L. S. Stavrinou, Balkan Federation, pp. 237 (Puto A, 2009:521)

³³¹ Puto A “Shqipëria Politike 1912-1939”, Toena, Tiranë 2009, ISBN:978-99943-1-467-6, fq 521-522

Ballkan dhe duke mos pranuar iniciativën turke dëshmuar se respektonin të gjithë popujt e tjerë në Ballkan, pavarësisht nga kombësia, raca dhe feja e tyre. Një pozicion të tillë kaq të qartë përëndimor e demokratik si Shqipëria dhe një doktrinë e tillë politike e tregonte se ky vend i vogël gjeostrategjik po pozicionohej në një urë Adriatiko-Ballkanike me rol balancues dhe ekuilibruar të admirueshëm. Shqipëria bëri gjithë përpjekjet për të ruajtur balancën Adriatiko-Ballkanike. Qëllimi i pozicionit balancues lidhej në kufizimin e revanshin në rritje të politikës ekonomike imperialiste Italiane në Shqipëri dhe përmirësimi i marrëdhënieve me Jugosllavinë drejt një rrugë zgjidhje të problemit të Kosovës dhe të pakicave të tjera shqiptare në atë shtet.

Atdhetarizmi nuk i mungonte diplomacisë shqiptare, por “*në diplomaci atdhetarizmi pa profesionalizëm është fare pak i dobishëm*”³³². Diplomacia shqiptare përballej me problemet më të mprehta kombëtare në historinë moderne të Shqipërisë. Lëvizja diplomatike shqiptare drejt balancimeve më të mira me fqinjët tokësorë dhe drejt realizimit të një ekuilibri Adriatiko-Ballkanik nuk arriti dot synimet e saj strategjike. Ndërkohë, revanshi Italian mbi Shqipërinë filloi të rritej ndërsa ekonomia shqiptare po binte. Jugosllavia nuk e mbështeti ekonomikisht sado pak Shqipërinë për të dalë nga kjo gjendje. Greqia ishte shumë e acaruar ndaj flirteve të Zogut me Italinë dhe shumë refraktare ndaj çdo lloj ndihme për vendin tonë.

Mbreti Zog, nisur nga recesioni i rëndë dhe i pashmangshëm, ndërmoi shkurtime shpenzimesh buxhetore, reduktime drastike të shpenzimeve operative e investimeve publike. Fashizmi Italian e kishte futur Mbretërinë Shqiptare në kolaps. Mbreti Zog hyri vetë në lojën diplomatike. Gjatë viteve 1934-1935, Zogu bëri demarshe të panumërta me Italinë për të siguruar një hua shtesë për ekonominë shqiptare, ndërsa *Musolini vuri kushte shumë ultimative dhe poshtëruese* ³³³. Mbreti iu rikthye resurseve të vendit, kryesisht vëmendjes për bujqësinë. Ai adoptoi ndryshime ligjore, dërgoi trupa rekrutësh ushtarak në mbështetje të bujqësisë, tentoi komunikime me Anglinë, u orvat drejt Lidhjes së Kombeve, por pa rezultat. Ishte e qartë se pakti i heshtur i fuqive të mëdha e kishte lëshuar Shqipërinë në duart e interesave italiane. Në fillim të vitit 1935 Mbreti Zog pothuajse arriti një marrëveshje me Jugosllavinë për “*gjashhtë milion franga ari për hapjen e një Banke Bujqësore në Shqipëri*”, ndërsa Italia këshilloi “*të ndalonte negociatat me Jugosllavinë*”³³⁴. Oferta italiane në shkurt të 1935 shërbeu si “*degë ulliri*”. Qeveria italiane kishte mirësinë të “*vinte në dispozicion qeverisë shqiptare një shumë prej tre milionë franga ari*”, si shenjë “*miqësie e sinqertë midis dy vendeve*”³³⁵. Mbas gjithë përpjekjeve, Mbreti u detyrua të rikthehej sërish drejt Italisë së Musolinit. Ministri Koch i Italisë në një raport mbi Shqipërinë shkruante se “*situata ishte bërë tanimë kaq kritike saqë të gjithë e kuptonin se nuk mund të bëhej më asgjë pa ndihmën e Italisë dhe se çdo shpresë për pajtim me Jugosllavinë do të ishte jo reale*”³³⁶.

Në këtë periudhë, Italia kishte pushtuar Abisininë dhe Lidhja e Kombeve donte t'i vinte Italisë sanksione, Mbreti Zog u shpalos në Lidhje kundër sanksioneve për Italinë. Arsyetimi

³³² Bashkurti L, “Çamëria”, Tiranë, Geer 2012, ISBN:978-9928-105-18-9, fq 361

³³³ AMPJ, dosja 203, viti 1933

³³⁴ Robert J. Stevens, 2004:79 & “Albania’, The Near East and India, 13 qershor 1935, fq 720-721

³³⁵ Robinson, op. cit., f. 117, (Robert J. Stevens, 2004:79)

³³⁶ Koch, “Italy and Albania”, raport i cituar, dt. 8.02.1934, (Bashkurti L, 2012:364-365)

bazohej te traktati i aleancës që Shqipëria kishte me Italinë, në bazë të tij qeveria shqiptare nuk i bashkohej vendimit për sanksione kundër Italisë. Delegacioni i Zogut *hodhi votën çdo herë në favor të Italisë*, pavarësia e Shqipërisë mbetej *vetëm si një fjalë, një teori, një hije dhe jo një realitet*³³⁷. Ishte ky një hap kurajoz dhe gjeneroz mjaft i rëndësishëm për Italinë. Musolini e vlerësoi këtë qëndrim pro Italian të Mbretërisë Shqiptare dhe i dërgonte *“falënderime të posaçme Mbretit Zog”*³³⁸. Diplomacia shqiptare po luante në teh të shpatës midis Italisë dhe fqinjëve territorialë.

Kryengritjet e papërgatitura dhe të paorganizuara brenda vendit dështuan, por e kishin hedhur Zogun përfundimisht në prerin Italian dhe i dha të drejtën e *“ndërhyrjes së armatosur në rast të një revolucioni kundër regjimit të Zogut”*³³⁹. Përballë situatave përherë e më kritike dhe forma rebelimesh kundër Mbretërisë si ai i dhjetor 1934 nga Muharrem Bajraktari e mbështetësit e tij në Veri, e vitit 1935 në Vlorë e Fier e Delvinës në maj 1937. Mbreti Zog bëri ndryshime në kabinetin e tij. Synohej fuqizimi i qeverisë, rritja e besimit mbi Mbretin Zog dhe relaksimi sado pak i marrëdhënieve me Italinë. Kështu që, në lëvizjet që bëri në kabinet mbas kryengritjes rebeluese antizogiste të Fierit të vitit 1935, Mbreti Zog harmonizoi një tërësi ministrash me prirje liberale me një kryeministër si Koço Kota, që ishte shumë luajal ndaj Mbretit Zog dhe Mbretërisë. Ndërkohë, Ministër të Brendshëm, për të fuqizuar strukturën konservatore të Qeverisë, Mbreti emëroi Musa Jukën. U krijua kështu një kabinet liberal i kryesuar kryesisht nga konservatorë. Këto të dytë përbënin pjesën më të besuar të Mbretit Zog, filozofia dhe sjellja politike e të cilit ishte më shumë konservatore sesa liberale. *Brenda në dhjetë vjetët e para të regjimit zogist ishin bërë katër lëvizje kryengritëse*. Përballë përplasjeve të brendshme, Zogu nuk reagoi ndryshe, por u fut thellë e më thellë nën mbrojtjen e Musolinit. Lëvizjet e brendshme do shuheshin me një traktat të ri ose me një marrëveshje të fshehtë midis Tiranës dhe Romës.

Ndryshimet liberale në kabinetin e Mbretit Zog i hapën rrugë përmirësimit të marrëdhënieve me Italinë. Musolini vlerësoi pozitivisht ato dhe i konvertoi në përmirësim hapash në mbështetje të ekonomisë shqiptare. U firmosën dymbëdhjetë marrëveshje bilaterale. Prej tyre gjashtë marrëveshje kishin karakter financiar dhe gjashtë të dytat kishin karakter ekonomik-tregtar. Kjo paketë e gjerë marrëveshjes e detyronte Shqipërinë që të hiqte çdo barrierë për mallrat Italiane. Ndërkohë hapësira për eksporte shqiptare në Itali mbetej e limituar. Gjithë marrëveshjet bilaterale Shqipëri-Itali në vitin 1936 u shkruan në shqip dhe italisht dhe u dekretuan me firmë të Mbretit Zogu I.

Avancimi i marrëdhënieve Shqiptaro-Italiane, solli reagime negative nga Jugosllavia dhe lëvizje diplomatike më të kujdesshme të Greqisë. Ndërsa Jugosllavia vijonte të mbante sloganin e Antantës Ballkanike, si frymë e filozofi anti-Italiane, me qëllim parandalimin e hyrjes së influencës dhe interesave Italiane në Ballkan. Ndryshe nga Jugosllavia, Greqia u tregua më e moderuar ndaj Italisë. Greqia e konsideroi, Antantën Ballkanike përballë Italisë si një nismë

³³⁷ Çekrezi K, “Shqipëria e shkuara dhe e tashmja”, Naimi, Tiranë 2012, ISBN:978-9928-05-098-4, fq 316-317

³³⁸ AMPJ, dosja 79. Viti 1935

³³⁹ Vllamasi S, “Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942”, ISBN:978-9928-140-54-8, fq 431

thjesht brenda Rajonale dhe jo më gjerë se kaq, duke shprehur njëkohësisht me këtë respektin ndaj aleatëve (Puto A, 2009:548).

Situata e rëshqitjes së Shqipërisë drejt fashizmit Italian dëshmoi më së miri se politikat ekonomike të gabuara, dritëshkurtra dhe të pamenduara, mund të shpien lehtësisht në humbje të sovranitetit të një shteti dhe akoma më keq në përkeqësime të marrëdhënieve me fqinjët e në ekspozimin e pambrojtur të popullsisë jashtë kufijve politik.

Skenari fashist Italian për pushtimin e Shqipërisë në Luftën e II-të Botërore do prihej nga lëvizje në planin diplomatik. Italianët po vononin derdhjen e fondeve të huasë në bazë të marrëveshjeve të vitit 1936. Vonesat synonin vënien e *“Zogut në vështirësi familjare”*³⁴⁰. Diplomacia e Musolinit punonte për një mirëkuptim për pushtimin e Shqipërisë kryesisht me Jugosllavinë, Anglinë dhe Gjermaninë. Me Jugosllavinë synohej të bënte *“palë të Boshtit Romë-Berlin-Tokio”*³⁴¹. Demarshet diplomatike Italo-Angleze lidheshin nga pozita mesdhetare e Anglisë, ndikimet e interesat në Greqi dhe shqetësimi për fuqizimin e Boshtit Euro-Qendror që nuk mund të kaloheshin lehtë nga diplomacia italiane. Mbi Shqipërinë, diplomacia angleze i kishte lënë duar të lira Italisë, duke i krijuar kështu një hapësirë interesave italiane në Ballkan. Përgjithësisht Londra nuk do të reagonte negativisht për pushtimin ushtarak të Shqipërisë. Me lëshimet ndaj Italisë, Anglia shpresonte afrimin italian nga Boshti Euro-Qendror, duke synuar dobësimin e Aksit Nazi-Fashist në Kontinent.

Sulmi i 7 prillit 1939 ishte vetëm finalizimi tij. Kritikët e Mbretit e kanë dënuar ikjen e tij në Greqi. Largimi i Mbretit dhe dobësimi i plotë i qëndresës u dha kështu mundësi trupave italiane të hynin në Shqipëri nga bregdeti në brendësi të vendit thuajse pa shtënë asnjë armë. Ushtria mbretërore prej *“rreth 15 mijë ushtarësh, xhandarësh dhe civilë të armatosur ishte shpërndarë nga të gjitha drejtimet”*. Zogu, suita e tij dhe anëtarë të qeverisë *“ishin nisur me automobilë drejt kufirit grek”*³⁴², braktisën vendin në një kohë kur vendi donte drejtim dhe rezistencë. Një nga bashkëpunëtorët e Zogut, Mirash Ivanaj, Ministër i Arësimit përjeton largimin e mbretit Zog në këtë mënyrë: *“pash djalin që pate dje, mos e le Shqipërinë. Mos del jashtë o Mbreti ynë! Mos del jashtë! Kthehu! Na pri! Shqipërinë e ke me vedi! Shqiptarët i ke me vedi!”*³⁴³.

Sipas autorit anglez O. Pearson; *“Zogu mori me vete 7 arka ushtarake me 100 qese napolona flori”*, të cilat ai i mbante gjithnjë në një kasafortë në zyrën e tij. Zogu mori me vete *“edhe një pjesë të rezervës së arit të Bankës Kombëtare, rreth 16000 stërlina”*³⁴⁴. Sipas historianit amerikan B.J.Fischer, referuar dokumentave gjermane citohet se *Zogu pati përhapur qëllimisht fjalë se Tirana do të bombardohej, që rrugët të boshatiseshin për t'i hapur rrugë largimit të tij pa u dukur,...ndërsa garnizoni shqiptar i Tiranës i kishte depozituar armët e veta në oborrin e Legatës Italiane, pra te përfaqësia e vendit pushtues*³⁴⁵.

³⁴⁰ Ikonomi I, 2014:39 & DDI, 8a Serie:1935-1939, Vol XI, fq 212-213. Nr 171

³⁴¹ J. B. Duroselle, Europe and the History of Its Peoples, London, Viking, 1990, ISBN:9780670829224, fq 224

³⁴² Ikonomi I, “Pushtimi- Ministri amerikan në Tiranë, Hugh Grant, rrëfen 7 prillin shqiptar”, UETPRESS, Tiranë 2014, ISBN:978-9928-4181-9-7, fq 86

³⁴³ Mirash Ivanaj, 24 orët e fundit të Mbretërisë së Zogut, (Puto A, 2009:642)

³⁴⁴ Pearson O, “Albania and King Zog”, London 2004, pp 447

³⁴⁵ B. J. Fischer, Shqipëria gjatë luftës 1939-1945, Çabej, Tiranë 2004, ISBN:99927-33-42-X, fq 54

Rezistenca popullore dhe konfrontim ushtarak modest nga patriotët shqiptar, ishin mesazhe për Italinë dhe mbarë botës se populli shqiptar nuk pajtohej me pushtimin fashist të vendit të tij. Pushtimi i Shqipërisë nga Italia fashiste kaloi pa tronditje të Romës. Shumë shpejt, mediat botërore, kancelaritë më të ndjeshme u pajtuan me këtë *fact accompli*. Pushtimi ndërpreu procesin e vështirë të shtetformimit shqiptar, solli lëvizje politike dhe atë komuniste, nxiti veprime luftarake, degradimin sërish të ekonomisë së vendit, përkeqësoi marrëdhëniet me fqinjët si dhe do niste prapë kalvarin e vuajtjeve të popullsisë shqiptare në vendet fqinjë, posaçërisht në Greqi dhe Jugosllavi.

5.5. Konkluzione!

Në historinë politike të Shqipërisë dhe profileve të spikatura të saj zë një vend të vecantë me ndikim të konsiderueshëm *Ahmet Zogu*. Ahmet Zogu nuk kishte as profil dhe as prirje origjinale në bazën e vetë. Ai erdhi nga një trashëgimi krahinariste, mentalitet orientalist, sjellje autoritariste, me stil e përzierje lindore. Ai ishte me natyrë të heshtur, jo publike, jo komunikative, por shumë aktive në tërë karrierën e tij politike.

Ahmet Zogu erdhi nga kultura orientale dhe u investua në kulturë perëndimore. Ai u lind dhe u formua në një mjedis patriarkal, por u rrit dhe u kualifikua në mjedis europian. Ahmet Zogu buroi si pinjoll i familjes tradicionale partiarkale shqiptare dhe vetë krijoi një familje moderne europiane. Ai erdhi nga kaosi, anarkia dhe përçarja dhe hodhi bazat e qëndrueshmërisë, stabilitetit dhe bashkimit. Ahmet Zogu u rikthye falë mbështetjes konjunkturale të fqinjëve territorialë por hodhi bazat e pushtetit dhe qëndroi me mbështetjen e fqinjëve dhe Fuqive Perëndimore. Ai erdhi në një mjedis ku projekti i Ismail Qemalit qëndronte vetëm formalisht, por e shëndërroi atë në një projekt me statut, ligje dhe institucione të standartit dhe përmasave europiane.

Karriera politike e Ahmet Zogut lidhet ngushtë me historinë e tij politike dhe të Shqipërisë nga Kongresi i Lushnjes (1920) deri në prill 1939. Ai u rrit dhe u formua në këtë proces. Fillimet e tij si Ministër i Brendshëm i Qeverisë së Lushnjes (1920), si Kryeministër 1922 - 1924 dhe rikthimi i tij Kryeministër e më pas - President, janar 1925 - shtator 1928, tregon një spirale përgjithësisht suksesi politik.

Ahmet Zogu për shumë kohë ishte pa vizione të qarta politike. Projekti i tij politik eci më shumë ad hok, duke përciellë më shumë konjunkturën. Periudha 1920 - 1928 dëshmon intuitë, aftësi konjunkturale, mundësi kompromisesh të brendshme dhe të jashtme por paqartësi ideologjike, vizionesh politike, modele politike dhe sisteme qeverisje.

Ahmet Zogu u investua dhe dështoi në shumë faza të karrierës së tij, ai bëri përpjekje të ndiqte dhe të udhëhiqte një model parlamentarizmi perëndimor, por e futi vendin në një paqëndrueshmëri të gjithanshme të karakterizuar nga kaosi, konflikti dhe dhuna e brendshme.

Projekti i Zogut si republikan dështoi, natyra e tij dhe sjellja politike ishin të papërshtatshme për republikanizmin parlamentar. Ahmet Zogu u ballafua pa alternativë me rrymën liberale të Fan Nolit. Nëse humbi mjedisin politik të brendshëm, ai siguroi mirëkuptimin e mbështetjen e mjedisit politik rajonal. Panvarësisht se zëra, grupe të tëra dhe aktorë politik e akuzuan si

humbës të pavarësisë të riamfirmuar në Kongresin e Lushnjës, sërisht Ahmet Zogu lëvizi nëpërmjet konjunkturave dhe kompromiseve për të tejkaluar këtë klimë armiqësore kundër tij. Nëpërmjet kompromisit dhe pragmatizmit Zogu u rikthye në Shqipëri si dhe largoi në mënyrë të parikthyeshme konkurentin dhe rivalin e tij politik, Fan Noli.

Rikthimi politik i Ahmet Zogut e futi Shqipërinë nga janari i vitit 1925 në një proces kërkimi për një sistem politik, që do pajtonte situatën dhe mentalitetin e brendshëm me sistemit politik dhe pranueshmërinë ndërkombëtare. Ky proces tranzitiv ndryshoi edhe formatin politik të Ahmet Zogut si dhe statusin e tij. Ai provoi republikanizmin dhe udhëhoqi qeverinë si kryeministër, pranoi pluralizmin, duke synuar të sigurote unitetin si President dhe të arrinte të sigurote metaforfozën e plotë drejt Monarkisë Kushtetuse Shqipëtare dhe shpalljes së vetes Mbret.

Shpallja e Monarkisë Shqiptare përmes statusit të saj kishte elementë të një trashëgimie të herëshme shqiptare. Mbreti Zog bëri çdo përpjekje për të prezantuar në opinionin e brendshëm dhe ndërkombëtar se nga buronte lidhja e familjes mbretërore. Në shërbim të promovimit të origjinës së tij mbretërore, Mbreti Zog përdori edhe lidhjet e Gjergj Kastriotit me Janush Junadin, duke e bërë këtë arsytim publik për martesën e tij me familjen aristokraciste hungareze Geraldine Apponyi. Në këtë proces Zogu u tregua demagog dhe manipulator i madh. Me qëllim të mbështeste Monarkinë Kushtetuse dhe pozicionin e tij si Mbret, atij i nevojitej të përfronte manipulimet historike mbi origjinën mbretërore me kompromiset e brendshme me origjinë partiarkale. Emblemën e Kastriotëve do ta mbështeste tek kompromisi me parinë shqiptare të kohës. Ky ishte kombinim mekanik që do prodhonte kompromise historike midis arsytimit të origjinës mbretërore me kompromiset e parisë së kohës.

Ky kompromis do prodhojë një Monarki jo fort të besueshme së brendshmi dhe ndërkombëtarisht por relativisht të pranueshme për synimet e brendshme dhe kompromiset ndërkombëtare. Statusi i Monarkut Zogu I-rë do të shërbente si një pikë konvergimi nga lart-poshtë për arritjen e një stabiliteti politik të brendshëm. I mbuluar me auerola dhe simbole të Gjergj Kastriot Skënderbeut dhe kultit të tij, mbështetjes nga pjesa më influenciale e vendit, Monarkia hodhi bazë të qëndrueshme që sintetizonte trashëgiminë me konjunkturën, idealet e rilindasve me pragmatizmin politik, simbolin e heroit kombëtar me parinë e kohës. Këtu qëndron thelbi i kontributit më të madh të Mbretërisë dhe Mbretit Zog mbi arritjen e stabilitetit politik në Shqipëri.

Në historinë politike të Shqipërisë dhe në profilin politik të Zogut, përpjekja për arritjen e stabilitetit politik për nxjerrjen e vendit nga kaosi dhe shmangjen e anarkisë së dhunëshme përbëjnë kontributin më të madh të Ahmet Zogut. Ky kontribut i tij është konsideruar pozitiv nga shumica e studiuesëve kombëtarë e ndërkombëtarë duke filluar nga bashkëkohësi i Zogut, diplomati Hugh Grant, deri tek akademiku Bernd Fischer. Kontributin për stabilitet nuk e kanë mohuar dhe kundërshtuar edhe autorë të brendshëm dhe të jashtëm me qasje të kundërt.

Mbreti Zog demostroi aftësi dhe vullnet konstitucionalë dhe institucionale. Gjatë periudhës së tij u hodhën themelet kushtetuese juridike në këtë vend shqiptar. Statuti Mbretëror u pasua me ligjet organike siç ishin kodi penal, civil, i administrimit, tregtar dhe një tërësi ligjesh pasuese. U krijua për herë të parë një kuadër juridik i plotë që synonte të nxirrte vendin nga kanunet

krahinore, mesjetare dhe fragmentuese dhe vënien e tij mbi baza juridike europiane. Ndërtimi i kuadrit juridik u shoqërua nga një administratë pozitive për ndërtimin e një shteti bazuar në parime juridike dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare.

Zogu demostroi vullnet shtet - formues. Nën drejtimin e tij u krijuan institucionet themelore të shtetit që garantonin tërësinë territoriale të vendit, kontrollin e territorit, homogjenitetin e popullsisë dhe unitetin e saj, sundimin e ligjit edhe me mjete violente si dhe njohjen e përfaqësimit ndërkombëtar të shtetit shqiptar. Krijimi i institucioneve të qeverisjes qendrore dhe vendore, konsolidimin e legjistativit dhe i organeve të drejtimit, ndërtimi i një administrate profesionale, formimi i strukturave të sigurisë, hedhja e bazave të shërbimit diplomatik shqiptar, krijimi i bankës nacionale përbëjnë në tërësinë e tij veprën më madhore, përjetësimin e projektit madhor të rilindasve dhe Ismail Qemalit. Këtu qëndron madhështia politike e Mbretit Zog.

Projekti i Mbretërisë Shqiptare u përballë me sfida shumë të mëdha ekonomike, sociale, shëndetësore dhe arsimore. Nga pikëpamja ekonomike Shqipëria ishte vendi më i varfër dhe më i prapambetur ballkanik. Nga këndvështrimi social vendi ishte në nivelet e një periferie të ish-Perandorisë Osmane. Mbi 90% e popullsisë ishte analfabete. Vdekshmëria foshnjore, jetëgjatësia, sëmundjet bënin kërdrinë në jetë njerëzore. Këto sfida Mbretëria Shqiptare i anashkaloi në mënyrë të konsiderueshme. Mungesa e burimeve financiare, instucionet e brishta shtetërore, kapacitetet e pamjaftueshme njerëzore e bënin të pamundshëm suksesin e plotë të Mbretit Zog në aspekte të zhvillimit ekonomik, social, arsimor dhe shëndetësor të Shqipërisë. Këtu qëndron edhe dështimi më i madh i Mbretit Zog.

Mbretëria Shqiptare dhe Mbreti Zog erdhën si kompromis rajonal dhe qëndruan në pushtet deri sa qëndroi ky kompromis. Politika e jashtme e Mbretit Zog reflekton përpjekjet e tij për të përafuar sovranitetin e Shqipërisë, pretendimet e fqinjëve dhe të ambicjeve të Italisë fashiste. Politika e jashtme dhe diplomacia e Mbretit Zog u orientua drejt Perëndimit, Austrisë, Italisë, Francës, Gjermanisë, Britanisë dhe SHBA. Këto shtete ngelen jo vetëm prioritete politiko-diplomatike por edhe ekonomiko-tregtare.

Dinamikat politike që karakterizuan zhvillimet politiko-europiane dhe ndërkombëtare sollën gradualisht prishjen e ballancave euro – ballkanike dhe midis lindjes dhe perëndimit. Prishja e këtyre ballancave në favor të aksit Romë – Berlin -Tokio do sillte fundin e pashmangshëm të Mbretërisë dhe Mbretit Zog. Italia fashiste nga një mbështetëset perëndimore të Mbretërisë dhe Mbretit Zog u shëndërrua në fuqi imperiale e kolonizuese të Shqipërisë. Shqipëria si kundër vendet e vogla të Afrikës së Veriut dhe të vendeve të Ballkanit ju nënshtrua politikave imperiale të fashizmit Italian.

7 prilli 1939 dëshmoi se Mbretëria Shqiptare dhe Mbreti Zog erdhën si konjunkturë dhe kompromis dhe përfunduan me ndryshimin e konjunkturave dhe dështimin e kompromisit. Kjo faqe e historisë politike dhe Mbretit Zog dëshmon se përmasat, fuqia dhe statusi i shteteve të vogla janë tërësisht të kushtëzuara nga konjunkturat, zhvillimet dhe politikat e shteteve, blloqeve të mëdha. Rënia e Monarkisë dhe largimi i Mbretit Zog lanë pas një trashëgimi ku nuk mund të shpërfillet as në planin e brendshëm dhe aq më pak në atë ndërkombëtar. Pavarësisht ndryshimeve të mëdha në sistemin politik dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare trashëgimia e

Mbretërisë Shqiptare dhe personalisht e Mbretit Zog I-rë do të ngeleshin gurë të qëndrueshëm të shtetformimit shqiptar në historinë politike moderne të Shqipërisë.

✚ Kap VI. Shqipëria në Luftën e II-të Botërore. Mjedisi historik i formimit të PKSH dhe Enver Hoxha.

Shtypi ndërkombëtar e konsideronte pushtimin ushtarak të Shqipërisë nga Italia fashiste, prill 1939, si një *akt me efekte serioze në të gjithë situatën ballkanike*³⁴⁶. Gazeta britanike “Times” paralajmëronte pushtimin e Shqipërisë se re të zeza po lëviznin ngadalë nga Shqipëria e pushtuar në drejtim të Greqisë³⁴⁷.

Veprimet e para të armatosura antifashiste u filluan nga patriotë dhe njerëz me ndikim në popullin shqiptar. Në këtë fazë të ngritjes së rezistencës antifashiste të shqiptarëve lindi, nëntor 1941, *Partia Komuniste Shqiptare*³⁴⁸. Ky moment shënonte fillimin e aksionit ideologjik e politik komunist në Shqipëri, me lidhje e ndikim fillimisht nga Partia Komuniste e Jugosllavisë dhe më pas nga vetë Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik. Emri i Stalinit filloi të depërtonte nëpër skutat e rezistencës antifashiste. Kjo situatë solli ndikim e inkurajim të formimit të çetave të para antifashiste si dhe të njësiteve guerile nëpër qytete.

Rrënjët komunisti i kishte nga fundi i viteve 20’, me grupet e para komuniste, ai njohu rritje në vitet 30’ me veprimtarinë e Ali Kelmendit i lidhur me Kominternin, kulmoi politikisht me themelimin e Partisë Komuniste me Enver Hoxhën.

6.1. PKSH – Ndikimi jugosllav dhe i Kominternit. Fronti antifashist dhe ushtria NÇL Shqiptare.

Mbas themelimit të Partisë Komuniste, drejtuesi i saj, Enver Hoxha lëvizi në dy drejtime: në formimin ideologjik dhe organizativ të Partisë Komuniste dhe në krijimin në vitin 1942 të Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare me bazë politike të gjerë për rezistencën antifashiste³⁴⁹.

PKSH ndërtoi dhe zbatoi strategjinë sipas orientimeve të Kominternit (Kongresi VII i Internacionales Komuniste mbajtur në vitin 1935). Strategjia kishte dy etapa; etapën e luftës për çlirimin kombëtar, pavarësinë dhe sigurimin e sovranitetit shtetëror, ndërsa etapa tjetër e pas luftës do përcaktohej me mbarimin e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare³⁵⁰.

Nga konjuktura antifashiste botërore, personi që përpiquej të përfitonte në mënyrë të rafinuar do ishte Stalini. Ai shprehej se; *“kjo luftë nuk është si në të kaluarën, kushdo që pushton një territor, imponon sistemin shoqëror. Kushdo që imponon sistemin e vet aq larg, sa mund të shkelë ushtria e tij. Unë nuk mund të jem ndryshe”*³⁵¹. Stalini shfrytëzoi konjunkturën e luftës për të shtrirë ndikimin e tij dhe sistemin komunist në Evropën Lindore dhe në Ballkan. Në një situatë

³⁴⁶ O. Pearson, Albania in occupation and War, Volume 2, New York 2005, pp. 57

³⁴⁷ Grazzi - Ciano's Diary, 4 gusht 1940, DDI, 9a serie, volume V. nr. 179

³⁴⁸ USHT & Insituti Historisë dhe Gjuhësisë, “Historia e Shqipërisë, Vëllimi II, Mihal Duri, Tiranë 1965, fq 704-706

³⁴⁹ ISML, “Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë”, “Naim Frashëri”, Mihal Duri, Tiranë 1968, fq 70-80

³⁵⁰ Ballvora Sh, “Zhvillimet politike në periudhën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, 7 prill 1939 – 29 nëntor 1944”, Dituria 2004, ISBN:99927-59-36-4, fq 61

³⁵¹ Milovan Djilas, “Conversation with Stalin”, New York, Harcourt, Brace & World, 1962, page 114

kaotike nga Lufta e II-të Botërore në Ballkan, Stalini shkatërroi dhe flaku tutje institucionet anti-majtiste të Ballkanit dhe i hapi rrugë strukturave politike komuniste dhe më pas do sillnin në pushtet modelin Sovjetik.

Doktrina nacionaliste e Ballkanit me doktrinën sociale të komunizmit kishte dallime në koncepte sociale, familjare dhe morale. Në dy vende zuri rrënjë dhe gjeneroi në rajon komunizmi sovjetik në Hungari dhe në Jugosllavi. Riorganizimi i PKJ, në 1939, solli në drejtim Josif Brozi, udhëheqës me përvojë dhe me lidhje të forta me Bashkimin Sovjetik. Ky ishte një figurë komplekse ushtarake, politike dhe diplomatike dhe shpejt u bë qendra e komunizmit në rajonin e Ballkanit. Të nxitur nga jugosllavët, komunistët shqiptarë u orientuan drejt luftës së menjëhershme kundër fashizmit dhe forcave të tjera politike.

6.2. PKSH – rruga drejt pushtetit. Konferenca e Pezës, Mukja, Labinoti dhe Kongresi i Përmetit.

Në luftë ndaj pushtuesin e huaj dhe për të çlirimin e vendit, pas viteve 1940-1941, në Shqipëri lindën forca ushtarake që u përkisnin grupimeve të ndryshme politike shqiptare të kohës dhe që u përballën me pushtuesit. Pjesa më e madhe i përkiste formacioneve partizane nën udhëheqjen e PKSH-së, dhe një pjesë tjetër, relativisht modeste, forcave të organizuar nga partitë e Ballit Kombëtar dhe të Legalitetit. Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar synonte çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj. Kjo luftë nisi fillimisht me disa çeta nacionaliste, por pas Konferencës së Pezës u rrit me shpejtësi dhe në fund të 1942 u njoh dhe u pranua nga Aleatët e Koalicionit Antifashist Botëror.

Afro një vit mbas krijimit të PKSH, Enver Hoxha në Konferencës së Pezës, shtator 1942, ftoi gjithë parinë patriotike shqiptare, pa dallim feje, krahine dhe ideje rreth frontit të luftës kundër fashizmit. Kësaj nisme iu bashkëngjitën shumë njerëz me emër e ndikim patriotik nga Jugu dhe Veriu. Konferenca e Pezës bëri bashkimin e popullit në luftën kundër pushtuesit, hodhi themelet e frontit Nacional-Çlirimtar dhe të pushtetit të ri demokratik-popullor, ndërsa Enver Hoxha me politikë dyvektorëshe, ishte lidhur qysh në fillim me komunistët jugosllav që do e asistonin atë gjatë tërë luftës deri edhe në vitet e para të mbas luftës³⁵².

Konferencës së Pezës nuk ju përgjigjën mjaft bejlerë, intelektualë liberalë dhe nacionalistë. Gradualisht, ky front njerëzish me ndikim kombëtar, por antikomunist në filozofinë e tyre krijuan në nëntor të vitit 1942 Ballin Kombëtar, një forcë me filozofi social-demokrate, por me frymë mjaft nacionaliste për kohën. Në krye të Ballit Kombëtar u vu Mit'hat Frashëri. Programi politik i Ballit Kombëtar "*Dekalogu*" përfshinte dhjetë pika³⁵³. Në fillim të vitit 1943 ekzistonte mundësi bashkëpunimi midis Ballit Kombëtar dhe Lëvizjes Antifashiste Nacional Çlirimtare. Balli Kombëtar, fillimisht ka pasur dy rryma, njëra antifashiste dhe tjetra më pro fashiste.

Marrëveshja Dalmazzo-Këlcyra, mars 1943, zbuti rrymat e Ballit Kombëtar midis tyre dhe e radhiti Ballin Kombëtar përfundimisht në anën e fashizmit. Kjo marrëveshje i dha krahë komunistëve shqiptarë që në shtator 1943, në Mukje të prishnin Frontin me nacionalistët, t'i

³⁵² B. J. Fischer: "Diktatorët e Ballkanit", AIIS, Tiranë 2009, ISBN:978-99956-736-0-4, fq 264-265

³⁵³ AQSH, "Program politik i Ballit Kombëtar", viti 1942, F. 270 AP.

deklaracionin ato bashkëpunëtorë të fashizmit, t'u deklaracionin luftë të hapur dhe të shpallnin programin e tyre politik të veçantë, ku parashihej jo vetëm lufta për çlirim kombëtar, por edhe lufta për marrjen e pushtetit politik mbas çlirimit. Mukja shënoi fundin e bashkëpunimit që u përpoq të krijonte Konferenca e Pezës në shtator të vitit 1942.

Prishja e komunistëve shqiptarë me Ballin Kombëtar në Mukje, shtator 1943, i kishte paraprirë takimi i Tapizës në korrik 1943. Në Tapizë u shkua si vazhdim i konferencës së Pezës por *“perëndimi i ushtrisë fashiste gjermane”*³⁵⁴ dhe hapja e frontit të Normandisë ndryshoi kursin antifashist duke shtuar edhe luftën për pushtet. Udhëzimet e Kominternit në BRSS, komunistëve shqiptarë iu përcollën nga eksponentë të Partisë Komuniste Jugosllave, Dushan Mugosha dhe Miladin Popoviç. Mukja ishte një formalitet dhe deklarim luftë të hapur, pasi beteja e Stalingradit, shkurt 1943, ndikoi në *“zgjerimin e lëvizjes nacional-çlirimtare në vendet e pushtuara nga shtetet fashiste”*³⁵⁵.

Më 17-22 mars të vitit 1943 në fshatin Labinot të Elbasanit u mbajt Konferenca I-rë e PKS H ndërsa forcat nacionaliste të Ballin Kombëtar nënshkruanin marrëveshjen Dalmazzo-Këlcyra. Konferenca mori vendime mbi *“forcimin e mëtejshëm të PKS H dhe të lëvizjes nacional-çlirimtare”*³⁵⁶. Konferenca zgjodhi Komitetin Qëndror të përhershëm dhe Enver Hoxhën sekretar të përgjithshëm të partisë. Më 4 korrik të vitit 1943 në fshatin Labinot të Elbasanit me iniciativën KQ të PKS H u mblodh Këshilli i Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar i cili krijoi Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH, ku komandant i tij u zgjodh major Spiro Moisiu dhe komisar politik Enver Hoxha. Ndër detyrat e dala ishte edhe *zgjerimi i KPNÇ dhe qëndrimi ndaj Ballit Kombëtar*³⁵⁷. Konferenca II-të Nacional-Çlirimtare u mblodh në Labinot më 4-9 shtator 1943. Konferenca vendosi të *“mos njihen asnjë forcë ose lloj pushteti tjetër në Shqipëri përveç pushtetit të këshillave nacional-çlirimtare”*³⁵⁸. U zgjodh Këshilli i ri Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar dhe synonte forcimin dhe zgjerimin e bazës demokratike të pushtetit dhe forcimin e Frontit Nacional-Çlirimtar në Shqipëri. U bë organizimi i pushtetit të këshillave nacional-çlirimtare. Këshillat nacional-çlirimtare *“në viset e çliruara përfaqësojnë pushtetin civil të vendit dhe punojnë në bashkëpunim të ngushtë me shtabin ushtarak nacional-çlirimtar”*³⁵⁹. Në konferencë citohej se çështja e Kosovës dhe Çamërisë do të zgjidhet në bazë të Kartës së Atlantikut, *“në bazë të parimit të vetëvendosjes së popujve”*³⁶⁰.

Formimi i *“partisë nacional-zogiste”*, u bë në mes të shtatorit 1943 dhe një muaj më pas Abaz Kupi njoftonte Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar mbi formimin e partisë nacionalzogiste që të rikthente mbretërinë demokratike konsitucionale të Zogut I. Shpallja e

³⁵⁴ J.V.Stalin, “Mbi Luftën e madhe patriotike të Bashkimit Sovjetik”, Tiranë 1952, fq 100

³⁵⁵ ISML, “Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë”, “Naim Frashëri”, Mihal Duri, Tiranë 1968, fq 111

³⁵⁶ USHT & Insituti Historisë dhe Gjuhësisë, “Historia e Shqipërisë, Vëllimi II, Mihal Duri, Tiranë 1965, fq 704-706

³⁵⁶ “PPSH, Dokumente kryesore”, vëll. I, Tiranë 1971, fq 732

³⁵⁷ Po aty, fq 738

³⁵⁸ ISML, “Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë”, “Naim Frashëri”, Mihal Duri, Tiranë 1968, fq 136-138

³⁵⁹ Rezolucioni i Konferencës II-të Nacional-Çlirimtare, 8 shtator 1943. Dokumenta të organeve të larta të pushtetit nacional-çlirimtar, fq 58

³⁶⁰ Hoxha E, Referat në Konferencën e II-të Nacionalçlirimtare, vepra, vëll.1, fq 464

partisë “Legaliteti” u bë në 21 dhjetor në Tiranë, të pranishëm ishin kryetari i ballistëve Mit’hat Frashëri dhe oficerë britanikë³⁶¹.

Ato ditë kemi thyerjen e trupave italiane dhe kapitullimin e saj. Thyerja e trupave italiane në Greqi tronditi së tepërmi Hitlerin ndërsa në këtë gjendje PKSHP i dëlnin detyra të reja. Kapitullimi i Italisë fashiste, 8 shtator 1943, ndryshoi raportin ushtarak të forcave në terrenin Ballkanik. Diplomacia gjermane synonte okupimin e Shqipërisë me forca të kursyera, të evitohej përplasja me frontin aktiv antifashist shqiptar, paraprihej nga taktika se gjermanët nuk kishin ardhur si pushtues, por të diktuar nga kapitullimi Italian dhe do rikthenin Shqipërisë pavarësinë, rimëkëmbjen e shtetit, duke i lejuar shqiptarët të vetëqeveriseshin pa ndikim nga Rajhu i Tretë.

Enver Hoxha, udhëheqësi i PKSHP dhe drejtues i lartë i Frontit Antifashist në Shqipëri kur po kapitullonte Italia Fashite, theksonte se *çështja e luftës është çështje e pushtetit dhe se fatet e luftës do të varen nga ai që merr pushtetin*.

Kongresi i Përmetit u mbajt 24 maj 1944, si vazhdim i Plenumit të I-rë të PKSHP, 15 maj 1944 në Helmëz të Skraparit. Më herët në Jugosllavi, Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar Jugosllav (AVNOJ) ishte i vetmi pushtet legjistativ në Jugosllavi. Enver Hoxha pohonte më vonë në Plenumin e II-të të Beratit se mbledhja e Helmësit ishte “e improvizuar” për të miratuar mbajtjen e Kongresit të Përmetit, për tu mbajtur “*si qe bërë në Jugosllavi*”³⁶².

Kongresi mori gjashtë vendime kryesore. Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar (KANÇ) u zgjodh si “*trup i kryesor legjistativ dhe ekzekutiv*” që përfaqëson “*sovrانيتetin e popullit dhe të shtetit shqiptar*” dhe të drejtën që të formojë komitetin “*me të gjitha atributet e një qeverie të përkohëshme popullore*”. Kongresi vendosi mosnjohje të asnjë qeverie që mund të formoheshin jashtë dhe brenda vendit “*kundër vullnetit të lirë të popullit shqiptar*”, e drejta e përfaqësimit i njëhej vetëm KANÇ. Në Kongres u vendos luftë e ashpër “*kundër të gjithë tradhëtarëve të grumbulluar rreth qeverisë kuislinge të Tiranës, Ballit Kombëtar, Legalitetit, etj*” dhe kundër “*çdo klike tjetër reaksionare që eventualisht mund të paraqitej më vonë*” deri në “*shkatërrimin e plotë të tyre*”. Komiteti i KANÇ kishte rolin e “qeverisë demokratike” të kryesuar nga Enver Hoxha. Kongresi theksoi se nuk do të njëhej asnjë marrëveshje që kishte lidhur pushteti në kohën e Mbretit Zog me shtetet e tjera. Nën shembullin jugosllav, mbledhjes së Jalcës, “*vuri gradat për luftëtarët e formacioneve partizane*”³⁶³. Kongresi shprehej në përkrahje të një modeli konfederativ ballkanik sipas kërkesës jugosllave. Në deklaratë theksohej se lufta vëllazërore e popullit shqiptar me popujt e tjerë, veçanërisht me popujt fqinjë të Ballkanit, krijonte “*konditat për krijimin e një konfederate ballkanike*”³⁶⁴.

Plani për mësymjen e përgjithshme të UNÇ kundër forcave gjermane dhe tradhëtarëve në veri, *Shtabi i Përgjithshëm e hartoi në prill 1924*³⁶⁵. Rezistenca dhe partizanët më së shumti ishin nga jugu dhe më pak nga veriu.

³⁶¹ Neuwirth H, “Qëndresë dhe Bashkëpunim në Shqipëri, (1939-1944)”, IDK, Tiranë 2006, ISBN:99943-832-1-3, fq 94

³⁶² AQSH, “Politikë antikombëtare e Enver Hoxhës, Plenumi i II-të i Beratit”, fq 160,

³⁶³ Dervishi K, “Historia e Shtetit Shqiptar 1912 – 2005”, Shtëpia Botuese 55, Tiranë 2006, ISBN:99943-799-3-3, fq 519

³⁶⁴ “Gazeta Zyrtare”, 21 dhjetor 1944, nr. 1

³⁶⁵ USHT & Insituti Historisë dhe Gjuhësisë, “Historia e Shqipërisë, Vëllimi II, Mihal Duri, Tiranë 1965, fq 704-706

³⁶⁵ “PPSH, Dokumente kryesore”, vëll. I, Tiranë 1971, fq 789

Në forcat antikomuniste bënin pjesë politikanë dhe ushtarakë të lartë të vendit me bindje antikomuniste, një pjesë e vogël e Ballit Kombëtar, forcat e Legalitetit dhe grupi i të pavarurve. “Independistët” ishin bajraktarë dhe padron në krahinat e tyre por të pa organizuar me njëri-tjetrin. Ndër këta renditeshin Gjon Marka Gjoni në Mirditë, Kol Bibë Mirakaj në Pukë, Muharrem Bajraktari në krahinën e Lumës, Gani Kryeziu në malësinë e Gjakovës, Preng Cali në malësinë e Shkodrës, familjet Kaloshi, Ndreu e Litat në Dibër. Një pjesë e tyre iu bashkangjitën “Legalitetit” por pa arritur të mirëorganizohen. Plani mbi shtrirjen dhe goditjen përfundimtare u shpall në 17 shtator 1944 nga kryesia KANÇ ku thuhej; “...për të forcuar luftën kundër armikut gjerman dhe për të shpejtuar çlirimin e Shqipërisë, ...u bëhet thirrje të gjithë shqipëtarëve që janë në bashkëpunim me okupatorin që të dezertojnë nga radhët e armikut dhe të hidhen në radhët e Frontit Nacionalçlirimtar”³⁶⁶. Oficeri anglez R. Hibbert shprehet se; “Nacionalistët humbën shancet e tyre plotësisht...”. Kjo solli komunistëve “fitoren dhe e ktheu Shqipërinë në një shtet komunist”³⁶⁷. Enver Hoxha dhe komunistët e tjerë nuk ishin më pak nacionalistë. Ata mendonin se duhej të luftohej me armë kundër okupatorit për të realizuar marrjen e pushtetit.

6.3. Zgjedhjet e para të vitit 1945. Shpallja e Republikës 1946. Komunistët në pushtet. Problemet me SHBA dhe Britaninë e Madhe.

Periudha 1941-1945 është periudhë veprimesh institucionale dhe jo individuale. Hallka kryesore e komunistëve pas çlirimit ishte “*ruajtja dhe forcimi i pushtetit popullor*” dhe “*forcimi i pozitës së tij ndërkombëtare*”³⁶⁸.

Konferencat Nderkombetare, të Jaltës, 4-11 shkurt 1945, dhe Potsdami, 17 korrik 1945, përfunduan Luftën e II-të Botërore.

Vendimet e Jaltës dhe Potsdamit hodhën mbi Evropë perden e hekurt. U vërtetua thënia e Çurçillit dhe ajo që Stalini i kishte deklaruar udhëheqësit jugosllav, malazezit Milovan Gjilas gjatë luftës. “*Ku do shtrihet Ushtria e Kuqe do vendoset sistemi Sovjetik*” ndërsa në rastin e Shqipërisë, *sistemi sovjetik do shtrihet edhe përtej vijës së Ushtrisë së Kuqe*³⁶⁹. Vendimet e Jaltës dhe Potsdamit sollën pasoja të padiskutueshme dhe fragmentarizim të Ballkanit. Ballkani u nda fillimisht në bllokun Lindor dhe atë Perëndimorë, më tej u ndanë akoma më shumë Rajonin në ekulibrin unik për Luftën e Ftohtë 2+2+2. Greqia e Turqia në Bllokun Perëndimorë, Bullgaria e Rumania në Bllokun Lindorë dhe Shqipëria e Jugosllavia jashtë dy Blloqeve me ndryshime respektive.

Kur mbaroi Lufta e II-të Botërore, qeveria komuniste nuk ishte njohur nga asnjë fuqi aleate, por kishte marrëdhënie ndërmjet misioneve me Jugosllavinë, Britaninë e Madhe, SHBA dhe Bashkimin Sovjetik. Regjimi Tiranës mbas Luftes II-të Botërore deri në Konferencën e Paqes në Paris (1946) u duk një qendrim konform politikës së aleancës së madhe të Luftës. Në fjalimin e Enver Hoxhas me rastin e vdekjes së Ruzveltit ngriti lart rolin e tij dhe vlerësoi shumë edhe

³⁶⁶ Dokumente të organeve të larta, fq 197, cit (Ballvora Sh, 2004:599)

³⁶⁷ Hibbert R: “Fitorja e hidhur – Lufta Nacional Çlirimtare e Shqipërisë”, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, A.Z.Çajupi, Tiranë 1993, fq 294

³⁶⁸ ISML, “Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë”, “Naim Frashëri”, Mihal Duri, Tiranë 1968, fq 198-203

³⁶⁹ Bashkurti L: “Diplomacia shqiptare – vëllimi III-të”, Geer, Tiranë 2004, ISBN:99927-989-4-7, fq 25-39

SHBA-të, ndërsa me Britaninë pati disponim për vijim marrëdhëniesh, por kjo ishte fare e përkohshme.

Regjimi i Tiranës krahas agjendës së tij të brendshme si ashpërsimi i luftës së klasave, gjyqeve publike ndaj bashkëpunëtorëve dhe “armiëve të klasës”, dënimët dhe internimeve, shpronësimeve, reformës së tokës etj..., ju kërkua nga Britania e Madhe dhe SHBA të bëjnë “zgjedhje të lira e të drejta dhe për liritë që lidhen me to”³⁷⁰. Në dhjetor 1945 u bënë zgjedhjet me një listë të vetme, të Frontit Nacionalçlirimtar si koalicion i vetëm fitues i luftës. Votimi u krye jo me fletë votimi por me gogla. Zgjedhjet me “gogla” ishin një gjetje e komunistëve nën direktivat e Kominternit. Me porosi të BRSS në funksion të marrëveshjes së Potsdamit duhej edhe identifikimi bashkëpunëtorëve të nazizmit. Stalini porosi që në listën e bashkëpunëtorëve të nazizmit të përfshihen edhe kundërshtarët politikë (jo nazistët, intelektualë opozitarë, të panvarur, klerikë etj...). Ekzekutimi ose eliminimi tyre synonte shmangjen e rezistencës për legjitimimin e pushtetit.

Tre ishin shkaqet kryesore të qëndrimit armiqëror të SHBA dhe Britanisë ndaj Shqipërisë. Së pari, SHBA dhe Britania kërkuan vijimin e traktateve dhe marrëveshjeve dypalëshe që regjimi Mbretit Zog I kishte firmosur me këto Fuqi përpara Luftës II-të Botërore. Qeveria e Tiranës nuk pranoi, sepse ishte hedhur poshtë së bashku me të drejtën e kthimit të Mbretit Zog I në Shqipëri sipas vendimeve të Kongresit të Përmetit. Së dyti, SHBA dhe Britania kërkuan të beheshin zgjedhje të lira e demokratike në Shqipëri sipas marrëveshjes së Jaltës mbi gjithë Evropën Lindore. Kerkohej një Qeveri legjitime si kush për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Tiranën. Mirëpo zgjedhjet në Shqipëri, në vitin 1945, jo vetem u manipuluan masivisht nga komunistet, por edhe u kontestuan fuqishëm nga forcat opozitare të kohës. Kjo u kritikua fuqishëm nga SHBA dhe Britania. Së treti, midis Shqipërisë dhe Britanisë kishte ndodhur aksidenti i Korfuzit në përfundim të Luftës II-të Botërore, ku kishin humbur jetën ushtarakë britanikë. Britania ju drejtua Gjykatës Ndërkombëtare duke u penalizuar Shqipërinë me rreth 800 mijë dollarë amerikanë gjobë. Qeveria komuniste kurre nuk e pagoi dhe reagimi britanik ishte refuzimi mbi kthimin e arit shqiptar të grabitur nga nazistët gjatë Luftës II-të Botërore.

Jugosllavia, Britania e Madhe, SHBA dhe BRSS e kishin njohur Shqipërinë zyrtarisht në 1945, por mosbërja e zgjedhjeve të lira dhe demokratike bëri që SHBA dhe Britania e Madhe të mos i shkëmbejnë misionet diplomatike me Shqipërinë. Lënia e hapësirave ër strehime dhe baza të sigurta për komunistët grekë gjatë luftës civile në Greqi, i ashpërsoi më tepër marrëdhëniet e Tiranës me Britaninë e Madhe dhe SHBA. Shqipëria me këtë hap po mbyllte çdo mundësi ndihme e zhvillimi me perëndimin dhe po rrëshkiste në lidhjet me Jugosllavinë drejt varfërimit, rritjeve të tensioneve në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Raportet shqiptaro-britanike kishin pasur raport të komplikuar me ulje-ngritjet e saj, lidhje dhe ndërprerje, ngrohje dhe ftohje, simpati dhe antipati. Britanikët kishin shfaqur prirjen *për të shpërdoruar komunistët me qëllim*

³⁷⁰ Hibbert R: “Fitorja e hidhur – Lufta Nacional Çlirimtare e Shqipërisë”, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, A.Z.Çajupi, Tiranë 1993, fq 356-357

*mbështetjen e forcave jo komuniste, që në fakt ishte strategjia e përgjithshme e diplomacisë së Çerçillit gjatë Luftës së Dytë Botërore*³⁷¹.

Gjatë periudhës 1944-1955, planet e Britanikëve dhe Amerikanëve ishin që të ndryshohej regjimi i Tiranës. Projektet mbështetnin forcat opozitare brenda vendit dhe mbajtje të lidhjeve me mërgatën shqiptare sidomos me Mbretin dhe Mit'hat Frashërin. Planet parashikonin dhe organizime e aksione diversioniste spiunazhi për pëmbysje me forcë. Këto plane u ekspozuan nga agjenti britanik i kohës, Kim Filby, i cili raportoi Moskës gjithë projektin e SHBA+Britani e Madhe kundër Europës Lindore. Zbulimi i këtyre planeve të CIA dhe Shërbimit Britanik si dhe vdekja e Stalinit bëri SHBA dhe Britaninë e Madhe të ndryshonin kursin ndaj Shqipërisë.

6.4. Shqipëria në Kampin Lindor – vasale e Jugosllavisë Komuniste.

Idetë e bashkimeve federale janë të hershme në Ballkan, *ndërsa idea Federatës së Sllavëve të Jugut, që përfshinte Jugosllavinë dhe Bullgarinë, ishte iniciuar nga Stalini në shtator 1944*³⁷². Në shkurt 1945 midis autoriteteve të Tiranës dhe Beogradit ishte nënshkruar një traktat bashkëpunimi. Të dy palët do të ndihmonin njëra-tjetrën për ruajtjen dhe mbrojtjen e pavarësisë, të sovranitetit, të kufijve kundra çënimeve ose sulmeve nga vende të tjera dhe *“t’u sigurojnë reciprokisht minoriteteve nacionale në vendet e tyre mbrojtje dhe respekt të plotë”*³⁷³. Në maj të 1946, Stalini i përgjigjet Titos mbi bashkimin shqiptaro-jugosllav se bashkimi do të hapte një konflikt i ri me Britaninë dhe Amerikën. Stalini hoqi dorë nga bashkimi shqiptaro-jugosllav dhe këshilloi *“orientim të mëtejshëm të Shqipërisë për lidhje më të ngushta me Jugosllavinë”*³⁷⁴. Tito nuk hoqi dorë nga federata shqiptaro-jugosllave por me dinakëri e zhvendosi në rendin e përparësive afrimin e Shqipërisë në Federatën Jugosllave.

Marrëdhëniet RPSH-BR dhe PKSH-PKBS nuk zhvilloheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë, por nëpërmjet Beogradit. Moska kishte fare pak dijeni dhe interesa mbi zhvillimet politike në Shqipëri. Në Jaltë, Potsdam dhe në Konferencën e Paqes në Paris 1946, Shqipëria si aleate e Frontit Antifashist nuk u konsiderua as nga Lindja as nga Perëndimi.

Prioriteti i politikës së jashtme të Shqipërisë ndaj Jugosllavisë lidhej me disa arsye: background politiko-historik mbi vendin dhe rolin e komunistëve jugosllavë dhe të Titos mbi krijimin e PKSH dhe lëvizjes komuniste e më pas antifashiste në Shqipëri nga 1941-1945; dobësia e shtetit shqiptar dhe epërsia e Jugosllavisë si shtet i madh, diletantizmi politiko-diplomak shqiptar mbas luftës përballë profesionalizmit dhe përvojës së Titos, Gjilasis, Pijades, Kardelit dhe Rankovicit. Udhëheqësit komunistë shqiptarë *“pa përvojë në aftësitë politike, lënë ‘vëllezërit e tyre jugosllavë të komandojë’*³⁷⁵.

³⁷¹ ISML pranë KQ të PPSH, Enver Hoxha, “Rreziku Anglo-Amerikan për Shqipërinë”, Kujtime, 8 Nëntori 1982, fq 23-28

³⁷² Universiteti i Tiranës & Instituti i Historisë, “Konferenca shkencore; “Panvarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shek. XX-të”, Përmbledhje studimesh, Klean, Tiranë 2008, ISBN:978-99956-648-1-7, fq 365

³⁷³ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme, viti 1945, dos.1

³⁷⁴ Universiteti i Tiranës & Instituti i Historisë, “Konferenca shkencore; “Panvarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shek. XX-të”, Përmbledhje studimesh, Klean, Tiranë 2008, ISBN:978-99956-648-1-7, fq 369

³⁷⁵ Pipa A “ad memorandum 1”, “Stalinizmi Shqiptar – anatomia e një patologjie politike”, IKK & Princi, Tiranë 2007, ISBN:978-99956-632-0-9, fq 53

Marrëdhëniet e Shqiptarisë me Jugosllavinë kaluan në tre faza; e para në përpunim e miratim të kuadrit juridik dhe ekonomik të përbashkët në fushat e zhvillimit ekonomik, monetar, financiar, doganor dhe tregtaro-industrial; e dyta në njehësimin e politikave në plan rajonal dhe ndërkombëtar dhe faza e tretë në konfliktet dhe prishjen e marrëdhënies dypalëshe.

Në mars 1945 ishte vendosur një Traktat Tregtar mbi dërgimin e stokut të rezervave në Jugosllavi dhe në këmbim të drithit dhe pajisjeve ushtarake. Në maj 1945 u bë një marrëveshje nga Ministria e Financave Shqiptare dhe Banka Kombëtare mbi këmbime financiare. Vizitën si kryeministër Enver Hoxha e bëri në Jugosllavi 23 qershor – 2 korrik 1946 dhe nënshkrua “Marrëveshja mbi bashkëpunimin ekonomik mes RPSH dhe RPFJ-së”. Kjo marrëveshje parashikonte krijimin e një Agjensie kordinim-planifikimit ekonomik shqiptaro - jugosllav. Kjo agjensi do shërbente si një qeveri e dytë në Shqipëri. Në 9 korrik u firmos në Tiranë “Traktati i miqësisë dhe i ndihmës reciproke”. Në 27 nëntor 1946 u nënshkrua “Marrëveshja e madhe ekonomike” mbi kordinimin e planeve ekonomike, bashkimin doganor dhe barazim të monedhave me RPSH dhe RPFJ-së. Enver Hoxha në plenumin e jashtëzakonshëm të mbledhur në Tiranë, 18-20 dhjetor 1946, theksonte; “Jugosllavia demokratike është më e avancuar, më e përparuar se ne. Interesi ynë është që ajo të jetë e fortë, se me Jugosllavi të fortë do të ketë demokraci në Ballkan. A është në interesin tonë të kërkojmë Kosovën? Kjo nuk është progresiste. Pra në këtë situatë, përkundrazi, duhet të bëjmë çështje e mundur që kosovarët të vëllazërohen me jugosllavët”³⁷⁶.

Në qershor 1947 ndihmat për qëllime ekonomike e kulturore ishin më të pakta se ato ushtarake dhe në fund të vitit 1947 u ngrit edhe çështja e bashkimit të ushtrisë shqiptare me atë jugosllave. Strategjia e bashkëpunimit ekonomik përgjithësisht ngrihet mbi bazën e strategjisë kombëtare. Titoja e zbatoi këtë strategji në marrëdhëniet me Shqipërinë, ndërsa Enver Hoxha nuk e përfilli në vitet e para në marrëdhëniet me Jugosllavinë. Praktikisht “ekonomia shqiptare u bë pjesë dhe parcelë e ekonomisë Jugosllave”³⁷⁷ dhe “të ashtëquajturat ndihmë ekonomike ndaj vendit tonë, ne shumë shpejt pamë dhe kuptuam përpjekjet dhe synimet djallëzore të titistëve...për ta vënë Shqipërinë nën zinxhirët e skllavërie të re”³⁷⁸.

Faza e dytë e marrëdhënieve synonte përafrimin e politikës së jashtme të Shqipërisë me strategjinë rajonale të Titos. Titoja kishte një politikë të jashtme të panvarur nga Moska dhe në politikë të brendshme që i ngjante më së shumti Stalinit. Strategjia Ballkanike e Titos synohej që nëpërmjet Federatës Komuniste Ballkanike nën udhëheqjen e tij, “të përfshinte Jugosllavinë, Bullgarinë, Shqipërinë dhe mundësisht Greqinë”³⁷⁹. Tek koncepti mbi politikën rajonale u përplasën interesat midis BS dhe Jugosllavisë, midis Stalinit dhe Titos. Injorimet jugosllave mbi Triesten, mosmbështetja për federatën Ballkanike, pengesat artificiale mbi planet ekonomike të zhvillimit Jugosllav dhe eliminimin e elitës udhëheqëse të PKJ ishin shenjat të cilat u lexuan mirë nga politikanë me përvojë, sidomos në Ballkan, ku komunizmi kishte një lloj profili më

³⁷⁶ AQSH, “Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948”, Tiranë 1996, fq 73

³⁷⁷ R.F.Byrnes, “East-Central Europe Under the Communists”, New York 1958, fq 25

³⁷⁸ Hoxha E, “Titistët”, Tiranë 1982, fq 274

³⁷⁹ Dusko Doder, “The Yugoslavs”, New York, 1979, fq 125

nacionalist. Konflikti Stalin-Tito nuk kishte kontradita ideologjike por mesazhin arrogant dhe nënshtrimin e lëvizjeve komuniste në mbarë Europën Lindore me çdo rrugë e mjet³⁸⁰.

Në fazën e tretë, udhëheqja komuniste e Tiranës nisi të reflektojë mbi marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave dhe të përfitojë nga divergjencat Beograd-Moskë. Enver Hoxha e informoi Stalinin mbi komplikimet e marrëdhënieve dypalëshe Shqipëri–Jugosllavi, prirjen jugosllave për nënshtrim, Enver Hoxha u ftua në Moskë në korrik 1947. Në kontakt të drejtpërdrejtë me Stalinin u morën iniciativa për bashkëpunim ekonomik të panvarura me BS, të cilat acaruan më tej marrëdhëniet dypalëshe Tiranë – Beograd. Stalin duke “shkëmbyer eksperiencën dhe kordinimi i veprimeve midis partive komuniste” pohoi se “mund të ndihmonte Shqipërinë por me anë të Jugosllavisë”, si dy vende kufitare³⁸¹. Përfaqësuesi jugosllav në Moskë shprehej se “nuk e kuptojmë se si në një kohë jemi të lidhur ekonomikisht, ju kërkoni të bëni marrëveshje ekonomike dhe tregtare të tjera, ...pa u marrë vesh më përpara me ne”³⁸². Akuzat jugosllave vazhduan dhe u përqëndruan në “vijën antijugosllave” dhe kundër rolit personal të Enver Hoxhës në këtë devijacion. Titoja filloi me metodat staliniste të aplikuara në Beograd ti përdorë për eliminimin e udhëheqjes kryesore të PKSH dhe zëvendësimin me “kukullat” e tyre.

Lidhur me orientimin gjeopolitik të Shqipërisë mbas Luftës II-të Botërore, ajo kishte shumë faktorë pro se sa kundër. Pro ishte se Shqipëria nuk kishte barrierë nga jashtë e nga Fuqitë Botërore, ndonjë traktat apo dokument detyrues që ta mbante lidhur orientimin gjeopolitik të pas lufte. Në Shqipëri nuk kishte struktura të PKBS dhe prani fizike të Ushtrisë së Kuqe dhe ekzistonin misione ushtarake të Aleatëve Anglo-Amerikan. Shqipëria ishte midis Lindjes dhe Perëndimit dhe orientimin dhe vetë strukturën gjeopolitike Rajonale, Greqia drejt Perëndimit, Jugosllavia drejt Lindjes, Shqipëria u vërtit hezitante dhe nuk shfrytëzoi pozicionin e saj detar.

Në lidhje me çështjen e Kosovës mbas Luftës II-të Botërore, Shqipëria kishte mjaft faktorë kundër se pro. Faktorët pro lidhen me konjunkturën e Luftës II-të Botërore dhe ripërcaktim të kufijve e para luftës. Prezenca e armatave Shqiptare e të dy anëve të kufirit u gjetën të vetme dhe të unifikuara gjatë fazës përfundimtare të Luftës. Dy divizionet shqiptare mbasi çliruan Kosovën me trupat e saj, krijuan hapësirë të lirë futjes së Armatës Jugosllave. Faktorët negativë lidhen me karakterin e dobët të shtetit shqiptar pas çlirimit dhe lidhjet shumë të dobëta me strukturat politike të Kosovës. Politika jugosllave ishte e përgatitur më herët për të mbajtur Kosovën si pjesë të saj. Titoja të gjitha llogaritë i kishte bërë më shqiptarët. Një “Federatë Ballkanike” përfshinte Shqipërinë në Jugosllavi, ndërsa një Kosovë në Serbi në kuadër të Jugosllavisë do shërbente si “zonë eksplozive” dhe “valvul shkarkimi” për nacionalizmin serb që do ngrinte krye kundër Kroato-Sllovenëve dhe pushtetit të tij personal.

³⁸⁰ Bashkurti L: “Diplomacia shqiptare – vëllimi II-të”, Geer, Tiranë 2003, ISBN:99927-887-6-3, fq 141

³⁸¹ AQSH, “Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948”, Tiranë 1996, fq 117

³⁸² Hoxha E, “Titistët”, Tiranë 1982, fq 316-317

Kap.VII-të. Enver Hoxha nga vasal i Jugosllavisë në satelit të BRSS (1948-1961)

7.1. Plani Marshall dhe Traktati i Varshavës. Sovjetizimi i Shqipërisë. Nga Stalini tek Hrushovi.

Fillimi i viteve 50' solli gradualisht zbehje të frymës së konferencës së Jaltës, fragmentarizim qëndrimesh dhe thellim ndarjesh dypolare të botës. “Doktrina Truman”, mars 1947, parashikonte ndihmat ekonomike dhe interesat amerikane. Në thelb ishte roli primar i SHBA në rendin e ri të marrëdhënieve ndërkombëtare. Doktrina bazohej në parimet karakteristike të filozofisë amerikane në marrëdhënie ndërkombëtare të përshtatura në kushtet dhe rrethanat e Luftës së Ftohtë. Doktrina harmonizoi mendimin politik anglo-sakson dhe institucionalizoi aksionin ndërkombëtar të SHBA me “Planin Marshall” dhe krijimin e Aleancës së Atlantikut Verior, NATO. “*Plani Marshall, ...synonte të ftonte për pjesëmarrje madje edhe vetë Bashkimin Sovjetik dhe satelitët e tij të Evropës Lindore*”³⁸³. SHBA kërkoi të plotësojë boshllëkun e krijuar britanik në zonat e sigurisë në Mesdhe dhe për të kufizuar hegjemonizmin rus në atë zonë. U krijua Republika Federale e Gjermanisë, u ndihmuan Turqia dhe Greqia, ndërsa kundërreagimi lindor erdhi nga politika e Stalinit duke shtërnuar më tepër vendet e Evropës Lindore.

Stalini, në kundërpërgjigje, rriti kontrollin ndaj të gjitha vendeve të Europës Lindore, iu largua frymës së Jaltës dhe ju shmang marrëveshjeve të bëra me Çurçillin për Ballkanin. Stalini ndërhyri në Jugosllavi për zëvendësimin e Titos, në Greqi gjatë luftës civile, në Turqi për të dalë në ngushticat detare drejt Mesdheut. Në maj 1955 në Varshavë u mbajt Konferenca për Garantimin e Paqes dhe të Sigurimit në Europë dhe themeloi “Traktatin e Varshavës” ku Bashkimi Sovjetik, Shqipëria, Bullgaria, Hungaria, Republika Demokratike Gjermane, Polonia, Rumania dhe Çekoslovakia ishin shtete themeluese. Si analoge e Planit Marshall, Stalini dhe “Satelitët Lindorë” krijuan Këshillin e Ndihmës ekonomike Reciproke, KNER.

Faza e parë e bashkëpunimit dypalësh shqiptaro-sovjetik përfshin periudhën 1948-1953. Në këtë periudhë BS e udhëhoqte Stalini. Në këtë periudhë u hodhën bazat e bashkëpunimit dypalësh politik, ideologjik ushtarak, ekonomik e kulturorë. Stalini tregoi vemendje në rritje për Shqipërinë. U realizuan takime në nivelet më të larta Enver-Stalin dhe në të gjithë fushat e bashkëpunimit. Shqipëria mori ndihma ekonomike të konsiderueshme nga BS. Në planin ndërkombëtarë BS mbështeti Shqipërinë për tu integruar në strukturat Euro-Lindore dhe i mbështeti diplomatikisht atë. Në ndryshim nga vendet e tjera Eurolindore që kishin rënë viktima të BS dhe të Ushtrisë së Kuqe, Shqipëria u vetëorientua drejt tij pa diktat e kërcënim prej BS dhe Ushtrisë së Kuqe. Regjimi Tiranës u vetëorientua drejt Moskës pa kurrëfarë imponimi ndërkombëtarë.

Situata e re i dha impulse të fuqishme politikës së brendshme të regjimit të Enver Hoxhës dhe nxitje të mëtejshme marrëdhënieve me jashtë. Kongresi I-rë i PKSH, 8-22 nëntor 1948, parashitri platformën e brendshme dhe ndërkombëtare të shtetit shqiptar. Enver Hoxha përfitoi nga kriza BS-Jugosllavi dhe “mbaroi punë” me kundërshtarët e tij politikë dhe konsolidoi pushtetin personal dhe u përgatit për procesin e reformave sovjetizues të vendit. Kongresi

³⁸³ John Lewis Gaddis, “The United States and the End of the Cold War”, New York, 1992, fq 49

politikën e jashtme të shtetit shqiptar e bazoi në “principet marksiste-leniniste” dhe në “interesat e popullit dhe të atdheut”. Reagimi jugosllav nuk vonoi, prishi njëanshmërisht “Traktatin e Miqësisë, Bashkëpunimit dhe Ndihmës Reciproke”, tërhoqi përfaqësuesit e saj diplomatikë në Tiranë dhe kërkoi largimin nga Beogradi të përfaqësisë shqiptare.

Nxitur nga këto rrethana diplomacia e Enver Hoxhës hodhi hapin e dytë drejt Moskës, por këtë radhë me projekt konkret dhe me një “*nënështrim akoma më kompleks*”³⁸⁴. Në mars 1949, Enver Hoxha shkoi në Moskë dhe u nënëshkrua “Marrëveshja për dhënien e një kredie Republikës së Shqipërisë nga BS për blerje pajisje dhe makineri të ndryshme” dhe “Portokolli mbi Shkëmbimin e Mallrave midis dy vendeve për Vitin 1949”. Marrëdhëniet nëpërmjet RPSH dhe RPBS do kushtëzoheshin pak a shumë sipas kushteve dhe kërkesave që Moska kishte realizuar me vendet e tjera të Europës Lindore. Stalini në këtë kohë ishte në kulmin e ndërhyrjeve të ashpra e pa kompromis në Evropën Lindore. Shqipëria hyri në dyert e Kremlinit në kohën kur shumëkush kishte filluar të kuptonte në Evropë dhe në Botë se duhej të dilej nga ajo portë.

Proçesi i sovjetizimit u shtri në të gjitha fushat e jetës së brendshme dhe në politikë të jashtme. Si hap të parë u bënë pastrimet dhe u goditën elementët që akuzoheshin si agjentë të Titos dhe Jugosllavisë, u anuluan të gjitha marrëveshjet dhe u provokua rritje tensioni në marrëdhëniet dypalëshe. “Sovjetizimi” përfshiu Kushtetutën dhe legjistacionin, ekonominë, ushtrinë, sigurimin, arsimin, kulturën, artin, fenë, propogandën dhe çdo detaj të jetës shoqërore. Ndryshimet në kushtetutë dhe derivatet e saj ishin elementë bazë të “vëllazërimit shqiptaro-sovjetik”. Kushtetuta e vitit 1946 nuk përkonte me karakteristikat të modelit kushtetues sovjetik, kërkohet përputhje më të plotë me lidhjet e afërta që bëheshin në Moskë, plot ambiguitete e kontradita që praktikisht i shërbenin sovjetizimit të vendit.

Amendamentet kushtetute të viteve 50’ përmbanin karakterin e tipik sovjetik. RPSH është *shtet i punëtorëve dhe fshatarëve*. Gjithë pushteti i republikës i përket *punëtorëve të qytetit dhe të fshatit*, përfaqësuar nga *Këshillat Popullorë*. Shteti *rregullon dhe kontrollon gjithë tregëtinë e brendshme në vend* (i shtohet kontrollit të tregëtisë së jashtme nga Kushtetuta e 1946). Shteti mbështet *zhvillimin socialist të bujqësisë* me anë të organizimit të ndërrmarrjeve bujqësore, stacioneve të makinave dhe traktorëve, kooperativave bujqësore të fshatarëve dhe *forma të tjera bashkimi me baza “vullnetare”*. Puna është bazë e rendit shoqëror në Shqipëri me parimin “*ai që nuk punon nuk ha*” dhe “*secili sipas aftësisë, secili sipas punës*”. U njohën organizatat e Frontit Demokratik, Bashkimeve Profesionale, kooperativat, organizatat e rinisë, gruas, sportit, mbrojtjes, kulturës, të teknikës dhe shkencës. *Partia* përcaktohet si *forca e vetme e ndërgjegjshme dhe avangarda e masave punonjëse* në ndërtimin e bazave të socializmit dhe të *rolit të klasës punëtore në tërë jetën e vendit*. Qytetarët ishin *të detyruar të mbronin dhe forconin pronën socialiste* (shtetërore dhe kooperativiste). Iniciativat ligjore i përkisnin Presidiumit të Kuvendit Popullor, qeverisë dhe deputetëve. Drejtësia vendosej nga gjykata e Lartë, gjykatat popullore, gjykatat ushtarake dhe nga gjykata speciale që ngriheshin me ligj për çështje të veçanta. Në vijim të Kushtetutës së re (1950) në qershor 1951u bënë ndryshime në sistemin e

³⁸⁴ Historia e Shqipërisë, Vëll. IV, Tiranë 1983, fq 180

drejtësisë, u bashkua *Gjykata e Lartë Ushtarake me atë Civile* dhe *Prokuroria e Lartë Ushtarake me atë Civile*, u zëvendësuan drejtuesit e gjykatave me drejtues të lartë nga Sigurimi i Shtetit.

Amendamentet kushtetute të viteve 50' ishin heqje dorë nga çdo mundësi për ndërtimin e një shteti dhe shoqërie demokratike. Ajo shërbeu si veshje e plotë për sovjetizimin e gjithë institucioneve ligjore, legjislative, ekzekutive, politike, shoqërore, ekonomike, ushtarake, arsimore e kulturore të vendit. Kushtetuta centralizonte të gjithë *“pushtetet në dorë të Byrosë politike të Partisë Komuniste”*³⁸⁵. Të gjitha institucionet vertikalisht dhe horizontalisht ishin një lloj prone private e Partisë Komuniste, e udhëheqësve të saj. Ambiguiteti, kundërshtitë, diskriminimi ishte i sanksionuar. Pika 14 e Kushtetutës thoshte *“gjithë qytetarët janë të barabartë përpara ligjit”*, ndërsa pika 21 theksonte *“vend të veçantë zinin qytetarët me ndërgjegje të lartë politike”*. Institucionet fetare u vendosën nën kontrollin e shtetit, lejoheshin gjithë organizatat por nën drejtimin e *“avangardës së masave punonjëse dhe Partisë Komuniste”*. Kushtetuta eliminonte kanidatët e panvarur, ndërmjet sigurimit të shtetit cënonte garancinë e jetës, privacinë, korespondencat. U bënë evakuime banesash, deportime njerëzish, ngritje kampesh përqëndrimi, censurim të rreptë të çdo komunikimi. Pikat 41 dhe 43 parashikonte Asamblenë Popullore si organ suprem, por praktikisht ishte formal dhe inefiçent. Deputetët mblidheshin dy herë në vit, miratonin mekanikisht projekt-ligjet e paraqitura, nuk gëzonin imunitet, Ministria e Brendshme mund ti ftonte, arrestonte dhe burgoste. Pikat 57-60 parashikonin kompetencat e Presidiumit të Asamblesë Popullore, të cilat ishin të zbehta, qeveria nuk zgjidhej nga asambleja Përfaqësuese por nga KQ i PKSHE dhe formalisht miratoheshin në asamble. Programi qeverisës miratohej nga struktura më e lartë politike e Partisë.

Sistemi i drejtësisë drejtohej dhe kontrollohej nga njerëz me njerëz nga strukturat e shërbimeve sekrete pa arsimim dhe profesionalizëm. Në artikulli 3 të dekretit 26 shkurtit 1951 thuhej se; *“gjkimi i personit mund të bëhej edhe pa praninë e akuzuesit dhe të akuzuarit”*, *“apeli kundër vendimit ishte i ndaluar”*, *“dënimi me vdekje mund të ekzekutohet fill mbas dhënies së vendimit”*. Prokuroria u bë detashment i policisë sekrete. I pari Prokuror Publik Bedri Spahiu shprehej se *“Në vendin tonë, organet e zyrës së Prokurorit Publik ...konsistojnë në përmbushjen e detyrave që rrjedhin nga misioni i krijimit të shoqërisë pa klasa”*.. ndryshimet në kushtetutë, legjislacion, drejtësi u shoqëruan me ndryshime radikale në ekonomi duke sjellë modelin sovjetik të ekonomisë.

Në shkurt 1949, Shqipëria u pranua anëtare e Këshillit të Asistencës së Përbashkët Ekonomike sponsorizuar nga Rusia. Si anëtare me të drejta të plota Shqipëria firmosi marrëveshje ekonomiko-tregtare me vendet e bllokut komunist.

“Sovjetizimi” u shtri edhe në fushat e sigurisë, mbrojtjes, shërbimeve inteligjente. Ushtria shqiptare u orientua drejt ushtrisë së Kuqe. U përgatitën kuadro të lartë ushtarakë, u morrën strategjitë, taktikat, teknikat, rregulloret dhe asistenca teknologjike e ushtrive të tipit lindor. Me Shqipërinë pjesë e *“Traktatit të Varshavës”* i krijohej mundësia bazave ushtarake Sovjetike në brigjet shqiptare. Shqipëria, nga pikëpamja e sigurisë së brendshme, rrëziko seriozisht sovranitetin shtetëror, ndërsa nga ajo rajonale dhe ndërkombëtare ju kundërvu *“sigurimit*

³⁸⁵ Bashkurti L: *“Diplomacia shqiptare – vëllimi II-të”*, Geer, Tiranë 2003, ISBN:99927-887-6-3, fq 185

kolektiv” të NATO-s, duke marrë përgjegjësi shumë të madhe ndërkombëtare. Shërbimet inteligjente u integruan tërësisht nën ombrellën e shërbimit sovjetik. Shkolla Speciale Sigurimi u ngrit në Tiranë (1953) dhe shëndërrua në nëndegë e shërbimeve sekrete sovjetike. Indokrinimi, politizimi ishin kriter bazë për të shërbyer në sigurim.

Proçesi i “sovjetizimit” u shtri në arsim, kulturë, art, tek besimi fetar dhe gjithë shoqëria. Rusifikimi u bë i detyruar në arsim, u orientua krijimtaria letrare-artistike drejt “letërsisë dhe arteve të realizmit socialist”. Rusifikimi u shtri edhe në artet figurative, pikturë e skulpturë, teatër e kinematografi, muzik dhe balet.

Shqipëria krahas hapjes ndaj BS u detyrua të ndiqte marrëdhëniet me vendet socialiste. Hapja drejt “demokracive popullore” krijoi dimensione pozitive të shfrytëzuara deri atëherë Shtetit Shqiptar. Marrëdhënie ekonomike të Shqipërisë me vendet e Bllokut Sovjetik u bënë në kuadër të KNER-it. U firmosën marrëveshje me Bullgarinë, Çekosllovakinë, Hungarinë, Rumaninë, Poloninë dhe Gjermaninë Lindore. Hapja ekonomike shmangu ndikimin jugosllav dhe *“nxorri gradualisht ekonominë shqiptare nga tregu i kufizuar ballkanik në sistemin ekonomik Europiano-Lindor”*³⁸⁶. Njëanshmëria e tregjeve, bazuar në kritere politike dhe në situata konjunkturale krijoi një strukturë varfëruese, të njëanshme dhe të prapambetur lindore. Enver Hoxha nuk e konsideroi diplomacinë ekonomike por prioritzoi diplomacinë politike.

7.2. Kongresi i 20-të i PK të BRSS – ndarja nga Hrushovi.

Periudha 1953-1957 përbën fazën e dytë mbi marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike. Në këtë periudhë kemi vdekjen e Stalinit dhe ardhjen në pushtet të Nikita Hrushovit.

Enver Hoxha mbas shkatërrimit të kundërshtarëve politikë, pro dhe kundër Jugosllavisë, nisi të instalojë sistemin komunist në Shqipëri. Metodot e përdorura nga E.Hoxha, kulti i individit që po ngrinte dhe përqëndrimi i pushtetit në duart e veta do shoqërohej me pakënaqësi në radhët e mjaft figurave të PKS. E.Hoxha me luftën kundër “titizmit” i hapi rrugë politikave për të vendosur në zbatim përvojën sovjetike në realitetin shqiptar. Në vitin 1951 nisi një fushatë pastrimi e radhëve të PKS nga elementë të dyshimtë dhe të papërshtatshëm për elitën politikë të kohës. Në kuadër të mosrealizimit të planit dyvjeçar 1948-1949, u goditën Tuk Jakova (sekretari organizativ i Partisë), Manol Konomi (ministër i Drejtësisë) dhe drejtori i kuadrit të KQ Teodor Heba. Jakova njihej si kundërshtar i industrializimit të shpejtë të Shqipërisë. Ai u padit si liberal dhe oportunist mikroborgjez kundër vijës së partisë.

Vdekja e Stalinit ishte pritur me shpresë nga Perëndimi për ndryshim kurs të politikës së Kremlinit. SHBA kishin dalë nga politika e vetëpërmbajtjes, kërkonte zgjerim të hapësirave gjeopolitike dhe kishte mbështetur projektet e zhvillimit ekonomik në të gjithë hapësirat euroatlantike. Kremlini në plan të brendshëm goditi përkrahësit tradicionalë të Stalinit ndërsa në plan ndërkombëtar shtoi agresivitetin politik dhe paraqiti plane të vjetra ekspansioniste. Ky orientim i Hrushovit uli ritmet e zhvillimit makroekonomik të trashëguar nga Stalini dhe thelloi hendekun ekonomiko-social me Perëndimin. Këto pasoja u reflektuan edhe në vendet e “demokracive popullore”, ku bënte pjesë edhe Shqipëria.

³⁸⁶ Bashkurti L: “Diplomacia shqiptare – vëllimi II-të”, Geer, Tiranë 2003, ISBN:99927-887-6-3, fq 206

Reagimet nuk munguan. Partnerë si Rumania, Çekosllovakia, Hungaria, Polonia po parashtronin përherë e më tepër pakënaqësi ndaj Moskës. Moska kundërshtoi këto prirje si lloj “komunizmave nacionalë” dhe prirje për zhvillim ekonomik të panvarur dhe shkëputje varësie nga BS. Ndërkohë që këto vende të “demokracive popullore” shfaqën tendencat, lidhshpini i Tiranës i qëndroi fanatik prioriteteve të ngurta ekonomike, në favor të industrisë së rëndë dhe nënvlerësim të degëve të tjera të ekonomisë.

Vizita e Hrushovi të Beograd ishte revizionim i qëndrimit të Stalinit dhe Informbyrosë ndaj Titos dhe socializmit specifik jugosllav. Hrushovi me këtë lëvizje i paraprinte tre prirjeve; frymës liberale të mendimit njerëzor, policentrizmit të botës komuniste dhe gjallërimit të rrugëve të ndryshme të ndërtimit të socializmit. Fryma hrushoviane e mbas vizitës në Beograd nxiti mendimin liberal edhe në vende të tjera satelite ndërsa në Shqipëri u prit me rritje çensure e kontrolli.

Në 1954 u bënë ndryshime të mëdha në qeverisjen shqiptare. Numri i ministrive u ul nga 19 në 10. Mehmet Shehu dorëzoi postin në parti dhe u emërua Ministër i Brendshëm dhe i kreut të Sigurimit. E.Hoxha ndryshoi emërtimin e pozicionit të kreut të partisë, nga sekretar e Sekretariatit të PPSH në sekretar i parë i Komitetit Qëndror. Afrimi sovjeto-jugosllav i shqetësoi shumë Tiranën dhe lëkundit themelet e marrëdhënieve shqiptaro-sovjetike.

Në Shqipëri pati tentativa e një grupi intelektual në një Plenumin e 14-të KQ-së (1955) dhe në Konferencën e Partisë së Tiranës (1956) për gjallërimin e kritikave në frymën e ideve të Hrushovit. Tuk Jakova ishte kthyer një nga kundërshtarët më të vendosur të Enver Hoxhës, kërkoi rishikim të historisë së PKSHP për të venitur mitin e krijuar mbi Enver Hoxhën. Ai u mbështet edhe nga Bedri Spahiu (Ministër i Arsimit dhe Kulturës). Ky rrebelim pësoi “*goditje fatale dhe izoluese si dhe u shoqërua me dëmtime e zhdukje fizike të njerëzve intelektualë të shquar*”³⁸⁷. Kremlini, në verën e 1955, “*këshillon udhëheqsin shqiptar të bëjë paqe me ish-padronin e tij*” Tito, ndërsa Enver Hoxha hezitoi³⁸⁸. Në Konferencën e Partisë së Tiranës (1956) pakënaqësia ndaj dyshes Hoxha-Shehu ju shtuan edhe prania e disa ushtarakëve të lartë. Goditjet do vazhdonin dhe synimi i klanit Hoxha ishte i qartë, eliminim kundërdërshtarësh të vijës politike dhe mesazhi ndaj të tjerëve për “mosrealizim të planeve ekonomike”. Armiqtë gjendeshin nga brenda gjirit të partisë. Lufta brenda llojit ishte pjesë e gjenezës filozofike komuniste të ndërtuara sipas modelit bolshevik sovjetik.

*“Shqipëria mbeti nën regjimin stalinist më të prapambetur ndër vendet e Europës Lindore dhe gjithashtu më radikal në orientim”*³⁸⁹.

Kthesa hrushoviane filloi në Kongresin 20-të PKBS (1956). Në atë Kongres, Hrushovi doli me dy raporte, një mbi veprimtarinë e KQ të PKBS dhe një Raport Sekret mbi Stalinin. Raporti i parë jepte linjat kryesore të ndryshimeve që synohej nga Hrushovi në plan të brendshëm dhe ndërkombëtarë. Jepej e ndarë me shtetet satelite Euro lindore dhe me kundërshtarët Perëndimorë. Raporti i dytë, ndriçonte mbi veprimtarinë e fshehtë kriminale të Stalinit dhe abuzimet e pushtetit

³⁸⁷ Bashkurti L: “Diplomacia shqiptare – vëllimi II-të”, Geer, Tiranë 2003, ISBN:99927-887-6-3, fq 279

³⁸⁸ Pipa A, The Politics of Language in Socialist Albania. Boulder: East European Monographs, Distributed by Columbia University Press, 1989, fq 53-54

³⁸⁹ Laqueur W: “Europa në kohën tonë, 1945 – 1992”, Dituria 1996 & 2003, ISBN:99927-59-151, fq 240

personal të tij. Raporti i dytë jepte mesazhin se Stalini edhe stalinistët, liderët pasues në Europën Lindore duheshin ndryshuar. Përmbajtja e dy raporteve prekte politika të mëdha dhe synonte ndryshime në jetën e PK të BS, të udhëheqësve në Evropën Lindore dhe politikave botërore drejt rritjes së aspektit të strategjisë së brendshme dhe ndërkombëtare të Hrushovit.

Karakteristikë themelore e politikës shqiptare në këtë periudhë (1953-1957) është dyzimi politik shqiptar dhe aplikimi i politikës me dy standarte. Në kohën kur po zbehej Stalini dhe po ngrihej Hrushovi, politika shqiptare adoptoi qëndrime staliniste në plan të brendshëm dhe qëndrime hrushoviane në plan të jashtëm. Stalinizmi ishte më i preferuari së brendshmi dhe për pushtetin personal të Enver Hoxhës, ndërsa hrushovizmi ishte më i preferuar së jashtëmi si rrymë e fortë e Moskës. Aplikimi i stalinizmit në marrëdhëniet ndërkombëtare për Enver Hoxhën do të ishte po aq i rrëzikshëm sa edhe aplikimi i hrushovizmit në punët e brendshme. Në këto dilemash standartesh dyfishe për Enver Hoxhën “filloi acarimi dhe fundi i miqësisë shqiptaro-sovjetike.

Qeveria shqiptare dhe lidershipi i saj e priti me kujdes tezat dhe qëndrimet e Kongresit të XX-të PKBS. Enver Hoxha pak muaj më vonë me një stil shumë të hollë deklaronte qëndrimin shqiptar në situatat në vazhdim. *“Ne duhet të luftojmë edhe do të punojmë me këmbëngulje, me forcat tona që të përballojmë çdo situatë, sado e rrezikshme qoftë. Gabime nuk do të bëjmë, atdheun, revolucionin dhe socializmin do t’i mbrojmë”*³⁹⁰. Enver Hoxha ishte “nuhatës” e thellimit të marrëdhënieve sovjeta-jugosllave. Fjalët “atdheu”, “revolucionin dhe socializmin” ishin mesazhe të prirjes së përgjithshme të komunizmit nacionalist. Në fund të 1956, Hrushovi publikoi raportin sekret, ndërsa Enver Hoxha shkruante se; *“Flamuri i luftës kundër ‘stalinizmit’ u shërben udhëheqjes jugosllave dhe gjithë revizionistëve si maskë për të larë hesapet me të gjithë kundërshtarët e tyre”*³⁹¹. Raporti sekret ishte kundër stalinizmit dhe stalinizmit, lexonte fundin e karrierës për stalinistët deri në dënime të pamëshirshme. Enver Hoxha njihej ndërkombëtarisht si mbështetës i stalinizmit, i konfliktuar me Titon dhe nuk parashikonte “ditë të mira” me epokën hrushoviane. Lidershipi i Tiranës adoptoi një qëndrim të plotë në përputhje me atë të Moskës. Politika e jashtme dhe diplomacia shqiptare nuk ofruan diçka origjinale dhe individuale. *“Shqipëria gjithnjë parapëlqente që të reflektonte lëvizjet e Moskës në politikën e saj”*³⁹².

Në lidhje me fqinjët dhe politikën rajonale, Tirana dhe lidershipi i saj u dominuan nga skepticizmi, servilizmi dhe marrëdhënie ekonomiko-tregëtare të vakëta. Periudha 1955-1960 ishte shtrirja e parimeve të Luftës së Ftohtë në Ballkan. Në planin shqiptar, tendenca liberalizuese dhe demokratizuese me ardhjen e Hrushovit, u tentua të reaktivohej nga intelektualë, personalitete dhe politikanë që të krijonin një mendim alternativ e më kritik brenda vendit dhe vetë partisë. Në Konferencën e Partisë së Tiranës, prill 1956, Enver Hoxha bëri goditje që nuk e kishte ndërmarrë asnjë prej udhëheqësve lindorë. Enver Hoxha goditi shpresat e brendshme në shqipëri dhe po *“fuste vendin në një prej regjimet më të egra e më obskurantiste”*³⁹³.

³⁹⁰ Hoxha E, Vepra, vëll. 14, fq 71.

³⁹¹ Hoxha E, Vepra, vëll. 14, fq 256.

³⁹² R.F.Byrnes, “East-Central Europe Under the Communists”, New York 1958, fq 30

³⁹³ Bashkurti L: “Diplomacia shqiptare – vëllimi II-të”, Geer, Tiranë 2003, ISBN:99927-887-6-3, fq 307

7.3. Konflikti shqiptaro – sovjetik. Lufta për pushtet.

Permbajtja e te dy raporteve të parqitura në Kongresin 20-të PKBS prekte politika të mëdha, synonte ndryshime në jetën e PKBS dhe të udhëheqjeve në Evropën Lindore, ndryshime të politikave botërore drejt rritjes së aspektit të strategjisë së brendshme dhe ndërkombëtare të Hrushovit. Tezat themelore të hedhura në Kongres, lidheshin mbi rishikimin e plotë të stalinizmit në këto aspekte; mbi ndryshimin e karakterit të epokës aktuale, mbi rrugët e kalimit në socializëm, mbi bashkëekzistencën paqësore, mbi konceptin për luftën dhe paqen, mbi qëndrimin ndaj revizionizmit modern dhe imperializmit. Ky proces do shërbente më tepër për kozmetikë se reforma dhe do të nxiste teorinë e “*policentrizmit*”, e cila parakuptonte krijimin e disa qendrave të komunizmit botëror. “Policentrizmi” i interesonte më tepër Kinës, një fuqi e madhe botërore, e vendosur larg Europës dhe përqëndruar forcat kryesore të komunizmit botëror. Ky orientim i ri i Kremlinit i binte ndesh platformës politike të regjimit të Enver Hoxhës, që mbështetej kryesisht në teorinë dhe praktikën e Stalinit.

Stalinizmi si teori dhe praktikë i shkonte më shumë për shtat regjimit dhe pushtetit personal të Hoxhës edhe kastës së tij të Luftës II-të Botërore. Shtypi zyrtar i Tiranës shprehej mbi “*përgatitjet e revizionistëve për sulm të përgjithshëm kundër marksizëm-leninizmit*” në tre drejtime; në përhapjen e idesë së shuarjes së luftës së klasave, në afrimin me klikën e Titos dhe rehabilitimin e saj, në zëvendësimin e luftës së popujve për ruajtjen e paqes me bashkëpunimin me krerët e imperializmit.

Mosmarrëveshjet shqiptaro-sovjetike filluan në plan ideologjik, lidhur me qëndrimin ndaj Jugosllavisë dhe Titos. Lidhshipi politik shqiptar e quante prekje direkte e interesave të Shqipërisë nga Moska. Konflikti ideologjik përfshiu dhe çështje të teorisë dhe praktikës së revolucionit, si debatet për luftën e paqen, për bashkëekzistencën paqësore dhe për Stalinin dhe rolin e tij.

Në bilancin e vitit të parë të planit të parë pesëvjeçar, lufta e PPSH krahas frontin ideologjik e lidhi me luftën për plotësimin e arritjeve ekonomike. Raporti i mbajtur në Kongresin e II-të PPSH, mars-prill 1952, në çështjet e brendshme paraqiti zhvillimin ekonomik e politik dhe kalimin në fazën e industrilizimit. “*Kongresi II-të PPSH hyri në histori si kongresi i industrilizimit të vendit*”³⁹⁴. Detyra politike kryesore ishte “forcimi i aleancës midis klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse dhe në forcimin e rolit drejtues të klasës punëtore në këtë aleancë,..”, ndërsa ajo ekonomike në “vazhdimin me një ritëm më të shpejtë të punës për ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit, për të bërë në fund të pesëvjeçarit vendi ynë të jetë transformuar nga një vend agrar i prapambetur në një vend agraro-industrial”³⁹⁵. Masat ekonomike synonin një centralizim mbi bujqësinë, “*centralizimi i theksuar i planifikimit në këtë degë ndrydhte iniciativën e ekonomive bujqësore...*”. Bujqësia zinte 14.1% të investimeve të ekonomisë³⁹⁶. Planifikimi i prodhimit bujqësor bëhej drejtpërdrejtë nga çdo ekonomi bujqësore shtetërore, kooperativiste dhe individuale në bashkëpunim me organet e bujqësisë dhe SMT. Viti

³⁹⁴ ASH e RPSSH & Insituti i Historisë, Historia e Shqipërisë IV, 8 Nëntori, Tiranë 1983, fq 144

³⁹⁵ Hoxha E, Vepra, vëll. 9, fq 171

³⁹⁶ ASH e RPSSH & Insituti i Historisë, Historia e Shqipërisë IV, 8 Nëntori, Tiranë 1983, fq 156

1955 shënoi rritje të prodhimit industrial veçanërisht në miniera, u përmirësua organizimi i punës, rritje dhe ndarje përgjigjësish. Krahasuar me vitin 1950 u rrit prodhimi industrial 179%, prodhimi i drithëra u rrit 53%, të ardhurat kombëtare u rritën me 70%. Rritja mesatare vjetore ishte 22%. U zhduk analfabetizmi për moshat deri 40 vjeç. Detyra kryesore e planit të parë pesëvjeçar ishte shëndërimi i Shqipërisë nga një vend i prapambetur agrar në vend agraro-industrial.

Kongresi i 3-të PPSH, dhjetor 1955, mori në diskutim; kursin revizionist të Kongresit 20-të PKBS, dështimin e orvatjeve për të revizionuar vijën e PPSH, vendosmërinë e Partisë për vazhdimin e kursit marksist-leninist dhe përcaktoi direktivat e planit të dytë pesëvjeçar³⁹⁷. Marrëdhëniet problematike në terrenin ideologjik u shtrinë edhe në planin politik: si partiak dhe shtetërorë. Në arsyetim lidërshipi i Tiranës kundërshtonte kursin e paraqitur nga Hrushovi, në Kongresin e 20-të PKBS, si shtrembërues të mësimave leniniste mbi luftën dhe paqen. Lenini mësonte se *“aleanca me revolucionarët e vendeve të përparuara dhe me të gjithë popujt e shtypur kundër të gjithë imperialistëve të çdo lloji”*³⁹⁸. Politika e Tiranës dhe lidërshipi i saj mendonin se *“parimi themelor i politikës së jashtme të një vendi socialist dhe të një partie komuniste është internacionalizmi proletar dhe jo bashkëjetesa paqësore”*³⁹⁹. Akuzat vazhduan mbi “garën paqësore të dy sistemeve, sistemit kapitalist dhe atij socialist”, “mohim të revolucionit socialist dhe të diktaturës së proletariatit”, mbi “kultin e individit dhe pasojat e tij” dhe përgjegjësia ndaj Stalinit. Lidërshipi i Tiranës dhe Enver Hoxha luftën *“kult të individit të Stalinit”* e etiketoi si armë kryesore në luftën kundër marksizëm-leninizmit. Në plan të brendshëm Konferenca e Tiranës, prill 1956, në prezencë të Enver Hoxhës *“detyroi elementët antiparti të pohonin me gojën e vet qëllimet dhe karakterin e veprimtarisë së tyre kundërrevolucionare. Komploti revizionist dështoi”*⁴⁰⁰.

Vitet 1955-1961 shënon kulmin dhe rënien e marrëdhënieve të Shqipërisë me BS, Traktatin e Varshavës, Europën Lindore dhe fillimin e flirteve me Kinën. Udhëheqja shqiptare e kohës mendonte se për arësyet gjeopolitike, historike, etnike, Jugosllavia përbënte rrëzikun më të madh dhe *“rruga e ftohjes me to u mendua si shpëtim”*⁴⁰¹. Shqipëria midis Jugosllavisë dhe BS zgjodhi këtë të fundit. Me BS marrëdhëniet ishin më të gjëra dhe komplekse. Shtrirja e marrëveshjeve përfshinte ideologjinë, politikën, ekonominë, ushtrinë, kulturën, artin, arsimin, shkencën dhe politikën e jashtme në aspektin dypalësh. Shteti shqiptar nuk kishte ndërtuar me asnjë shtet marrëdhënie dimensionale dhe komplekse sa pati ndërtuar me BS. *“Komunistët shqiptarë ishin në kushte më pak të lehta nën kontrollin Rus sesa nën kontrollin Jugosllav. Rusët kishin presligjin që Jugosllavët nuk e gëzonin. Më këtë ndryshim, Shqipëria avancoi nga statusi i nënsatelitit në atë të satelitit”*⁴⁰².

³⁹⁷ ASH e RPSSH & Insituti i Historisë, Historia e Shqipërisë IV, 8 Nëntori, Tiranë 1983, fq 316-327

³⁹⁸ V.I.Lenin, “Politika e jashtme e revolucionit rus”, (Hoxha E, Vepra, vëll. 25, fq 86)

³⁹⁹ ISML, “Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë”, Shtëpia Botonjese “Naim Frashëri”, Mihal Duri, Tiranë 1968, fq 317

⁴⁰⁰ ISML, “Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë”, Shtëpia Botonjese “Naim Frashëri”, Mihal Duri, Tiranë 1968, fq 321-322

⁴⁰¹ Bashkurti L: “Diplomacia shqiptare – vëllimi II-të”, Geer, Tiranë 2003, ISBN:99927-887-6-3, fq 341-342

⁴⁰² R.F.Byrnes, “East-Central Europe Under the Communists”, New York 1958, fq 26

Enver Hoxha e kuptoi që në fillim se rehabilitimi i Titos shërbente si fillim fushate fshehje justifikimesh ideologjike, politike, ekonomike, ushtarake dhe ndërkombëtare ky justifikim i duhej për konsum të brendshëm politik dhe justifikim ndërkombëtar. Projekti Hrushovian përfshinte platforma të reja e njerëz të rinj ndërsa Enver Hoxha e paraqiste si rivalitet për ndikim ndërkombëtar. Enver Hoxha përjashtonte motivet e pushtetit të tij personal duke hedhur teza “*asnjëra nga palët nuk vepronte në bazë dhe në interes të marksizëm-leninizmit, ...antikomunizmi qëndronte në bazën e marrëdhënive të tyre, nga pozitat e antikomunizmit të dy këta kalendarë do bënin çmos për ta nënshtruar shoku-shokun, secili në interesin e vet*”⁴⁰³. E vërteta është se Titoja pati bërë përpjekje serioze për të siguruar lidhshimin e vendeve të Europës Juglindore, por mbas përjashtimit nga Informbyroja, ai filloi të profilizohet si i paangazhuar midis dy blloqeve, inicioi lëvizjen e të paangazhuarëve dhe synonte lidhshimin e saj botëror. Enver Hoxha në sajimin e rivalitetit Tito-Hrushov, ndiqte i shqetësuar e me vëmendje vlerësimet bërë titos, si “marksist”, si udhëheqës i “shquar” që ndërton rrugën e një “socializmi” të vërtetë. Tito-ja në nëntor 1956 sulmoi hapur Enver Hoxhën, kultin e individit me po atë frymë e stil të Hrushovit kundër Stalinit. Marrëveshja Tito-Hrushov parashihte ndryshime në elitën udhëheqëse lindore dhe ndryshimin e udhëheqjes shqiptare, personalisht të Enver Hoxhës. Mbi fjalimin në Pula nëntor 1956, Enver Hoxha shprehet se “*atje jo vetëm që i bëhej një sulm i shfrenuar antimarksist teorisë dhe praktikës së rendit socialist, por Titoja drejtpërdrejtë dënoi ‘kultin e Enver Hoxhës’ dhe bëri thirrje për përmbysjen e udhëheqjes sonë*”⁴⁰⁴. Jugosllavia përbënte një shqetësim konstant për politikën shqiptare dhe personalisht për Enver Hoxhën.

Enver hoxha për Hrushovin përfaqësonte “një udhëheqës i dalë nga lufta i tipit stalinist”, duhej ndryshuar dhe zëvendësuar me të tjerë. Hrushovi nuk e njihte drejtpërdrejtë Enver Hoxhën por ishte bazuar edhe nga vlerësimet e Titos, ndaj “*çdo lëvizje të Hrushovit drejt Titos ai e shihte si lëvizje e djallit tek temjani dhe e përcillte me dyshim të madh*”⁴⁰⁵. Enver Hoxha mbronte pozitat e veta drejt pushtetit absolut duke çmuar filozofinë, praktikën dhe sjelljen staliniste. Në plan ndërkombëtar motivoi elementët e patriotizmit me ato të marksizëm-leninizmit. Enver Hoxha me elementët patriotikë synonte sigurimin e mbështetjes së gjërë popullore, duke e rënditur në grupin e liderave komunistë me prirje nacionaliste. Autorë të kohës mendojnë se; “*debatet ndërmjet shteteve komuniste në vetëvete kishin më shumë bazë nacionaliste sesa ideologjike...*”⁴⁰⁶.

Mospërputhja tjetër lidhej me pozicionin strategjik të Shqipërisë. Me largimin e Jugosllavisë hapësira detare zvogëlohej, por Shqipëria kishte ngelur si vendi më i përshtatshëm për pozicionin rus në Ballkan.

Acarimi i marrëdhënive Shqipëri-Bashkimi Sovjetik dhe afrimi i Kinës do shoqërohej me tjetër spastrim. Në krye të grupit prosovjetik ishin anëtarët e Byrosë Politike, Koço Tashko dhe Liri Belishova. Pak muaj më vonë në Kongresin e 4-ër deklarohet se veprimtaria armiqësore ishte zbuluar nga Sigurimi dhe u asgjësua. Drejtuesit e kësaj lëvizje u gjykuan publikisht dhe

⁴⁰³ Hoxha E, “Hrushovianët”, Kujtime, Tiranë 1982, fq 101

⁴⁰⁴ Hoxha E, “Titistët”, Kujtime, Tiranë 1982, fq 528

⁴⁰⁵ Bashkurti L: “Diplomacia shqiptare – vëllimi II-të”, Geer, Tiranë 2003, ISBN:99927-887-6-3, fq 381

⁴⁰⁶ Chrles W. Kegley, Eugene R. Wittkopf, Amerikan Foreign Policy, Fourth Edition, New York 1991, fq 42

morën dënime të rënda. Enver Hoxha si lideri i Partisë dhe Mehmet Shehu si kryeministër dëshmonin pushtetin e plotë mbi gjithë makinerinë partiake, forcat e armatosura dhe policinë sekrete. Në kulmin e acarimit shqiptaro-sovjetik pozitat e Enver Hoxhës shiheshin prej elitës komuniste shqiptare si “shpëtimtari i kombit” dhe u fuqizuan së tepërmi.

Vitet 1957-1958 sollën një lloj stabiliteti në ndarjen bipolare të Evropës dhe vendosjen e Perdes së Hekurt. Mbas dështimit të Notës së Paqes, përpjekjeve për “çlirimin” e hungarisë, zgjidhjen e krizës së Berlinit të dy palët e botës së ndarë po shkonin drejt një ballancimi forcash. Gjermania, e cila kishte pasë qënë “molla e sherrit” në Luftën e nxehtë, u bë “dega e ullirit” në Luftën e Ftohtë⁴⁰⁷. Me konsolidimin e kontureve të ndarjes me Perde të Hekurt, të dy blloqet ju kthyen problemeve të tyre. SHBA, Franca dhe Britania e Madhe përcaktuan qartë natyrën e Aleancës Euro-Atlantike, rolin e armëve bërthamore dhe të ardhmen e Europës.

Divergjencat në kampin socialist lidheshin me konceptet e unitetit në gjirin komunist dhe qëndrimet drejt prirjeve komuniste. Prirjet e përgjithshme liberalizuese nacionaliste të brendshme në vendet socialiste dhe ato policentriste në marrëdhëniet ndërkombëtare midis partive komuniste dhe vendeve socialiste, filluan të marrin pamjen e divergjencave të hapura.

7.4. Konflikti ideologjik, politik dhe ushtarak. Dalja nga traktati i Varshavës, 1968.

Mosmarrëveshjet shqiptaro-jugosllave, midis Enverit dhe Hrushovit, erdhën në ngritje. Palët u ballafaquan në planin partiak, e nisën në Tiranë, e vazhduan përplasjen e hapur në Bukuresht, vjeshtë 1960, dhe kulmoi në Mbledhjen e 81 Partive Komuniste e Punëtore në Moskë, nëntor 1960. Ndërkohë përshkallëzoheshin acarimet dypalëshe shqiptaro-sovjetike, Tirana filloi lëvizjen e kursit të saj ideologjik e politik, në mënyrë të matur dhe jo shumë publike me Partinë Komuniste të Kines dhe Kinën e Mao Ce Dunit. Enveri e kishte kalkuluar rrezikun dhe kufirin deri ku mund të shkonin marrëdhëniet me Moskën ndaj kërkonte rrugë dalje ndërkombëtare paraprake. Kjo diktonte rrugen drejt Kinës së largët. Lëvizja drejt Kinës filloi nga viti 1956. Komunistët shqiptarë dinin pak për Kinën dhe Mao Ce Dunin deri atë kohë. Moska kishte centralizuar gjithçka të botës komuniste. Mbas vdekjes së Stalinit, Mao Ce Duni mbetej lideri komunist më i madh e kontributor, ndaj nuk mund të pranonte kultin ndërkombëtarë të Hrushovit, rrezikshmërinë e tij ofensive ndaj Kinës dhe monopolizimin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare në Kremlin. Këto arsye nxitën procesin e çarjes së botes komuniste në dy qendra. Ishte fillimi i dobësimit të frontit komunist botëror.

Regjimi Enver Hoxhes manipuloi mjaft me shkathtësi këtë ndarje të madhe mbarë komuniste për t’i paraprirë rreziqeve që mund t’i vinin Tiranës nga prishja me BS.

Në mbledhjen e 12 partive komuniste, nëntor 1957, Bashkimi Sovjetik donte të përmirësonte me çdo çmim e çdo kusht imazhin ndërkombëtar dhe krijimin e idesë së ekzistencës së plotë të unitetit brenda kampit socialist e partive komuniste.

Hapi fillestar lidhej me pjesëmarrjen e gjithë spektrit politik respektiv duke përfshirë edhe Jugosllavinë me Titon. Tito dhe Jugosllavia ishin simbol i rezistencës kundër Stalinit dhe stalinizmit, ishin alternativë e socializmit dogmatik, modeli i zgjidhjeve neutrale dhe të

⁴⁰⁷ Bashkurti L: “Diplomacia shqiptare – vëllimi II-të”, Geer, Tiranë 2003, ISBN:99927-887-6-3, fq 386

paangazhuarëve. Nga shkëputja e Titos dhe Jugosllavisë nga Kremli ishin frymëzuar lëvizjet me baza patriotike dhe jo ideologjike si dhe lëvizjet reformatore, jo dogmatike. *“Për Perëndimin, Tito po bëhej figura më e dashur, për Lindjen, po bëhej figura më pak e urreyer”*⁴⁰⁸. Tito i njihte mirë synimet e Hrushovit dhe ndoqi rrugën e parashtrimit të një sërë kërkesash si parakusht pjesëmarrje në mbledhje, e cila e bënte të panevojshme organizimin e mbledhjes së Moskës. Tito e dinte se Hrushovi ishte në krizë identiteti, diplomacia jugosllave mendonte se më mirë të dështonte në normalizim marrëdhëniesh me BS se sa të rrezikonte statusin e veçantë që po fitonte në Perëndim. Hrushovi i hodhi poshtë parakushtet e Titos dhe u detyrua të pranonte në heshtje mospjesmarrjen e tij. Mungesa e Titos solli krisjen e pariparueshme të unitetit të shtirur të Moskës për imazh botëror.

Deri në vitin 1957, qeveria shqiptare vijonte me të gjitha forcat që marrëdhëniet ndërshtetërore Shqipëri-Bashkimi Sovjetik të vazhdonin normalisht. Hrushovi dhe politika e tij ndaj Shqipërisë konstatonte se politika shqiptare ishte në kundërshtim me atë të BS. Kremli po rriste presionin mbi udhëheqjen shqiptare dhe paralajmëronte edhe masa të tjera kufizuese shtetërore. Hrushovi nuk ndante kontraditat ideologjike e politike të karakterit partiak me marrëdhëniet njerëzore.

Presioni i parë lidhej mbi qëndrimin ndaj Titos dhe Jugosllavisë në dy aspekte, udhëheqja shqiptare duhet të reviziononte politikën e saj ndaj Titos e Jugosllavisë dhe të rikonsideronte të gjithë eksponentët politikë shqiptarë si mbështetës të Titos dhe Jugosllavisë. Revizionimi i përgjithshëm politik ndaj Titos dhe Jugosllavisë ishte përmbysje e gjithçkaje, në thelb pranim gabimi dhe udhëheqja të mbante përgjegjësinë. Kjo ishte e papranueshme përballë synimeve keqëdashëse, aneksoniste e kolonializuese ndaj Shqipërisë. Pasojat dhe dëmet mbi Shqipërinë dhe Kosovën kërkonin revizionim të politikës jugosllave ndaj Shqipërisë në plan ndërkombëtar dhe ndaj Kosovën në plan të brendshëm.

Rehabilitimi i gjithë eksponentëve politikë të dënuar me motivim për qëndrim pro Titos dhe Jugosllavisë i hapte rrugë largimit nga politika e dënuesëve të tyre. Ndryshimin e elitës kryesore politike shqiptare ishte në përputhje me platformën e Kongresit të 20-të PKBS. Presioni politik hrushovial ju bë udhëheqjes komuniste shqiptare në Moskë, prill 1957. Enver Hoxha shprehet; *“Çështja jugosllave, si dhe më parë, ishte një ndër shkaqet kryesore që na ndante me hrushovianët, të cilët bënë çmos që ne të pajtoheshim me revizionistët jugosllavë”*⁴⁰⁹. Enver Hoxha kritikoi ashpër politikën jugosllave në dy dimensione; në marrëdhëniet dypalëshe, partiake, shtetërore shqiptaro-jugosllave dhe në aspekti brenda jugosllavisë, të marrëdhënieve me Kosovën dhe popullsinë shqiptare të saj.

Në dimensionin dypalësh shqiptaro-jugosllav, Enver Hoxha theksoi mospërputhjet në aspektin partiak, dallimet e thella ideologjike midis dy partive të dy vendeve. *“Revizionistët jugosllavë nuk pajtohen me sistemin tonë socialist, janë kundër diktaturës së proletariatit, ata kanë hequr dorë përfundimisht nga marksizëm-leninizmi, ...e kanë bashkuar zërin e tyre me atë*

⁴⁰⁸ Bashkurti L: “Diplomacia shqiptare – vëllimi II-të”, Geer, Tiranë 2003, ISBN:99927-887-6-3, fq 393

⁴⁰⁹ Hoxha E, “Hrushovianët”, Kujtime, Tiranë 1982, fq 327

të fuqive perëndimore kundër nesh”⁴¹⁰. Enver Hoxha informoi palën jugosllave mbi ndërhyrjet në punët e brendshme të Shqipërisë nga jugosllavët dhe në dimensionin shtetëror. Enver Hoxha për herë të parë ngriti para autoriteteve më të larta sovjetike çështjen e Kosovës dhe të popullit të saj. “Kjo është një çështje delikate dhe e rëndësishme për ne, sepse nga Kosova ata jo vetëm organizojnë një veprimtari të dëndur kundër vendit tonë, por përpiqen të likujdojnë popullsinë shqiptare të Kosovës, duke e shpërngulur në masë në Turqi e në vende të tjera”⁴¹¹. Jugosllavia kërkonte të inkriminonte sa më tepër Kosovën e njerëzit e saj që të ngjallte pakënaqësi dhe dyshime. Shpërngulja e Kosovarëve për “arësye ekonomike dhe lëvizja e lirë” drejt Turqisë e vendeve të tjera europiane dëhmonte se politika jugosllave e Titos dhe Rankoviçit kishte filluar të zbatonte platformën e Vasa Çubriloviçit për pastrimin etnik të Kosovës.

Në marrëdhënie me fqinjët, politika e Shqipërisë kishte pak manovrime dhe kërkonte llogaritje të mirë të raportit të forcave me interesat. Greqia ishte inkuadruar në kampin Perëndimor. Marrëdhëniet me Italinë ishin të zbeta nga Lufta e II-të Botërore dhe nga orientimi i hapur ndaj partnerëve Anglo-Amerikan. Me Rumaninë, Bullgarinë orientoheshin nga politika komunitare e kampit socialist dhe orientimeve të Moskës, KNER-it dhe Traktatit të Varshavës. Me Turqinë ishin në situatë ftohje nga koha e Ataturkut dhe Mbretit Zog. Politika shqiptare determinohej nga dogmatizmi ideologjik e politik dhe injorimit të modernizmit diplomatik.

Në fund të viteve 50’ Moska kishte filluar të rishikonte gjithë politikën e saj ndaj shqipërisë. Ideologjikisht mospërputhjet po thelloheshin, politikisht entuziazmi i viteve të para po zbehej, ekonomikisht kreditimi dhe ndihmat në nivelet e kërkuara nga Shqipëri po reduktoheshin në minimum. Vetëm ushtarakisht interesi sovjetik mbetej i lartë ndaj Shqipërisë. Gjithçka në optikën ruse po reduktohej në aspektin strategjik-ushtarak. Për BS dhe interesat e saj gjeopolitike, Shqipëria ishte e përshtatshme dhe dobishme vetëm si një zonë ushtarake.

Në fund maji 1959, vjen në Shqipëri një delegacion i nivelit të lartë me Hrushovin në krye. Udhëheqja shqiptare dhe Enver Hoxha kishin rënë dakort që të vetëpërmbahej në bisedime me Hrushovin, të mos rihapte pika debati, të toleronte çdo mendim apo vërejtje të Hrushovit, madje të pranonte çdo kërkesë të tij.e gjithë kjo frymë vetëpërmbytje apo nënshtruese do të arsyetohej nga me traditën mikëpritëse të shqiptarit “mikun e pranon në shtëpi me të mirat dhe të ligat”. Në diplomacinë moderne kjo quhet e pakuptimtë. Vetëpërmbytja zotëroi gjithë veprimtarinë dypalëshe shqiptaro-sovjetike në fjalë. Mospërputhjet dhe kontraditat nuk dolën në pahë, vizita shkoi paqësore dhe miqësore. Hrushovi ishte i paparashikueshëm, ai dëshironte të bënte me dije Tiranës se BS nuk do të pranonte politikën shqiptare kundër Titos dhe Jugosllavisë. Bisedimet u përqëndruan në fushat ekonomike, kulturore dhe strategjike.

Pala shqiptare prezantoi edhe rezervat naftëmbajtëse dhe kërkoi Hrushovit të ngrihej baza industriale përpunuese të saj. Hrushovi reagoi me sens komercialist të çdo lloj investimi të madh dhe nevojave të tregut. “...nafta juaj është e rëndë, ka squfur. A bëni llogari ju? Do ta përpunoni, por do t;ju kushtojë më shtrenjtë një litër benzine sesa një kilogram havjar. Duhet parë mirë ana

⁴¹⁰ Hoxha E, “Hrushovianët”, Kujtime, Tiranë 1982, fq 337

⁴¹¹ Po aty, fq 336

komerciale. S'është e thënë ta keni çdo gjë vetë. Përse i i keni miqtë"! Koha do tregonte se investimet në energji ishin me leverdi dhe domosdoshmëri për tregun dhe ekonominë e vendit.

Pala shqiptare prezantoi prioritetet e politikës agrare. Enver Hoxha kishte prioritet prodhimin e bukës në vend dhe fshinte përgatitjen për politikë izolacioniste. Hrushovi shprehej qartë dhe haptazi; *"grurë ju japim ne. Sa keni nevojë ju për grurë, neve na e hanë minjtë..., mos harxhoni tokën dhe klimën tuaj të mrekullueshme me misër dhe grurë. Këto nuk ju sjellin të ardhura".* Enver Hoxha ndoqi rrugën e heshtjes ndaj këtyre sygjërimeve me sens mjaft ekonomik, ndërsa Hrushovi e thjeshtëzoi gjithë aspektin shqiptar për përfitime ekonomike në aspektin njohës e këmbyses mendimesh. Në konkluzion të bisedimeve ekonomike i Hrushovi i theksoi Enver Hoxhës *"..përse u përket nevojave tuaja, dua t'ju them se ne nuk kemi ardhur për të shqyrtuar ato. Nuk jemi autorizuar nga qeveria për të biseduar çështje të tilla. Ne kemi ardhur të njihemi, të shkëmbejmë mendime".*

Enver Hoxha i mërzhitur nga deklarata ekonomike e Hrushovit i bën karshillëk diplomatik duke i paraqitur projektet në fushën e kulturës. Enver Hoxha i shpjegoi kulturën e lashtësisë, vazhdimësinë iliro-shqiptare, vazhdimësinë historike si pasardhës të ilirëve në troje autoktone. Hrushovi shprehej *"përse harxhoni gjithë këto fonde me gjëra të tilla të vdekura. Lëreni helenët dhe romakët në lashtësinë e tyre... E përse t'ju vlejnjë këto? E rrisim mirëqënien e popullit"? BS si Ruisë Cariste nuk i interesontepopulli shqiptar për vlerat e lashta, origjinale, autoktone, të patjetërsueshme, por pozicioni strategjik i Shqipërisë. Gjatë vizitës në Butrint, Hrushoi parashitri synimin e vizitës së tij në Shqipëri... *"Mund të ndërtohet një bazë ideale për nëndetset tona. Të gërmohen dhe të hidhen në det këto vjetërsira (objektet arkologjike të Butrintit), ta shpojme këtë mal dhe të dalim matanë. Do kemi në dorë bazën më ideale e më të sigurtë në Mesdhe. Që këtu mund të paralizojmë e të sulmojmë gjithçka"*⁴¹². Udhëheqja shqiptare i dëgjoi mirë synimet synimet strategjiko-ushtarake në Shqipëri, por në moment nuk reagoi. Më vonë ra dakort për ngritjen e bazës së Pasha Limanit, një nga bazat më të rëndësishme të Traktatit të Varshavës në Mesdhe. Ky ishte një konçesion shumë i madh, me rrezikshmëri të lartë për sovranitetin e Shqipërisë, për paqen dhe stabilitetin e mbarë rajonit. Me bazën e Pasha Limanit, Shqipëria de facto ndryshoi raportin ushtarak të forcave në Ballkan dhe Mesdhe. Vendimi u morr nga kupola e vendit dhe u bë fakt i kryer kur filloi ndërtimi i bazës. Konçesioni ushtarak ndaj BS dhe Traktatit të Varshavës ishte një nga gabimet më të rënda dhe më me pasoja të politikës së jashtme shqiptare gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë.*

Kriza shqiptaro-sovjetike filloi ngritjen e shpejtë në Bukuresht 1960 dhe kulmoi në Mbledhjen e 81 Partive Komuniste e Punëtore në Moskë, nëntor 1960. Në atë mbledhje kontradiktat dypalëshe shqiptaro-sovjetike u shpalosën ndërkombëtarisht dhe morën karakter dhe dimension multilateral. Shumë faktorë dhe aktorë u përfshinë në atë krizë. Pjesa dërmuese ishin vasale ideologjike e politike të Moskës. Vetëm delegacioni Kinës dhe disa nuanca të disa partive komuniste Perëndimore mbështetën direkt ose indirekt platformën e delegacionit shqiptar. Diplomacia shqiptare me Enver Hoxhën në atë mbledhje u pozicionua haptazi në favor të qendrës së dytë të komunizmit botëror: Kinës Mao Ce Dunit. Ky qëndrim madhorë ishte

⁴¹² N.Hrushovi, Nga Takimi në Tiranë, maj 1959, (Hoxha E, "Hrushovianët", 1982:353-357)

kryekëput kundër interesave të Moskës dhe kundër platformës së përbashkët Eurolindore. Kjo mjaftoi që Hrushovi në vitin 1961 të ndërpriste në mënyrë të njëanshme marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë. Ishte rasti i parë dhe unik që Bashkimi Sovjetik do ta bënte në këtë mënyrë me një vend Eurolindorë.

Ish-ambasadori amerikan në Rusi shprehej, “*ekziston një mundësi, që komunizmi rus të mund të shkatërrohet nga vetë pjellat e tij në formën e rrebelimit të partive komuniste të vendeve të tjera. nuk shoh asnjë zhvillim tjetër që të jetë më i drejtë dhe më logjik...*”⁴¹³. Kennan pati të drejtë. Në një hark dhjetëvjeçar në Bllokun Sovjetik kishin filluar shenjat e rrebelimit nga vetë pjellat e komunizmit rus. Rrebelimet kishin filluar, krisje marrëdhëniesh dypalëshe, ndeshje e hapur për shpëtim, skepticizëm i plotë, dyshime e mospërputhje, ndeshje ideologjike serioze, prirje tërheqjesh gravitacionale drejt Pekinit. Këto rrebelime dypalëshe, partiake, shtetërore, ideologjike, politike, ekonomike dhe ushtarake në fund të viteve 50’ nxorrën krye në forumet shumëpalëshe të Bllokut Sovjetik. Hrushovi përpiqej ti zgjidhte mosmarrëveshjet brenda bllokut ndërsa diplomacia e SHBA u angazhua “*për ngjalljen e rivaliteteve Kino-Sovjetike*”⁴¹⁴. Përballë teknologjisë amerikane BS e kishte shumë të vështirë manovrimin. “*...Shtetet e Bashkuara ishin më tolerant në diversitetin e sferave të tyre të influencës sesa rivali i tyre, Bashkimi Sovjetik. ...nuk ishte aspak aksidentale që miqësia Franko-Amerikane i mbijetoi Charl De Golit, ndërsa miqësia Kino-Sovjetike nuk i mbijetoi Mao Ce Dunit*”⁴¹⁵. Qëllimi i Perëndimit ishte të sillte një panvarësi efçente midis Pekinit dhe Moskës dhe të ngritjen e Japonisë. SHBA nuk dëshironin shumë angazhim në Lindjen e Largët. Politika e Perëndimit kishte konsoliduar mendimin se procesi i dizentigrimit të Kinës me BS do të ishte i pashmangshëm për arësyen e vetë sistemit të tyre.

Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu në shkurt 1960 ishin në një mbledhjetë Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës. Aty u njohën me sinjalet e para të mosmarrëveshjeve Kino-Sovjetike. Përfaqësuesi sovjetik shprehej se “*i vetmi ndryshim midis Mao Ce Dunit dhe stalinistit është se Maoja nuk ua pret kokën kundërshtarëve të tij, kurse Stalini po*”⁴¹⁶. Sinjali i dytë erdhi nga pala kineze në maj 1960 në mbledhjen e Sindikatave Botërore në Pekin, ku delegacioni kinez kundërshtoi tezat e Kongresit të 20 PKBS. Sinjali i tretë erdhi nga Moska, që sqaronin divergjencat “parimore” midis PKK dhe PKBS. Sinjali i katërt erdhi po nga Moska mbi një unifikim reagimi të partive komuniste kundër Kinës komuniste. Mbledhja e Bukureshtit e Partive Komuniste e Punëtore të kampit Socialist, qershor 1960, nxorri plotësisht krizën Kino-Sovjetike. Enver Hoxha shmangu vajtjen e tij dhe dërgoi Hysni Kapon për tu njohur nga afër mbi divergjencat, prononcimet, këmbimin e mendimeve. Enver Hoxha mendon se kjo mbledhje ishte një kurth i Hrushovit që t’i zinte të papërgatitur Partitë Komuniste e Punëtore, realizimin e një qëndrimi zyrtar të unifikuar kundra Kinës. Delegacioni shqiptar, mbas instruksioneve të Tiranës, u shpreh kundër akuzave sovjetike ndaj Kinës, kundër metodës së përdorur në një forum shumëplanësh me agjendë tjetër. Panvarësisht diplomacisë së “koridoreve”, delegacioni shqiptar

⁴¹³ George F. Kennan, Papers, Box 17, Seeley Mudd Library, Princeton University, September 19, 1949

⁴¹⁴ Bashkurti L: “Diplomacia shqiptare – vëllimi II-të”, Geer, Tiranë 2003, ISBN:99927-887-6-3, fq 428

⁴¹⁵ John Lewis Gaddis, “The United States and the End of the Cold War”, New York, 1992, fq 15-16

⁴¹⁶ Mikoiani, Biseda me Delegacionin Shqiptar, Moskë, shkurt 1960, (Hoxha E, “Hrushovianët”, 1982:368)

nuk ndryshoi qëndrim. Kjo është kthesa e madhe drejt Kinës. Argumentat e delegacionit shqiptarë ishin se PKK mbante qëndrime parimore, ndërsa PKBS kishte devijuar nga rruga marksiste-leniniste. Këto argumenta ishin kontraditorë në kohë, hapësirë dhe në logjikë për diplomacinë shqiptare dhe Enver Hoxhën. Vetëm dy vjet më parë PKSH kishte shprehur rezerva mbi teorinë kineze “njëqind shkollat” e “njëqind lulet” mbi sistemin ekonomik. Enver Hoxha shprehet; *“ne mbështetëm Partinë Komuniste të Kinës jo si një parti të madhe, por mbrojtëm parimet, mbrojtëm të drejtën marksiste-leniniste”*⁴¹⁷.

Me mbarimin e mbledhjes së Bukureshtit filluan presionet diplomatike nga Moska dhe vendet satelite të saj. Moska arriti të provokojë edhe krizë urie në 1960 në Shqipëri. Ambasadorët e vendeve satelite merrnin pjesë në mitingjet e organizuara në Mitrovicë, Kosovë dhe provokoheshin incidente brenda ambasadave shqiptare. Acarimi politik e partiak filloi të shtrihet në marrëdhëniet ndërshtetërore, dypalëshe, KNER dhe Traktatin e Varshavës. *“Qeveria sovjetike, nga qershori 1960, ndoqi sistematikisht rrugën e prerjes së ‘heshtur’ të çdo ndihme ekonomike për RPSH. ...në kundërshtim flagrant me të gjitha marrëveshjet dypalëshe, i anulloi ato në mënyrë të njëanëshme dhe pa asnjë paralajmërim”*⁴¹⁸.

Mbledhja e 81 Partive Komuniste e Punëtore në Moskë do ti paraprinte një Komision Përgatitor për projekt-deklaratën e mbledhjes. Si përfaqësues shqiptarë ishin Hysni Kapo dhe Ramiz Alia. Delegacioni shqiptar vajti në takim me instruksione fikse, me një zgjidhje ndërsa të tjerët me shumë instruksione, me shumë variante e opsione që mund të aplikoheshin sipas ecurisë së negociatave. Delegacioni shqiptar paraqiti mendimet në kundërshtim me tezat sovjetike dhe duke anuar nga poli i ri i komunizmit botëror. Parrullat, tezat teorike, argumentat ideologjikë pasqyronin mediokritet në formim teoriko-filozofik dhe justifikime mbi orientimin ndaj Kinës. Delegacioni kinez u tregua më fleksibël, më oportunistë dhe ndiqte dinamikën e debateve dhe dialogut. Tezat mbi politikën e jashtme përgatiteshin në Tiranë, në mënyrë të ngurtë dhe paragjyquese ndërsa debati e dialogu politik evoluonte. Mungesa e fleksibilitetit të diplomacisë shqiptare e shëndërroi në megafonë me të njëjta fraza dhe sterotipe, panvarësisht dialogut dy ose shumëpalësh.

Në Mbledhjen e Moskës, Byroja Politike caktoi kapacitetet më të larta politike dhe intelektuale që posedonte PPSH, Enver Hoxha, Mehmet Shehu, Hysni Kapo dhe Ramiz Alia. Periudha para mbledhjes ishte dinamike, me takime, biseda dhe negociata mbi dokumentin kryesor. Rusia dhe Kina po hynin në një rivalitet të brendshëm dhe përplasje interesash gjeopolitike. Në materialin e shpërndarë, shqipëria nuk figuronte fare si vend socialist. Sovjetikët e kishin kuptuar lojën diplomatike të udhëheqjes shqiptare drejt Pekinit. Fjala e Hrushovit karakterizohej nga tone të buta, frymë pacifiste, tolerancë e moderacion dhe vullnet për mirëkuptim dhe unitet në radhët e lëvizjes komuniste botërore. Në mënyrë ambige, Hrushovi sulmoi PKK, PPSH dhe disa parti të tjera me prirje ndarëse nga Moska. Ne negociatat e bëra nga delegacioni shqiptar, Enver Hoxha u takua edhe me Hrushovin e parti të tjera komuniste. I nisur

⁴¹⁷ Hoxha E, “Hrushovianët”, Kujtime, Tiranë 1982, fq 384

⁴¹⁸ ASH e RPS të Shqipërisë & Insituti i Historisë, Historia e Shqipërisë IV, 8 Nëntori, Tiranë 1983, fq 267

nga teza e doktrina marksiste dhe pa dialektikën e duhur, fjalimi i Enver Hoxhës mbylli çdo shteg për ardhmërinë e marrëdhënieve shqiptaro-sovjetike dhe demokracitë popullore lindore. Enver Hoxha ngriti dhe trajtoi edhe çështje që lidheshin me Raportin Sekret kundër Stalinit, qëndrime kundër jugosllavëve, mbi ngjarjet në Hungari, marrëdhëniet ndërmjet partive komuniste e punëtore të botës dhe ndaj Mbledhjes së Bukureshtit. Enver Hoxha konsideronte revizionizëm çdo ndryshim teorik nga bazat e ngurtësuara të teorisë marksiste-leniniste. Ai nuk pranonte ndryshimin dhe zhvillimin as në teori as në praktikë. Ishte tipik dogmatik. I tillë do të shpalosej edhe në modelin socialist që do të aplikonte më vonë në Shqipëri. Delegacioni kinez mbante qëndrim më fleksibël, me shumë opsione dhe gjuhë e stil diplomatik. Enver Hoxhës i mungonte diplomacia, fleksibiliteti, opsionaliteti, negocimi, taktikat, manovrat për të realizuar qëllimet e veta strategjike. *“Delegacioni kinez, siç u duk, kishte ardhur në Mbledhjen e Moskës me mendimin që mund të zbuteshin gjakrat,... siç po dukej, ata ishin përgatitur një qëndrim me ‘dy-tri variante’. Kjo na u duk e çuditshme, pas atyre sulmeve të egra që ishin bërë kundër PPK dhe Mao Ce Dunit në Bukuresht”*⁴¹⁹.

Marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike do përkeqësoheshin edhe më tepër pas Mbledhjes së 81 partive në Moskë. Enver Hoxha mendonte disa alternativa për shpëtuar partinë, popullin nga vuajtjet dhe pushtetin e tij personal. Në raport me BS, Enver Hoxha ishte bërë pengesë për reformat hrushoviane. Hrushovi dhe kremlini kërkonin largimin e tij nga pushteti.

Perëndimi si alternativë i kishte kërkuar para rreth një dekade e gjysëm mbajtjen e zgjedhjeve të lira, njohje të opozitës, lejimin e lirive dhe të drejtave demokratike dhe një politikë të orientuar qartësisht nga perëndimi. Zgjedhje të lira mbi bazën e pluralizmit politik, ndërtimi i demokracisë, ekonomia e tregut dhe një orientim perëndimor do të thoshte humbje pushteti për komunistët dhe Enver Hoxhën.

Kina komuniste ishte e vetmja alternativë për Enver Hoxhën. Ai ruante imazhin si parti komuniste e vend socialist dhe nuk rrëzonte pushtetin e tij personal. Kina i konvergonte kësaj skeme. PPSH mbështete Kinën në kampin komunist dhe arenën ndërkombëtare, ndërsa Kina nuk trazonte Enver Hoxhën në pushtetin e tij personal. Filozofia kineze pranonte qëndrimin pafundësisht në pushtet.

BS kishte dy opsione për Enver Hoxhën. Kompromisin e përkohshëm ose presion në të gjitha fushat, mbi PPSH, popullin dhe Shqipërinë. Kompromisi i forzonte pozitat personale të Enver Hoxhës, ndërsa shtimi i presionit do ngjallte pakënaqësi brenda Partisë dhe në popull dhe rriste dyshimin mbi figurën e Enver Hoxhës. Hrushovi zgjodhi opsionin e dytë, shtimin e presionit mbi PPSH, popullin dhe vendin. Ngutja e Hrushovit e nxitoi Enver Hoxhën të hidhej shpejt drejt Pekinit. Me këtë lëvizje Enver Hoxha shmangu ndërhyrjen e sovjetikëve tek pushteti i tij personal dhe ruajti imazhin e komunizmit e të socializmit. Presioni sovjetik u shtri në të gjitha fushat, përfshiu politikën, ekonominë, tregëtinë e jashtme, ushtrinë. Goditja në ekonomi u shoqërua me anulim kredish të akorduara nga Moska dhe demokracitë popullore, u asfiksua tregëtia e jashtme, u ndërpreu ndihmat ushtarake. Udhëheqja shqiptare reagoi me masa shtërnguese, miratoi ligjin e kursimeve dhe të mbështetjes në forcat e vbeta. Ligjet u

⁴¹⁹ Hoxha E, “Hrushovianët”, Kujtime, Tiranë 1982, fq 412

propoganduan si ligjësi të sistemit komunist dhe pjesë integrale të teorisë së socializmit shkencor. Ligji i kursimit do ishte esencial i politikës ekonomike dhe uljes graduale të nivelit të jetesës së masave. Ligji i mbështetjes në forcat e veta diktohej nga politikat izacionaliste të parashikuara nga Enver Hoxha. Ligj që do sillte sistem autarkik, ekonomi në falimentim, një kulturë dhe psikologji të prapambetur, moral shoqëror pesimist, imazh tepër të dyshimtë ndërkombëtar. Enver Hoxha dhe klani i tij jepte shenjat e para se për hir të konsolidimit të pushtetit personal e klanor komunist ishin të gatshëm të nisnin kalvarin e sakruifikimit të gjithçkaje që lidhej me qytetarët, zhvillimin dhe përparimin e vendit.

Pika më e nxehtë konfrontimi shqiptaro-sovjetik ngelej Baza Ushtarake e Vlorës. Kjo bazë ishte marrëveshje Qeveri Shqiptare-Traktati i Varshavës me qëllim të dyfishtë, ruajtjen e sovranitetit të Shqipërisë dhe në shërbim të interesave strategjike të Traktatit të Varshavës. Marrëveshja dypalëshe parashikonte pajisjen e plotë dhe përfshirjen e dhjetë nëndetësve moderne sovjetike. Ngritja e bazës së Vlorës ishte një nga gabimet e rënda të bëra nga politika e Enver Hoxhës. NATO dhe SHBA shtuan arsenalin ushtarak në Mesdhe dhe Adriatik dhe mbanin nën tension gjithë Mesdheun. Enver Hoxha dhe diplomacia shqiptare e kishte kuptuar gabimin me marrëveshjen me traktatin e Varshavës. Konflikti u përqëndrua së kush do ruante kontrollin mbi bazën. Pala sovjetike insistonte që baza të kalonte nën komandën e Traktatit të Varshavës, ndërsa pala shqiptare insistonte kalimin nën komandën e Shqipërisë. Arsytimi shqiptar ishte se baza shërbentë edhe për mbrojtjen e Shqipërisë prandaj është vendosur në territorin e një shteti sovran. Në 1961 Hrushovi ndërpreu në mënyrë të njëanshme marrëdhëniet diplomatike me idenë se në Shqipëri do ketë revolta në parti, popull dhe do sillte ndryshimin e elitës politike shqiptare. Hrushovi nuk e njihte gjendjen mjaftueshëm në Shqipëri, përkundrazi vendimi i nxituar u përdor nga Enver Hoxha dhe elita komuniste shqiptare si propogandë e provë që vërtetësonte drejtësinë e qëndrimeve të PPSH dhe udhëheqjes së saj mbi qëndrimin armiqësor të udhëheqjes komuniste ndaj Shqipërisë. Prishja e marrëdhënieve diplomatike me BS reduktoi marrëdhëniet edhe me demokracitë popullore. U ndërpreu gradualisht marrëdhëniet me KNER-in dhe me Traktatin e Varshavës ato u ngrinë menjëherë mbas largimit të trupave sovjetike nga baza e Vlorës. Brenda vendit, Partia e Punës realizoi disa spastrime të udhëheqësve dhe eksponentëve që mendohej se kishin pasur lidhje konfidenciale me BS. Gjithçka bëhej që të krijohej brenda vendit përshtypja e lidhjeve të pashmangshme populli-parti, ndërsa jashtë vendi të përforcohej imazhi për legjitimitetin e udhëheqjes shqiptare⁴²⁰. Mbas prishjes marrëdhënieve diplomatike Shqipëri-Bashkim Sovjetik, rruga e Shqipërisë drejt Kinës së largme ishte e hapur. Ky hap shënon një fazë të re për politikën e jashtme dhe diplomacinë shqiptare gjatë Luftës së Ftohtë.

Kap. VIII-të. Aleancat fluide shqiptaro-kineze, 1968-1978. Konteksti i zhvillimeve globale në periudhën e detantes.

Politika e Tiranës nga viti 1956 dhe në vijim u dyzua ndaj dy qendrave të mëdha të komunizimit botëror, duke reduktuar bashkëpunimin ideologjiko-politik me Moskën dhe duke fuqizuar gradualisht bashkëpunimin politiko-ideologjik me Kinën. Brenda asaj ideologjie e

⁴²⁰ Bashkurti L: "Diplomacia shqiptare – vëllimi II-të", Geer, Tiranë 2003, ISBN:99927-887-6-3, fq 463-469

politike të komunizmit botëror kjo mund të konsiderohet si një manovër diplomatike rrugëdalëse për regjimin e Tiranës.

Ndërprerja e marrëdhënieve politike dhe diplomatike midis Shqipërisë, BRSS dhe dalja nga Traktati i Varshavës, vendim të Kuvendit Popullor i Republikës së Shqipërisë shtator 1968⁴²¹, u pasua me zhvillime shumë të rëndësishme ndërkombëtare. Lidërshipi politik shqiptar dhe qeveria e Tiranës deklarorin se largimi është e një rëndësie shumë të madhe dhe lidhet “*me mbrojtjen e pavarësisë së atdheut tonë*”⁴²². Në Bllokun Lindor ndodhi “*Pranvera e Pragës*” e cila u shtyp me forcën e armëve nga trupat e Traktatit të Varshavës të udhëhequra nga Sovjetikët, gusht 1968. Dalja e Shqipërisë nga Traktati i Varshavës ishte një nga aktet më të rëndësishme që udhëheqja politike dhe diplomacia shqiptare gjatë periudhës së Luftës së ftohtë. Ky hap ndikoi në ruajtjen e pavarësisë dhe tërësisë territoriale të Shqipërisë, në favor të paqes, sigurisë dhe stabilitetit Rajonal. Ky moment shënon pikën kulmore të diplomacisë së Enver Hoxhës gjatë sundimit të tij dyzetë e pesë vjeçar dhe moment ku elementët kombëtar dominuan ato ideologjikë.

Nxitur nga këto lëvizje liberale dhe nacionaliste në vendet socialiste Presidenti i BRSS Leonid Brezhneviti parashtroi doktrinën e tij “sovrانيتeti i kufizuar”. Doktrina e Brezhneviti synonte parandalimin e politikave sovraane të shteteve socialiste si dhe çdo tendencë liberale të shoqërive të tyre. Këto synime doktrina do i realizonte nëpërmjet forcimit të kontrollit të drejtpërdrejtë të Moskës mbi vendet socialiste si dhe imponimit të politikave sovjetike konservatore në shoqëritë e këtyre vendeve. “*Sovraniteti i çdo vendi socialist nuk mund t'i bjeri ndesh interesave të botës së socializmit, të lëvizjes revolucionare botërore*”⁴²³. Ndërhyrja e Moskës dhe Traktatit të Varshavës, ishte sinjal i qartë që doktrina e Brezhneviti nuk ishte vetëm ideologjike por edhe plan veprimi. Brenda kampit socialist, doktrina Brezhneviti ishte kthim prapa në krahasim me politikën liberale të Hrushoviti, sepse ishte për sovranitet të kufizuar dhe të kontrolluar nga Moska, por hap para sepse ishte për realizimin e detantes dhe heqjen dorë nga strategjia ofensive e Hrushoviti.

Në këtë mjedis të përkeqësuar gjeopolitik, regjimi komunist i Tiranës vendosi daljen në mënyrë të njëanshme nga Traktati i Varshavës (1968) dhe të demaskonte veprimet e tij në Çekoslovaki. Një veprim i tillë u shoqërua me prioritizimin e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës. Pakti shqiptaro-kinez ishte në interes reciprok në dy pika. Kina kishte nevojë për zgjerimin e mbështetjes ndërkombëtare me qëllim anëtarësimin në Kombet e Bashkuara për ti dhënë fund izolimit ndërkombëtar, ndërsa Shqipëria kishte nevojë për mbështetjen e gjithanshme të Kinës për përballimin e pasojave të prishjeve së marrëdhënieve me BRSS. Zhvendosja e politikës zyrtare të Tiranës drejt Pekinit ishte një sipërmarrje e vështirë, e kushtueshme dhe pa prespektivë historike. Në thelb ky prioritizim shpërfillte gjeopolitikën shqiptare. Kushtëzimet gjeopolitike qëndrojnë në themelin e profileve të politikave kombëtare e rajonale në tërë historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare.

⁴²¹ ASH e RPSSH & Insituti i Historisë, Historia e Shqipërisë IV, 8 Nëntori, Tiranë 1983, fq 382

⁴²² Hoxha E, “Superfuqitë”, Tiranë 1986, fq 220

⁴²³ Brezhnev L, “Historical Documents, Speech to Polish United Workers Congress”, November 1968

Ndërkohë në nivelet globale ndryshimet që ndodhin në Shtëpinë e Bardhë mbas vdekjes së Kenedit dhe në mënyrë të veçantë me ardhjen e presidentit Nikson do të sillnin një klimë e cila do shkonte drej “*detantës*” në marrëdhëniet midis dy blloqeve të Luftës së Ftohtë. Leadershipi amerikan mbajti me kujdes ekulibrin midis politikës së forcës dhe “*detantës*”, i dha një dimension të ri politikës së përmbajtjes duke marrë guximin e hapjes graduale të dy blloqeve ndaj njëri-tjetrit, realizoi fillimin e transformimeve të brendshme të sistemit sovjetik. “*Shoqëria sovjetike nuk është tanimë e izoluar nga influencat dhe tundimet e botës së jashtme dhe sa që mund të pengojë nevojën e kontakteve me jashtë*”⁴²⁴.

Politika e jashtme dhe diplomacia shqiptare gjatë *detantes* u dalluara nga vazhdimësia dhe risitë. Vazhdimësia lidhej me vijimin e politikave komuniste në planin e brendshëm, sidomos me reforma pro kineze në politikë, ekonomi, mbrojtje dhe kulturë. Në shkurt 1966, Enver Hoxha kishte kopjuar aleatin kinez dhe ndërrmori “*revolucionin kulturor shqiptar*” kopje e “*revolucionit kulturor kinez*”. Qëllimi ishte të luftoheshin të gjitha “*mendësitë e dëmshme të trashëguara nga e kaluara*” dhe vendosja e autoritetit të PPSH në të gjithë sferat e jetës.

Politika shqiptare u kinezërua tërësisht. PKK u paraqit si partia më e madhe dhe e vetme qëndër komuniste M-L në bote. Mao Ce Duni u shpall klasik i M-L. Në ekonomi u futën mallra, teknike e teknologji masive kineze në industrinë e lehtë dhe ushqimore, hidroenergjitikë, industrinë mekanike, elektrike, kimike, metalurgjike dhe ushtarake. Në ushtri u ndryshuan strukturat, u hoqën gradat, u ndryshuan uniformat, u fut teknike e armatim, pajisje e teknologji ushtarake kineze. Në shkurt 1967 u shpall faza e dytë e revolucionit në ideologji e kulture, u ndalua ushtrimi i fesë, u shkatërruan objektet e kultit dhe u shpall Shqipëria shtet ateist. Për demaskimet ndaj “*prijëve mikroborgjeze*” dhe moskryerjen e detyrave u përdor *fletërrufeja*, analoge e *dacibaos* kineze.

Fillimi i viteve 70, avancoi proceset politike ndërkombëtare. Hapi më i rëndësishëm ishte fillimi dhe kurorëzimi i Aktit Final të Helsinkit (1975), që do të shënonte të parin iniciativë kooperimi midis BRSS - Europës Perëndimore, SHBA dhe Kanadasë. Procesi i Helsinkit u shoqërua paralelisht me zbutjen e marrëdhënieve midis Kinës dhe SHBA dhe hapjen e dritës jeshile për largimin e Tajvanit nga OKB-ja, futjen e Kinës në OKB dhe në Këshillin e Sigurimit.

Këto dinamika ndërkombëtare brenda një periudhe shumë të shpejtë e bënë regjimin komuniste të Tiranës të ndërrmerrte veprime të shpejta dhe radikale në politikën e brendshme dhe të jashtme. Në politikën e brendshme sfida kryesore ishte parandalimi i ndikimeve, efekteve të Helsinkit mbi proceset e brendshme. Konkretisht, Tirana zyrtare parandaloi efektet e tre shportave kryesore të Helsinkit. Shportat përmbanin çështjet politike, ekonomike dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. Kongresi i 4-r PPSH (1-7 nëntor 1971) e në vazhdim pati një ashpërsim të dukshëm të luftës së klasave në fushën ideologjike, politike dhe ekonomike. Kjo luftë u zhvillua kundër “*veprimtarisë së egër të armiqve të jashtëm e të brendshëm, por edhe në gjirin e popullit kundër mbeturinave të ideologjisë, të zakoneve, të normave e të praktikave të huaja*”⁴²⁵.

⁴²⁴ Kissinger H, “Amerika’s Permanent Interests, U.S. Departments of State Bulletin, Vëll. LXXIV, nr.1919, 5 prill 1976, fq 427-428

⁴²⁵ ASH e RPSH & Insituti i Historisë, Historia e Shqipërisë IV, 8 Nëntori, Tiranë 1983, fq 402

Për parandalimin e shportës të lidhur me lirinë dhe të drejtat e njeriut regjimi i Tiranës ndërmori një valë goditjesh ideologjike në fushën e letërsisë dhe arteve, nën slloganin “*të luftojmë shfaqet e huaja dhe qëndrimet liberale ndaj tyre*”. Në Plenumin e 4-ër KQ të PPSH, 26-28 qershor 1973, u dënuan zyrtarë të lartë të sektorit ideologjik sekretari i KP së Tiranës Fadil Paçrami, Todi Lubonja si drejtor i radio-televizionit dhe shumë artistë dhe krijues. Këta eksponente në kundërshtim me vijën e PPSH, përpiqeshin të shuanin “*luftën e klasave dhe të përhapte një frymë të theksuar liberale moderniste në letërsi, art e kulturë*”⁴²⁶. Ky proces shënoi një kthim të konsiderueshëm prapa të krijmarisë letrare dhe artistrike, thelloi skematizmin e social-realizmit dhe të indoktrinimit të shkencës, letërsisë, arteve dhe kulturës.

Akoma më represive ishte parandalimi në shportën politike dhe të sigurisë. Plenumi 5-të KQ të PPSH, 25-26 korrik 1974, zbuloi “tezat teorike-ushtarake” në kundërshtim të plotë me vijën ushtarake të PPSH dhe tezat e Këshillit të Mbrojtjes për Artin Ushtarak Popullor. Represioni mbi strukturat e sigurisë goditi strukturat më të larta të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. U dënuan me vdekje Ministri i Mbrojtjes Beqir Balluku, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm Petrit Dume, Drejtori i Përgjithshëm Politik Hito Çako dhe një grup i madh gjeneralësh. Këta u akuzuan si rezivionues të tezave të Enver Hoxhës mbi Artin Ushtarak Popullor, si nostalgjik të Sistemit Sovjetik dhe Traktatit të Varshavës dhe si kundërshtues të reformave të sistemit të mbrojtjes nën ndikimin kinez. Enver Hoxha akuzoi ushtarakët e lartë se kishin kundërshtuar vendosjen e Komandave Ushtarake nën komandën e Partisë si dhe heqjen e sistemit hierarkik të gradave në ushtri.

Për përandalimin e efekteve të shportës në ekonomi, regjimi i Tiranës ndërmorri një valë represioni në të gjithë strukturat e larta ekonomike. Në shkurt të vitit 1975 u “*zbulua se në ekonomi vepronte një bandë armiqsh...*”⁴²⁷. Regjimi arrestoi dhe ekzekutoi eksponent të lartë si nën/kryeministri Abdyl Këllezi, Ministrin e Industrisë dhe Minierave Koço Theodhosi, Ministrin e Tregëtisë Kiço Ngjela dhe ndërshkoi grupe në sektorin e naftës, bujqësisë dhe sektorë të tjerë të ekonomisë. Këto zyrtarë të lartë të ekonomisë u akuzuan për tendenca liberale dhe vetëadministruese në ekonominë e brendshme dhe në bashkëpunimin ekonomik e ndërkombëtarë. Këta eksponentë “pengonin zhvillimin e ekonomisë socialiste,... përpiqeshin të fusnin në drejtimin dhe organizimin e ekonomisë forma e metoda të vetëadministrimit titist dhe të ekonomizmit kapitalist”. Plenumi 7-të KQ të PPSH, 26-29 maj 1975, përcaktoi masat për forcimin e mëtejshëm ekonomik të vendit dhe kujtoi se “*lufta e klasave zhvillohej më ashpër dhe e gërshetuar në fushën politike, ideologjike dhe ekonomike*”⁴²⁸.

Akti Final i Helsingit ishte fillimi i fundit të paralajmëruar të sistemit sobjetik dhe i triumfit të parashikuar të demokracisë perëndimore. Goditjet e ndërmarra në tre fushat kryesore, të cilat akti i Helsinkit i kishte parashikuar si strategji reformash të brendshme dhe ndërkombëtare u sanksionuan në nivelin më të lartë, në Kushtetutën e Re të RPSSH, dhjetor 1976. Në këtë kushtetutë regjimi i Tiranës sanksionoi rolin udhëheqës të partisë me diktaturën e proletariatit,

⁴²⁶ ASH e RPSSH & Insituti i Historisë, Historia e Shqipërisë IV, 8 Nëntori, Tiranë 1983, fq 407

⁴²⁷ Po aty, fq 411

⁴²⁸ Po aty, fq 412-413

parimin e mbështetjes në forcat e veta, zhvillimin konsekuent të luftës së klasave, ndalimin e çdo ndihme dhe kredie të huaj. Në planin ndërkombëtar, Kushtetuta e vitit 1976 sanksionoi doktrinën drejt vetëizolimit.

8.1. Shqipëria sponsorizuese e Kinës komuniste. Pragmatizmi dhe subjektivizmi ndërkombëtar i Kinës.

Hapi i parë më i rëndësishëm i Shqipërisë mbi mbështetjen ndërkombëtare u ndërmor nga sistemi i shërbimit të jashtëm, misioni në Neë York duke propozuar dhe bërë lobing në mbështetje të kandidaturës së RPK për anëtarësim në OKB. Propaganda dhe retorika shqiptare e ekzagjeronte peshën dhe rolin shqiptar në procesin e pranimit të kinës në OKB. Qëllimi përfitues politik del mjaft qartë në tërë historinë e marrëdhënieve të RPK me Kombet e Bashkuara. Kjo çështje nuk ishte çështje shtetesh individuale, sa kritere të papërmbushura, por *çështje e vendosjes raportit politik të forcave kontrolluese mbi Organizatën*. Pranimit do ti paraprinte shkrirja e akujve midis Ëashingtonit dhe Pekinit me vizitën e delegacionit amerikan dhe hapja e rrugës së “diplomacisë së ping-pongut”. Sponsorizimi dhe votimi i RPSH në favor të RPK, vjeshtë 1971, ngeli një nga gurët themelorë mbi të cilin do ngriheshin dhe zhvilloheshin marrëdhëniet miqësore dypalëshe shqiptaro-kineze në dekadën e viteve 70⁴²⁹.

Periudha 1971-1976, përkon me Kongresin 6-të PPSH dhe shënon fillimin e mospërputhjeve në marrëdhëniet ideologjike e politike shqiptaro-kineze. Krisja ishte e brendshme, konspirative dhe jo publike. Mospërputhjet lidheshin me lëvizjet kineze drejt hapjes me SHBA. Udhëheqja kineze ndihej e çuditur nga iniciativa e një partie tepër të vogël që jepte udhëzime për politikën e jashtme të një partie e një vendi gjigand. PPSH bënte analizë të frangmentuar, trajtesa ideologjike të pabazuara lidhur me politikën e re kineze ndaj SHBA. Kina me këtë lëvizje me vlera ndërkombëtare shpëtonte izolimin e saj ndërkombëtar. *“Nuk mund të mbështetesh në një imperializëm për të luftuar tjetrin...”*⁴³⁰. Udhëheqja politike shqiptare kontestoi qëndrimet e Kinës ndaj Tregut të Përbashkët Europian (TPE). Kina miratoi TPE dhe *“deklaroi se procesi i integritit evropian përbën një element esencial për të arritur një ulje të vërtetë të tensionit, ...ky proces të mos kufizohet në sektorin ekonomik, por të prekë edhe fushat e politikës dhe të mbrojtjes”*⁴³¹. PPSH kontestoi tendencën e politikës kineze mbi “Botën e Tretë”. Rritja e interesimit botëror drejt Kinës komuniste e bënte domosdoshmëri ndërtimin e një strategjie të re globale nga Kina. PPSH ishte e dështuar sepse nuk do duhej të ishte Kina që të ndiqte Shqipërinë në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare, por Shqipëria duhej të ndiqte Kinën nëse donte të ruante benefitet e marrëdhënieve me të. Arsyeimi i Enver Hoxhës ishte *“...do të thotë t’u largosh vëmendjen popujve nga lufta e vërtetë revolucionare”*⁴³². Ky konkluzion nga Enver Hoxha ishte alogjik dhe mjeran dhe krijonte reflekse po aq alogjike dhe mjerane për fatet e Shqipërisë.

⁴²⁹ Bashkurti L: “Diplomacia shqiptare – vëllimi III-të”, Geer, Tiranë 2004, ISBN:99927-989-4-7, fq 365-374

⁴³⁰ Historia e PPSH, Botimi i II-të, viti 1981, fq 476

⁴³¹ Çu En Lai, (Enver Hoxha, “Superfuqitë”, 1986:321-329)

⁴³² Enver Hoxha, “Superfuqitë”, viti 1986, fq 331-332

8.2. Lëvizjet e Kinës drejt Jugosllavisë dhe Rumanisë. Rënia e interesit për Shqipërinë.

Reflektimet e brendshme të udhëheqjes politike shqiptare lidhur me karakterin strategjik në mesin e viteve 70' ndikuan në pragmatizmin e politikës shqiptare dhe bashkëpunimin me Kinën. Pragmatizimi shqiptar u përqëndrua në dy fusha emergjente; në zhvillimin ekonomik dhe në fuqizimin e sigurisë dhe të mbrojtjes. Strategjia ekonomike e zhvillimit të Shqipërisë u parashtrua në Kongresin e VI-të duke ju përmbajtur me ekzigjencë synimit strategjik ndërtimit të industrisë së rëndë dhe konsiderimin si dytësore bujqësinë, industrinë e lehtë dhe atë ushqimore. Ky invest në doktrinën e Enver Hoxhës synonte imponimin e ekonomisë politike mbi politikat ekonomike. Doktrina ekonomike nuk kishte kaluar pa kundërshtarë të brendshëm, por u eliminuan “elementët armiqësorë në ekonomi”. Programi “reformues ekonomik shqiptar” ju paraqit palës kineze, kryeministrit kinez Çu En Lai dhe ekspertëve të ekonomisë kineze. Pala kineze sygjeroi të investohej më pranë realiteteve dhe nevojave ekonomike të Shqipërisë dhe popullit shqiptar si dhe tregjeve rajonale ku bashkëpunonte ekonomia shqiptare. Enver Hoxha in sistonte për kombinat metalurgjik duke e cilësuar si rruga për “çlirimin e dytë të Shqipërisë” e cila në fakt ishte akti për varrosjen e ekonomisë shqiptare⁴³³. Mao Ce Duni, pas hezitimesh, i hapi dritë jeshile platformës ekonomike të Enver Hoxhës, ndërsa si paradoks lidhshipi politik shqiptar nuk tregojë mirënjohës por do të fajësonte palën kineze për dështimet e saj të brendshme. Enver Hoxha po përpiquej të përfitonte për vete mbi sukseset e të tjerëve si dhe delegimi i dështimeve tek të tjerët. Enver Hoxha në rrafshin politik ishte diktator si gjithë të tjerët, ndërsa në politikat ekonomike ishte një mediokër i paprecedent. Në dimensionin e sigurisë dhe atë ushtarak bashkëpunimi shqiptaro-kinez ishte shumë më delikat sesa bashkëpunimi ekonomik. Në kontekstin europian, Ballkani përjetonte një strukturë 2+2+2, Turqia e Greqia në NATO, Bullgaria e Rumania në Traktatin e Varshavës ndërsa Jugosllavia e Shqipëria jashtë dy blloqeve. Ky neutralitet ishte nën vëmendjen e blloqeve të cilat nuk do të toleronin futjen në këtë sonë tappone të ndonjë fuqie tjetër. Doktrina ushtarake e Enver Hoxhës kishte ndikime nga ushtria Kineze, nga strukturat, rregullat dhe uniformat e saj. Kundërshtimi sakrifikoi figura të larta të ushtrisë.

Vështruar dokumentat e periudhës 1971-1975 të bëra publike në atë kohë, vërehet që marrëdhëniet shqiptaro-kineze ishin në kulmin e lulëzimit të tyre në planin ideologjik, politik, ekonomik, ushtarak e në fusha të tjera. Dyshimi dhe skepticizmi ishin të një natyre krejt konspirative dhe të përjashtuara nga dokumentat zyrtare. Referuar edhe dokumentave të publikuara më vonë tregohet se këto marrëdhënie nuk kanë qënë të shkëlqyera dhe efçente. Indeksi i të dhënave mbi marrëdhëniet ekonomike dhe ushtarake është problematikë. Pala kineze nga vitet 1971-1975 kishte patur më shumë retorikë sesa ndihma e bashkëpunim konkret ekonomik-tregtar midis Shqipërisë dhe Kinës, ndërkohë që flitej për rritje e zgjerim të këtij bashkëpunimi. Ky deficit tregtar i Kinës ndaj Shqipërisë konsiderohet shkelje e njëanshme e kontratave tregtare midis dy vendeve dhe me dëme të mëdha në ekonominë shqiptare në atë periudhë. Pala shqiptare kishte pasë bërë investimet e konsiderueshme për realizimin e këtyre

⁴³³ Bashkurti L: “Diplomacia e Vetëizolimit, Rasti i Shqipërisë 1961 – 1989”, Geer, Tiranë 2004, ISBN:99927-989-4-7, fq 403

projekteve kineze në vend⁴³⁴. Praktika dhe eksperiencia e marrëdhënieve midis vendeve socialiste deri vitet 1961 fliste për elementë solidariteti, kredi të buta, falje ose lehtësira në dhënien e tyre. *“...kreditë dhe ndihmat nga Kina nuk jepeshin në frymën e internacionalizmit proletar, siç kishin kujtuar PPSH dhe populli shqiptar...”*⁴³⁵.

Faktorët që ndikuan më së shumti në ftohjen graduale midis Shqipërisë dhe Kinës lidhen edhe me ndryshimet që ndërromori Kina në marrëdhënie ndërkombëtare. Lëvizje politiko-diplomatike të Kinës gjatë viteve 70' tërhoqën seriozisht vëmendjen e politikës së jashtme të Shqipërisë. Së pari, modulimi shumë oportunist i politikës së Kinës kundrejt BRSS me ardhjen e Brezhnjev. Këtë oportunitet tipik kinez udhëheqja shqiptare, e cila shquhej për dogmatizëm, nuk do ta përtypete. Së dyti, afrimi i Kinës me SHBA, vizita e Kissingerit në Pekin, takimi i Niksonit me udhëheqjen Kineze solli shqetësime serioze në politikën e Tiranës. Afrimi i Pekinit me Uashingtonin ngushtonte bashkëpunimin e Tiranës me Pekinin. Së treti, pranimi i Republikës Popullore të Kinës në Kombet e Bashkuara dhe në Këshillin e Sigurimit, ulte tërësisht rëndësinë e fushatës sponsorizuese të Shqipërisë në OKB. Së katërti, afrimi i Josif Bros Titos me Mao Ce Dunin e zhvendosi gradualisht prioritetin ballkanik drejt Jugosllavisë. Udhëheqja kineze po ecte në linjën e Moskës në politikën me Jugosllavinë. Për Enver Hoxhën qëndrimi ndaj Jugosllavisë dhe Titos ishte “gurë prove” e “vijë demarkacioni midit tyre” për marksistët-leninistët e vërtetë. *Në mënyrë demonstrative ata zgjeruan dhe forcuan marrëdhëniet shtetërore dhe partiake me Jugosllavinë, ...ftuan e pritën me nderime e bujë të jashtëzakonshme revizionistin Tito në kinë, duke e cilësuar atë “një udhëheqës të madh marksistë-leninistë”, kurse partinë komuniste jugosllave “një parti marksiste-leniniste”*⁴³⁶. Shqipëria dhe Enver Hoxha me këtë lëvizje dret Jugosllavisë mendonte duheshin bërë konsultime paraprake politiko-diplomatike shqiptaro-kineze. Me afrimin drejt Jugosllavisë dhe rehabilitimin e Titos si “një udhëheqës të madh marksistë-leninistë”, Enver Hoxha filloi të parandjejë reduktimin drastik të marrëdhënieve Shqipëri-Kinë. Së pesti, mbivlerësimi kinez ndaj Rumanisë, një shtet i mesëm dhe që ofronte mundësira të mëdha bashkëpunimi. Politikat e Nikolae Çauçeskut në Rumani filluan të prioritetizojnë bashkëpunimin ekonomik-tregtar midis Bukureshtit dhe Pekinin. Prioritetet kineze vendosën në plan të parë Rumaninë, në plan të dytë Jugosllavinë dhe Shqipëria kaloi në plan të tretë në interes të Kinës drejt Ballkanit dhe Europës Juglindore. Prioritizimi i padeklaruar kinez por i realizuar praktikisht nuk u prit mirë nga pala shqiptare por nuk solli reagimin e kësaj pale. Palës shqiptare dhe Enver Hoxhës i mungonte realizimi në gjykimin e peshës dhe rolit të Shqipërisë krahasuar me Rumaninë dhe Jugosllavinë në politikën e fuqisë madhore kineze.

8.3. Konfliktet shqiptaro – kineze, shkaqet dhe pasojat.

Vështruar në distancë kohore dhe bazuar në dokumenta të shumta mund të arrijmë në konkluzion me realist dhe më pranë të vërtetës mbi shkaqet e prishjes së marrëdhënieveshqiptaro-kineze. Marrëdhëniet ekonomik-ushtarake midis Shqipërisë dhe Kinës

⁴³⁴ Bashkurti L: “Diplomacia shqiptare – vëllimi III-të”, Geer, Tiranë 2004, ISBN:99927-989-4-7, fq 464-467

⁴³⁵ Historia e PPSH, Botimi i II-të, Tiranë 1981, fq 555

⁴³⁶ Historia e PPSH, Botimi i II-të, Tiranë 1981, fq 550

nuk ishin teknike, siç i paraqiste pala kineze, por as politiko-ideologjike, siç i paraqiste pala shqiptare. Shkaqet janë sa politiko-ideologjike, po aq edhe tekniko-ekonomike. Shkaqet politike e ideologjike përveç lëvizjeve të politikës së jashtme kineze lidhej edhe daljen në skenë të “*Mao-Ce Dun Idesë*”. Kjo ishte një doktrinë ideologjike e hegjemonizmit kinez, me të cilin Enver Hoxha nuk pajtohej dhe e stigmatizoi si një amalgamë pikpamjesh nga Konfuci e Menci, te revizionizmi modern e deri te elkektizmi, oportunizmi dhe pragmatizmi kinez i kohës⁴³⁷. Përfundimi i Kongresit VII-të PPSH dhe miratimi i Kushtetutës 1976, ngurtësuan hapësirat e mundshme të bashkëpunimit politik, diplomatik, ekonomik dhe strategjik midis PPSH dhe RPK. Vdekja e Mao Ce Dunit, viti 1976, i hapi rrugën ardhjes në pushtet të reformatorit Ten Sia Pin. Ten Sia Pin lançoi politikat e “*katër modernizimeve*” brenda Kinës dhe pacifizimin e marrëdhënieve të Kinës me BRSS dhe Perëndimin⁴³⁸. Enver Hoxha dhe qeveria e Tiranës reagues negativisht ndaj nismës së re kineze, ndërsa udhëheqja e re kineze nuk e toleroi më tutje qëndrimin dogmatik ideologjikisht dhe pa vision politik të udhëheqjes së Tiranës.

Në vitet 1977-1978 ndihmat ekonomike dhe strategjike kineze në drejtim të Shqipërisë u reduktuar në mënyrë drastike. Udhëheqja kineze dukej e vendosur për të mos financuar më tutje projektet e bashkëpunimit ekonomik, tregtar dhe strategjik me Shqipërinë. Mbas shumë korespondencash e takime diplomatike në Tiranë e Pekin për të përafuar vizionet ekonomike dhe strategjike dhe gjetjen alternativë bashkëpunimi midis RPSH dhe RPK, niveli i bashkëpunimit bilateral erdhi drejt reduktimit maksimal në gjashtë mujorin e parë të vitit 1978.

Shkaqet tekniko-ekonomike qëndronin në debatin e hershëm dhe në mospërputhjet e strategjive për zhvillimin ekonomik dhe atë ushtarak midis palëve. Kinezët në negociatat e zyrtarëve të lartë ku përfshiheshin Kryeministrat Mehmet Shehu dhe Cu En Lai dhe ministrat përkatës, patën mospërputhje për prioritetet e Shqipërisë mbi industrinë e rëndë, ku pala kineze nuk e mbështeste ose e mbështeti me vështirësi dhe pjesërisht⁴³⁹.

Mbi strategjitë ushtarake, pala kineze nuk ishte që Shqipëria të ndërtonte konceptin strategjik të mbrojtjes e luftës frontale, por të luftës partizane. Këto ndryshime ishin në themelin e kontradiktave, sepse nga pranimi ose jo i tyre vareshin edhe sasia dhe drejtimi i ndihmave e kredive ekonomike e ushtarake të Kinës për Shqipërinë. Përplasja midis dy strategjive të zhvillimit ekonomik-ushtarak ishte esenciale në konfliktin shqiptaro-kinez. Ajo lidhej me ndryshime vizionesh të të dy udhëheqjeve, dhe pasohej me ndryshime të mëdha investimesh e teknologjishë, të cilat pala kineze u quante joproduktive dhe të rrezikshme për mos shlyerjen e ardhshme të kredive⁴⁴⁰.

Në rrafshin strategjik bashkëpunimi u komplikua akoma më shumë. Udhëheqja politike dhe qeveria e Tiranës rritën insistimin për importe industrial-ushtarake dhe të kapaciteteve strategjike të Shqipërisë nga Kina. Këto kërkesa strategjike në rritje ndeshën në kundërshtime të dukshme të udhëheqjes politike dhe qeverisë kineze. Për qeverinë e Tiranës po krijohej mendimi që RPK po hiqte dorë gradualisht nga bashkëpunimi ekonomik, tregtar dhe ushtarak me Shqipërinë.

⁴³⁷ Bashkurti L: “Diplomacia e Vetëizolimit, Rasti i Shqipërisë 1961–1989”, Geer, 2004, ISBN:99927-989-4-7, fq 477-483

⁴³⁸ Bashkurti L: “Diplomacia shqiptare – vëllimi III-të”, Geer, Tiranë 2004, ISBN:99927-989-4-7, fq 483

⁴³⁹ Bashkurti L: “Diplomacia e Vetëizolimit, Rasti i Shqipërisë 1961–1989”, Geer, 2004, ISBN:99927-989-4-7, fq 464-467

⁴⁴⁰ Bashkurti L: “Diplomacia shqiptare – vëllimi III-të”, Geer, Tiranë 2004, ISBN:99927-989-4-7, fq 484-487

Sipas dokumentave të periudhës 1970-1975, bëra publike mbas viteve '90-të rezulton se marrëdhëniet e vërteta shqiptaro-kineze asnjëherë nuk kanë qënë ashtu siç paraqiteshin formalisht, publikisht dhe mediatikisht. Këto realitete të nëndheshme prapa fasadës politike e ideologjike, prapa propogandës analizohen në dy fusha: në ekonomi dhe në ushtri.

Dokumentat e publikuara më vonë na bëjnë me dije se ka patur një indeks problematik në *marrëdhëniet ekonomike kino-shqiptare*. Sipas tyre, pala kineze nga vitet 1971-1975 ka patur më shumë retorikë sesa ndihmë e bashkepunim ekonomik real. Në vitet 1971-75 grafiku i këmbimeve tregëtare midis dy vendeve ka ardhur duke rënë vazhdimisht, në një kohë kur propaganda dhe dokumentat publike thonin të kundërtën.

Në *tregëti* në bazë të dokumentave rezulton se në vitin 1975 Kina nuk realizoi detyrimet totale tregëtare prej 40 milione jenësh, në një kohë kur Shqipëria i kishte realizur detyrimet e saj kontraktuale 100%. Ky defičit kinez, ishte shkelje e njëanshme e kontratës dhe me dëme të mëdha për ekonominë shqiptare.

Në fillim të viteve 70-të *investimet* kineze përfshinin 35 objekte të projektuara e kontraktuara midis palëve. Nga 1971-1976 u realizuan vetem 15 prej këtyre objekteve. Pala kineze e transferoi këtë fond investimesh në vitin 1976-1981, por nuk u realizua praktikisht. Në periudhën 1975-1976 midis palëve u bënë negociata për financimet e nevojshme mbi pesëvjecarin e II-të të viteve 70-të, ndërsa praktikisht Kina akordoi de facto vetem 25% të vlerës së kreditimeve.

Ne aspektin *ushtarak* vetëm në periudhë dy-tre vjeçare mbas daljes nga Traktati i Vrashavës, Shqipërisë ju dha mbështetje, ndërsa nga gjysma e viteve 70' ndihma ushtarake erdhi duke u reduktuar. Dokumentacioni kontabel rezulton se për pesëvjecarin e II-të, Kina përfshiu ndihmën ushtarake ndaj Shqipërisë brenda 25% të kreditimeve të përgjithshme. Përfshirja e ndihmës ushtarake në paketën e reduktuar ekonomike, ishte reduktim drastik i ndihmës ushtarake për Shqipërinë. Ishte mesi i Luftës së Ftohtë, mbas largimit të Shqipërisë nga Traktati i Varshavës dhe mbas lobingut shqipëtar në OKB për futjen e Kinës.

Në *politikën e jashtme* lëvizjet kineze tërhoqën vëmendjen e Shqipërisë dhe patën impakte direkte në prishjen e marrëdhënieve shqiptaro-kineze. *Modulimi mjaft elastik kundrejt BS*, deri tek *ndërmjetësimi mbi ri-normalizimin e marrëdhënieve Shqiptaro-Sovjetike*. Normalizimi i marrëdhënieve Kino-Amerikane përbënte lëvizjen më të paparashikueshme nga pala shqiptare. KQ i PPSH qortonte Kinën, ndërsa diplomacia e ping-pongut kishte nisur bisedimet e niveleve më të larta SHBA-Kinë.

Përballë kësaj shtate dëshpëruese e pa shpresa ndryshimi në korrik 1978, udhëheqja politike dhe qeveria e Tiranës i dërgoi notë zyrtare qeverisë së RPK për ndërprerjen e bashkëpunimit ekonomik e strategjik. Kjo notë ishte në përgjigje të komunikimit zyrtar të Pekinit për ndryshimet radikale e të gjitha projekteve të bashkëpunimit dypalësh ekonomik, tregtar, industrial dhe strategjik me Shqipërinë. Argumentat kineze ishin të karakterit teknik dhe nuk cënoheshin marrëdhëniet diplomatike dypalëshe. Notat diplomatike u shkëmbyen brenda korrik 1978.

Periudha mbas viteve 1978-1981 shoqërohet me ndryshime serioze në politika ekonomike dhe strategjike të Shqipërisë. Eshtë koha kur përgatitej **Kongresi 8-të PPSH**, nëntor 1981. Në

Kongres u bë analizë e thellë por tërësisht e indokrinuar e situatës së brendshme dhe bashkëpunimit ndërkombëtar të Shqipërisë me Kinën. Ndërkohë në Ballkan pati ndryshime të dukshme, Greqia u pranua në Komunitetin Ekonomik Europian, ndërsa në Jugosllavi vdekja e Josif Bros Titos në 1980 u pasua me demonstrata të mëdha studentore në Prishtinë, viti 1981. Në këtë moment Tirana zyrtare e udhëhequr nga Enver Hoxha po përdorte vetëm për propogandë kauzën kombëtare shqiptare për të mobilizuar resurset e fundit, kartën e nacionalizmit shqiptar.

Kongresi i 8-të PPSH është moment rrëshqitje e doktrinës së socializmit e internacionalizmit të Enver Hoxhës drejt socializmit nacional. Social-nacionalizmi i Enver Hoxhës reflektonte në thelb kalimin e vendit në vetëizolim politik e diplomatik ndërkombëtar dhe në autarki të plotë, mbyllje ekonomike. Mbas shterimit të të gjitha resurseve ekonomike, teknike, teknologjike, strategjike të brendshme dhe ndërkombëtare, Tiranës zyrtare nuk i ngelej gjë tjetër veç socializmit nacional. Në shërbim të saj u inskenua grupi armiqësor më i lartë në historinë e regjimit komunist. Ky ishte grupi i kryeministrit Mehmet Shehu dhe bashkëpunëtorëve të tij Kadri Hazbiu dhe Feçorr Shehu. Ishte fshesa e fundit e hekurt që regjimi i Enver Hoxhës ndërrmori ndaj bashkëlufetarëve dhe bashkëpunëtorëve të tij të ngushtë.

Eliminimi i grupit më të lartë me kryeministrin Mehmet Shehu dhe Kadri Hazbiu i shërbeu dy qëllimeve njëherësh të diktatorit Enver Hoxha; së pari i shërbeu arsytimit të të gjitha dështimeve ekonomike dhe strategjike të Shqipërisë për shumë vite, së dyti i hapi rrugën për lidhshimin e ardhshëm të Enver Hoxhës trashëgues të tij, Ramiz Alia. Pak përpara se të ndërronte jetë Enver Hoxha vendosi në postin e Presidentit të Kuvendit Popullor Ramiz Alinë. Ardhja e Ramiz Alisë dha sinjale vazhdimësie të politikës së Enver Hoxhës në rrafshin e brendshëm dhe ndërkombëtar. Në vitin 1985, Enver Hoxha ndërroi jetë, vdekja e tij në vitet në vijim u pasua me stanjacion të plotë në zhvillimet e brendshme dhe vijimin e politikës izolacionaliste në planin ndërkombëtar.

8.3.1. Rënia ekonomike e Shqipërisë dhe ashpërsimi i luftës së klasave.

Prishja e marrëdhënieve me Kinën e kishte ekspozuar Shqipërinë ndaj rreziqeve që paraqiste faza e fundit e Luftës së Ftohtë. Vendi nuk mbështetej ekonomikisht, politikisht e ideologjikisht nga asnjë fuqi e madhe apo e mesme komuniste. Vendi po kalonte në një autarki të plotë. Mbyllja në vetëvete, mbështetja vetëm në resurset e brendshme po e bënte udhëheqjen shqiptare të përpunonte strategjinë e vet të vetëizolimit. Kjo strategji u paraqit Kongresit të 8-të PPSH, i cili mund të konsiderohet testamenti politik i diktatorit Hoxha.

Enver Hoxha theksonte perspektivën shqiptare nën udhëheqjen komuniste; *“Ky është plani i parë që do të realizohet duke u mbështetur plotësisht në forcat dhe mundësitë tona. Shqipëria është sot i vetmi vend në botë që zhvillohet dhe ecën përpara në rrugën e socializmit pa asnjë ndihmë e kredi nga jashtë”*⁴⁴¹.

Vizioni dhe koncepti i Enver Hoxhës pasqyrohej në strategjinë e ardhshme të Shqipërisë. **Ne fushen ekonomike ishin** ligjet themelore ekonomike socialiste dhe të centralizmit të ekonomisë dhe planifikimit shtetërorë. U miratuan edhe dy ligje të tjera për situatën autarkiste: ligji për

⁴⁴¹ Hoxha E, Raport në Kongresin e 8-të të PPSH, Tiranë 1981, fq 15

mbështetjen plotësisht në forcat e veta dhe ligji për kursimin. Parashikoheshin prioritete ekonomike si zhvillimi i ekonomisë së rëndë dhe minierave, industrisë së lehtë dhe konsumit, bujqësisë. Për infrastrukturën dhe turizmin e vendit nuk parashikohej asnjë investim. Infrastruktura dhe turizmi do ngeleshin krejtësisht të harruara në projektet ekonomike të Enver Hoxhës. Këto mangësi buronin nga doktrina e tij autarkiste.

Siguria dhe mbrojtja u prioritzuan në strategjinë e Kongresit të 8-të PPSH, në testamentin e Hoxhës. Ndërprerja e bashkëpunimit ushtarak me Kinën e bënte regjimin e Tiranës të përballonte vetë gjithë investimet në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes së vendit. Shqipëria e viteve 80' nuk kishte asnjë vend mik, aleat, partner që të mund t'i ankorohet për bashkëpunim ushtarak. Ajo jo vetëm ishte jashtë blloqeve ushtarake, por edhe i kishte shpallur lufte ideologjike atyre. Testamenti i Enver Hoxhës e shpalle mbrojtjen e Atdheut “detyrë mbi detyrat”. Kjo e prioritzonte atë në investime dhe shpenzime në kurriz të ekonomisë së vendit dhe tepër të rrënuar nga vetëizolimi. Investimet u zhvendosën kryesisht në fushën e fortifikimit të vendit. Qindra mijra bunkere, transhe, hendek-lidhje rrethuan me beton-arme gjithë Shqipërinë. Kjo ishte goditje fatale në ekonominë e izoluar shqiptare.

Politika e jashtme dhe zhvillimet ndërkombëtare ishin dhe mbetën fusha më për zemër e teorisë dhe praktikës së Enver Hoxhës. Ai la mbrapa një korpus me mijra faqe lidhur me zhvillimet ndërkombëtare, me politikën e jashtme të Shqipërisë, me fqinjët, Rajonin, Evropën, Fuqitë e Mëdha, me gjithë hapsirat globale. Sidomos gjate viteve 80', Hoxha jetonte më shumë me zhvillimet ndërkombëtare sesa ato të brendshme. Lidhja e Enver Hoxhës me zhvillimet ndërkombëtare arsyetohej; Së pari, me një angazhim mbi çështjet ndërkombëtare Enver Hoxha ushqente politikën, ideologjinë dhe gjithë makinerinë propogandistike të vendit përballë vetëizolimit. Së dyti, Hoxha donte të ngrinte akoma më lartë kultin e tij brenda partisë dhe vendit. Enver Hoxha sikundër klasikët e marksizmit, shkruante për botën, revolucionin, çlirimin e popujve dhe aspekte ekonomike e sigurie globale. Kjo i shërbente shumë kultit të tij. Se treti, me zhvendosje të vëmendjes drejt botës e zhvillimeve të jashtme, Hoxha synonte që të arsyetonte orientimet e tij, strategjinë vetëizoluese dhe gjithë problemet e brendshme, dështimet, rënien ekonomike dhe prioritzimet absurde ekonomike e ushtarake të vendit.

Marrëdhëniet me Jugosllavinë ngelën të ngrira në planin politikë, ideologjik gjate regjimit të Hoxhës. Kjo situatë buronte nga ndryshimet e sistemeve të ndjekura nga Hoxha dhe Tito dhe nga ekzistenca e shqiptarëve në Jugosllavi dhe problemeve të shumta me të cilat ato ballafaqoheshin here pas here.

Vdekja e Titos solli një situatë përkeqësimi për shqiptarët në Jugosllavi. Në Kushtetutën e vitit 1974, Kosova ishte Krahinë Autonome brenda Serbisë por element konstituiv përfaqësues në Federatë. Vdekja e Titos ekspozoi nacionalizmat dhe prodhoi kriza të vazhdueshme deri në shpërthimin e konfliktit të viteve 90'-të. Në pranverën e vitit 1981 në Kosovë filluan lëvizje politike e shoqërore, për më shumë liri e të drejta kombëtare. Platforma politike shkante të kërkesa “Kosova Republikë” brenda federatës. Lëvizja u shtyp me ushtri e tanke të armatës Jugosllave. Kosova u shoqërua me emigracion masiv dhe burgje me të dënuar politik.

Politika e jashtme e Shqipëria reagoi në mënyrë aktive. Ajo mbështeti kërkesën “Kosova Republikë” dhe dënoi përdorimin e dhunës mbi popullsinë e Kosovës. Për herë të parë në Kongresin 8-të PPSH, Enver Hoxha përcakton saktë dhe drejtë se: *“Shqiptarët në Jugosllavi përbëjnë një etni, një popull të formuar në shekuj, që ka historinë, gjuhën, kulturën e vet, një popull autokton”*⁴⁴². Enver Hoxha analizon historinë e shkëputjes së Kosovës marrëdhëniet e tij me Titon mbi çështjen e Kosovës. Ai u ndal në vendimet Bujanit (dhjetor 1943 - janar 1944, ku u sanksionua e drejta e popullit të Kosovës përvetevendosje), te vendimet e Jajtës (shkurt 1945, që ishin të kundërta me ato të Bujanit), te takimi i Enver Hoxha-Tito (Beograd 1946, ku Hoxha kërkoi bashkimin Shqipëri-Kosovë, ndërsa Tito e pamundësoi me arsyetimin se nuk do ta pranonin serbët për momentin)⁴⁴³. Enver Hoxha konkludonte se; *“Kërkesa për t’i njohur Kosovës statusin e Republikës brenda Federatës është një kërkesë e drejtë, ajo nuk çënon ekzistencën e Federatës”*⁴⁴⁴. Hoxha nuk ishte për pavarësinë e Kosovës dhe bashkimin me Shqipërinë (Beograd 1946), por statusin e Republikës së Kosovës brenda Federatës Jugosllave. Hoxha nxiti shqiptarët në kërkesat e tyre, por shmangu konfrontimin mbi ndryshimin e kufijve shtetërore të Evropës së kohës.

Një vit pas pas vdekjes së diktatorit Enver Hoxha, u mbajt **Kongresi 9-të PPSH**. Ky Kongres u definua si Kongresi i vazhdimësisë. Dhe në fakt i tillë ishte në të gjitha aspektet. Në raportin e tij Ramiz Alia mbrojti pa ekuivok parimet e sanksionuara në Kushtetutën e vitit 1976. Ramiz Alia përformoi si dishepulli besnik i E Hoxhës, mbrojtës dhe zhvillues i trashëgimisë së tij për elementët, grupet dhe kategoritë e shoqërisë shqiptare, të cilët prisnin ndryshime pas vdekjes së Enver Hoxhës. Kongresi 9-të PPSH ishte një zhgënjim i madh. Ndërsa për faktorët ndërkombëtar të interesuar për Shqipërinë, Kongresi 9-të PPSH u shoqërua me iluzione mjaft kontraditore.

Tre ishin sfidat në të cilat do ballafaqohej Ramiz Alia gjatë qeverisjes së tij, varfëria, diktatura dhe izolimi. Alia ngeli në thelb komunist, mbështeti më së shumti platformën e Enver Hoxhës dhe u përpoq që të çmonte e të lartësonte pas vdekjes veprën e tij. Alia nuk ishte njësoj si Hoxha, por një komunist më liberal, më i hapur ndaj botës, me fleksibël për reforma dhe më i pranueshëm nga shumë faktorë të brendshëm e të jashtëm. Nga fundi i karrieres së tij, Alia u përpoq të ndiqte linjën e Gorbaçovit, për një reformim të shoqërisë, të politikave të brendshme e të jashtme, por pa ndryshuar thelbin komunist të modelit dhe filozofinë e tij. Alia ishte me liberal se Hoxha, por me fanatik se Gorbaçovi. Ramiz Alia arriti të menaxhonte rënien e komunizmit dhe fitoren e demokracisë në fillim të viteve 90’. Koha tregoi se aspirata e Ramiz Alisë ishte kalimi i butë i sistemit komunist në atë demokratik, pa dhunë, pa konfrontin e pa gjakderdhje. Kjo ishte kurora e ullirit që i vuri vetes pozitivisht Alia.

8.3.2. Vetë-izolimi i plotë i vendit.

Doktrina shqiptare e vetëizolimit mbështetej në traditën izolacioniste të njohur ndërkombëtare, por të aplikuar në kushtet e veçanta të Shqipërisë, të sistemit të dy polarizuar të

⁴⁴² Hoxha E, Raport në Kongresin e 8-të të PPSH, Tiranë 1981, fq 193

⁴⁴³ Po aty, fq 197

⁴⁴⁴ Po aty, fq 202

Luftës së Ftohtë dhe të rrethanave gjeopolitike të Shqipërisë. Sipas studiuesit amerikan K.J.Holsti doktrina tradicionale e vetëizolimit shpjegohet në tre fazat e izolimit të plotë; neutralitetin, mbështetjen në forcat e veta dhe vetëizolim⁴⁴⁵. Te tre përcaktimet e Holstist qëndrojnë në parim në rastin shqipëtar, ndërsa praktikisht ka pamje, thellësi, dimensione e pasoja mjaft specifike për Shqipërinë.

Duke analizuar *netralitetin*, analizohen raste shtetesh analoge. Në gjithë këto raste netraliteti shpreh mosangazhim, qëndrim jashtë blloqeve e aleancave ndërkombëtare, mos përdorim të vendit nga palë në konflikt dhe mos kërcënim të askujt nga territori i dhënë. Neutraliteti nuk pajtohet me lidhje, angazhim të pjeshëm, të njëashëm apo të përkohshëm.

Analiza e *mbështetjes në forcat e veta* fokusohet tek realiteti amerikan në fillim të shekullit 20-të dhe Kinës komuniste të viteve 60'. Mbështetja në forcat e veta është bazimin e zhvillimit kryesisht ose tërësisht në resurset dhe kapacitetet e brendshme, pa lidhje me ndihma e mbështetje ekonomike ushtarake apo të fushave të ndryshme nga jashtë.

Vetëizolimi analizohet në rastet e japoneze, amerikane dhe të Burmas gjatë Luftës së Ftohtë. Te tre shkallët e izolimit, neutralitetit, mbështetjes në forcat e veta dhe vetëizolimi u përjetuan në Shqipëri nga vitet 70' deri në fund të viteve 80'. Vendi kaloi në *neutralitet* (1961-1975), mos angazhimi, qëndrimi dhe mospërdorim i Shqipërisë nga asnjë lloj pale në konflikt dhe qëllime të njenashme, të *mbështetjes në forcat e veta* mbas Kushtetures së 1976 (1976-1981), të bazimit të zhvillimit në resurset e brendshme, pa ndihma e kredi nga jashtë dhe pa kurrëfarë mbështetje në asnjë fushë, vetëizolimi (1981-1989) që shënoi shkallën më të lartë të mbylljes së plotë të vendit nga bota, të nivelit më të ulët të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërkombëtarë. Kjo situatë vetëizolimi e gjeti Shqipërinë në kohën kur Evropa u përfshi në proceset demokratike mbas rënies së Murit të Berlinit.

8.4. Konkluzione!

Profili politik i *Enver Hoxhës* ka një bazë historike në të cilën ka elementë që ngelen të qëndrueshëm, sikundër ka elementë që evoluojnë. Qysh në gjenezën e krijimit të Partisë Komuniste Shqiptare dhe më pas të Frontit Nacional-Çlirimtar dhe të Ushtrisë së saj, Partia Komuniste e Shqipërisë e bashkëthemeluar dhe bashkëdrejtuar nga Enver Hoxha dhe këshilltarët politik të Partisë Komuniste Jugosllave, Dushan Mugosha dhe Miladin Popovici, hodhën bazat politike si dhe platformën e pushtetit të ardhshëm në Shqipëri.

Momentet në të cilat kaloi procesi politik në Shqipëri, përcaktoi profilin ideologjik marksist-leninist të PKSH (1941), tentativën për kompromis kombëtar në luftë ndaj pushtuesëve fashistë në Konferencën e Pezës (1942), prishjen e kompromisit të Pezës dhe fillimin e luftës politike dhe civile në Konferencën e Mukjes (1943), hedhjen e bazave të pushtetit të ardhshëm politik në Konferencën e Labintit (1944), si dhe parashtrimin e platformës së plotë të pushtetit të ardhshëm, si dhe të qëndrimit ndaj Mbretit Zog në Kongresin e Përmetit (maj 1944).

Këto momente janë shumë të ndikuara nga zhvillimet në frontin e Luftës II-të Botërore, sic ishin kapitullimi i Italisë fashiste 1943, thyerja e Gjermanisë në frontin e lindjes 1942-1943, dhe

⁴⁴⁵ K.J.Holsti, "International Politics-a Framework for Analyses", Prentice Hall, Englewood Cliffs, New Jersey 1992, pp 86

hapja e frontit të Perëndimit të aleatëve anglo-amerikan në 1944. Në këto faza rritet BRSS, Partia Komuniste e BRSS dhe roli dhe reputacioni personal i Josif Bros Stalinit. Por gjatë kësaj periudhe udhëheqja komuniste shqiptare dhe Enver Hoxha lidheshin me Kominternin dhe Stalinin vetëm nëpërmjet udhëheqjes së Beogradit dhe Titos. Ky element ka shumë rëndësi sepse ka kushtëzuar zhvillimet politike në Shqipëri me strategjinë jugosllave për fatin e Kosovës dhe të shqiptarëve në Jugosllavi gjatë dhe pas Luftës II-të Botërore.

Në këtë periudhë kritike por edhe vendimtare për fatin e shqiptarëve në Ballkan nuk patën impakte pozitive as Konferenca e Bujanit (dhjetor 1944 – janar 1945) dhe as demarshet diplomatike të Enver Hoxhës me Titon në 1946. Pjekuria politike dhe aftësia diplomatike e Titos manipuloi mjeshtërisht naivitetin politik dhe amatorizmin diplomatik të Enver Hoxhës.

Paslufta e II-të Botërore e vuri Shqipërinë në dilema të orientimit gjeopolitik ndërkombëtar. Në këtë moment politik, fati i orientimit politik dhe gjeopolitik i Shqipërisë u kushtëzua nga kërkesat Anglo-Amerikane. Këto kërkesa lidheshin me zgjedhjet të lira e të ndershme, me vazhdimin e traktateve të Mbretit Zog, si dhe njohjen dhe kthimin e pronave të shtetasve anglo-amerikanë në Shqipëri.

Qeveria komuniste e Tiranës nuk i konsideroi asnjë nga këto kërkesa anglo-amerikane. Injorimi i këtyre kërkesave principale Anglo-Amerikane nga regjimi komunist i Tiranës nën drejtimin e Enver Hoxhës dhe nën influencën jugosllave sollën ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike të Shqipërisë me dy nga aleatët kryesorë të Luftës së II-të Botërore, SHBA dhe Britaninë e Madhe. Regjimi i Tiranës bëri kthesën e parë kundër orientimit Perëndimor të vendit. Kjo frymë antiperëndimore, veçanërisht kundër Anglo-Amerikanëve do ngelej e pandryshueshme nga Enver Hoxha dhe e pasuesit të tij. Nga ai moment Enver Hoxha do kthehej fuqishëm dhe në mënyrë konsistente drejt ideologjisë marksiste-leniniste, sistemit politik sovjetik dhe modelit qeverisës të Stalinit.

Në fazën e parë të shkëputjes nga Perëndimi, Shqipëria priorizoi marrëdhëniet e saj me Jugosllavinë. Këto marrëdhënie kaluan nga vasaliteti i plotë në periudhën 1945 - 1946 drejt konfliktualitetit në rritje në periudhën 1947 - 1948. Këto konflikte përfshijnë marrëdhëniet partiake dhe ato ndërshtetërore midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Këto konflikte të thella kishin baza të thella historike, nacionale dhe ideologjike. Nyja e komplikuar midis dy palëve do zgjidhej me ndërhyrjen e Stalinit në 1948. Stalini bëri ndarjen midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë për shkak të përplasjeve të interesave të tij në Ballkan duke përjashtuar PKJ nga Kominterni dhe në këtë kontekst duke mbështetur PKS-h dhe Enver Hoxhën.

Viti 1948 shënon orientimin prioritar politik, shtetëror dhe ideologjik të Enver Hoxhës drejt BRSS dhe Stalinit. Ky prioritet e orientoi Enver Hoxhën drejt profilit Stalinit dhe mënyrës së tij të qeverisjes. As zhvillimet e mëvonshme brenda vendit dhe as konjunkturat e ndryshme ndërkombëtare gjatë Luftës së Ftohtë (1948-1985) nuk do të ndryshonin preferencën individuale të Enver Hoxhës për modelin Stalinit dhe mënyrën qeverisëse të tij.

Nga periudha 1948 deri sa ndërroi jetë (1953), Stalini ngeli modeli më i preferuar për Enver Hoxhën dhe stalinizmi ngeli mënyra e tij qeverisëse. Edhe kur vendi ndërpreu marrëdhëniet politico - diplomatike me BRSS dhe u ballafaqua me vështirësi të brendshme dhe

ndërkombëtare, modeli preferencial i Enver Hoxhës ngeli Stalini si individ dhe stalinizmi si model qeverisës.

Në procesin e evoluimit të tij politik Enver Hoxha u ndikua konjunkturalisht nga zhvillimet politike në Bllokun Lindor. Në vitet 1961 - 68 pati shenja luhatje midis Hrushovizmit dhe Stalinizmit, por erdhi gjithnjë e më shumë duke forcuar tiparet staliniste duke hyrë në konflikt me Hrushovin, ndërkohë sërisht nën ndikimin e konjunkturës politike dhe gjeopolitike Lindore filloi zhvendosjen e prioriteteve të bashkëpunimit politik, ideologjik dhe shtetëror me Republikën Popullore të Kinës.

Harku kohor 1961 – 1968, përbën nënshkrimin e plotë të PKSHE nga PKK dhe të Shtetit Shqiptar nga Republika Popullore e Kinës. Në këtë periudhë Enver Hoxha ndeshi në rezistencë të brendshme për politikën ndaj Kinës, në rrafshin ideologjik, ekonomik dhe ushtarak. Këtë rezistencë Enver Hoxha e shtypi me represion ndaj grupeve kundërshtarë të brendshme. Në Plenumet 4,5,6 KQ të PPSH që përfshinin ideologjinë, ekonominë, tregëtinë si dhe ushtrinë, regjimi i Enver Hoxhës eliminoi me dhunë çdo ide liberale, çdo tentativë për bashkëpunim ekonomik tregtar ndërkombëtar si dhe çdo tezë apo veprim ushtarak kundër të ashtëquajturit “*arti ushtarak popullor*” dhe roli udhëheqës i partisë në ushtri. Kjo konsolidoi pozitën e brendshme të pushtetit të Enver Hoxhës, thelloi luftën e klasave dhe diktaturën e proletariatit.

Në këtë periudhë ndodhën ndryshime të mëdha gjeopolitike. Në nivel global, Republika Popullore e Kinës u pranua në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe anëtare e Këshillit të Sigurimit në OKB. Kjo arritje e Kinës do të ndryshonte prioritetet ndërkombëtare. Gradualisht, Pekini do reduktohej çdo bashkëpunim me Tiranën si dhe do ngrinte nivelin e bashkëpunimit me Jugosllavinë dhe Rumaninë. Shqipëria do kalonte në plan të tretë në Ballkan.

Në plan Euro-Atlantik themelohet OSBE si një pakt midis SHBA, Europës Perëndimore dhe BRSS. Në këtë periudhë *detante* të Luftës së Ftohtë, regjimi komunist i Tiranës dhe personalisht Enver Hoxha preferuan jo hapjen dhe integrimin por mbylljen dhe izolimin. Thellimi i luftës së klasave, autarkizmi ekonomik si dhe vetëizolimi ndërkombëtar do fitonin terren në zhvillimet e brendshme dhe ndërkombëtare të Shqipërisë. Proçesi drejt vetëizolimit kaloi gradualisht nëpërmjet neutralitetit Lindje - Perëndim, midis BRSS dhe Kinës si dhe midis kampit socialist lindor dhe Botës së Tretë (1962-1972). Nga kjo periudhë regjimi i Tiranës dhe Enver Hoxha gradualisht synuan të ndërtonin socializmin vetëm me forcat e veta.

Fillimi i divergjencave shqiptaro-kineze (1976 - 1978) nisi fillimisht si përplasje vizionesh të ndryshme të zhvillimit të modeleve ekonomike. Ndërsa regjimi i Tiranës dhe Enver Hoxha kërkonin strategji ekonomike autarkiste, Kina e post Mao Ce Dunit e orientonte ekonominë shqiptare drejt konceptit hrushovian. Ishte Kushtetuta e Shqipërisë e vitit 1976 që bëri diferencën përfundimtare midis modelit autarkik të Shqipërisë (parimi i mbështetjes në forcat e veta) nga modeli i “*katër modernizimeve*” të RPK. Periudha mbas viteve 1978 përcaktoi përfundimisht doktrinën e vetëizolimit të plotë të Shqipërisë.

Doktrina e vetëizolimit ishte në thelb e vetë shterimit të brendshëm dhe të gjithanshëm të Shqipërisë. Konsumimi i të gjithë resurseve politike, ideologjike dhe ekonomike dhe strategjike

nxjorren gjithnjë në pahë elementë individual të profilit politik të Enver Hoxhës në dekadën e fundit të udhëheqjes së tij.

Enver Hoxha në dekadën e tij të fundit vijoi të qëndronte më fanatik ideologjisë marksiste-leniniste ortodokse. Ndikimet konjunkturale jugosllave, sovjetike, kineze nuk e ndryshuan pozicionin e tij ideologjik, përkundrazi ky pozicion erdhi duke u forcuar mbi bazat ideologjike fanatike, të cilat i shërbenin më shumë pushtetit të tij politik, sesa modelit socialist të zhvillimit të vendit.

Në fillimin e viteve 1980 ndryshimet në mjedisin politik Ballkanik sollën tronditje politike të Jugosllavisë pas vdekjes së Titos (1980). Ndërkohë filluan prirje nacionaliste në vendet Euro lindore socialiste pas vdekjes së liderit konservator Sovjetik Leonid Brezhnjev. Ndërkohë brenda shoqërive euro lindore nisën lëvizje liberale kryesisht nën ndikimin e frymës së Helsinkit.

Në Ballkan kjo periudhë përkon me lëvizjen studentore në Kosovë dhe demonstrata masive me parrullën “*Kosova Republikë*” (1981). Enver Hoxha e kapi këtë moment për të mbështetur kërkesat e shqiptarëve në Kosovë me qëllim të mobilizonte burimet njerëzore në Shqipëri dhe Jugosllavi nëpërmjet ideve, emocioneve dhe sentimenteve nacionale. Enver Hoxha si marksist-leninist konsistent në momentin kur kishte konsumuar ideologjikisht, politikisht, ekonomikisht, strategjikisht si dhe ishte cënuar seriozisht në opinionin ndërkombëtar, nisi të përdorte deri në abuzim kartën e nacionalizmit.

Përdorimi i kartës së nacionalizmit ishte më së shumti një taktikë në rrafshin propogandistik, i pashoqëruar me strategji, plane veprimi, masa konkrete në rrafshin e brendshëm dhe ndërkombëtar. Sidoqoftë në vitin 1981 për herë të parë kemi një sinergji panshqiptare në Ballkanin Perëndimor. Në ndërgjegjen politike dhe qytetare shqiptare ky nacionalizim i doktrinës marksiste fanatike të Enver Hoxhës krijoi efekte kontraverse afatgjate në Kosovë dhe në shqiptarët e tjerë në Jugosllavi.

Në këtë periudhë munguan tendencat për të sensibilizuar edhe individë dhe grupe të diasporës. Në këtë fazë të socializmit nacional, midis të kaluarës së gjatë staliniste dhe përpjekjes për nacionalizimin konjunktural të saj, Enver Hoxha ndërroi jetë. Ai ngeli në thelb pasuesi i fundit i modelit marksist ortodoks i tipit të Stalinit si dhe aplikuesi më konsistent i modelit të tij qeverisës. Ky profil personal dhe model qeverisës i Enver Hoxhës u sanksionua në Kushtetutën e vitit 1976. Në planin politik vijoi edhe në Kongresin e 8-të PPSH, i fundit i Enver Hoxhës si dhe në Kongresin e 9-të, i quajtur si Kongresi i vazhdimësisë i drejtuar nga pasuesi i tij dhe i modelit të tij qeverisës, Ramiz Alia.

Konkluzione të përgjithshme!

Bazuar në analizën e detajuar përgjatë studimit si dhe në analizat individuale të liderëve politik kryesorë arrijmë në këto konkluzione të përgjithshme, të cilat mbështeten në një metodë analitike krahasuese. Nga ky proces analitik krahasues arrijmë në një sintezë të ndarë në katër aspekte që më së shumti kanë ndikuar në lidhshimin politik shqiptar. Së pari; back-groundi individual historik e formues, arsimor dhe eksperiencia. Së dyti; mjedisi politik ku e zhvillojnë veprimtarinë politike dhe identitetin e vetë individual. Së treti; sjellja individuale e secilit prej

tyre që përcakton profilin politik. Së katërti; ndikimi i konjunkturave nacionale, rajonale e ndërkombëtare që ndikojnë me profilin situacional të secilit prej tyre.

1. Back-ground individual historik dhe formues. Bazat arsimore e formuese. Eksperienca.

Ismail Qemali përfaqësonte një nga familjet më të pasura e patriotë shqiptarë. Ai u ndikua nga ideologjia orientale dhe filozofia e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Figura e tij është sintezë e idealizmit rilindas dhe e pragmatizmit politik, e recidivave osmane, e ndikimeve europiane, e ëndrrave shqiptare dhe realiteteve gjeopolitike konjunkturale. Jeta dhe vepra e tij është një spirale që fillon në Vlorë, rritet dhe formohet në Janinë, Selanik dhe si shtetar i Perandorisë Osmane në dy anëve të Bosforit.

Krahas gjuhës amëtare shqipe mësoi greqisht, turqisht dhe mori mësim në italisht. Shkollimin në shqip e mori nën drejtimin e të atit dhe nënës së tij, përfundoi studimet në gjimnazin Zosimea të Janinës dhe vazhdoi studimet për drejtësi në Stamboll.

Ismail Qemali ka një eksperiencë të pasur e të gjatë pune. Karrierën e fillon si punonjës i Ministrisë së Jashtme, e në vazhdimësi në rangje e pozicionet të larta shtetërore osmane me personalitete e figura të ndryshme të Portës së Lartë. Eksperienca e gjatë dhe e larmishme si shtetar Osman, duke arritur si guvernator i përgjithshëm, sekretar Shteti dhe i Sulltanit, deputet i parlamentit Osman, kryetar i partisë opozitare (partia liberale) e rëndit Ismail Qemalin një nga figurat më të rëndësishme të etapës së fundit të Perandorisë Osmane.

Jeta e gjatë politike e në funksion të Perandorisë Osmane e shtrirë nga Perëndimi në Azi, nga Mesdheu në Europën Veriore, mbi popullsi e mentalitete të ndryshme e ushqueu me traditat, kulturën e gjuhën e tyre. Ismail Qemali ishte njohës i traditës e gjuhëve evropiane, ai trashëgoi dhe forcoi lidhjet miqësore me familje myslimane, të krishtera dhe hebreje. Ai ngeli stoik në filozofi lindore, ishte liberal dhe symbol i zhgënjimit. Ai ngelet lideri i ambicjeve dhe dilemave të mëdha, por plani i tij mbeti i papërbushur. Ismail Qemali erdhi në prag të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe realizoi një Shqipëri minimaliste, Londineze.

Fan S.Noli u lind dhe u rrit në Ederne të Turqisë, në një nga shtatë fshatrat ortodokse shqipfolëse. Noli ishte pjesë e komunitetit shqiptar ortodoks nga jugu i Shqipërisë dhe përfaqëson një nga familjet shqiptare të ikura nga trazirat socialo-politike (shekulli i 18-të), të vendosura në Ibrik-Tepe, në këtë hapësirë gjeografike të Turqisë që sot quhet Traka Lindore. Studimet e mesme i kreu në gjimnazin më të mirë grek të Edernesë, Adrianopojë dhe krahas gjuhës shqipe mësoi turqisht, greqisht, arabisht.

Noli ishte osman dhe në moshë të re shëtititi gjithë pellgun e Mesdheut, jetoi në Greqi, Egjipt dhe në Odessa, Rusi. Noli punoi si përkthyes, aktor, mësues i greqishtes e këngëtar në kishë dhe në moshë të re emigroi në SHBA.

Noli në SHBA diplomohet për art në universitetin e Harwardit dhe mori gradën Ph.D. në Universitetin e Bostonit. Formimin intelektual, kulturor e enciklopedik të tij e realizon pranë elitave përëndimore të kohës, të orientuar më tepër drejt idealizmit se sa ndaj realizmit dhe mjaft larg realiteteve politiko-sociale ekonomike të Ballkanit e të shqipëtarëve. Krahas gjuhëve të përvetësuar më herët, përvetësoi gjuhën angleze, spanjolle dhe franceze, angazhohet në

veprimtari politike dhe si botues i gazetave e revistave shqiptaro-amerikane. Noli ishte politikan, diplomat, poet, kronikan, studiues, ispirues dhe u përpoq të lidhë fatin e Shqipërisë me Perëndimin, me ideologjitë, politikat e institucionet liberale.

Fan S.Noli është themeluesi i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, letërsisë kishtare shqiptare dhe pjesë e elitës së komunitetit shqiptar në Boston të Amerikës. Fan Noli nderohet si kampion i letërsisë, historisë, teologjisë, diplomacisë, gazetarisë, muzikës dhe unitetit kombëtar.

Noli me përkthimet e kryeveprave të letërsisë botërore ndikoi në konsolidimin e gjuhës shqipe si gjuhë kombëtare e Shqipërisë. Karriera diplomatike-politike e tij e ndihmoi të udhëheqë me sukses Shqipërinë për anëtarësim në Lidhjen e Kombeve. Me largimin në Itali, 1924 dhe vendosjen përgjithmonë në Shtetet e Bashkuara 1930, përfundoi përfshirjen e tij politike në realitetin shqiptar. Ai e kaloi pjesën tjetër të jetës si akademik, udhëheqës dhe shkrimtar religjioz. Noli ngelet lideri me aftësi universale por edhe me qasje kundraverse.

Ahmet Zogu u lind në Burgajet, qytezë afërt Burrelin pjesë e Perandorisë Osmane. Ai rridhte prej familje patriakale shqiptare myslimane, nga familjeje bejlerësh e pronarë tokash të trashëguara në krahinën e Matit. Prindërit ishin mësuesit e parë të tij. Në moshën pesë vjeçare në vendlindje filloi të mësojë shkrim e këndim në gjuhën amëtare, gjuhën turke dhe disa mësimë mbi historinë e gjeografinë. Largohet për në Stamboll dhe fillon studimet në Lycée Impérial de Galatasaray dhe më vonë në Akademinë Ushtarake të Stambollit. Në Turqi mori dije ushtarake dhe iu bashkua një rrethi arsimor shqiptar në Stamboll. Pas vdekjes së atit më 1908, u bë Beu i Matit në vend të të vëllait.

Gjatë Lufta e Parë Botërore doli vullnetar në krah të Perandorisë Austro-Hungareze. Qëndroi në Vjenë e në Romë e kthehej në Shqipëri më 1919. Në Vjenë, u njoh me stilin e jetës europiane, me kulturën perëndimore, sistemet politike dhe kushtetueshmërinë. Mori mësimë në gjuhën gjermane dhe thelloi njohuritë në artin ushtarak dhe në fushën e diplomacisë.

Zogu qëndroi midis kulturës orientale osmane dhe asaj Austro-Hungareze perëndimore. Ai erdhi nga kultura orientale dhe u investua në kulturë perëndimore, u formua në një mjedis patriarkal por u rrit dhe u kualifikua në mjedis europian. Ahmet Zogu ishte pinjoll i familjes tradicionale partiarkale shqiptare dhe që krijoi një familje moderne europiane. Ahmet Zogu simbolizon liderin shqiptar që bëri aleancë me të gjithë dhe luftoi kundër të gjithëve.

Enver Hoxha rrjedh nga një familje qytetare tregtare shqiptare, pronare tokash dhe me traditë bektashiane. Familja ndikoi në nxitjen dhe formimin intelektual të tij. Mësimet e para i mori në vendlindje, më pas i vijoi në Liceun e Korçës në një shkollë të mesme frënge ku mësoi mbi historinë, letërsinë, filozofinë franceze dhe njihet me idetë komuniste.

Me anë e një burse nga qeveria e Mbretit Zog (1930) shkoi në Francë për të studiuar në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Montpeljesë, dega e biologjisë. Në mars të vitit 1934 i ndërpritet bursa nga Ministria e Arsimit Shqiptare pasi nuk kishte kaluar asnjë provim universitar, tërhiqet për të studiuar në drejtësi pranë Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Sorbonës por pa kaluar provimet dhe nuk mundi të vazhdojë më tej.

Para themelimit të Partisë Komuniste Shqiptare, Enver Hoxha simpatizonte pikëpamjet social-demokrate europiane dhe gjatë qëndrimit në Francë ndikohet nga Shoqata e Punëtorëve

Francez, Partia Komuniste Franceze e gazeta komuniste L'Humanité. Krahas njohurive të marra por i pa profilizuar mbi fushë të caktuar, bashkëpunoi me gazetën komuniste L'Humanité duke shkruajtur mbi situatën në Shqipëri. Mbas eksperiencës franceze dhe angazhimit dy vjeçar pranë konsullatën shqiptare në Bruksel, në korrik të vitit 1936, Enver Hoxha kthehet përfundimisht në Shqipëri.

I ndodhur përballë pushtimi fashist Italian dhe qeverisë së Mustafa Merlika-Kruja, Enver Hoxha refuzon alternativën fashiste shqiptare dhe në dhjetor 1939 largohet nga mësim-dhënia për mungesë diplome. Rreth dyqanit “Flora” ruajti dhe zgjeroi kontaktet me grupet komuniste shqiptare dhe më 8 nëntor 1941, shfaqet bolshevik i brumosur në shkollën staliniste. Enver Hoxha është bashkë-themelues dhe bashkë-drejtues i Partisë Komuniste Shqiptare.

Enver Hoxha ishte i edukuar dhe rritur nën ndikimin perëndimor majtist. Ai fliste rrjedhshëm frëngjisht dhe kishte njohuri për të komunikuar në italisht, serbo-kroatisht, rusisht e anglisht. Ai kishte kulturë të gjërë, ishte popullor dhe më i lexuar në raport me liderët komunist të bllokut lindor. Referenca të përhershme të tij ishin gazetat perëndimore “Le Monde” dhe “International Herald Tribune”. Enver Hoxha edukohet dhe evoluon që nga fillimi tek ideologjia Marksiste-Leniniste duke u profilizuar ideologjikisht në profilin e stalinizmit si ekstrem i Marksizëm-Leninizmit. Ai ngeli deri në fund pasuesi i fundit i modelit marksist ortodoks i tipit të Stalinit si dhe aplikuesi më konsistent i modelit të tij qeverisës.

2. Mjedisi dhe hapësira politike në të cilën zhvillohet veprimtaria e tyre.

Ismail Qemali është produkt i shoqërisë patriarkale shqiptare, rritet e formohet në Janinë, Selanik, formohet si shtetar i Perandorisë Osmane dhe përfundon themelues i shtetit pavarur shqiptar. Mjedisi multireligjioz ballkanik e Osman, ndjenjat positive të tij mbi kulturën, gjuhën e traditat evropiane ndikuan në lidhjet miqësore dhe frymën bashkëpunuese me figura dhe personalitete të kohës. Identiteti dhe evoluimi i tipareve të tij në mjedisin politik ballkanik dhe Osman, u ndikua nga dy faktorë, nga Kriza Lindore që kulmon me shpërbërjen e Perandorisë Osmane dhe Rilindjen Kombëtare Shqiptare me ngritjen e nacionalizmit shqiptar.

Ismail Qemali u ndikuar nga ideologjia orientale dhe filozofia e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Ai ishte pjesë e nacionalizmit dhe lidhshimit shqiptar të shek. 20-të, ndikuar nga filozofia aristokrate, konservatore, dinamikat politike, lëvizjet liberale, nacional-shtetformuese dhe imperiale. Ismail Qemali dhe liderët pasues shqiptar u ndikuan nga idetë rilindase dhe programi e saj politik kombëtar, konsoliduan ndërgjegjen kombëtare, kapërcyen prirjet lokaliste dhe separatizmin patriarkal feudal.

Ismail Qemali u mbështet në traditën mbarë kombëtare shqiptare, trashëgoi pasuritë e çmuara historiko-kulturore, vlerat morale e politike, zhvilloi platformën ideologjike e politike dhe e vuri në shërbim të pavarësisë dhe çështjes kombëtare shqiptare. Ismail Qemali dhe rilindasit shqiptarë mbajtën gjallë entuziazmin kombëtar shqiptar dhe krahas realizimit të shpalljes së pavarësisë, u përgatitën për sfida të mëdha në planin e brendshëm dhe ndërkombëtar.

Eksperienca në administratën osmane dhe mjedisi politik i siguruan bashkëpunim me personalitete me statura prej shtetari dhe mbartës të vlerave liberale. Mjedisi diversifikues lindor,

eksperiencia e gjatë administrative dhe legjislative i siguruan një karrierë të shpejtë e të pasur të dikuar nga idetë liberale, modelet e administrimit dhe të qeverisjes. Ismail Qemali është kulminacion e gërshetim i vlerave patriotike shqiptare me vizionin europian, i kapacitetit të lartë diplomatik me origjinë osmane por me kulminacion europian.

Fan S.Noli u lind dhe u rrit në mjedis osman dhe jetoi e punoi në mjedis mesdhetar e perëndimor. Fan S.Noli ishte produkt dhe vazhdues i kauzës së Rilindasve Shqiptarë, por jetuar dhe kontribuar larg realitetit ballkanik e shqiptar të kohës. Noli u ndikua nga ngjarjet dhe figura që i paraprinë reformimit Osman por me emigrimin dhe shkollimin në SHBA ai u orientua drejt demokracive liberale perëndimore. Fan S.Noli në mjedisin perëndimor amerikan realizoi formimin intelektual, kulturor e enciklopedik të tij, por larg realiteteve politiko-sociale-ekonomike të Shqipërisë e të shqipëtarëve.

Fan S.Noli ishte romantik, ëndërrimtar i iluminizmit francez, i ndikuar nga ideologjitë perëndimore dhe u karakterizuar nga idealizmi e liberalizmi. Filozofia politike, idetë, konceptet ishin liberale dhe aspironin vendosjen e rendit kushtetues e demokratik në Shqipëri.

Formati dhe back-groundi i tij e orientuan më tepër drejt idealizmit se sa ndaj realizmit. Noli erdhi në politikë për të lidhur fatin e Shqipërisë me Perëndimin, me ideologjitë, politikat, institucionet liberale, por pa konsideruar realitetet shqiptare, ballkanike, ndërkombëtare të kohës.

Noli ngeli vizioni i së ardhmes, i huaj për ambjentin dhe kohën që kërkoi të zbatohet, por i preferuar për ardhmërinë e lidhshimit politik shqiptar. Noli la dilemma të mëdha por nga pikëpamja idealiste ai mbeti lider në profil me tendencë pro-europiane dhe liberale.

Fan S.Noli mishëronte konceptet demokratike e liberale perëndimore të ballafaquara në realitetin shqiptar me mentalitet e tradita osmane, me prapambetjen ekonomike të ndërthurur me atë kulturore, me analfabetizëm e inteligjencë të pakët, ndikim austriak në veri, italian në bregdet dhe grek në jug.

Mungesa e një tradite demokratike shqiptare dhe trashëgimia armiqësore shumë shekullore me zgjidhje e mentalitet oriental ja vështirësonin rrugën parlamentarizmit, ngritjes dhe konsolidimit të shtetit shqiptar. Sfida shqiptare në planin nacional do ballafaqohet me të mësuarin e funksionimin e shtetit modern. Noli kërkonte ta lidhte fatin e Shqipërisë me Perëndimin, por u ballafaquan me intolerancë dhe ngadhënim të autoritarizmit.

Noli u karakterizua nga kontradita midis vizioneve dhe programeve politike, midis programit politik dhe mënyrës qeverisëse, midis qasjes kombëtare dhe ndërkombëtare. Idetë liberale e nxitnin drejt Perëndimit ndërsa klasat shoqërore, çifligarët e fshatarësia e tërhiqnin drejt orientalizmit, drejt sjelljeve radikale revolucionare. Idealizmi Nolian u kryqëzua midis vizionit Perëndimor, orientalizmit çifligar dhe radikalizmit fshatar.

Ahmet Zogu erdhi nga trashëgimi kraharariste e patriarkale, mentalitet osman e kulturë orientale. Ai është vazhdues i traditës së lidhshimit politik shqiptar. Ai u rrit në një mjedis me kulturë dhe filozofi orientale, i orientuar nga lindja dhe qëndroi midis kulturës osmane e asaj Austro-Hungareze. Ai për shumë kohë ishte pa vizion të qartë politik, eci më shumë ad-hoc, duke përciellë më shumë konjunkturën.

Ahmet Zogu si nacionalist oriental, në periudhën politike (1920 – 1928) dëshmoi intuitë, aftësi konjunkturale por të shoqëruar me paqartësi ideologjike, mungesë vizionesh, modele politike dhe sisteme qeverisje. Ai erdhi nga kaosi, anarkia me mbështetje konjunkturale, u formua si statist dhe hodhi baza qëndrueshmërie, stabiliteti dhe bashkimi.

Zogu trashëgonte filozofinë rilindase të Ismail Qemalit, vinte pas kulkuluesit të çifligut personal nga politikani oportunist Esat Pashë Toptani, ai u ballafaqua me Fan Nolin, mishëruesin e demokracisë liberale dhe të liberalizmit. Filozofia politike e Ahmet Zogut u ballafaqua me filozofinë liberale e perëndimore të Fan Nolit, ishte përplasje vizionesh midis forcave tradicionale shqiptare dhe tregtarëve progresistë, me politikanëve me prirje demokratike të kohës, ishte konkurrencë të orientimeve politike thellësisht të djadhtë me orientimin politik të majtë.

Ahmet Zogu bëri përpjekje të udhëhiqte një model parlamentarizmi perëndimor por vendi u karakterizua nga kaosi, konflikti dhe dhuna e brendshme. Zogu u investua si republikan, por natyra dhe sjellja politike nuk përshateshin me republikanizmin parlamentar. Ahmet Zogu, përballë alternativës liberale të Fan Nolit, nëpërmjet konjunkturave dhe kompromiseve siguroi mirëkuptimin e mbështetjen e mjedisit politik rajonal.

Monarkia që themeloi Zogu hodhi bazë qëndrueshmërie, sintetizonte trashëgiminë me konjunkturën, idealet e rilindasve me pragmatizmin politik, simbolin e heroit kombëtar me parinë e kohës. Zogu ishte mbreti pa mbretëri, lideri me luhatje e paqëndrueshmëri ndaj fqinjëve rajonal, autokrati europian që eci në sens të kundërt të Europës.

Enver Hoxha simbolizon liderin politik me bazë historike të qëndrueshme dhe elementë që evoluojnë. Shoqëria ku u rrit ishte botë hakmarrjesh dhe dredhish, pjesë e një mentaliteti osman ku sundonte feja islame, dominimi mashkullor, prapambetje kulturore, filozofike dhe mungesë idesh. Mjedisi shoqëror e politik ishte realitet lindor në qasje kulturore, me mendësi e filozofi orientale, i ballafaquar me procesin e lindjes dhe të zhvillimit të shtetit shqiptar, me konflikte të brendshme dhe problemet e konsolidimit e të zhvillimit të vendit.

Gjatë qëndrimit në Francë, Enver Hoxha u njohë me qarqet e politikës radikale franceze. Interesi në rritje për të majtën e ideologjinë e saj e shtyn me disa shkrime në gazetën L'Humanité kundër regjimit të Zogut e mbi gjendjen në Shqipëri. Qëndrimi në Paris e Belgjikë do sillte impakt të thellë e afatgjatë tek Enver Hoxha. Kontaktet me komunistët franceze dhe shqiptarë e bindën se ideologjia marksiste-leniniste dhe modeli stalinist ishte më i miri për tu ndjekur. Qëndrimi në Francë e Belgjikë i shtoi dashurinë për kulturën perëndimore dhe me kthimin në Shqipëri kemi një zhvillim të shpejtë të ideologjisë majtiste tek ai. Në kontakt dhe si pjesë e grupit të Korçës u bë më aktiv e pjesë e organizimit të lëvizjes antifashiste dhe përqafimit të vijës së Kominternit.

Mjedisi politik shqiptar në të cilin Enver Hoxha zhvilloi veprimtarinë e tij ishte i ndikuar nga konjunktura ndërkombëtare dhe veçanërisht nga Kominterni dhe Partia Komuniste Jugosllave. Ky mjedis sllavo-komunist do ndikonte për një periudhë shumë afatgjatë mbi Enver Hoxhën.

3. Sjellja individuale.

Ismail Qemali është shtetari, politikani dhe diplomati i shtetit modern shqiptar. Ai ishte politikan mendjemprehtë, liberal dhe symbol i zhgënjimit. Ismail Qemali është kulminacioni dhe gërshetim i vlerave patriotike, vizioneve europiane, kapacitetit të lartë diplomatik me origjinë osmane por me kulminacion europian. Ismail Qemali demostroi fleksibilitet, zotërues i busullës mbi ngjarje të shumëanshme, syri kureshtar e largpamës dhe me disa iluzione. Ai ngeli lindor në filozofi dhe perëndimor në vision, ai nuk ishte cinik dhe demostroi qëndrueshmëri përballë fqinjëve ekspansionistë e grabitqarë.

Ismail Qemali u përpoq të hedhë bazat politike të shtetit shqiptar por nuk arriti ta implementojë e formalizojë qartësisht. Ambicja dhe plani i tij mbetën të papërmbushura, i paqartë në formën politike dhe sistemin qeverisës.

Ismail Qemali është modeli i liderit që konsiderohet si tërësi tiparesh individuale. Ai mishëron liderin rilindas, liberalin perëndimor, shtetarin osman, diplomatin e regjur dhe kalkuluesin e fuqive. Ismail Qemali me temperamentin, karakterin, mënyrat e sjelljes dhe të komunikimit, të politik-bërjes e vendim-marrjes, zbatimit të politikave dhe marrëdhëniet me aktorë të ndryshëm lokalë e ndërkombëtarë mbajti gjallë entuziazmin kombëtar shqiptar dhe krahas realizimit të shpalljes së pavarësisë kombëtare, përgatitën vendin për sfida të mëdha në planin e brendshëm dhe ndërkombëtar.

Ismail Qemali ishte produkt i shkollës osmane por realizoi shkëputjen e trojeve shqiptare nga Perandoria Osmane duke dalë edhe nga projekti i autonomanisë brenda kësaj perandorie i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ismail Qemali si lider e vazhdues i traditës shqiptare dha prova urtësie e largëpamësie politike, i thirri arësyes, ndjenjës patriotike, u tregua praktik dhe diplomat.

Ismail Qemali ngelet realizuesi i panvarësisë shqiptare nën mbrojtjen e Fuqive të Mëdha si alternativë e qëndrueshme jashtë mbrojtjes osmane e të mbijetesës së identitetit shqiptar. Ismail Qemali ishte perëndimor sepse njohuritë, aftësitë dhe vizionin e tij e vuri në dispozicion të kombit shqiptar, rikuperoi Shtetin Shqiptar në orientimin pro-evropian duke e shkëputur nga praktikat orientaliste osmaniste e lindore.

Ismail Qemali është mishërues i stilit autoritar dhe pjesëmarrës. Ai dallohet për centralizim, nga determinimi personal, shquhet për imponimin e personalitetit të vet, bazohet në eksperiencë të gjatë, fuqi e përvojë politikbërëse. Ismail Qemali favorizon udhëheqjen bashkëpunuese, demostroi sjellje motivuese, stil efikas dhe frymë pozitivist.

Fan S.Noli mishëron politikanin, diplomatin, poetin, kronikanin dhe studiuesin frymëzues. Noli ishte debatues, negocues dhe imponues racional.

Si lider Noli themeloi një stil e sjellje politike tërësisht individuale që nuk përqaset me mentalitein dhe kulturën politike të mjedisit. Noli është heroi i demokracisë shqiptare dhe viktima e përkushtimit demokratik. Noli ishte i dështuar si individ por ngjallës i idealistëve të mendimit, dështues me politikën por ngadhëjues i historisë. Noli nuk arriti të pajtojë mendimin me aksionin, ëndrrat me vrazhësinë e jetën, profetizmin e diagnozave me mënyrat e qasjen për eliminimin e tyre.

Fan S.Noli është lider spiritual, romantik, illuminist, idealist, liberal dhe revolucionar. Noli është aspirues i vendosjes së rendit kushtetues e demokratik në Shqipëri. Profili i tij si lider u ngrit mbi realitete orientale, konsevatore, autoritare, revolucionare dhe fare pak liberale. Ai mishëron liderin e bashkëjetesës së ideve liberale e të avancuara perëndimore me veprime, praktika e sjellje radikale, revolucionare lindore.

Sjellja politike dhe veprimet praktike të tij pasqyrojnë trashëgiminë e tipareve të lidërshiptit shqiptar. Noli përsëriti sindromin e vjetër të lidërshipeve politike shqiptare. Goditja ndaj parlamentit, pikëpamjet konfuze në vizionin e tij, mungesën e taktit politik, vendime të nxituara dhe të keqkonceptuara, përputheshin me stilin e tij autoritar qeverisës.

Sjellja ndaj parlamentarizmit, ndjekja dhe dënimi i kundërshtarëve politik ishin rezultat i stilit autoritarist i qeverisjes, ndërkohë simpatitë për lëvizjen revolucionare pasqyrojnë profilin kontravers politik të tij. Noli ishte produkt dhe vazhdues i kauzës së Rilindasve Shqiptarë, por jetuar dhe kontribuar larg realitetit ballkanik e shqiptar të kohës. Noli ngeli vizioni i së ardhmes, i huaj për ambjentin dhe kohën në të cilën tentoi të implementohet, por i preferuar për ardhmërinë e lidërshiptit politik shqiptar. Noli la dilemma të mëdha por nga pikëpamja idealiste ai mbeti lider në profil me tendencë liberale e pro-europiane. Brengosja, zhgënjimi, nervozizmi dhe sjellja politike jokorrekte përballë indiferentizmit e cinizmit të faktorit ndërkombëtar ishte fatale për Nolin dhe fatin e mëtejshëm të Shqipërisë.

Noli ngelet lideri me aftësi universale por me sjellje kundraverse. Ai me sjelljet e tij ndikoi në performancën e grupeve mbështetëse dhe kundërshtitë e brendshme e të jashtme. Noli është lideri me autoritet dhe papajtueshmëri, me theks të fortë në detyrë dhe me më pak theks në kërkesat e njerëzve. Noli ishte autokrat dhe udhëhiqet nga filozofia e determinimit personal, shquhet për imponimin e personalitetit të vet dhe dominues mbi të tjerët. Ai është kontrollues, kërkues dhe drejtoi me stil diktatorial. Noli u tregua i përshtatshëm si lider në situatë të caktuar, ndërsa me ndryshimin dhe evoluimin i situatës nuk e përshtati stilin e tij udhëheqës.

Ahmet Zogu erdhi nga një trashëgimi krahinariste, mentalitet orientalist, sjellje autoritariste, me stil e përzjerje lindore. Ai ishte me natyrë të heshtur, jo publike, jo komunikative, por shumë aktive në tërë karrierën e tij politike. Ahmet Zogu portretizohet si autokrat dhe mjaft raste të tjera si diktator. Zogu në thelb qeverisi i vetëm dhe u bë më tepër autoritar. Zogu drejtoi vendit me një stil oriental dhe “jetoi” si perëndimor. Nga traditat e zakone të vjetra myslimane, Zogu e çliroi veten nga një farë orientalizmi, por formimi i mangët dhe shumë pak perëndimor e bëri atë të ekspozuar dhe paksa naiv në nënshtrimin ekonomik të vendit.

Ahmet Zogu erdhi nga kultura orientale dhe u investua në kulturë perëndimore, u formua në një mjedis patriarkal, por u rrit dhe u kualifikua në mjedis evropian. Ahmet Zogu ishte pinjoll i familjes tradicionale partiarkale shqiptare dhe krijoi një familje moderne evropiane me princeshë katolike hungareze. Ai erdhi nga kaosi, anarkia dhe përçarja dhe hodhi bazat e qëndrueshmërisë, stabilitetit dhe bashkimit.

Zogu demonstronte inteligjencë natyrore, aftësi njohje në thellësi të njerëzve, i qetë e dinjitoz, pasionant e xheloz, fshinte për mrekulli ndjenjat e veta dhe priste momentin për të goditur rivalët

potencialë. Zogu ishte dredharak dhe oportunist. Ai vuante nga mosbashkërendimi dhe delegimi i punëve. Zogu kishte natyrë arbitrare dhe vetësiguri të tepruar.

Ahmet Zogu u tregua demagog dhe manipulator. Statusi i Monarkut Zogu I-rë i shërbeu atij si një pikë konvergimi nga lart-poshtë për arritjen e një stabiliteti politik të brendshëm, hodhi bazë qëndrueshmërie që sintetizonte trashëgiminë me konjunkturën, idealet e rilindasve me pragmatizmin politik, simbolin e heroit kombëtar me parinë e kohës. Mbretëria shqiptare e drejtuar nga Ahmet Zogu u tregua e aftë për të nxjerrë vendin nga kaosi duke afruar bazat për stabilitet, por u tregua e dobët përballë presioneve dhe dinamikave gjeopolitike rajonale.

Ahmet Zogu ishte lider me tërësi sjelljesh që arrin të dominojë dhe identifikohet me sjelljet e tij nga të tjerët. Ahmet Zogu konsiderohet lider me një tërësi sjelljesh ndikuese. Qasja e stilit e mishëruar tek profili i Ahmet Zogut thekson sjelljen e tij, fokusimin në objektivat dhe mënyrën sesi e realizon. Qasja e tij si stil shpie në vetëbesim dhe njëkohësisht vlerësim të lartë nga të tjerët. Udhëheqja e tij vjen në ngritje e duke ndikuar tek vartësit për të arritur qëllimin. Me krijimin e eksperiencës qeverisëse synon efektivitet, tenton të përshtasë stilin udhëheqës në përputhje me rrethanat e situatat e ndryshme e me nivelin e zhvillimit të vartësve.

Ahmet Zogu është lider me stil e përzierje lindore. Ai është autokrat dhe autoritarist, vendos theks të fortë ndaj detyrës dhe më pak theks ndaj kërkesave të njerëzve. Ai përshkruhet shpesh si "babai" ndaj ndjekësve, trajton qeverisjen si një "familje", shpërblenë besnikërinë e bindjen duke ndëshkuar edhe mospërputhjet. Zogu aplikon stil lidërshipi oportunist, ai përshtat stilin qeverisës për avancim personal përpara prioriteteve të tjera. Ky stil udhëheqës përshkruhet i pamëshirshëm, dinak dhe të vetë motivuar. Si lider situacional u tregua i aftë në një situatë të caktuar, për të nxjerrë vendin nga kaosi dhe hedhur bazat e stabilitetit por me ndryshimin e situatave u tregua i papërshtatshëm e i dobët përballë presioneve dhe dinamikave gjeopolitike rajonale. Zogu nuk realizoi stilin e duhur qeverisës përballë dinamikave të zhvillimit të shoqërisë. Zogu paraqitet si narcizoid, pëlqen veten, rrit distancën midis vetes dhe njerëzve që rrethojnë. Zogu njihet për stil manipulues dhe natyrë abuzive. Abuzon mbi besimin e të tjerëve dhe shfrytëzon makinerinë e fuqisë, statusit, ndikimit për imponimin e ideve të veta.

Enver Hoxha ngeli deri në fund pasuesi i fundit i modelit marksist ortodoks i tipit të Stalinit si dhe aplikuesi më konsistent i modelit të tij qeverisës. Eksperienca e gjatë qerisëse e avantazhon në raport me udhëheqësit e tjerë komunistë. Enver Hoxha nuk ofron model socializmi si alternativë të qëndrueshme. Ai simbolizoi liderin që ka të gërshetuar shtatën e diktaturës së proletariatit me njeriun e arsimuar perëndimor. Ai është i lexuar, inteligjent dhe stalinist nga ana tjetër.

Enver Hoxha kishte aftësi aktori, gërshetonte vendosmërinë me argumentimin, demonstronte kokëfortësi dhe i lodhte kundërshtarët. Tek Enver Hoxha ndërthuret inteligjenca, aftësia vëzhguese, vigjilenca, çiltërsia dhe dredhia. Përshypjen positive dhe forcën tërheqëse e shfrytëzonte për fituar dhe mbajtur pushtetin.

Enver Hoxha ishte manipulator dhe dredharak. Shoqëria ku u rrit ishte botë hakmarrjesh dhe dredhish, pjesë e një mentaliteti osman ku sundonte feja islame, dominimi mashkullor, prapambetje kulturore dhe mungesë idesh. Ai mbajti pushtetin më tepër se çdo udhëheqës tjetër

jo-trashëgimtar në Europën Lindore, i jetoi të gjitha dhe pati suksesin më të shpejtë si lider i PKSH se çdo lider i regjimeve komuniste të kohës.

Në çdo konflikt me jugosllavët, rusët dhe kinezët, Enver Hoxha paraqet primare parimet ideologjike të marksizëm-leninizmit por arsyet nacionaliste evidentohen më tepër se ato ideologjike. Enver Hoxhës u orientua drejt profilit Stalinist dhe mënyrës së tij qeverisje. Stalini ngeli modeli më i preferuar për Enver Hoxhën dhe stalinizmi ngeli mënyra e tij qeverisëse. Raporti midis aftësive të tij qeverisëse dhe Stalinizmit të tij të verbër është një nga aspektet dalluese të tij.

Në procesin e evoluimit të tij politik, Enver Hoxha forcoi tiparet staliniste, zhvendosi prioritetet e bashkëpunimit politik, ideologjik e shtetëror, sanksionoi modelin autarkik të Shqipërisë duke përcaktuar përfundimisht doktrinën e vetëizolimit të plotë të Shqipërisë.

Enver Hoxha dhe regjimi i Tiranës ishin kundër frymës dhe sjelljes së lidërshiptit perëndimorë të vendit dhe Perëndimit. Ai injoronte demokracinë dhe lartësonte stilin autoritarist nga lart-poshtë.

Enver Hoxha përballë dinamikave të zhvillimit të shoqërisë shqiptare nuk realizoi stilin e duhur qeverisës. Vizioni i Enver Hoxhës udhëhiqej nga nacionalizmi i rreptë. Ai ngelet lider me profil socialist nacional. Visioni i tij për “socializmin”, arsyet gjeo-stategjike dhe pastërtia ideologjike shërbenin si mbulesë e përshtatshme e arsytimit për socializmin nacional. Politika e udhëhequr nga Enver Hoxha ka qënë më tepër politikë absenuese dhe refuzuese sesa izolacioniste.

Enver Hoxha përformonte me kulturë, demonstronte popullaritet dhe sjellje si populist. Enver Hoxha kishte aftësinë t'i kombinonte; dinakërinë, vigjilencën ballkanike, ideologun, parimorin, aplikuesin e metodologjisë dhe të zakoneve post-leniniste. Tek Enver Hoxha kombinohet brutaliteti me sharjet tradicionale shqiptare.

Stili qeverisës dhe dinamikat e zhvillimit të shoqërisë shqiptare nuk u atëruan tek Enver Hoxha. Tek profili i Enver Hoxhës identifikohet grup universal tiparësh dhe qasja ndaj rrethanave e situatave. Lidërshipti i Enver Hoxhës është një përzierje dhe mpleksje e teorisë së tipareve të trashëguara dhe të adoptimit situacional. Karakteristikat personale dhe origjina familjare e social-ekonomike janë pjesë e tipareve të trashëgueshme tek ku profil lideri. Përshtatja situacionale dhe efikasiteti në disa situata arsyeton lloje të ndryshme lidërshipti nga autoritaristi te individualisti deri te ekipi.

Enver Hoxha dallohet për talent, aftësi, karizëm, karakteristika fizike dhe cilësi të tjera lidërshipti. Ai është trashëgues i tipareve të lidërshiptit shqiptar, me tipare të lindura e të trashëguara. Profili i tij karakterizohet nga karakteristika të poseduara nga udhëheqësit e mëdha shoqërorë, politikë dhe ushtarakë. Enver Hoxha mishëron disa tipare e karakteristika themelore si inteligjencën, vetëbesimin, përcaktimin, aftësinë dominuese, përshtatshmërinë, insistimin, statusin social – ekonomik dhe qënia i shoqërueshëm.

Enver Hoxha është lider me profil e stil të përzierë, dallohet për stilin autokratik e autoritarist, për rrugën e mesme ndaj detyrës dhe njerëzve ose qasje mbështetëse, për oportunitizëm drejt avancimit personal, narcizoid dhe helmatosës.

Ai është autokrat dhe autoritarist, vendos theks të fortë ndaj detyrës dhe më pak theks ndaj kërkesave të njerëzve. Ai karakterizohet nga centralizimi dhe procesi vendim-marrës në duart e tij, nga filozofia e determinimit personal; imponimin e personalitetit të vet, bazohet në eksperiencë të gjatë e të lidhur me totalitarizmin. Stili autokratik ka karakterizuar sistemin stalinist shqiptar. Modeli dhe stili "diktatori dashamirëse" përshkruan dhe trajton qeverisjen si një "familje", shpërblehet besnikëria dhe ndëshkohet mospërputhja. Stili oportunist përdoret për avancim personal e si i pamëshirshëm, dinak dhe të vetë motivuar.

Enver Hoxha pëlqen veten, është narcisist, rrit distancën me njerëzit që e rrethojnë. Ai përdor stil manipulues dhe abuzues. Ai shfrytëzon makinerinë e fuqisë, statusit, ndikimit për imponimin e ideve të veta dhe abuzon mbi besimin e të tjerëve. Si lider situacional u tregua i aftë në një situatë të caktuar, por i papërshtatshëm e i dobët përballë presioneve rajonale dhe dinamikave e zhvillimeve gjeopolitike globale.

4. Ndikimin e konjunkturave nacionale e ndërkombëtare.

Në të gjithë liderët politik shqiptar kanë patur ndikim konjunkturave në tre nivele, në nivelin nacional, rajonal dhe ndërkombëtar. Në periudha të ndryshme ndikimi në nivelet e lartpërmendura ka patur ndikime të ndryshme.

Konjunkturave ndikuese në periudhën e Ismail Qemalit janë ndikuar më së shumti nga niveli ndërkombëtar e ai rajonal dhe më pak kombëtar. Së pari; ishte rënia e Perandorisë Osmane dhe ndikimi i saj në nivele ndërkombëtare. Së dyti; ishte ngritja e Rusisë në Lindje dhe ngritja e Fuqive të Europës Qëndrore. Së treti; ishin Luftat Ballkanike dhe ngritja e nacionalizmave shtetformues. Në fazën e fundi rritet ndikimi konjunktural i nacionalizmit shqiptar dhe konvergimi i gjithë rrymave drejt pavarësisë. Ismail Qemali përcolli dhe reflektoi me stilin e tij konjunkturave e mësipërme. Back-groundi otoman, rritja e ndikimit europian, konfrontimi me fqinjët prodhuan një lider me fleksibilitet situacional.

Fan S.Noli e zhvilloi profilin e tij politik kryesisht pas Luftës së Parë Botërore. Rënia e Fuqive të Europës Qëndrore, ngritja e ndikimit të demokracive liberalë me SHBA e presidentin Eillson përbënin konjunkturën më ndikuese ndërkombëtare. Në nivele rajonale konjunktura pas luftës dominohet nga arritja e nacionalizmave ballkanikë, fuqizimit të sistemeve autotarkike plot konflikte ndërshtetërore. Në nivele kombëtare konjunktura e kohës së Nolit shquhet për disa alternative politike dhe social-ekonomike mjaft kontraditore dhe konfliktoze që e mbanin vendin në trazicion të gjatë. Noli është një reflektim ideal i konjunkturës ndërkombëtare si idealist, liberal dhe demokrat. Nën presionin e konjunkturës rajonale ai adapton veprime dhe sjellje revolucionare, bolshevike dhe stil qeverisës autokratik. Këto sjellje konjunkturale nga jashtë u përplasën me konjunkturave e brendshme të Shqipërisë të cilat më së paku u kuptuan dhe u përthithën nga sjellja politike e Nolit. Kjo e bëri lidërshtipin e tij joefekas dhe në analizën e fundit të dështuar.

Karakteristika të tjera e dalluan zhvillimin e situatës rajonale e ndërkombëtare periudhën midis dy luftave ku zhvilloi dhe kulmoi profilin e tij Ahmet Zogu.

Në nivel ndërkombëtar në periudhën midis dy luftave u përplasën tre ideologji dhe sisteme politike; fashizmi dhe sistemi fashist, marksizmi dhe sistemi komunist, si dhe liberalizmi dhe

sistemi demokratik. Të tre këto ideologji dhe sisteme politike u konfrontuan në të gjitha fushat duke kulmuar në shpërthimin e Luftës së Dytë Botërore. Në një vend rajonal periudha midis dy Luftave Botërore karakterizohet nga rivalitete nacionale por edhe përplasje gjeopolitike, në të cilat Ballkani preket dhe ndikohet nga përplasjet e interesat marksiste-ruse dhe fashiste-italiane. Më dobët paraqitet influenca liberale dhe demokratike perëndimore. Ahmet Zogu është produkt hap pas hapi i kësaj konjunktore. Eksperimentues i ideologjive dhe modeleve qëverisëse, nga republikanizmi parlamentar deri tek monarkizmi autarkik. Midis këtyre sjelljeve ndikon konjunkturalizmi dhe tradicionalizmi kombëtar, aq sa mund të thuhet se ndikimi situacional mbi Zogun ishte dominues në mënyrën si erdhi në pushtet dhe si u largua nga pushteti. Ardhja në skenën politike e ndikimit në rritje të marksizmit dhe modelit sovjetik u provokua më së shumti nga rritja e pranimet fashist dhe pushtimit fashist të Ballkanit.

Lëvizja komuniste në Shqipëri si dhe themelimi i PKSH-së ishte mirëfilli ndikim i influencës të marksizmit, të Bashkimit Sovjetik, të Partive Komuniste në Ballkan. Vetë lindja dhe organizimi komunist në Shqipëri pati ndikim të drejtpërdrejtë nga orientimet gjeopolitike para, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore.

Veprimtaria dhe profili i Enver Hoxhës fillojnë dhe formohen në situatë rritje të ideologjisë marksiste dhe influencës sovjetike. Kjo situatë ndikon konjunkturalisht në themelet e profilit të Enver Hoxhës. Konjunktura që e solli ndikoi në ideologjinë e tij marksiste ortodokse, në ndërvarësinë e stileve të liderëve komunist dhe të sjelljes qeveriste staliniste.

Panvarësisht nga ndikimi konjunkturalisht i brendshëm që e pasuronte stilin individual të Enver Hoxhës me populizëm dhe frymë nacionaliste, sërisht konjunktura përcaktuese në profilin e tij politik ngelet stili stalinist qeverisës.

Bibliografia!

Literatura

1. Historia e Popullit Shqiptar III, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Toena, Tiranë 2007, ISBN:978-99943-1-269-6
2. Historia e Popullit Shqiptar IV, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Toena, Tiranë 2008, ISBN:978-99943-1-452-2
3. Historia e Shqipërisë IV, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë & Insituti i Historisë, 8 Nëntori, Tiranë 1983
4. Historia e Shqipërisë, USHT & Insituti i Histories dhe i Gjuhësisë, Vëllimi II, shtypur Mihal Duri, Tiranë 1965
5. Historia e PPSH, Insituti i Studimeve Marksiste – Leniniste, Botimi i II-të, Shtëpia Botonjëse “Naim Frashëri”, Tiranë 1981
6. Historia e Shqipërisë, USHT & Insituti i Histories dhe i Gjuhësisë, Vëll. IV, Tiranë 1983
7. Historia e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri, Tiranë 2001
8. Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë, Insituti i Studimeve Marksiste – Leniniste, Shtëpia Botonjëse “Naim Frashëri”, Mihal Duri, Tiranë 1968

9. Universiteti i Tiranës & Instituti i Historisë, “Konferenca shkencore; “Panvarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shek. XX-të”, Përmbledhje studimesh, Klean, Tiranë 2008, ISBN:978-99956-648-1-7
10. Instituti i Historisë – Prishtinë & Instituti i Historisë – Tiranë, “Çështja e Kosovës – një Problem Historik dhe Aktual”, Simpozium Tiranë 1993, EURORILINDJA, Tiranë 1996
11. Instituti i Historisë – Prishtinë, “Serbia dhe Shqiptarët”, Libri I-rë, Prishtinë 2011, ISBN:978-9951-409-30-8
12. Studime Historike, Nr. 1, vëllimi XXXI (XIV), Akademia e Shkencave, Tiranë 1977
13. Akademia e Shkencave, Studime Historike, Nr. 1, vëllimi XXXI (XIV), Tiranë 1977
14. AQSH, “Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948”, Tiranë 1996
15. A. Dh. Dhima: “Hyrje në Antropologji - botim i tretë”, Ideart 2010, Tiranë, ISBN: 978-99943-43-74-4
16. ADAIR J: “LEADERSHIP AND MOTIVATION: The fifty-fifty rule and the eight key principles of motivating others”, United States by Kogan Page in 2006, ISBN:0-7494-4798-2
17. Buda A, e të tjerë, “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë 1985
18. A. Buda (Hrsg.): Alfabeti i gjuhës Shqipe dhe Kongresi i Manastirit (14-22 nëntor 1908). Studime, materiale, dokumente. Tirana 1972.
19. Bashkurti L: “Diplomacia shqiptare – vëllimi I-rë”, Geer, Tiranë 2005, ISBN:99943-789-4-5
20. Bashkurti L: “Diplomacia shqiptare – vëllimi II-të”, Geer, Tiranë 2003, ISBN:99927-887-6-3
21. Bashkurti L: “Diplomacia shqiptare – vëllimi III-të”, Geer, Tiranë 2004, ISBN:99927-989-4-7
22. Bashkurti L : “Çamëria në rrugën e zgjidhjes”, Geer, Tiranë 2012, ISBN:978-9928-105-18-9
23. Bashkurti L: “Koncerti dhe Funerali, 1815 – 1914, Shqiptarët – Ballkani – Fuqitë e Mëdha”, Geer, Tiranë 2013, ISBN:978-9928-07-211-5
24. Bashkurti L: “Diplomacia e Vetëizolimit, Rasti i Shqipërisë 1961 – 1989”, Geer, Tiranë 2004, ISBN:99927-989-4-7
25. Bashkurti L, “Shqiptarët në Rrjedhat e Diplomacisë”, Geer, Tiranë 2003, ISBN:99927-832-9-X
26. Bashkurti L, “National and European Identity of Albanian”, ADSh, GEER, Tiranë, 2006, ISBN:99943-854-7-X
27. Bashkurti L, Krizat Ndërkombëtare, ADSh, GEER, Tiranë 2008, ISBN:978-99956-22-47-3
28. Ballvora Sh, “Zhvillimet politike në periudhën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, 7 prill 1939 – 29 nëntor 1944”, Dituria 2004, ISBN:99927-59-36-4
29. Barjaba K & Gasparini A: “Rruga Shqiptare e Modernizmit”, ISNG, Shtëpia botuese: Grafika Goriziana – Gorizia, Itali 2011.
30. Budini B: “Tri kohë të Shqipërisë në Time, 1923 - 2013”, UET Press, 2014, ISBN:978-9928-190-08-6
31. Bobbio N, “E djathta & e majta – Gjykime dhe kuptime të një dallese politike”, IDK, ISBN:978-99943-982-2-5
32. Besli H & Ozbay O: “Rexhep Taip Erdogan – Lindja e një lideri”, Botimet 55, ISBN:978-9928-106-25-4
33. Beqaj B: “Lidershipi – si të bëhemi të rëndësishëm”, Universum Press, Prishtinë 2010, ISBN:978-9951-531-03-3
34. Brzezinski Z: “Zgjedhja – Dominim Global apo Udhëheqje Globale”, Zenith, Prishtinë 2006, ISBN:9951-479-00-6
35. Brzezinski Z: “Shanci i fundit i Amerikës”, Botues Helga’s Secrets, ISBN:978-9928-4022-1-9
36. B. J. Fischer, “Diktatorët e Ballkanit”, AIIS, Tiranë 2009, ISBN:978-99956-736-0-4
37. B. J.Fischer, King Zog and the Struggle for stability in Albania,1984
38. B. J.Fischer, “Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri”, Çabej,Tiranë 2004, ISBN:99927-33-41-1
39. B. J.Fischer, “Shqipëria gjatë luftës, 1939-1945”, AIIS,Tiranë 2012, ISBN:978-9928-4062-7-9
40. B. J.Fischer, “Shqipëria gjatë luftës, 1939-1945”, Çabej,Tiranë 2004, ISBN:99927-33-42-X
41. Biberaj E, “Çështja Kombëtare Shqiptare”, AIIS 2014, Tiranë, ISBN:978-9928-195-03-6
42. Boriçi Gj: “Pushteti dhe Lidershipi”, Geer, Tiranë 2007, ISBN:978-99943-38-69-6
43. Belegu M, “Politika Zogiste e dyerëve të hapura në 1925-1926”, Studime historike, Tiranë 1964
44. Belegu M, Mbi Lëvizjen e Dukagjinit në nëntor 1926”, revista “Studime historike”, nr 1, Tiranë 1971.

45. Blakaj S & Ismaili I; “Letërkëmbime të Rilindjes Kombëtare Shqiptare”. Prishtinë: ARBI Ltd; New York: Vatra, 2014, ISBN:978-9951-452-13-7
46. Clayer N: “Në fillimet e nacionalizmit shqiptar”, Botime Përpjekja, Tiranë 2009, ISBN:978-99956-786-0-9
47. Castellan G: “Histori e Ballkanit”, Tiranë, Çabej 1991
48. Cana Z: “Politika e Serbisë kundrejt Çështjes Shqiptare 1903-1913”, Prishtinë, Instituti Albanologjik I Prishtinës 2006, ISBN:9951-411-31-2,
49. Cana Z, “Shpallime Historike”, RILINDJA, Prishtinë 1982
50. Cassels A, “Mussolini’s Early Diplomacy”, Princeton 1970,
51. Cici A, “Marrëdhëniet Shqiptaro-Italiane në vitet 1920-1934, Afërdita, Tiranë 2002, ISBN:99929-37-98-0
52. Chirot D: “Si Ndryshojnë Shoqëritë”, AiiS, Tiranë 2012, ISBN:978-9928-4125-0-8
53. Cassels, Alan, “Mussolini’s Early Diplomacy”, Princeton 1970
54. Çami M, “Shqipëria në Rrjedhat e Historisë 1912-1924”, Tiranë, Onufri 2007, ISBN:978-99943-42-19-8
55. Çeku E & Destani B, “Shqipëria në prag të Konferencës së Paqes”, Dokumente Historike nga Departamenti i Inteligjencës Politike Britanike, Insituti i Çështjeve Kombëtare – Tiranë & Qendra për studime Shqiptare Londër, Tiranë 2015, ISBN:978-99956-691-3-3
56. Duka V, “Histori e Shqipërisë 1912 – 2000”, Kristalina-KH, Tiranë 2007, ISBN:978-99956-650-1-2
57. Duka Gerald, “Kongresi i Berlinit dhe Shqiptarët”, Insituti i Studimeve Albanistike “Gjon Gazulli”, Mirgeeralb, Tiranë 2015, ISBN:978-9928-07-374-7
58. Dervishi K, “Historia e Shtetit Shqiptar 1912 – 2005”, Shtëpia Botuese 55, Tiranë 2006, ISBN:99943-799-3-3
59. Dupre B, “50 Ide Politike”, Plejad 2012, ISBN:978-99956-57-87-1
60. Dubrin A: “Leadership”, Houghton Mifflin Company, Neë York, 2007,
61. Dunne T & Kurki M & Smith S: “Teori të Marrëdhënieve Ndërkombëtare – disiplina dhe shumëllojshmëria”, UET Press, Tiranë 2010, ISBN:978-99956-39-32-7
62. Dako K: “Ahmet Zogu – mbret i shqiptarëve”, Tiranë 1937, Shtëpia Botonjëse “Kristo Luarasi” themeluar më 1896
63. Davutogllu A: “Thellësia strategjike – pozita ndërkombëtare e Turqisë”, Logos – A, Shkup 2010, ISBN:978-9989-58-356-9
64. Durham E, “Bregua e Ballkanit”, SHB. Naum Veqilharxhi, 1998
65. Duraku I, “Vaso Çubrilliq – Shpëngulja e shqiptarëve”, Klubi i Poezisë, GEER, Tiranë 2015, ISBN:978-9928-4261-4-7
66. Dusko Doder, “The Yugoslllavs”, New York, 1979,
67. E. M. Zenelaj, “Diplomacia e Ismail Kemal Bej Vlorës, Rivalitetet e Brendshme në Shqipëri dhe rruga e Panvarësisë 1912-1913”, burime arkivore – austrohungareze – italiane dhe osmane, Vatra, Prishtinë 2013, ISBN:978-9951-441-86-5
68. E. E. Halevy: Përzgjedhje botimesh, “Klasat & Elitat në Demokraci dhe në Demokratizim”, botimet Dudaj, Tiranë 2009, ISBN:978-99943-0-122-6
69. E. B. Plava, “Plava e Gucia në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”, Marin Barleti, Tiranë 2002, ISBN:99927-39-22-3
70. E. Kofos, Greece and Eastern Crisis 1875-1878, Thesaloniki, 1975
71. E. C. Helmreich, The diplomacy and the Balkan wars (1912-1913), Cambridge Mass. 1938
72. E.C.Helmreich; “Politika ballkanike e Austro-Hungarisë” (1912-1913), 1938
73. F. A. Muna and Z. A. Zennie: “Developing Multicultural Leaders: The Journey to Leadership Success”, First published 2010 by PALGRAVE MACMILLAN, ISBN:978-0-230-28045-8
74. Fukuyama F, “The End of History and the Last Man”, New York: Harper Perennial, 1992
75. Fukuyama F, “Fillesat e Rendit Politik”, AIIIS, Tiranë 2012, ISBN:978-9928-4062-5-5
76. F. Lico: “Probleme të marrëdhënieve Greko – Shqiptare”, Tiranë, Neriada 1977
77. Frashër K: “Ahmet Zogu – vështrim historik”, Botime M&G,Tiranë 2014, ISBN:978-9928-172-22-8
78. Frashëri K, “Lidhja Shqiptare e Prizrenit”, Vëllimi I-rë, botim 1989

79. Frashëri K, “Historia e Shqipërisë”, Tirana: 8 Nëntori, 1964
80. Frashëri K, “Historia e të majtës në Shqipëri”, Tiranë 2006
81. Francione G: “Skënderbeu një Hero Modern”, Naim Frashëri, Tiranë 2006, ISBN:99927-38-75-8
82. Fan S. Noli, Autobiografia, Prishtinë 1968
83. Fevziu B: “Para dhe pas Kamerave”, Onufri, Tiranë 1999, ISBN:99927-30-76-5
84. Fevziu B; “Ahmet Zogu”, UETPRESS, Tiranë 2014, ISBN:978-9928-190-09-3
85. Fevziu B; “Enver Hoxha”, Bot.VI-të, UETPRESS, Tiranë, tetor 2014, ISBN:978-99956-39-35-8
86. Falaschi R, “Ismail Kemal Bey Vlora – Mendimi dhe Veprimtaria nga Dokumentet Italiane”, Bardi Editore, Roma, Luglio 1985,
87. Feraj H: “Skicë e mendimit politik shqiptar”, Pegi 2006, ISBN:99943-867-7-8
88. Faik Konica, Vepra 3, Tiranë 2001
89. Fane Veizi, “Mbi Lëvizjen Kombëtare dhe Demokratike Shqiptare në vitet 1918-1924”, Tiranë 1966
90. Faensen Johannes: “Die albanische national bewegung”, Berlin, 1980
91. Frashëri Sami, Vepra, Tiranë 1978.
92. Glenn M: “Histori e Ballkanit 1804 – 1999, Nacionalizmi, Luftërat dhe Fuqitë e Mëdha”, Toena, Tiranë 2007, ISBN:978-99943-1-231-3
93. G Lee with D Elliott-Lee: “Courage - The Backbone of Leadership”, Copyright © 2006 by Gus Lee. Published by Jossey-Bass A Wiley Imprint 989 Market Street, San Francisco, CA 94103-1741 www.josseybass.com ISBN-13: 978-0-7879-8137-2
94. GJINAJ A & LILA F: “Lidershipi Shqiptar përmes Historisë së Ushtrisë”, Geer 2012, Tiranë, ISBN:978-9928-07-105-7
95. Gurakuqi L, “Shkrime dhe Kujtime”, Tiranë 1978.
96. Gaërych, George. The Crescent and the Eagle. London: I.B. Tauris, 2006
97. Heyëood A: “Politika – botim i dytë”, Dudaj, Tiranë 2008, ISBN:978-99943-0-082-2
98. Hysi G, “Organizimi i shtetit shqiptar dhe lufta politike rreth tij në vitet 1920-1924, Tiranë 1988
99. Halliday J: “Shqiptari Dinak – Enver Hoxha”, Bota Shqiptare 2012, ISBN:978-9928-00-010-1
100. Hibbert R: “Fitorja e hidhur – Lufta Nacional Çlirimtare e Shqipërisë”, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, A.Z.Çajupi, Tiranë 1993
101. Hoti R, “Gjenitë dhe Drama e Kosovës”, Infopress, Prishtinë, 2011, ISBN:978-9951-8840-0-6,
102. Hoti I, “Qëndrimi i Diplomasisë Italiane ndaj Shqipërisë dhe Shqiptarëve 1930-1941”, Insituti I Historisë – Prishtinë, Prishtinë 1997
103. Hoxha E, Referat në Konferencën e II-të Nacionalçlirimtare, vepra, vëll.1
104. Hoxha E, “Titistët”, Tiranë 1982
105. Hoxha E, “Rreziku Anglo-Amerikan për Shqipërinë”, Kujtime, ISML pranë KQ të PPSH, 8 Nëntori 1982.
106. Hoxha E, Vepra, vëll. 14, ISML pranë KQ të PPSH, 8 Nëntori, Tiranë
107. Hoxha E, Vepra, vëll. 9, ISML pranë KQ të PPSH, 8 Nëntori, Tiranë
108. Hoxha E, Vepra, vëll. 25, ISML pranë KQ të PPSH, 8 Nëntori, Tiranë
109. Hoxha E, “Hrushovianët”, Kujtime, Tiranë 1982
110. Hoxha E, “Superfuqitë”, Tiranë 1986
111. Hoxha E, Raport në Kongresin e 8-të të PPSH, Tiranë 1981
112. Ikonimi I: “Pushtimi, Ministri amerikan në Tiranë, Hugh Grand, rrëfen 7 prillin shqiptar”, UET Press, Tiranë 2014, ISBN:978-9928-4181-9-7
113. Ikonimi I: “Panvarësia – udhëtim i paharruar i Ismail Qemalit”, UET Press 2012, ISBN:978-99956-39-76-1
114. Ivetic E, “Luftërat ballkanike”, Dituria 2008, Tiranë, ISBN: 978-9943-46-60-8
115. Islami M, “Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe Çështja e Bashkimit Kombëtar”, Afërdita, Tiranë 1998, ISBN: 99927-37-09-3
116. J. S. Nye, Jr. “Soft Power, Hard Power and Leadership”, United States 2006.
117. J. S. Nye JR. “The Powers To LEAD”, Oxford University Press 2008, ISBN:978-0-19-533562-0
118. J. S. Goldstein: “Marrëdhëniet Ndërkombëtare”, Dituria 2003, ISBN:99927-59-23-2

- 119.J. O. MED: “Leadership - Essential Skills That Put You On Top”, Copyright © 2008 by Judith Orloff, Published by Sourcebooks, Inc. P.O. Box 4410, Naperville, Illinois 60567-4410, ISBN-13:978-1-4022-1691-6
- 120.Jorgaqi N, “Jeta e Fan S. Nolit”, Vol. I, Shtëpia botuese: OMBRA GVG, Tiranë, Dhjetor 2005, ISBN:978-9928-123-48-0
- 121.Jorgaqi N, “Udhëtim me Fan Nolin”, Tiranë: Dituria, 1994
- 122.Jorgaqi N, “Letërkëmbimi i Fan Nolit”, Tiranë: Botime Erik 2012, ISBN:978-9928-123-48-0
- 123.John Lewis Gaddis, “The United States and the End of the Cold War”, New York, 1992
- 124.John J. Mearsheimer: “Përse gënjejnë politikanët”, AIIS, Tiranë 2011, ISBN:978-9928-4062-1-7
- 125.J.B. Duroselle & Andre Kaspi: “Historia e Marrëdhënieve Ndërkombëtare – Vëllimi I, nga viti 1919 deri më 1945”, Lira, Tiranë 2011, ISBN:978-99956-801-3-8
- 126.J.B. Duroselle & Andre Kaspi: “Historia e Marrëdhënieve Ndërkombëtare – Vëllimi II, nga viti 1945 deri ditët e sotme”, Lira, Tiranë 2011, ISBN:978-99956-801-7-6
- 127.J. B. Duroselle, “Europe: A History of Its People”, ISBN:9780670829224, London, Viking, 1990.
- 128.J. L. Gaddis, “The United States and the End of the Cold War”, New York, 1992
- 129.John Lewis Gaddis, “The United States and the End of the Cold War”, New York, 1992
- 130.Kissinger H: “Diplomacia”, Laert, Tiranë 1999, ISBN:99927-634-0-X
- 131.Kissinger H, “Amerika’s Permanent Interests, U.S.Departments of State Bulletin, Vëll. LXXIV, nr.1919, 5 prill 1976
- 132.Kinross P: “Ataturku – Rilindja e një Kombi”, Botimet 55, ISBN:978-9928-106-23-0
- 133.Kuaroni P, “Valiçja Diplomatike”, Albinform, Tiranë 1993
- 134.Keka Gj : “Ibrahim Rugova–Lidership i idealeve të mëdha”, Botart, Tiranë 2011, ISBN:978-9928-116-12-3
- 135.Kennedy, P, The Rise and Fall of Great Powers, New York: Vintage Books, 1987. ISBN:0679-720197.
- 136.Kval-Mellbye-Tranov, “Politika dhe Diplomacia”, Onufri, 2006, ISBN:99943-32-96-1
- 137.Konica F, “Albania, the Rock Garden of Southeastern Europe”, Boston, G.M.Panariti, 1957
- 138.Laqueur W: “Europa në kohën tonë, 1945 – 1992”, Dituria 1996 & 2003, ISBN:99927-59-151
- 139.Lory B: “Europa Ballkanike nga 1945 në ditët tona”, Dituria 2007, ISBN:978-99943-46-30-1
- 140.Langlois L: “The Anatomy of Ethical Leadership”, Published by AU Press, Athabasca University 2011 , ISBN:978-1-897425-74-9
- 141.Logoreci A, “The Albanians: Europea’s Forgotten Survivors”, London: Victor Gollancz, 1977, fq 55
- 142.L. J. Cohen: “Milosheviç – Misteri i Pushtetit”, AIIS, Tiranë 2010, ISBN:978-9928-4003-6-9
- 143.Lushaku H: “Qeveria e Përkohshme e Vlorës”, Urtësia Bektashiane,Tiranë 2013, ISBN:978-9928-05-140-0
- 144.M. G. Schmidt: “Teoritë e Demokracisë”, Tiranë, Botart 2012, ISBN:978-9928-116-18-5
- 145.Mazower M, “Ballkani – një histori e shkurtër”, Skanderbeg book 2003, ISBN:99927-817-4-2
- 146.Mousset A, “Shqipëria përballë Europës”, Dituria, Tiranë 2004, ISBN:99927-59-42-9,
- 147.M C Kelmendi: “Shanci Gjerman dhe Shqiptarët”, Naimi 2014, ISBN:978-9928-109-56-9
- 148.Maxhuni S, “Konspiracioni antishqiptar Sllavo-Grek”, Prishtinë, 2011, ISBN:978-9951-585-29-3
- 149.Milo P, “Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927, Tiranë 1992.
- 150.Masar Kodra, “Fan Noli-Në rrjedhat politike të shoqërisë shqiptare, 1905-1945”, Prishtinë: Rilindja 1990
- 151.Moisi D: “Gjeopolitika e Emocioneve”, AIIS, Tiranë 2010, ISBN:978-9928-4003-0-7
- 152.Mehmetaj F, “Veprimtaria kriminale e ‘Dorës së Zezë’ serbe në trojet shqiptare, Prishtinë, 2004
- 153.Naska. K, “Shën Naumi dhe diplomacia e kohës”, Tiranë 2012
- 154.N C. Guy, “Lindja e Shqipërisë – Nacionalizmi Etnik, Fuqitë e Mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Panvarësisë Shqiptare”. Botime Pegi, Tetor 2012, ISBN:978-9928-162-17-5
- 155.Novruz Zejnati: “Esad Toptani- ti japim gjeneralit atë që kërkon”, Reklama, Tiranë 2012, ISBN: 978-9928-125-68-2
- 156.Ndreca M, Ballkani Perëndimor në kontekstin e sfidave të (dez)integritit, Tiranë 2010,
- 157.Neuwirth H, “Qëndresë dhe Bashkëpunim në Shqipëri, (1939-1944)”, IDK, Tiranë 2006, ISBN:99943-832-1-3

158. Novosela S, "Kosova 75' – Proçesi i Prishtinës i vitit 1975", LOGOS.A 2012, ISBN:978-9989-58-437-4
159. Noli F "Autobiografia", Prishtinë 1968
160. Omari L, "Sistemi parlamentar", Tiranë 1994
161. Peter G. Northouse: "Leadership Theory and practice • Sixth Edition", Copyright © 2013 by SAGE Publications, Inc. Library of Congress Cataloging-in-Publication Data, United States of America, ISBN:978-1-4522-0340-9,
162. P. Pastoreli, "Italia e Albania 1924-1927", Firenze 1967, p.34.
163. Puto A: "Shqipëria Politike 1912 – 1939", Toena, Tiranë 2009, ISBN:978-99943-1-467-6
164. Puto A: "Historia Diplomatike e Çështjes Shqiptare 1878-1926", Albin, Tiranë 2003, ISBN:99927-51-42-8
165. Puto A: "Nëpër analet e diplomacisë Angleze", Albin, Tiranë 2001, ISBN:99927-51-00-2
166. Puto A: "Pavarësia Shqiptare dhe Diplomacia e Fuqive të Mëdha, 1912-1914", 8 Nëntori, Tiranë 1978.
167. Puto A: "Demokracia e Rrethuar", 8 Nëntori, Tiranë 1990
168. Puto A, Çështja Shqiptare në Aktet e periudhës së imperializmit, 1878-1912, 8 Nëntori, Tiranë, 1984.
169. Pipa A, "Fan Noli as National and International Albanian figure", Sudost Forschungen 1984
170. Pipa A, The Politics of Language in Socialist Albania. Boulder: East European Monographs, Distributed by Columbia University Press, 1989
171. Pipa A "ad memorandum 1", "Stalinizmi Shqiptar – anatomia e një patologjie politike", IKK & Princi, Tiranë 2007, ISBN:978-99956-632-0-9
172. Prishtina H. Vepra, ASH e RPSSH, Tiranë, 1984.
173. Prifti K, "Doktor Ibrahim Temo-Jeta dhe Vepra, 1865-1945, Prishtinë 1996
174. Qosja R, "Fan S. Noli - (1882-1965)". Gjurmime Albanologjike. 1 (1969); 196-238
175. Qosja R, "Strategjia e Bashkimit Kombëtar", Vëllimi 24, Insituti Albanologjik 2010, ISBN:978-9951-411-95-0 & 978-9951-596-26-8
176. Qosja R, "Porosia e Madhe", Toena, Tiranë 2000, ISBN:99927-1-337-2
177. Qemali I, "Kujtime", Botimet Toena, Tiranë, 2009, ISBN:978-99943-1-558-1
178. Rama B, "Faktori shqiptar dhe siguria rajonale", Geer, Tiranë 2011, ISBN:978-9928-07-000-5
179. R. A. Dahl "Poliarkia – Pjesëmarrja dhe Opozita", Pegi 2005, ISBN:99943-693-0-X
180. Rickards T and Clark M: "Dilemmas of Leadership", First published 2006 by Routledge 2 Park Square, Milton Park, Abingdon, Oxon OX14 4RN, USA, ISBN:0-203-00226-1
181. Roussel E: "Gjeneral De Gol – Historia e jashtëzakonshme e liderit të Francës moderne", Botart 2012, Tiranë, ISBN:978-9928-116-21-5
182. R. J. Stevenson: "Political Development in Albania, 1920-1939" Uashington, D.C. June 1954
183. R. J. Stevens: "Zhvillimet politike në Shqipëri 1920 – 1939", Geer 2004, ISBN:99927-946-4-X
184. R. D. Kaplan: "Fantazma e Ballkanit", Plejad, Tiranë 2011, ISBN:978-99956-57-65-9
185. R. C. Austin, "Shtegu i pashkelur i Fan Nolit", Albin, Tiranë 2003, ISBN:99927-32-59-8,
186. Rich N; Diplomacia e Fuqive të Mëdha, 1814 – 1914, ID&K, Tiranë, Toena 2006, ISBN:99943-1-199-9
187. Richard D. Levis: "When Cultures Collide – Leading Across Cultures, third edition", Nicholas Brealey International, London 2013, ISBN:978-1-904838-02-9
188. Rose G & Tepperman J: "Përplasja e ideve", AIIS, Tiranë 2012, ISBN:978-9928-4062-6-2
189. Robert Michels, Zur Soziologie des Parteiwesens in der modernen Demokratie (Stuttgart:Kröner, 1911/1989).
190. R. E. Giuliani: "Udhëheqja", Dudaj, Tiranë 2006, ISBN:99943-33-81-X
191. R.F. Byrnes, "East-Central Europe Under the Communists", New York 1958
192. Robinson V, "Albania's Road to Freedom", London 1941
193. S. D. Sazonov: "Kujtime", (1910-1916) Botues Helga's Secrets, ISBN 978-9928-4022-8-8
194. Shpuza G, "Ataturku dhe Shqiptarët", Dituria, Tiranë 1994
195. Susan Butler & Artur Achlesinger, Jr: "I dashur Stalin... letërkëmbimi i plotë i Franklin D. Ruzveltit dhe Josif V. Stalinit", Kristalina - KH, Tiranë 2006, ISBN:99943-37-26-2

- 196.S.P. Huntigton: “Vala e Tretë – Demokratizimi në fund të shekullit të njëzetë”, AIIS, Tiranë 2011, ISBN:978-9928-4062-4-8
- 197.S.P. Huntigton: “Përplasja e Qytetërimeve dhe ribërja e rendit të ri botëror”, Logos-A 2009, ISBN:9989-58-284-X
- 198.Syla S, “Shteti shqiptar dhe Çështja e Kosovës 1939-1981”, Insituti I Historisë – Prishtrinë, Prishtinë 2012, ISBN:978-9951-409-32-2
- 199.Shala B & Halili LL & Reka H, “Unë, Ramiz Alia Dëshmoj për Historinë”, Dituria, Botim II-të, Tiranë 1993
- 200.Sadiku Xh: “Shqipëria 1878-1928, Roli i Elitës Politike”, Tiranë, Mirgeerald 2014, ISBN:978-9928-07-257-3
- 201.Stavro Skendi, “The Political Evolution of Albania”, New York, 1954
- 202.Shpuza S, “Revolucioni Demokratiko-Borgjez i Qershorit 1924 në Shqipëri”, Tiranë 1959
- 203.Sëire J, “Albania - The Rise of a Kingdom”, New York: Arno Pree, 1971
- 204.Selenica T, “Shqipëria më 1923”, Tiranë: Ministria e Brendshme, 1923
- 205.Selenica T, “Shqipëria më 1927”, Tiranë Ministria e Brendshme, 1928
- 206.Saraçi Ç, “Zogu i Shqiptarëve. Një histori e jetuar”, Tiranë 2006
- 207.Shuflai M: “Serbët dhe Shqiptarët”, Bargjini, Prishtinë 2001
- 208.Tracy Brian: “Lidershipi”, Botime Damo, Prishtinë 2014, ISBN:978-9951-642-27-9
- 209.Tracy Brian: “Delegimi & Mbikqyrja”, Botime Damo, Prishtinë 2013, ISBN:978-9951-642-12-5
- 210.Vasa P, Poezia, “O moj shqypni”, Historia e Letërsisë Shqipe, ASH e RPSSH, Tiranë, 1980.
- 211.P. Vasa, Përmbledhje shkrimesh, Tiranë, 1982.
- 212.Vllamasi S, “Ballafaqime Politike në Shqipëri 1897-1942”, Vllamasi, Tiranë 2012, ISBN:978-9928-140-54-8
- 213.Vinca A, “Shqiptarët mes Mitit dhe Realitetit”, Shkupi, Shkup 1997, ISBN:9989-720-12-6
- 214.Vlora E, “Kujtime 1885-1925”, Botimi i II-të, IDK, Tiranë, ISBN:99927-780-6-7
- 215.Xhunga R: “Fletorja e Luftës 70 vjet, LANÇ – Shqipëria, hera e parë në anën e duhur”, Guttenberg, Tiranë 2014, ISBN:978-9928-176-02-8
- 216.“Zog I, Me jetue në shekullin e sotëm”, Shtëpia Botuese “Dardania”, Tiranë 1995
- 217.Zejnati N: “Ahmet Zogu – politikan apo ushtarak”, Shtëpia botuese Reklama, ISBN:978-9928-125-36-1
- 218.Zhelyazkova A: “Albania and the Albanian Identitiers, IMIR, Sofia 2000
- 219.Zavalani T, Histori e Shqipnisë, Tiranë, 1998
- 220.Marrëdhëniet shqiptaro – jugosllave 1945-1948, DOKUMETE, shtypur “Gjergj Fishta”, Tiranë 1996
- 221.Forumi i Intelektualëve të Shqipërisë, “Zëri i Inteligjencës për Çështjen Kombëtare”, EURORILINDJA, Tiranë 1995

Leksione & Studime

1. Ramsfeld’s Rules Leadership – Lessons in Business
2. Richard Stengel, “Mandela: His 8 Lessons of Leadership”, Time Magazine, July 9, 2008,
3. Stogdill.R.M.(1974). Handbook of leadership: A survey of theory and research. New York: Free Press
4. Holland, Thomas Erskine (1898), “The Execution of the Treaty of Berlin”, Studies in International Law, Oxford: Clarendon Press, p. 227, retrieved 2013-02-02.
5. Mind tools – Leadership skills pdf
6. Spenser Herbert (1840), Fred Fidler, Viktor Vroom, Filip Yetton (1973), Artur Jago (1988).
7. Lao Tzu, Tao Te Ching: A Neë Version, with foreword and notes by Stephen Mitchell (London: macmillan, 1988),
8. Teoricienë si Fleishman 1991, Kozlowski 1996, Hackman dhe Walton 1986, Zaccaro 2001;

9. Teoricienë si Herbert Spenser (1840), Fred Fidler, Viktor Vroom, Filip Yetton (1973), Artur Jago (1988); Kevin Mick, David MakKleland, Bërd, Stgdill dhe Mann (1940-1959), Thomas Karlile, dhe Francis Galton.
10. Vico Montegazza, "Questioni di Politika Estera", Milano 1914,
11. Aleksandër Lambert: Besa Info. 1 dhjetor 2007
12. Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj, Tiranë, 1963, dokument 16,
13. H.N.Brailsford, Macedonia, its Races and their Future, Londer 1906,
14. J.S.Barnes,"Ahmet Zogu, King of Albanians", English Review, mars 1929
15. Russian: - ; Peace of San-Stefano, - ; Peace treaty of San-Stefano, Turkish: Ayastefanos Muahedesi or Ayastefanos
16. Holland, Thomas Erskine (1898), "The Execution of the Treaty of Berlin", Studies in International Law, Oxford: Clarendon Press, p. 227, retrieved 2013-02-02.
17. Akademia e Shkencave, Mendimi Politik e Shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Përmbledhje Artikujsh, 1908-1910, Tiranë 1976
18. L. S. Stavrianos, The Balkans since 1453, Neë York 1961
19. P. N. Pipinelis, Europe and Albanian Question, Chicago, 1963,
20. Prishtina H, Një shkurtim kujtimesh mbi kryengritjen shqiptare të vitit 1912, Bari, 1925, BK, me shifër S53R27
21. I. Broënlie,"Principles of Public International Laë", (7 th. ed. Oxford University Press, Oxford 2008),
22. George Ë Gaërych 1980 & Stavro Skëndi 1967
23. Prishtina H 1921: 5; Kondis 1976: 65; Gjukë 1991: 20
24. Vico Montegazza, "Questioni di Politika Estera", Milano 1914
25. Noel Malcolm, A short History of Kosovo
26. Hall, Richard, The Balkan Wars 1912-1913
27. Antonio Baldaçi, "Studi Speciali Albanesi", I, Roma, 1932
28. E.C.Helmreich; "Politika ballkanike e Austro-Hungarisë" (1912-1913)
29. Sir F.Cartwright to Sir Edward Gray, Vienna, British Dokumenti on the Origins of the War,
30. Lefter Dilo, "Ligjëron Fan Noli", Përmbledhje, Tiranë: Ismail Mal'Osmani, 1944,
31. Department of state, Merrit-Sëift to Secretary of State, 30 November 1923. 875,00/107
32. FO 371/10658 (C4115/4115/90) Tiranë 8 mars 1925
33. Fan S. Noli, "Faqe të panjohura-artikuj dhe shënime publicistike, 1915-1919", Tiranë 2002
34. P. Fauchile, Traite de droit international public, I partie, Paris, 1922
35. Ë. Bland, J. Price, A. Tangeled Web
36. The Assembly of Lusnia". n.d., Herbert MSS, DD/DRU; O.Pearson, Albania, I
37. Hofmeister W & Grabow K: Partitë Politike - Funkzioni dhe organizimi në shoqëritë demokratike, 1998
38. In this regard the Konrad-Adenauer-Foundation has collected some useful information and tips in a manual: KAS (Hrsg.), Handbuch Politische Kommunikation, (Belgrad, 2006).
39. Otfried Jarren and Patrick Donges, Politische Kommunikation in der Mediengesellschaft: Eine Einführung (Ëiesbaden: Verlag für Sozialëissenschaften 2. überarbeitete Auflage, 2006), S. 236.
40. Karl-Rudolf Korte and Manuel Fröhlich, Poltiik und Regieren in Deutschland (Paderborn: Schöningh, 2. Aufl., 2006), S. 188.
41. Hans Mathias Kepplinger and Marcus Maurer Abschied vom rationalen Wähler: Warum Wahlen im Fernsehen entschiedenwëerden (Freiburg/München: Verlag Karl Alber, 2005), S.188.

Gazeta & Raporte & Dokumente

1. Gazeta "Dielli", Nr. 42, datë 14 janar 1910
2. Konica F, "28 Vjesht'e Tretë 1912", Gazeta Kuvendi, Romë, 30 nëntor 1919
3. Gazeta "Corriere d'Italia, 20.1.1911; Intervista col deputato hessad pascia,

4. Kombi, Weekly Albanian Newspaper, Moti i Parë, Boston. Mass. Saturday, July, 15, 1906
5. Kombi, Weekly Albanian Newspaper, Moti i Parë, Boston. Mass. Nr.101, September, 11, 1908
6. Gazeta "Liri e Shqipërisë", datë 30, Vjeshtë III, 1912.
7. Faik Konica, "28 Vjeshtë e Tretë 1912", Gazeta Kuvendi, Romë, 30 nëntor 1919
8. Gazeta Il Piccolo, Trieste, 20 nëntor 1912,
9. Gazeta "Populli", 6 shkurt 1919
10. Stephane Lauzanne, "Les Beneficiaires de la guerre" Le Martin, 4 dhjetor 1912.
11. L.Iliescu, "Interview cu Ismail Kemal bey", Universul, 6 nëntor 1912
12. "Statement by Count Berchtold", Times, 6 nëntor 1912,
13. Dokumenta e Materiale Historike nga Lufta e Popullit Shqiptar për Liri e Demokraci 1917-1941, Botim i Drejtorisë së Arkivave Shtetërorë të R. P. SH. Tiranë 1959
14. Statuti Themeltar i Mbretërisë, botuar në përmbledhjen Ligje, Dekrete e Rregullore, Tiranë 1939
15. I. Broënlie, "Principles of Public International Law", (7 th. ed. Oxford University Press, Oxford 2008),
16. Raporti i nënkonsullit austro-hungarez, Halla në Durrës, drejtuar MPJ Vjenë, 23 korrik 1908
17. Braun për Berchtold, 8 nëntor 1912, HHStA,PA, Nr,4315
18. Raport i agjentit të Policisë dhe Sigurimit të Përgjithshëm, Bukuresht, 25 tetor/7 nëntor 1912.
19. Pallavicini, "Bericht aus Konstaninopel", 30 maj 1910, osterreich-Ungarns Aussenpolitik, vëll.2, f.880. Nr.2187 & Pallvicini për Aehrenthal, 13 shkurt 1912, HHStA,PA XIV, Albanien V6, Nr.10 & Pallavicini, "Privatschreiben aus Konstantinopel", 3 dhjetor 1912, Osterreich-Ungarns Aussenpolitik, vëll.5, f.21. nr.4755 and Weinzell për Aehrenthal, Cetinë, 14 qershor 1911,HHStA,nr.128
20. Berchtold, telegram i shifruar për von Merey, Romë 22 nëntor 1912, Nr.196, HHStA, 3438
21. Tel. i Berchtold-it, dt.22XI-1912, HHStA.PA.XII Turkey XXXXV/b Karton 417
22. Documents of British Foreign Policy 1919-1939, London, 1962, I, vo.IV, dok.18
42. AQSH, FO.99, Viti 1912, Dosja 195, fl.4;
43. AQSH, Fan Noli – Fondi Personal. F. 14, D. 19 & AQSH, M.P.B. –Periudha e Zogut, V. 1923, D.6
44. AQSH,F.20, D2/3,fl.296 & AQSH, Fondi Personal-Fan Noli, F. 14, D.89, fq 1 (Programi i Kabinetit)
45. Treaty of Berlin, Protocol, No. 13, 1878.
46. Treaty of Berlin, Article 28, 1878.
47. Protocol of Istanbul, 1880.
48. AQSH, Fondi 20, Dosja 1, 2 & AQSH,F.20, D2/3,fl.296 & AQSH, FO.99, Viti 1912, Dosja 195, fl.4;
49. Proçesverbali i Mbledhjes së Bukureshtit, më 23/5 vjeshtë e tretë 1912
50. Prof. Orazio Iriami, "Risveglio Albanese", New York 1911
51. Antonello F.M. Biagini, "Momenti di Storia Balcanica 1878-1914", aspetti militari, Roma 1981
52. Sbornik sekretnih diplomateskih dokumentov bivsh. Imperatorskovo Sossijkovo Ministerstrua Inostrannih Djell, Moskva 1922,
53. Gianni Baj Macario, "Balcani 1912-13", 1937 – XV. 1
54. Hysni Myzyri, Nuri Naci, Tiranë, 1986
55. AS, MID, PO, Konf. 580, 20.IV.1910; Legata e Stambollit, Konf. 151, 15.IV.1910
56. Raporti i nënkonsullit austro-hungarez, Halla në Durrës, drejtuar MPJ Vjenë, 23 korrik 1908
23. HHSTA,PA,Karton 417, Liasse XIV/6o, 6b,6c.(Tel.i konsullit austro-hungarez Rudney nga Durrësi,dt 21.11.1912)
24. Proçes-verbal i Mbledhjes I-rë të Kuvendit Kombëtar në Vlorë më 28.XI.1912
25. "Qeveria e Përkohëshme e Vlorës", dosje nr 16
26. P. Fauchile, Traite de droit international public, I partie, Paris, 1922
27. Raporti i Komisionit mbi veprimtarinë e tij në Shqipëri deri 20.12.1921. SDN Journal Officiel, III annee, Janvier 1922
28. League of Nations-official Journal, May 1925, V.6, No.5
29. Official Journal – League of Nations, V.4, 1923
30. Gazeta e Korçës, 1 dhjetor 1923

31. Gazeta Politika, 2 tetor 1924
32. Shqiptari i Amerikës, 4 mars 1924
33. Faik Konica, “Dielli, datë 14 qershor 1924, faqe 316-318
34. Fan S. Noli, “The Adriatic Review”, september 1918
35. Department of state, Merrit-Swiift to the Secretary of State, 30 November 1923. 875,00/107
36. Department of State, Grand-Smith to the Secretary of State, no.287, 16 June 1924, 875.00/151
37. Gazeta Dielli, 4 nëntor 1924
38. Department of State, Grand-Smith to the Secretary of State, no.287, 16 June 1924, 875.00/151
39. Gazeta “The Times”, 7 June 1924
40. FO 371/10658 (C4115/4115/90) Tiranë 8 mars 1925
41. L.Iliescu, “Interview cu Ismail Kemal bey”, Universul, 6 nëntor 1912,
42. “Statement by Count Berchtold”, Times, 6 nëntor 1912,
43. Braun për Berchtold, 8 nëntor 1912, HHStA,PA, Nr,4315. 7
44. Raport i agentit të Policisë dhe Sigurimit të Përgjithshëm, Bukuresht, 25 tetor/7 nëntor 1912.
45. Declarations de M.Pachitch”, Le Temps, 8 nëntor,1912,

Linke (webside)

1. PoliticsasaVocation,http://www.ne.jp/asahi/moriyuki/abukuma/weber/lecture/politics_vocation.html
2. <http://www.time.com/time/world/article/0,8599,1821467,00.html>
3. <http://www.businessballs.com/leadership-theories.htm>
4. <https://en.wikipedia.org/wiki/Leadership>
5. http://www.ripublication.com/gjmbs_spl/gjmbsv3n3spl_14.pdf
6. www.danieletrevisani.com/...for_leaders/leadership_power_profiles.htm
7. https://en.wikipedia.org/wiki/Donald_McGannon
8. <https://depts.washington.edu/.../ESR-2011-Leadership-is-Action>.
9. [Wikipedia.org/wiki/Skanderbeg's_italy](http://en.wikipedia.org/wiki/Skanderbeg's_italy) (Vatican Enciclopedia)
10. <http://fishmedia.info/lajme/marveshja-mes-zogut-dhe-pashiqit/#sthash.XMUjZgfY.dpuf>
11. www.josseybass.com
12. <https://depts.washington.edu/.../ESR-2011-Leadership-is-Action>.